

ENVER HOXHA

VEPRA

20

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

20

JANAR 1961 – PRILL 1961

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1976

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 20-të

Vëllimi i 20-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin dokumente që i përkasin periudhës janar-prill 1961. Këto dokumente, shumica e të cilave botohen për herë të parë, janë shkruar në një kohë kur vendi ynë sapo kishte hyrë në planin e tretë pesëvjeçar, ndërsa në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, revizionistët modernë me revizionistët hrushovianë në krye kishin intensifikuar veprimtarinë përçarëse, presionet e shantazhet dhe luftonin për të organizuar një bllok kundër partive marksiste-leniniste që kundërshtonin revizionizmin.

Në këto kushte PPSH e quante detyrë të dorës së parë të mbronte me vigjilencë dhe të zbatonte me vazhdimësi vijën e saj revolucionare, teorinë dhe praktikën marksiste-leniniste të ndërtimit socialist, të konsolidonte fitoret e arritura, të mbronte dhe të propagandonte parimet themelore të marksizëm-leninizmit që ishin vënë në shenjë nga revizionistët modernë.

Ngjarja më e shënuar e kësaj periudhe, së cilës i kushtohet shumica e materialeve të këtij vëllimi, është Kongresi IV i PPSH, që u zhvillua më 13-20 shkurt 1961. Ky Kongres, duke bërë bilancin e shndërrimeve të thella që kishin ndodhur në vendin tonë, erdhi në përfundimin

se në RPSH ishte ndërtuar baza ekonomike e socializmit si në qytet ashtu edhe në fshat dhe se tani Shqipëria hynte në një etapë të re historike — në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Kongresi diskutoi dhe miratoi gjithashtu direktivat e planit të tretë pesë-vjeçar (1961-1965) të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH.

Materialet e përfshira në këtë vëllim, veçanërisht raporti historik dhe fjala e mbylljes në Kongres, fjala në Plenumin I të KQ të Partisë, bisedat me delegacione të partive komuniste e punëtoare që morën pjesë në Kongres etj., janë pasqyrë e qartë e analizës së thellë marksiste-leniniste dhe e përgjithësimeve shkencore që i bënte PPSH dhe shoku Enver Hoxha përvojës revolucionare të ndërtimit socialist të vendit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, flasin për trajtimin marksist-leninist të problemeve të mëdha, siç janë roli udhëheqës i klasës punëtoare dhe i partisë së saj, diktatura e proletariatit, zhvillimi i pandërprerë i luftës së klasave, si edhe për problemet e revolucionit e të kalimit revolucionar në socializëm, e luftës kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern etj.

Kongresi IV i PPSH që një goditje tjetër e fuqishme kundër pikëpamjeve antimarksiste dhe veprimtarisë e synimeve armiqësore të revizionistëve modernë. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe pasuesit e tyre shpresonin se Kongresi IV i PPSH nuk do ta miratonte veprimtarinë e delegacionit të PPSH në Mbledhjen e Moskës të nëntorit 1960, ëndërronin që udhëheqja të izolohej nga masa e Partisë dhe ngjarjet të ktheheshin në dobi të tyre. Për këto qëllime sabotuese e komplot

tiste kishin ardhur delegacionet e PK të BS e të disa partive të tjera në Kongresin IV të PPSH.

Por ndodhi krejt e kundërta. Kongresi IV i PPSH, duke miratuar njëzëri raportin historik të mbajtur nga shoku Enver Hoxha si dhe veprimtarinë e delegacionit të PPSH në Mbledhjen e Moskës të 81 Partive komuniste e punëtorë, tregoi unitetin e çeliktë të Partisë së Punës të Shqipërisë, pjekurinë, guximin dhe trimërinë marksiste-leniniste, shpirtin e saj luftarak. Ai shprehu vendosmërinë e papërkulur për të ecur kurdoherë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

Në Kongresin IV të saj, PPSH u tregua e përmbajtur dhe nuk nxori në shesh botërisht veprimtarinë revizioniste të udhëheqësve revizionistë sovjetikë dhe të pasuesve të tyre. Por ajo u dha përgjigjen që meritonin veprimeve antimarksiste e komplotuese të të dërguarve të udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe shërbëtorëve të tyre. Delegatët e Kongresit, duke ruajtur gjakftohtësinë, i vunë me shpatulla në mur provokatorët dhe u bashkuan plotësisht jo vetëm me raportin e Komitetit Qendror, por edhe me diskutimet e udhëheqësve të Partisë e të delegatëve të tjerë të Kongresit, që kishin të gjitha të njëjtën frymë uniteti ideologjik e organizativ marksist-leninist, sikundër edhe raporti.

Në shkrimet e botuara në këtë vëllim një kujdes dhe vëmendje e posaçme u kushtohet problemeve të mprehjes së vigjilencës revolucionare dhe forcimit të gatishmërisë dhe të aftësisë mbrojtëse të atdheut. Partia dhe shoku Enver i dërrmuan përpjekjet e revizionistëve sovjetikë për të dobësuar fuqinë mbrojtëse të RPSH dhe për të përdorur Traktatin e Varshavës si vegël presioni

e dhune, shkatërruan komplotin e përbashkët imperialisto-revizionist të kurdisur kundër RPSH, të shoqëruar me manovra provokuese të Flotës VI amerikane në ujërat e Mesdheut e të Adriatikut, si dhe me mbështetjen e kamufluar të udhëheqjes sovjetike. Shkatërrimi i planeve të armiqve u sigurua në saje të gatishmërisë së plotë të masave punonjëse për mbrojtjen e fitoreve të arritura, të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut.

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim zënë problemet që kanë të bëjnë me zbërthimin, kuptimin dhe me mobilizimin e përgjithshëm për vënien në jetë të detyrave të mëdha e të vështira që shtroi Kongresi IV historik. Komiteti Qendror i Partisë dhe shoku Enver Hoxha, duke parë se revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre po e dendësonin veprimtarinë sabotuese e antishqiptare dhe po kalonin drejt organizimit të kompleteve e bllokadave, porosin të përgatiteshim në mënyrë të gjithanshme për t'u bërë ballë këtyre kompleteve e bllokadave, të merreshin mirë në dorë çështjet ekonomike, të kuptoheshin ato politikisht dhe të kapërceheshin me guxim e heroizëm gjithë vështirësitë për ta realizuar planin në të gjitha drejtimet, duke u mbështetur në forcat e veta si dhe në përkrahjen internacionaliste të forcave revolucionare botërore, sidomos të RP të Kinës, e cila u tregua e gatshme për të ndihmuar RPSH në ato çaste të vështira. Në rend të ditës qëndronte porosia që komunistët të zhvillonin një punë të gjithanshme sqaruese, bindëse, edukative me masat, me qëllim që të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, të ngriheshin në këmbë për të realizuar me sukses detyrat e mëdha e të lavdishme që shtronte etapa e re e zhvillimit socialist.

Dokumentet që përfshihen në vëllimin e 20-të të Veprave të shokut Enver Hoxha kanë një rëndësi të madhe teorike dhe praktike. Si të gjitha veprat e tjera të tij, ato janë armë në duart e komunistëve, të kuadrove dhe të masave punonjëse dhe shërbejnë si një flamur pune dhe lufte për të mobilizuar të gjitha forcat mendore, fizike dhe organizative në shërbim të Partisë, të atdheut e të socializmit, për të mbrojtur me vigjilencë parimet e marksizëm-leninizmit, për të çelikosur e për të çuar më tej fitoret e arritura në ndërtimin e shoqërisë së re socialiste.

ÇDO LËSHIM NË PARIME ÇON NË DEGJENERIMIN E PARTISË E TË DIKTATURËS SË PROLETARIATIT

*Nga fjala e mbylljes në Konferencën VIII të organizatës
së Partisë të kryeqytetit¹*

6 janar 1961

Dëshiroj të shfaq edhe unë pikëpamjen time, të shokëve të Byrosë Politike dhe të presidiumit të kësaj konference.

Konferenca VIII e organizatës së Partisë të Tiranës i zhvilloi punimet në një nivel të lartë politik e ideologjik. Kjo tregon pjekurinë e madhe të komunistëve të kryeqytetit. Konferencat e organizatës së Partisë të Tiranës kanë qenë kurdoherë të zjarra dhe janë karakterizuar nga një frymë luftarake. Entuziazmi dhe vendosmëria e komunistëve të Tiranës, si kudo në Shqipëri, kanë ardhur vazhdimisht duke u ngritur. Kështu do të ndodhë përherë, sepse në këtë proces ngritjeje është bërë edhe zhvillimi i gjithanshëm i intelektit dhe i ndërgjegjes së komunistëve. Kjo i detyrohet punës së

¹ Kjo konferencë u zhvillua prej datës 4 deri 6 janar 1961.

madhe edukative të Partisë dhe luftës që kanë bërë vetë komunistët në jetë, për të vënë në zbatim vijën e Partisë. Prej kohësh organizata e Partisë e kryeqytetit, në këtë drejtim, është në pararojë të organizatave të rretheve të tjera të Shqipërisë.

Faktet tregojnë se ndërmarrjet ekonomike, institucionet arsimore e kulturore kanë arritur rezultate të mira në plotësimin e detyrave të ngarkuara. Prandaj ne mburremi me punëtorët, teknikët dhe inxhinierët e ndërmarrjeve ekonomike të Tiranës, sepse pothuajse të tërë e kanë realizuar me sukses planin pesëvjeçar në të gjitha drejtimet. Ne konstatojmë me kënaqësi, sikurse raporto i këtu edhe shoqja Fiqret [Shehu], se shumë organizata e kanë filluar mjaft mirë punën edhe për vitin e ri.

Ne shohim, gjithashtu, se niveli teknik e kulturor i punëtorëve tanë është ngritur më tepër. Shumë nga ata që disa vjet përpara ishin punëtorë të thjeshtë, tani janë jo vetëm teknikë të mesëm, por edhe inxhinierë. Këtu diskutuan mjaft nga ata që më parë ishin punëtorë të thjeshtë, por që me luftën dhe me përpjekjet e tyre, duke shfrytëzuar si duhet mundësitë që u ka dhënë Partia, janë bërë shembull në këtë drejtim. Kjo u duk edhe në mënyrën se si u fol këtu, jo vetëm nga pikëpamja e entuziazmit dhe e vendosmërisë së diskutantëve për vijën e Partisë, por edhe nga përmbajtja e thellë e diskutimeve të tyre. Kjo ka shumë rëndësi dhe është një fitore e madhe e Partisë që krijoi, edukoi dhe kaliti një klasë punëtore të tillë, e cila po rritet jo vetëm në Tiranë, por kudo në Shqipëri. Prandaj, kjo na gëzon se është siguria më e madhe për forcimin e

për kalitjen e pushtetit tonë popullor, është siguria për realizimin e fitoreve të ardhshme, të cilat do të jenë edhe më të mëdha se deri tani, është siguria për ndërtime me sukses të socializmit dhe për ecjen e pandalshme drejt komunizmit. Klasa jonë punëtore i jep tonin gjithë jetës së vendit. Prandaj i gjithë populli dhe Partia jonë janë krenarë për klasën tonë punëtore.

Partia jonë ka një pjekuri të madhe. Kjo pjekuri nuk varet nga pjekuria e dy, pesë ose dhjetë njerëzve, por nga ngritja e nivelit të të gjithë komunistëve. Kur ne shkuam në Mbledhjen e Moskës dhe mbrojtëm atje marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar, kishim parasysh Partinë tonë që na ka mësuar dhe na ka edukuar. Prandaj, kur ne flisnim, pavarësisht se kishite njerëz që nuk i hopenpsnin pikëpamjet tona të drejta, ishim të bindur në drejtësinë e qëndrimit tonë, prandaj as nuk na trembej syri, sepse dinim që mbrojmë një çështje të drejtë, ishim të bindur që komunistët e vërtetë do ta aprovonin vijën e drejtë të Partisë sonë dhe se ne kishim rreth vetes gjithë Partinë tonë heroike.

Gjatë punimeve të Mbledhjes së Moskës u ngrit e foli përfaqësuesi i një partie e tha: «Dëgjuam me durim për dy orë rresht shokun Enver Hoxha duke kritikuar udhëheqjen sovjetike dhe sidomos shokun Hrushov, por këto që tha këtu përpara nesh, sikur t'i thotë përpara partisë së tij, as dy minuta nuk do ta duronin komunistët shqiptarë». (Të qeshura në sallë). Kështu qeshëm edhe ne kur fliste ai, bile i thamë edhe Mikojanit: «Urdhëro, të ftojme të vish në Shqipëri dhe të dëgjosh se ç'thotë Partia jonë!». Në këtë kohë Mikojani

na ftoi të asistonim në një mbledhje të plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së tyre. Po ne i thamë se kemi qenë në mbledhje të plenumit të tyre dhe kemi dëgjuar gjëra të përgjithshme. Prandaj, po të dëshironi, e jani ju e asistoni në mbledhje të Plenumit të KQ të Partisë sonë, kur flitet për çështje politike dhe ideologjike. Me këto dua të them se pikëpamjet që ne shtruum në Mbledhjen e Moskës, ishin pikëpamjet e gjithë Partisë. Dhe në fakt konferenca e organizatës së Partisë të Tiranës, dhe me siguri e gjithë Partia jonë, do të aprovojë njëzëri dhe me entuziazëm vijën e drejtë që ka ndjekur Komiteti Qendror, sepse kjo vijë është në mbrojtje të marksizëm-leninizmit.

Ju e keni të qartë se çdo lëshim në çështjet parimore sjell dobësimin e Partisë, të diktaturës së proletariatit, të pozitive të socializmit. Prandaj, Partia jonë, që kur lindi, na ka mësuar t'i mbrojmë me këmbëngulje parimet, qoftë edhe kundër korentit dhe mos të bëjmë lëshime. Për këtë flet N. Hrushovi, flasin edhe udhëheqësit e shumë partive të tjera, por në praktikë ata i kanë hapur portat oportunitizmit, duke bërë lëshime dhe në këtë mënyrë i kanë shkaktuar dhe i shkaktojnë një dëm kolosal çështjes së komunizmit. Prandaj Partia jonë, në luftë e në përpjekje për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, ka arritur një pjekuri të tillë politike e ideologjike që mbron me vetëmohim dhe me bindje të plotë marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar.

Gjatë punimeve të kësaj konference më janë drejtuar disa pyetje. Në përgjithësi ato janë rreth divergjencave tona me udhëheqjen revizioniste sovjetike dhe

të disa vendeve të tjera të Evropës dhe unë do të përpiqem t'u përgjigjem. Megjithëse këto pyetje nuk janë të shumta, përsëri janë një tregues që dëshmon se Partia jonë i kupton çështjet në lartësinë e duhur dhe në parim, ajo interesohet të jetë e qartë për çdo gjë, sidomos për çështjet kryesore. Dhe ne kemi satisfaksionin se Komiteti Qendror për çdo gjë që ka pasur, ka informuar organizatat-bazë, se këto janë themeli i Partisë.

Kjo mënyrë veprimi tregon, konkretisht, lidhjet e ngushta të Komitetit Qendror me organizatat-bazë të Partisë, të cilat po të mos vihen në dijeni, sidomos për çështjet jetike të Partisë, të vendit, të socializmit, punët nuk do të shkonin mirë. Në rast se Partinë nuk e informon, ose i flet, por shtrembëron faktet, ajo nuk të beson dhe si pasojë e humbet besimin në udhëheqje, çorientohet e dobësohet.

Shumë udhëheqje të partive që janë në pozita oportuniste ia fshehin partisë së tyre të vërtetën. Përse? Sepse këto udhëheqje janë në pozita oportuniste. Por ne duhet të kemi besim të madh te partitë, në radhët e të cilave ka komunistë luftëtarë të shquar, megjithëse ka edhe elementë karrieristë e oportunistë. Duhet pasur parasysh se në gjirin e partive që kanë një udhëheqje revizioniste, ka shumë komunistë të vendosur, marksistë-leninistë, të cilët do të vijë dita që ta thonë fjalën e tyre. Kjo tregon forcën e marksizëm-leninizmit. Deviatorët, trockistët, oportunistët e kanë jetën të shkurtër, ata mund të gënjejnë një numër njerëzish, por nuk është e mundur të gënjejnë për një kohë të gjatë të gjithë partinë dhe popullin.

Nga ana tjetër, elementët që janë të lëkundshëm

në veten e tyre, krijojnë kontradikta të mëdha, sepse jeta është luftë dhe krijon situata, ndaj të cilave duhet të mbash qëndrim. Por qëndrimet e këtyre njerëzve do të jenë të lëkundshme, nuk do të jenë të prera. Ata do të presin me frikë se ç'do të thotë Partia, do ta pëlqejë Partia qëndrimin që mbajnë, apo jo. Kështu çdo orë që shkon për ta, do të krijojë kontradikta të rrezikshme. Prandaj, në rast se nuk je në rregull me partinë, por vetëm me tre a katër njerëz të udhëheqjes, sigurisht do të të dalë boja, në mos sot, nesër.

Le të marrim Partinë Komuniste të Bullgarisë, e cila është një parti e vjetër marksiste-leniniste, që ka nxjerrë nga gjiri i saj revolucionarë të lavdishëm si Bllagojevi, Dimitrovi etj. Për shumë çështje ne nuk jemi dakord me udhëheqjen e sotme të Partisë Komuniste të Bullgarisë dhe këto ia kemi thënë asaj, ia thamë edhe tani në Mbledhjen e Moskës. Ne vëmë re se në radhët e kësaj partie ka shumë komunistë që aprovojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e drejta të Partisë sonë. Ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Bullgarisë, por kemi të drejtë të themi se pas Mbledhjes së Bukureshtit dhe pas aktiveve të partisë që u bënë në Bullgari mbi këtë çështje, të gjithë komunistët e organizatës së një lagjeje të Sofjes kaluan nën dritaret e ambasadës sonë duke brohoritur për Partinë e Punës të Shqipërisë.

Pas Mbledhjes së Bukureshtit udhëheqja bullgare i ktheu bateritë kundër Partisë Komuniste të Kinës, duke thënë se ajo na qenka për luftën, se është dogmatike, sektare etj., etj. Por shumë organizata-bazë të Partisë Komuniste të Bullgarisë, i kundërshtuan me

rreptësi këto akuza dhe mjaft prej tyre deshën që ta thonin fjalën e vet, por, kur erdhi koha, udhëheqja nuk i lejoi anëtarët e partisë të bënin as pyetje, pa le diskutime e debate. Komunistët bullgarë duhej vetëm të dëgjonin. Mendoni ç'situatë krijohet në një parti, kur anëtarëve të saj u thuhet: «Mos flisni, mos pyesni, vetëm dëgjoni»!. Megjithatë në aktive të Partisë janë ngritur komunistë bullgarë dhe kanë folur në favor të Partisë sonë, duke mbështetur vijën e drejtë të saj. Kjo tregon se ka shumë komunistë bullgarë që s'janë dakord me vijën e udhëheqjes së Partisë së tyre. Ja ku qëndron forca e madhe e marksizëm-leninizmit, pavarësisht nga vështirësitë e përkohshme që po kalojmë.

Në Mbledhjen e Moskës kishte një numër partish, që ishin të një pikëpamjeje me Partinë tonë. Atje u krijua një situatë e tillë, që shumë parti nuk mund të pajtoheshin me pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike. Pozita e këtyre partive duhet kuptuar siç është. Shumë prej tyre janë në kushte ilegaliteti dhe luftojnë kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit, ndjekin, pra, një vijë revolucionare. Mirëpo udhëheqësit e tyre, duke bredhur nga një vend në tjetrin, e që çdo informatë e marrin jo nga baza e tyre, por nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ose nga organet e saj, kanë rënë në oportunizëm. Së pari, ata nuk kanë lidhjet e duhura me partitë e tyre që luftojnë në vendin e vet, së dyti, ata jetojnë jashtë vendeve të tyre dhe po të kenë pikëpamje të kundërta nga ato të udhëheqjes së vendit ku qëndrojnë, u pritët koromania. Po të mos ishin oportunistë dhe të kishin vullnet të çeliktë, do të thoshin: «Sikter me gjithë koromanen tënde, unë legalisht ose

ilegalisht do të kthehem në vendin tim të luftoj me shokët!». Po ata nuk mbajnë qëndrime të tilla dhe ndonjë breh me ski, saqë thyen edhe këmbën¹ dhe ata që s'e dinë këtë, e duartrokasën si invalid luftime, kurse në vendin e tij populli lufton. Njerëz të tillë, pra, janë me vijën e Hrushovit. Mirëpo si ky ka edhe të tjerë. Duhet pasur parasysh se ka parti që janë larg nga Bashkimi Sovjetik, por kanë për të një dashuri idealiste, duke menduar se çfarëdo që të bëjë Hrushovi, ai nuk gabon se është udhëheqës i Bashkimit Sovjetik. Pra, këta shokë nuk i shikojnë çështjet në mënyrë kritike, sado që vetë luftojnë çdo ditë.

Ja, për shembull, përfaqësuesit e partive komuniste të Amerikës Latine, çështjen e pushtetit, të luftës kundër imperializmit, kundër borgjezisë, kundër revizionizmit jugosllav, i trajtojnë në përgjithësi drejt. Por ata nuk mungojnë t'i bëjnë edhe clozhe udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik e, veçanërisht, Hrushovit. Pra në jetë, në praktikë, për shumë probleme ata janë të një mendimi me ne, por nuk mbajnë qëndrim kundër udhëheqjes sovjetike.

Le të marrim si shembull punën e delegacionit të Partisë Komuniste të Kubës. Në fillim, gjatë punës së komisionit të redaktimit, ky delegacion mbajti një fjalim të zjarrtë, pra, ishte në pozitë tona, kundër Hrushovit dhe pasuesve të tij. Mirëpo më vonë, kur filluan ta përpunonin, ai e ndryshoi qëndrimin dhe u bë një

¹ Është fjala për Larbi Buhalinë, sekretar i Partisë Komuniste të Algjerisë, shërbëtor i përlurur i N. Hrushovit. Në periudhën kur populli algjerian derdhte gjak për lirinë e atdheut, Buhalia, që jetonte në Bashkimin Sovjetik, e kalonte kohën me zbavitje.

nga më aktivët në mbështetje të pikëpamjeve të Hrushovit. Megjithatë, kur foli në Mbledhjen e Moskës, ishte i detyruar të mbronte vijën e partisë së tij përsa i përket luftës kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern, e veçanërisht atij jugosllav. Kështu vepruan përfaqësuesit e të gjitha partive të Amerikës Latine.

Ndërsa shumë parti të tjera mbajtën qëndrim pro nesh. Ato nuk thanë asnjë fjalë të keqe kundër Partisë sonë.

Prandaj ne themi se në Mbledhjen e Moskës një numër partish luftuan haptazi për të mbrojtur vijën tonë të drejtë, por atje kishte edhe parti, të cilat ishin të detyruara të mbanin formalisht pikëpamje të njëjllota me ato të udhëheqësve sovjetikë, por në fakt, kur diskutuan, nuk ishin dakord me ta. Sikur t'i marrim së bashku ato parti që u treguan të vendosura në Mbledhjen e Moskës për marksizëm-leninizmin del se ne jemi 17-18 milion nga 36 milion komunistë që ka aktualisht në botë. Por siç theksova më lart, dhe në parti të tjera, siç ndodh në Bullgari e gjetkë, ka shumë komunistë që janë kundër vijës oportuniste të udhëheqjes së tyre. Ka edhe anëtarë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që nuk janë dakord me pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike. Unë mund t'ju them vetëm një fakt: në takimet që kanë njerëzit tanë me njerëz sovjetikë të bazës, dhe me këtë nuk duhen kuptuar vetëm punëtorët dhe studentët, po deri te mareshalë të lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, ata u shtrëngojnë dorën shqiptarëve dhe u thonë «malladje!»¹.

¹ Nga rusishtja — Ju lumtë!

Deri tani, ne asnjë fjalë të keqe nuk kemi dëgjuar nga njerëzit e thjeshtë sovjetikë. Dhe jemi të bindur se masa e komunistëve sovjetikë nuk është e mundur të pajtohet me pikëpamjet revizioniste të Hrushovit dhe të grupit të tij. Por çështja është se ata janë zotër në shtëpinë e tyre, prandaj le t'i gjykojnë si të duan veprimet dhe vijën e udhëheqjes së tyre. Por neve na gëzon zemra kur shohim se njerëzit dhe komunistët sovjetikë, të vjetër e të rinj, aprovojnë vijën e Partisë sonë.

Ne jemi të sigurt se do të fitojmë, pse me ne është shumica, pse me ne është e drejta. Pavarësisht nga qëndrimet që mbajnë ose do të mbajnë udhëheqja sovjetike dhe ato të vendeve të demokracisë popullore, ne duhet të jemi të kujdesshëm në luftën ideologjike kundër tyre, që të mos biem, ashtu si nuk kemi rënë në fyerje, siç bëjnë ata, por të kapemi fort në parimet, të luftojmë me argumente, nga të cilat kemi plot.

Qëndrimin e Partisë sonë ju, pra, e keni kuptuar drejt dhe si duhet. Ne nuk mund të bëjmë lëshime se dashkan të kenë një tjetër vijë Hrushovi, Zhivkovi apo Gomulka. Ne jemi në kundërshtim me vijën e tyre dhe e kemi për detyrë ta luftojmë atë vijë se kështu mbrojmë marksizëm-leninizmin, unitetin e lëvizjes komuniste e punëtore të botës. Por mbrojtja e marksizëm-leninizmit dhe e unitetit të komunizmit ndërkombëtar është detyrë e çdo partie marksiste-leniniste, qoftë e madhe ose e vogël. Të gjithë jemi komunistë, atëherë duhet t'i themi njëri-tjetrit edhe të mirat, edhe të këqijat. Të gjitha t'i diskutojmë së bashku si marksistë, në mënyrë që çështjet të zgjidhen në rrugë të drejtë.

Këto çështje i diskutuam në Mbledhjen e Moskës, kritikam i bëmë dhe së bashku vendosëm dhe aprovuam një deklaratë. Atëherë kjo deklaratë duhet të zbatohet nga të gjithë dhe, në rast se ndonjë nuk e zbaton, do ta kritikojmë. Ne mund ta durojmë një herë, dy herë, pastaj do të flasim hapur dhe përgjegjësia i mbetet atij që e shkel deklaratën.

Kështu, një shkelje flagrante është bërë nga Valter Ulbrihti. Ai në Mbledhjen e Moskës nuk pati guxim të kritikonte Partinë tonë, as kur foli vetë, as pasi folëm ne, siç bënë shumë të tjerë, që i dhanë edhe me shkrim pikëpamjet e tyre kundër fjalimit tonë. Po të kishte gjë kundër nesh, ai kishte plotësisht të drejtë të thoshte fjalën e tij, si e thanë të gjithë të tjerët. Mirëpo Ulbrihti, sa u kthye nga Moska në Berlin, bëri mbledhjen e Komitetit Qendror të PSB të Gjermanisë. Se çfarë u tha atje, nuk e dimë, vetëm mësuam se në organin e partisë «Nojes doçland» shkruhet se Partia e Funës e Shqipërisë ka mbajtur qëndrim dogmatik dhe sektar (!). Natyrisht, kjo është jo vetëm një falsifikim i realitetit, por edhe një gabim që atyre do t'u kushtojë, sepse shkelën Deklaratën e Moskës.

Ulbrihti na dërgoi ambasadorën e RDGJ në RPSH, gjoja për të na vënë në dijeni se si u punua Deklarata në plenumin e Komitetit Qendror të partisë së tyre. Kur njeriu ynë i tha ambasadores se Ulbrihti ka shkelur Deklaratën e Moskës, pasi ka akuzuar Partinë tonë dhe ka propaganduar kundër nesh edhe me shtyp, ajo sikur gjoja u çudit e tha se nuk e paskish lexuar fjalën e Ulbrihtit. Që ambasadorja të mos e ketë lexuar fjalimin e udhëheqësit të partisë së saj, ne këtë nuk e besojmë.

Pavarësisht nga përçapjet që do të bëjmë për këtë çështje, ne kurdoherë do të mbajmë qëndrim të drejtë dhe do të luftojmë për të forcuar lidhjet e miqësisë me të gjitha partitë motra dhe do të flasim me to, si kurdoherë, hapët, sinqerisht dhe në mënyrë komuniste. Ashtu siç na porosit Komiteti Qendror këto çështje të mos bëhen muhabete rrugësh, sepse janë çështje të mëdha partie.

Mundet dhe do të ketë njerëz që, duke përfituar nga këto situata, të synojnë për të diskredituar Bashkimin Sovjetik, por BS do ta mbrojmë si kurdoherë, jo vetëm në kohë të mira, por edhe në kohë të këqija. Marksistët shqiptarë i kuptojnë momentet e vështira që kalojnë komunistët dhe popujt sovjetikë, prandaj e kemi për detyrë marksiste t'i mbrojmë, duke luftuar kundër elementëve, që do të përpiqen të shfrytëzojnë këtë situatë «për të peshkuar në ujë të trubullt».

Do të ketë njerëz që do të mundohen të kapen nga këto gjëra me qëllim që jashtë Partisë të krijohet një situatë e vështirë, sidomos te ata që nuk janë të ngritur politikisht. Të gjithëve duhet t'u bëhet e ditur se ne kemi mosmarrëveshje politike dhe ideologjike me udhëheqjen sovjetike dhe këtë kemi të drejtë ta themi, por këto nuk duhet të kalojnë në marrëdhënie shtetërore midis dy vendeve. Në qoftë se udhëheqja sovjetike do t'i shtrijë mosmarrëveshjet edhe në marrëdhëniet shtetërore, ne do ta kritikojmë, dhe kritika marksiste ka për qëllim t'i ndreqë njerëzit, qoftë në një organizatë partie, qoftë në shkallë ndërkombëtare. Ai që pranon tezën leniniste se anëtari i thjeshtë i partisë ka të drejtë të kritikojë cilindo, qoftë edhe udhëheqës, kur ky bën gabime,

atëhere këtë parim të madh leninist duhet ta pranojë edhe në marrëdhëniet midis partive, në shkallë ndërkombëtare, pra ta pranojë kritikën edhe kur i vjen nga një Parti, siç është Partia e Punës e Shqipërisë.

Ne kemi pasur diskutime të ashpra me Hrushovin, Mikojanin etj. Ata pranuan që ambasadori i tyre te ne dhe mareshalët e Bashkimit Sovjetik Malinovski¹ dhe Greçko² kanë bërë gabime politike, po këtë pranim ata e bënë në takimet që patëm, sa për të na gënjyer, se, kur i kritikua në Mbledhjen e Moskës, nuk pranuan asgjë. Nëse i njeh këto si gabime, atëherë, më vonë, përse thua që janë shpifje? Derisa në takim pranove që ata kanë gabuar, duhet të pranosh edhe para mbledhjes, ndryshe nuk je marksist.

Partia jonë nuk mund të përulet para atyre që shkelin marksizëm-leninizmin. Për mbrojtjen e tij ajo qëndron me gjoks përpara. Prandaj, ti që e shkel atë, prano kritikën që të bëjnë dhe ndërro rrugë, ndryshe nuk je marksist.

Ky, pra, është qëndrimi ynë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste. Miqësinë me ta, pa shkelur parimet, do ta ruajmë. Kështu u thanë shokëve sovjetikë, në takimin e fundit që patëm me ta shokët Mehmet Shehu e Hysni Kapo. Ne kritikën ua bëmë drejt, po dhe miqësinë e duam në rrugën marksiste-leniniste, prandaj ta kalitim atë mbi këtë bazë dhe të ecim përpara, kjo sigurisht varet tani nga ata. Inte-

¹ Në atë kohë ministër i Mbrojtjes i BRSS.

² Në atë kohë komandant i përgjithshëm i Forcave të Armatosura Ushtarake të Bashkuara të Traktatit të Varshavës.

resi ynë kërkon që të kemi miqësi. Por ne asnjëherë nuk do të pranojmë të mos themi fjalën tonë ndaj gabimeve që vërtetohen nga udhëheqësit e vendeve mike. Ne besojmë se e gjithë Partia jonë është dakord me këtë rrugë.

Tani, jemi duke u ndeshur me udhëheqjen sovjetike dhe disa të tjerë në fushën e marrëdhënieve ekonomike, për të përfunduar marrëveshjet e kleringut dhe të kreditit si për vitin 1961 ashtu edhe për pesëvjeçarin e tretë në tërësi. Qysh këtë vit si Bashkimi Sovjetik ashtu edhe disa nga vendet e demokracisë popullore po e vonojnë përfundimin e marrëveshjeve, duke nxjerrë pengesa dhe zvarritje me qëllime të caktuara, të cilat krijojnë vështirësi ekonomike për planin tonë pesëvjeçar.

Sidoqoftë, edhe në këtë situatë të vështirë, në marrëdhëniet tona ekonomike, Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste të Evropës duhet të mbajnë angazhimet, ashtu siç i mbajmë edhe ne, por ne ato që kemi për të thënë i themi dhe atje ku duhet. Ata nuk i pranuan kritikën tona, përkundrazi na ofenduan, kështu secila palë mbeti në pozitat e veta. Tani ne kemi Deklaratën e Moskës, prandaj të gjithë duhet ta zbatojmë në jetë, të ndjekim ngjarjet, të shohim se kush i respekton dhe kush i bën bisht dhe nëse kjo ndodh, gjuhën në gojë e kemi. Partia jonë nuk na ka rritur dhe nuk na ushqen që të mbyllim gojën, por, kur është puna për mbrojtjen e Partisë, të popullit, të atdheut dhe të marksizëm-leninizmit, asnjëherë të mos rrimë pa thënë fjalën tonë.

Dua të vë në dukje në këtë konferencë se, edhe ndër partitë që mbajtën anën e udhëheqjes sovjetike,

duhen bërë diferencime. Unë kam folur edhe herë të tjera, për shembull, se udhëheqja hungareze, për një arsye ose për një arsye tjetër, mban ndaj nesh një qëndrim ndryshe nga të tjerat, të paktën deri tani. Kështu në Mbledhjen e Moskës delegacioni i Partisë së Punonjësve të Hungarisë u shpreh se «shokët shqiptarë e kuptojnë ndryshe nga ne çështjen e kundërrevolucionit, por ne ruajmë pikëpamjen tonë, atë që ka aprovuar kongresi i partisë sonë dhe jemi të bindur për këtë». Ne iu përgjigjëm atyre se nuk na kuptuan drejt përsa i përket kritikës që i bëmë udhëheqjes sovjetike, e cila ka bërë gabime edhe në çështjen hungareze.

Po përse shokët hungarezë mbajnë këtë qëndrim ndaj nesh? Shokët sovjetikë nuk kanë bërë gabime vetëm kundër nesh, po edhe kundër partive të tjera dhe pavarësisht se shumë njerëzve në dukje nuk u pëlqeu qëndrimi marksist-leninist i delegacionit të Partisë sonë, ka pasur nga këta që kanë thënë: «U lumtë shqiptarëve, sepse sovjetikët edhe neve na kanë bërë gjëra të tilla!».

Kjo është punë e tyre. Ne nuk dimë me hollësi si janë zhvilluar ngjarjet në Hungari, por dihet nga të gjithë se para kundërrevolucionit Kadari ishte në burg dhe në krye të partisë atje ishte Rakoshi, për të cilin nuk dimë që deri atëherë të kishte bërë ndonjë faj. Në kohën e ngjarjeve të Hungarisë, Kadarin, pasi e liruan, e zgjodhën sekretar të parë të organizatës së partisë në Budapest. Nuk dimë si u ndodh Kadari me Imre Nagin në parlament, pra me kundërrevolucionin, por dimë se me zor e ka tërhequr andej Mikoiani me një tanks.

Kur ishim në një darkë në Kremlin¹, me shokun Mehmet dhe me shokë të tjerë, Molotovi haptazi, si me shaka i tha Mikojanit se e bëre çorbë punën në Hungari, tani përpiqu ta bësh këtë edhe në Austri². Prandaj «për këtë që bëre, do të të nxjerrim në gjyq!». Mikojani iu përgjigj se «po të më nxirrni mua në gjyq, do të nxirrni edhe Kadarin». Kështu janë punët.

Tani shumë vetë mendojnë: «Shqipëria është vend i vogël, i rrethuar gjeografikisht nga armiq, ekonomikisht i varfër, por ama shokët shqiptarë, kur është për të thënë, ta thonë fjalën hapur, në sy!». Pra disa i pranojnë pikëpamjet dhe qëndrimet tona, duke e shprehur këtë me gjysmë zëri, disa të tjerë qëndrojnë në pritje. Ata do ta shohin edhe më mirë nesër drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Njerëzit shohin dhe gjykojnë dhe kështu do të ndodhë.

Po kthehem prapë te ngjarjet e Hungarisë. Kur shkuaam për në RP të Kinës, kaluam në Hungari e në Moskë³. Kjo ishte para se të bëhej kundërrevolucioni i vitit 1956, pasi te ne ishte zhvilluar Konferenca e Partisë e qytetit të Tiranës dhe pasi ne ishim në dijeni që

¹ Në prill të vitit 1957, një delegacion i PPSH, i kryesuar nga shoku Enver Hoxha, ndodhej në Moskë për një vizitë zyrtare.

² Më 22 prill 1957, A. Mikojani u nis për në Austri në krye të një delegacioni qeveritar sovjetik me ftesë të qeverisë austriake.

³ Gjatë muajit shtator 1956, shoku Enver Hoxha mori pjesë në delegacionin qeveritar të RPSH që vizitoi RP të Mongolisë, RDP të Koresë dhe kryesoi delegacionin e PPSH që mori pjesë në Kongresin VIII të PK të Kinës.

Titoja e kishte njoftuar Tuk Jakovën se ishte shpejtuar, se duhet të kishte pritur. Atje, në Budapest, ziente kazani. Na ftuan në një darkë ku ishte pothuajse e gjithë Byroja Politike e Partisë së Punonjësve të Hungarisë. Në darkë Rakoshi nuk ndodhej. Shokët hungarezë na treguan ç'po ngjante në klubin «Petëf». Ne u treguam si vepruam me elementët antiparti e tradhtarë të Konferencës së Tiranës. Në këto bisedime, një anëtar i Byrosë Politike na pyeti se ku ndodhet mbreti Zog, se në Hungari përpiqet të kthehet Horti. Një tjetër na pyeti se si na dukej fjalimi i Toliatit, ku ai kishte sulmuar sistemin sovjetik. «Ky është një fjalim i poshtër, i thamë ne, pasi atje Toliati godet rendin socialist që është vendosur në Bashkimin Sovjetik». «Jo, u përgjigj ai që na pyeti, nuk është kështu». Ato ditë Imre Nagi festonte ditëlindjen dhe dy anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë kishin shkuar për darkë te Nagi. Ne nuk ua aprovuam një qëndrim të tillë.

Shkuam në Bashkimin Sovjetik, atje u takuam me Susllavin, që në atë kohë ishte sekretar i KQ të PK të BS. Ne e vumë në dijeni mbi çka pamë në Hungari, i thamë se vendi po zien, se Nagi është tradhtar, ai po organizon kundërrevolucionin. «Gaboheni, na tha ai, Nagi është njeri i mirë, ai ka bërë autokritikë»! Bile hapi sirtarin dhe na nxori autokritikën e Imre Nagit. Pra Susllavi nuk ishte dakord me ne. Biseda u zhvillua pikërisht kështu. E kur ne i vumë në dukje këto gjëra në Mbledhjen e Moskës, udhëheqësit sovjetikë thanë se këto janë shpifje. Atyre u mungon ndershmëria e komunistit, prandaj i mohuan këto sy ndër sy.

Në kohën e kundërrevolucionit, katër herë shkuan

udhëheqësit sovjetikë të Titoja në Brioni, në një kohë kur kishin dijeni që ai ishte një nga organizatorët e kundërrevolucionit në Hungari. Kur është kështu, përse shkon e bisedon me atë që organizon kundërrevolucionin? Kur ishim me një delegacion të Partisë dhe të Qeverisë sonë më 1957 në Bashkimin Sovjetik, gjatë bisedimeve filluam të flisnim kundër revizionistëve jugosllavë, Hrushovi si me sustë u ngrit në këmbë e me nervozizëm tha: «Nuk bisedohet me ju shqiptarët, t'i presim bisedimet!». Atëherë ne iu përgjigjëm me gjakftohtësi Hrushovit: «Mirë, ju keni pikëpamjen tuaj për jugosllavët, ne kemi tonën, por bisedimet s'ka pse t'i presim».

Ka edhe parti të tjera që kanë pasur divergjenca me udhëheqjen aktuale sovjetike, por kanë heshtur. Kjo është punë e tyre. Ne mendojmë se vija jonë është e drejtë dhe kemi besim të plotë në të. Këtë e lidh me një pyetje që është bërë mbi këtë çështje. Gjithashtu, ne kemi besim të plotë se marksizëm-leninizmi do të fitojë kundër të gjitha rrymave antimarksiste, oportuniste, revizioniste. Herët ose vonë ne do të shohim që marksizëm-leninizmi do të triumfojë plotësisht.

Nuk është burrnore të sulmosh Shqipërinë, siç bëri Ulbrihti, për t'u dhënë një farë satisfaksioni Hrushovit, Titos dhe imperialistëve. Po ne nuk duam të dimë nga këto, se radiot e imperializmit kemi vite që i dëgjojmë, e dimë se ato gënjejnë aq shumë saqë edhe të bardhën e bëjnë të zezë. Këto radio tani janë kapur pas fjalëve të Ulbrihtit dhe thonë: «Iku Shqipëria, as pesëvjeçar nuk ka për të realizuar, as lirinë nuk e mbron dot si e rrethuar që është». Ja, pra, se Ulbrihti u dha një armë

armiqve të Shqipërisë. Shqipëria është po në ato pozita që është edhe Republika Demokratike Gjermane, në grykën e ujkut. Por Partia, Qeveria dhe populli ynë dinë t'u qëndrojnë me gjoks armiqve. Ata kanë bërë, bëjnë dhe do të bëjnë një luftë të vendosur kundër agresorëve imperialistë amerikanë dhe revanshistëve të Bonit, për mbrojtjen e Republikës Demokratike Gjermane.

Ne kemi pasur shumë herë kundërshtime me Hrushovin. Në vitin 1959 ai vizitoi vendin tonë, po para se të vinte, na lajmëroi që të mos flisnim kundër revizionistëve jugosllavë. Në takimin e parë, pa filluar bisedimet, deklaroi se nuk do të fliste kundër jugosllavëve, sikur ne nuk e dinim, por ai e bëri këtë për të impresionuar njerëzit tanë dhe t'u linte të kuptonin se ai nuk ishte dakord me ne. Por ne e respektuam mikun sa qëndroi në shtëpinë tonë dhe, porsa u largua, i lëshuam topat kundër revizionizmit jugosllav.

Ju nuk i keni dëgjuar radiot e Perëndimit dhe shumë mirë bëni, por, kur ishte këtu Hrushovi, ata thoshin se ai ua «mbylli» gojën shqiptarëve. Jo, ai nuk mund të na e mbyllë dot gojën për të drejtën, kur të tjerët bëjnë gabime. Miqësia është miqësi dhe kritika është kritikë. Ne do të përpiqemi ta forcojmë edhe më shumë këtë miqësi, por në rrugë të drejtë. Ne do ta forcojmë edhe më tej kritikën ndaj revizionistëve jugosllavë. Gabimet nuk i kemi ne, po ata, prandaj le t'i ndreqin, dhe t'i ndreqin me vepra.

Tani udhëheqësit sovjetikë, me anë të ambasadorit të ri që do të vijë në vendin tonë, përpiqen të rifillojnë bisedimet. Ne nuk jemi kundër bisedimeve, por vetëm

në rrugë të drejtë, jo ta përkëdhelim imperializmin dhe revizionizmin, siç bën Hrushovi, por t'i konsiderojmë ashtu siç janë, armiq të socializmit. Pra, këtij parimi t'i përmbahemi në bisedime, të mos u bëjmë asnjë lëshim armiqve dhe të mos u fërkojmë krahët.

E dimë cili është qëndrimi i popullit dhe i komunistëve sovjetikë ndaj Shqipërisë dhe kufijve të saj, e dimë se sa na duan ata. Po Hrushovi çfarë bën? Ai për të bërë lajka, për të treguar politikën e tij «të madhe» dhe se sa rëndësi ka gjoja çështja e bashkekzistencës, i bën koncesione Venizellosit. Tani ka filluar t'u bëjë koncesione edhe amerikanëve, duke tërhequr nga OKB-ja akuzën që e trumbetoi aq shumë për aeroplanin spiun U-2. Përse vepron kështu Hrushovi? Këtë sulm imperializmi amerikan nuk ia bëri vetëm Bashkimit Sovjetik, por të gjitha vendeve socialiste dhe veprime të tilla kushedi sa herë i ka bërë imperializmi kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër nesh. Këtu nuk është çështja e dërgimit të një avioni në qiellin sovjetik, por e gjithë politikës së spiunazhit të imperializmit amerikan kundër vendeve socialiste. Hrushovi ashtu si bëri sot këtë për hir të «miqësisë» dhe të bashkekzistencës, nesër mund të falë edhe spiunin¹ që shpëtoi nga aeroplani U-2.

Ne jemi për bashkekzistencën, për çarmatimin, por jo të kemi besim te Ajzenhaueri apo te Kenedi dhe të hedhim parullën e «botës pa armë, pa ushtri, pa luftëra».

Nuk mund të pajtohemi me koncesione të tilla që

¹ Dhe me të vërtetë kështu ndodhi. Piloti amerikan Fransis Geri Pauers, u fal me vendim të Presidiumit të Sovjetit Suprem të BS, për «përmirësimin e marrëdhënieve sovjeto-amerikane».

janë të dëmshme dhe për probleme të tilla kemi edhe ne pikëpamjen tonë. Ja, për shembull, ç'duhet bërë për problemin e Berlinit? Deri tani asgjë përveç fjalëve nuk po shohim të bëhet për këtë çështje me rëndësi të madhe. Ne e kemi thënë pikëpamjen tonë të drejtë.

Një ditë më erdhi ambasadori sovjetik dhe më pyeti se ç'mendonim ne për çështjen e Berlinit. Unë i thashë se, po kërcënove, duhet ta mbash fjalën, i thashë se Hrushovi nuk bëri mirë që shkoi vetë në Berlin pas Mbledhjes së Parisit. Ai duhet të kishte mbledhur të gjithë anëtarët e Traktatit të Varshavës, dhe të nënshkruanim traktatin e paqes me Republikën Demokratike Gjermane, kështu do ta kishim zgjidhur një herë e mirë këtë çështje. Momenti atëherë ishte shumë i përshtatshëm, sepse amerikanët ishin diskredituar shumë dhe partnerët e tyre lëkundeshin. Kjo është një çështje që duhet zgjidhur, sa më vonë ta lësh, aq më keq është për paqen dhe për vetë RD të Gjermanisë.

Këtë pikëpamje ia thamë edhe Mikojanit, i cili u shpreh se kjo çështje është për t'u diskutuar. Mirëpo kush ta merr parasysh? Megjithëse për çështje të tilla me kaq rëndësi duhet të vendosim të gjithë, del Ulbrihti dhe, pa pyetur njeri, propozon 10 vjet paqe me Perëndimin! Mirë, mundet edhe ta shtyjmë problemin e Berlinit, po ama duhet të vendosim bashkërisht, se po të ndodhë gjë, do të luftojmë të gjithë. Të gjithë për një dhe një për të gjithë.

Kështu qëndron puna për këto çështje. Ne duhet të kemi kurdoherë besim në forcën e marksizëm-leninizmit, se çdo gjë do të vihet në rrugën e drejtë po të udhëhiqemi nga parimet e mëdha të tij. Si kurdoherë

të jemi të drejtë dhe korrektë me njerëzit sovjetikë, si me çdo të huaj tjetër të çdo vendi mik. Por duhet që edhe çdonjëri nga këta ta kryejë ndershmërisht detyrën e ngarkuar. Atëherë nga ne kurdoherë do të shohin dashuri dhe miqësi.

Te njerëzit tanë asnjëherë nuk duhet të mungojë vigjilenca. Kjo nuk do të thotë mosbesim ndaj njerëzve të vendeve mike në Shqipëri, por është plotësisht e drejtë dhe e domosdoshme t'u themi njerëzve tanë të jenë kurdoherë vigjilentë për të mbrojtur Partinë dhe shtetin nga çdo e keqe. Vigjilent je edhe atëherë kur i tërheq vëmendjen një shoku që bën një gabim. Kjo nuk do të thotë se ai që gabon është armik, por duke i tërhequr veshin e ndihmon atë që të mos shkojë më tutje. Kështu duhet kupltuar të qenit vigjilent.

Me njerëzit e vendeve socialiste, kur jemi miq e vëllezër, ndjekim të njëjtin qëllim, frymëzohemi nga të njëjtat ideale, dhe luftojmë kundër të njëjtëve armiq — imperialistëve dhe revizionistëve, atëherë duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin, e jo si udhëheqësit sovjetikë që i udhëzojnë specialistët e tyre të merren me veprime antisocialiste dhe antishoqërore. Në rast se ti kërkon të na dëmtosh, ne nuk të lejojmë.

Deri tani neve nuk na ka dalë ndonjë gjë serioze lidhur me specialistët e huaj dhe jemi të bindur se, po të ndodhë diçka nga ata, kjo nuk do të vijë pa nxitjen e udhëheqjes së tyre, pa udhëzimet që ata mund të marrin nga lart. Prandaj dashuria dhe miqësia e njerëzve tanë ndaj tyre është një detyrë internacionaliste marksiste-leniniste. Ne dimë se kur u hoqën padrejtësisht nga Kina specialistët sovjetikë, ata u larguan me

keqardhje të madhe dhe nuk kuptonin përse udhëheqja e tyre merrte një masë të tillë, përse i largonin nga një popull dhe nga një vend ku i donin aq shumë. Heqja e specialistëve, natyrisht, nuk mund ta shkatërronte ekonominë e Kinës së madhe, por e ka dëmtuar dhe e ka penguar atë. Tani përpara opinionit të të gjithë popujve të vendeve socialiste që nuk e kanë aprovuar këtë masë, ata u kanë thënë shokëve kinezë, po të doni ua dërgojmë përsëri specialistët, kur të doni lajmëroni, ata janë gati të vijnë. Këto janë metoda krejtësisht antimarksiste dhe antisocialiste. E tillë pra është udhëheqja aktuale sovjetike.

Qëndrimet antimarksiste të Hrushovit nuk e ulin aspak autoritetin e Partisë sonë. Përkundrazi, ato e forcojnë atë. Ato nuk prekin gjithashtu edhe besnikërinë e Partisë sonë ndaj popujve dhe komunistëve të Bashkimit Sovjetik. Ne do të luftojmë kurdoherë që këto gjëra të ndreqen në rrugë marksiste-leniniste.

Duke mbyllur fjalën time, dua të theksoj se shoqja Fiqret i shtroi mirë në raportin e paraqitur detyrat për organizatën e Partisë, të cilat vihen në dukje me forcë edhe në letrën e Komitetit Qendror¹ që u punua në këtë konferencë. Letra e Komitetit Qendror rekomandon që e tërë Partia të mobilizohet për realizimin e këtyre detyrave të rëndësishme. Komunistët duhet të jenë në

¹ Është fjala për letrën e KQ të PPSH drejtuar gjithë organizatave-bazë të Partisë mbi zhvillimin e Mbledhjes së Moskës të vitit 1960 të 81 partive komuniste e punëtoresh dhe mbi qëndrimin e PPSH në luftën kundër revizionizmit modern (31 dhjetor 1960). Shih «Dokumente kryesore të PPSH», vëllimi III, f. 468 Tiranë 1970.

ballë të luftës dhe shembull në çdo gjë, shembull disipline, ndershmërie, vendosmërie. Ata duhet të jenë në sulm dhe të tërheqin me vete të gjitha masat e popullit për të realizuar me sukses planet tona. Kjo do të jetë dëshmia më e qartë e drejtësisë së vijës së Partisë sonë dhe e zotësisë së saj kundër të gjithë atyre që kanë dashur ta sulmojnë Partinë tonë, si Mikoiani që me paturpësinë më të madhe tha se «do të shohim ç'do të ndodhë».

Udhëheqësit sovjetikë flasin sikur ndihmat që i ka dhënë Bashkimi Sovjetik vendit tonë i kanë nxjerrë nga xhepi i tyre. Por ne e dimë se ato janë ndihma internacionaliste, vëllazërore të popullit sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të punëtorëve dhe të kolkozianëve sovjetikë, që ne nuk do t'i harrojmë kurrë. Ajo që mendon Mikoiani, nuk do të ngjasë kurrë. Prandaj ne, me qëndrimin dhe me punën tonë, t'u tregojmë atyre se forcat e Partisë dhe të popullit tonë janë të tilla që do të bëjnë mrekullira. Përveç asaj, siç thotë Komiteti Qendror nëpërmjet letrës, çdo gjë e kemi të siguruar, bile do të kemi edhe të tjera, do të kemi prodhime të reja, në mënyrë që të mundim të shkurtojmë sa më shumë importin, të sigurojmë sidomos përparimin e mëtejshëm të bujqësisë, e cila ka rëndësi shumë të madhe për vendin tonë. Rëndësi kanë të gjithë sektorët dhe ne ndiejmë kënaqësi të madhe që industria jonë në çdo situatë ka dalë me sukses e faqebardhë. Kuadrot tanë, të dalë nga radhët e klasës punëtore, janë duke kryer mirë detyrën dhe bëjnë të tejkalohen planet e prodhimit, të rriten rendimentet, të ulët kostoja etj.

Natyrisht, ne kemi edhe të meta e gabime në punën

tonë, prandaj duhet luftë e përpjekje për t'i eliminuar këto. Sidoqoftë është fakt që industria jonë ecën përpara. Ajo do të zhvillohet edhe më shumë, sikurse e kemi konstatuar në projektdirektivat, dhe kjo është e sigurt, se vendi ynë ka pasuri të tjera të mëdha, që, duke i shfrytëzuar, do të forcojnë edhe më shumë ekonominë tonë dhe do të pëlqasin ata që mendojnë se Shqipëria do të ngrejë duart lart para vështirësive që do të hasë.

Të gjitha ato që thotë Partia, do të bëhen, se ajo, në radhë të parë, është e fortë si çeliku, me një unitet të shëndoshë, që i kupton drejt çështjet në këto situata të vështira, jo vetëm për vendin tonë, por për të gjitha vendet socialiste dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ne kemi bindjen e plotë se Partia do ta kapërcejë me sukses edhe këtë situatë.

Është një sukses shumë i madh që Partia jonë e Punës ka arritur të edukojë edhe njerëzit e thjeshtë me nuhatjen e duhur politike për të kuptuar drejt çdo situatë dhe për të kaluar me guxim dhe me vendosmëri çdo pengesë.

Çështja, pra, është te një mobilizim më i madh në të gjitha drejtimet: të ruajmë Partinë nga sëmundjet dhe nga goditjet e armiqve dhe të jemi parimorë dhe të vëmendshëm që të kritikojmë çdo gjë që nuk shkon në rregull. Kur krijohen momente të tilla heroike si këto që po kalojmë, disiplina, konspiracioni, vrulli, entuziazmi dhe vendosmëria e anëtarëve të Partisë dhe e organizatave të Partisë duhet të ngrihen në atë nivel siç kanë qenë në kohën e luftës. Natyrisht këto detyra janë të përhershme, por në këto momente ne duhet t'i kemi parasysh edhe më tepër.

Ka njerëz që nuk do t'i kuptojnë menjëherë këto gjëra, që do të habiten e do të thonë si mund të veprojnë kështu Bashkimi Sovjetik. Këta nuk do të mund të bëjnë dot dallimin midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe udhëheqjes aktuale sovjetike. Prandaj, duke i mbajtur pranë njerëzit, duke i sqaruar me durim, ne do t'ua bëjmë gjithçka të qartë. Partia ka për të bërë një punë të shumanshme sqaruese dhe bindëse për të gjitha këto probleme.

Edhe një herë ju uroj në emër të Komitetit Qendror dhe nga ana ime suksese të mëdha në punë dhe në detyrat që ju ka ngarkuar Partia! Të gjithë anëtarët e Partisë duhet të mobilizohen me të gjitha forcat me një dashuri të sinqertë dhe të thellë për njëri-tjetrin dhe për popullin tonë, për të arritur sukseset që dëshiron Partia, me qëllim që e gjithë Shqipëria të rrojë e lumtur dhe e gëzuar. Në radhë të parë të mobilizohet Partia, e cila të jetë si kurdoherë në krye të masave që të realizohen planet tona të ardhshme, për të ecur me hapa më të shpejtë në ndërtimin e socializmit dhe më vonë të komunizmit në vendin tonë.

Të rrojë Partia jonë!

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**PRESIONI I HAPËT POLITIK DHE EKONOMIK I
REVIZIONISTËVE SOVJETIKË DO TË DËSHTOJË
PARA VENDOSMËRISË DHE VULLNETIT
TË HEKURT TË POPULLIT DHE
TË KOMUNISTËVE SHQIPTARË**

Letër dërguar KQ të PK të BS

14 janar 1961

**KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK**

M o s k ë

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, me anën e një note të ambasadës sovjetike në Tiranë, më 6 janar 1961, mori njoftim për përgjigjen e Qeverisë së Bashkimit Sovjetik lidhur me përfundimin e marrëveshjes së kleringut midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe BRSS për periudhën 1961-1965, dhe për nënshkrimin e marrëveshjes mbi kredinë e akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik për mekanizimin e bujqësisë. Për këtë qëllim, në

përgjigjen e saj qeveria sovjetike, pasi njofton se nuk pranon propozimin e Qeverisë Shqiptare për të dërguar në Moskë një zëvendëskryetar të Këshillit të Ministrave, «ripohon edhe një herë që çështjet ekonomike, të cilat, sikundër dihet, lidhen drejtpërdrejt me normalizimin e marrëdhënieve, mund të diskutohen në kushtet e krijuara, vetëm në nivelin më të lartë të partive dhe të qeverive».

Një qëndrim i tillë nga qeveria sovjetike neve nuk na duket i drejtë, në pajtim me vetë çështjen në shqyrtim dhe aq më pak në pajtim me karakterin e marrëdhënieve midis vendeve pjesëtare të kampit socialist.

Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar popullin shqiptar dhe Republikën Popullore të Shqipërisë në përpjekjet për të zhdukur sa më shpejt prapambetjen shekullore dhe për të ndërtuar socializmin. Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria jonë si dhe i gjithë populli shqiptar e kanë çmuar kurdoherë me mirënjohje këtë ndihmë, e kanë konsideruar atë dhe e konsiderojnë gjithnjë si një shprehje të internacionalizmit proletar, si një ndihmë që i jep shoku shokut dhe vëllai vëllait.

Në këtë frymë Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë iu drejtuan Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe Qeverisë së Bashkimit Sovjetik për kredi të reja për realizimin me sukses të planit të tretë pesëvjeçar 1961-1965 të zhvillimit të ekonomisë popullore të Shqipërisë.

Sikundër dihet, në bazë të bisedimeve të zhvilluara në Moskë lidhur me këtë çështje në dhjetor 1958, midis përfaqësuesve të partive dhe të qeverive të të dy vendeve në nivelin më të lartë, Bashkimi Sovjetik i akordoi Republikës Popullore të Shqipërisë një kredi për peri-

udhën 1959-1965 dhe marrëveshja përkatëse, së bashku me listat mbi veprat që do të zgjerohen ose do të ndërtohen në Shqipëri, me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, në bazë të kësaj kredie, u nënshkrua në Tiranë më 3 korrik 1959. Po kështu, në përgjigje të kërkesës së Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, më 30 prill 1960, për një kredi të veçantë për mekanikë-bujqësore dhe për plehra kimike, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik pranoi t'i akordojë Republikës Popullore të Shqipërisë për këtë qëllim një kredi tjetër dhe më 25 korrik 1960 qeveria sovjetike i paraqiti Qeverisë Shqiptare projekt marrëveshjen përkatëse për nënshkrim. Përsa u përket shkëmbimeve në bazë kleringu, për periudhën 1961-1965, qysh më 3 prill 1959, pas bisedimeve të zhvilluara për këtë qëllim, është nënshkruar protokoll i përkatës nga delegacionet qeveritare të dy vendeve tona.

Në kushte të tilla, duke i konsideruar të gjitha këto çështje të vendosura në nivelin më të lartë të partive dhe të qeverive të të dy vendeve dhe të përfunduara në rregull, Qeveria Shqiptare, propozoi që marrëveshja mbi kleringun 1961-1965 dhe ajo e paraqitur nga qeveria sovjetike mbi kredinë për mekanizimin e bujqësisë të nënshkruar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë. Është e qartë se nuk kishte mbetur asnjë çështje pa u rregulluar, përveç disa ndryshime objektesh të kërkuara nga Qeveria Shqiptare me notën e ambasadës shqiptare në Moskë më 28 tetor 1960 dhe që mund të zgjidheshin fare lehtë nga të dy delegacionet.

Këtu është rasti të përmendet se pak muaj më parë vetë qeveria sovjetike i konsideronte çështjet në të njëjtën mënyrë, dhe u paraqit e gatshme të dërgonte në Shqipëri për nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve ministrin e Tregtisë së Jashtme të Bashkimit Sovjetik. Kur nga pala sovjetike na u njoftua se ky nuk mund të vinte dot në Shqipëri, për arsye shëndetësore, nga ana jonë u bënë përçapjet e nevojshme që të vinte në Moskë një delegacion qeveritar shqiptar, i kryesuar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

Sikundër shihet, çdo gjë është shumë e qartë dhe propozimi i Qeverisë Shqiptare, për të dërguar delegacionin në fjalë për qëllimin e mësipërm, është plotësisht me vend dhe i rregullt. Në këto rrethana, ne me të drejtë na çudit qëndrimi që mban qeveria sovjetike tani së fundi për këto çështje dhe nuk mund ta kuptojmë se nga ç'baza niset ajo që në mënyrë të njëanshme kërkon rishikimin e çështjeve të lartpërmendura, të diskutuara dhe të vendosura në nivelin më të lartë të partive dhe të qeverive të të dy vendeve dhe të rregulluara përfundimisht. Në përgjigjen e saj të 6 janarit 1961 qeveria sovjetike bën edhe aluzione dyshimi mbi marrëdhëniet midis dy shteteve tona dhe flet për normalizimin e tyre.

Lidhur me këtë qëndrim të qeverisë sovjetike, ne e shohim me vend t'ju shprehim hapur mendimin tonë se ky qëndrim i Qeverisë së Bashkimit Sovjetik parimisht nuk është i drejtë dhe praktikisht nuk pajtohet me gjendjen reale të fakteve dhe të çështjes në shqyrtim. Qeveria sovjetike, duke përzier marrëdhëniet shte-

tërora me ato midis partive, pa të drejtë, dhe në mënyrë të papranueshme në marrëdhëniet midis vendeve tona socialiste, kërkon t'i imponojë vullnetin e saj Partisë së Punës të Shqipërisë për të dërguar përfaqësuesin kryesor të Partisë për të biseduar për këto çështje.

Pikëpamja jonë është se çështjet e ngritura nga qeveria sovjetike kanë karakter të shtrembër dhe mund të konsiderohen me të drejtë si presione ekonomike që i bëhen shtetit tonë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, në pragun e Kongresit IV të saj, për t'i nxjerrë vështirësi ekonomike etj. Ne mendojmë se marrëdhëniet midis të dy shteteve tona janë krejt normale dhe qeveria sovjetike, duke vënë në dyshim karakterin e tyre të vërtetë, bën një vlerësim shumë të gabuar dhe të njëanshëm, me të cilin ne nuk mund të pajtohemi.

Ne duam të theksojmë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e kanë konsideruar dhe do ta konsiderojnë kurdoherë kënaqësi takimin e delegacioneve të të dyja partive e qeverive tona të nivelit më të lartë dhe të çdo niveli tjetër. Por në kushte të tilla, si e paraqit çështjen qeveria sovjetike, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e gjen të arsyeshme dhe as me vend që të dërgojë një delegacion të nivelit të lartë. E para, për arsye se siç u tha më lart çështjet për të cilat bëhet fjalë janë shqyrtuar dhe janë vendosur përfundimisht nga të dyja palët, në marrëveshje të plotë midis tyre dhe në nivelin më të lartë, dhe e dyta, për arsye se qeveria sovjetike i ngre këto çështje në mënyrë jo të drejtë, në kundërshtim me frymën e marrëdhënieve midis vendeve socialiste, pra, të papranueshme nga ana jonë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreson se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të marrë masa që edhe në të ardhshmen marrëdhëniet midis të dy vendeve tona të vazhdojnë në rrugën e drejtë të marrëdhënieve miqësore që kanë ekzistuar për një kohë të gjatë, marrëdhënie këto që i kanë lidhur ngushtë të dy vendet dhe popujt tanë. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreson se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të marrë masat e nevojshme, në mënyrë që delegacioni i caktuar nga Qeveria Shqiptare të vijë sa më parë në Moskë dhe të nënshkruajë me përfaqësuesit e qeverisë sovjetike akordet që kanë lidhje me marrëveshjet e përfunduara më parë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dëshiron t'i vërë në dukje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se, në qoftë se do të ecet në atë rrugë si i shtron çështjet qeveria sovjetike, në lidhje me marrëdhëniet midis të dy vendeve tona, duke u munduar të krijojë vështirësi për ndërtimin socialist në Shqipëri, ajo është rrugë pa krye. Natyrisht, qeveria sovjetike do të mbante përgjegjësi për rrjedhimet që do të kishin këto veprime në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, veprime që janë të papajtueshme me praktikën e deritanishme të marrëdhënieve midis partive marksiste dhe vendeve socialiste. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim se do të mënjanohen pengesat artificiale që i vihen Partisë së Punës të Shqipërisë dhe një vendi mik e aleat, një Partie marksiste dhe një vendi të vogël socialist, që luftojnë pa u tundur, në kushtet e rrethimit gjeografik armiqësor,

kundër imperialistëve dhe armiqve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve jugosllavë, për mbrojtjen jo vetëm të interesave të popullit shqiptar, por edhe të interesave të të gjitha vendeve socialiste.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë thekson se çfarëdo rrethanash që të paraqiten për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për popullin shqiptar, të cilët janë të vendosur të përballojnë me heroizëm çdo vështirësi, miqësia me popullin e madh sovjetik do të qëndrojë e paprekshme.

Ne shpresojmë se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do t'i shqyrtojë me vëmendje këto çështje të rëndësishme dhe do të na japë përgjigje brenda një kohe të afërt, me qëllim që marrëveshjet në fjalë të nënshkruhen sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me porosi të Komitetit Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të PPSH»,
vëll. III, Tiranë, 1970*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LETËR PËRGËZIMI DREJTUAR NAFTËTARËVE DHE EFEKTIVIT TË REPARTEVE TË AVIACIONIT

7 shkurt 1961

GJITHË PUNONJËSVE, INXHINIERËVE DHE TEKNIKËVE
TË INDUSTRIË SË NAFTËS
GJITHË EFEKTIVIT TË REPARTEVE TË AVIACIONIT

Qyteti «Stalin»

Të dashur shokë,

Lajmi juaj mbi prodhimin e lëndës djegëse për aviacionin tonë reaktiv na gëzoi shumë. Ky sukses i ri i specialistëve të naftës dhe të regjimentit të aviacionit në pragun e Kongresit IV të Partisë sonë të dashur është një fitore e rëndësishme në forcimin e ekonomisë dhe të aftësive luftarake të ushtrisë sonë të lavdishme, për mbrojtjen e kufijve ajrorë të atdheut tonë socialist.

Partia jonë e Punës e ka çmuar gjithmonë shumë kontributin e punonjësve të industrisë së naftës për ndërtimin socialist të vendit. Përfundimi me sukses i provave për prodhimin dhe për përdorimin e lëndës djegëse reaktive për aviacionin është një shembull i ri i

patriotizmit të lartë të naftëtarëve, i dashurisë që ata ushqejnë për Partinë e Punës dhe për Ushtrinë tonë Popullore, që lindi në betejat e ashpra të luftës kundër okupatorëve dhe kundër tradhtarëve të vendit. Ai është fryt i bashkëpunimit krijues e të ngushtë midis specialistëve të naftës dhe të aviacionit tonë ushtarak, i cili e ka burimin në punën e madhe që ka bërë Partia për edukimin komunist të punonjësve, të cilët nuk kursejnë asgjë për të mirën e atdheut dhe të popullit, për forcimin e ushtrisë sonë që është roje vigjilente e pavarësisë dhe e tërësisë tokësore të Shqipërisë, e fitoreve të mëdha që ka korrur populli ynë në ndërtimin socialist.

Duke ju përshëndetur nxhtësisht dhe duke ju përgëzuar nga zemra për këtë sukses, u uroj gjithë punonjësve, inxhinierëve dhe teknikëve të industrisë së naftës fitore më të shkëlqyera në punë, për të prodhuar sa më shumë produkte të reja naftë të nevojshme për ekonominë tonë popullore!

I uroj gjithashtu gjithë efektivit të reparteve të aviacionit suksese më të mëdha në pregatitjen luftarake për mbrojtjen e kufijve të shtrenjtë të Republikës Popullore të Shqipërisë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PARTIA JONË ËSHTE EDUKUAR TË MBROJË ATA
QË KANË TË DREJTË DHE TË KRITIKOJË
ATA QË S'KANË TË DREJTË**

*Bisedë me delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës
që kishte ardhur për të marrë pjesë
në Kongresin IV të PPSH¹*

9 shkurt 1961

Në fillim, shoku Enver Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë të PPSH përshëndeten nxehtësisht me miqtë kinëzë dhe u urojnë mirëseardhjen. Ndërkaq, kryetari i delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës, shoku Li Hsien Nien, thotë:

Shoku Mao Ce Dun dhe shokët e tjerë ju përshëndesin ju shoku Enver Hoxha, shoku Mehmet Shehu, shoku Hysni Kapo dhe shokë të tjerë të Komitetit Qendror.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemi nderit shumë!

SHOKU LI HSIEN NIEN: Si jeni me shëndet?

¹ Në këtë takim, nga ana e PPSH ndodheshin edhe shokët Mehmet Shehu, Hysni Kapo dhe Spiro Koleka.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne jemi shumë mirë dhe punët na venë gjithashtu mirë. Jemi përgatitur për Kongresin IV të Partisë dhe jemi shumë të lumtur e të gëzuar që kemi me këtë rast në gjirin e Partisë dhe të popullit tonë përfaqësuesit e Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, jemi të gëzuar që kemi këtu shokun Li Hsien Nien, një nga bashkëpunëtorët e afërt të shokëve Mao Ce Dun, Çu En Lai, Çu De, Ten Hsiao Pin. Partia dhe populli do të gëzohen shumë kur të marrin vesh sonte ardhjen tuaj në Shqipëri, sepse ata e duan me gjithë shpirt popullin dhe Partinë tuaj të lavdishme.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Ju falemi nderit!

SHOKU ENVER HOXHA: Si janë me shëndet shokët Mao Ce Dun, Çu En Lai dhe shokët e tjerë?

SHOKU LI HSIEN NIEN: Janë shumë mirë të gjithë. Edhe ne gëzohemi që ju jeni shumë mirë, sepse shëndeti juaj është lumturi jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht ne kemi edhe vështirësi, po kemi një Parti të çeliktë, kemi një popull të fortë, luftëtar dhe patriot, që nuk u tremben vështirësive, po i kapërcejnë ato me vendosmëri.

Populli kinez dhe populli ynë janë të lashtë nga historia, por të rinj nga zemra. Ata kanë luftuar gjithë jetën e tyre për të drejtën dhe për të mirën. Jeta pa luftë nuk ka kuptim për popujt tanë. Me këtë, natyrisht, nuk duhet kuptuar se dy popujt tanë janë partizanë të luftës së nxehtë, «për të shpallur luftën botërore», ashtu sikurse na akuzojnë, (të qeshura) po janë partizanë të luftës për mbrojtjen e paqes, për ndërtimin e

socializmit dhe për demaskimin gjer në fund të imperializmit dhe të revizionizmit. Me një fjalë, luftën ne e kuptojmë si marksistë.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Në Mbledhjen e Bukureshtit si dhe në atë të Moskës qëndrimet dhe pikëpamjet e PPSH, me shokun Enver Hoxha në krye, ishin shumë të prera dhe të qarta dhe ne ju jemi shumë mirënjohës përjetë për përkrahjen që i dhatë atje Partisë sonë. Të gjithë komunistët kinezë si dhe mbarë populli ynë e dinë shumë mirë se në Shqipëri ka një Parti marksiste-leniniste.

Në vendin tonë midis komunistëve kinezë njihen shumë shprehje revolucionare shqiptare, si «me parimet ne nuk bëjmë tregti», «marksizmi nuk mbrohet vetëm në një vend të madh, ai mund të mbrohet shumë mirë edhe në një vend të vogël» etj. Dhe jeta po vërteton drejtësinë e vijës së PPSH që udhëhiqet nga shoku Enver Hoxha.

Duke vazhduar shoku Li Hsien Nien u bën të ditur shokut Enver Hoxha dhe udhëheqësve të tjerë të Partisë e të shtetit tonë që ndodheshin në takim se, gjatë udhëtimit për në Shqipëri, delegacioni kinez, duke kaluar në Moskë, u prit nga Susllovi, Kozllovi e Andropovi, të cilët, ndër të tjera, ngritën disa probleme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet sovjeto-shqiptare.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne i dëgjuam me shumë kujdes këto që na thatë. Unë dëshiroj t'ju them juve se ne kemi bindje që Partia jonë, si në Bukuresht, ashtu edhe në Moskë, mbajti atë qëndrim që duhet të mbante çdo parti marksiste-leniniste, domethënë një qëndrim të patundur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe

të internacionalizmit proletar. Kjo ishte një detyrë për çdo parti marksiste.

Këtë qëndrim Partia jonë nuk e mori rastësisht, po me plot ndërgjegje, sepse ashtu është edukuar. Partia jonë është edukuar të mbrojë kurdoherë marksizëm-leninizmin, të mbrojë ata që kanë të drejtë dhe të kritikojë ata që nuk kanë të drejtë, që janë larguar nga marksizëm-leninizmi, pavarësisht kush janë ata. Këtë Partia jonë e bën në frymë të drejtë dhe internacionaliste.

Me këto qëndrime që mbajti Partia jonë në Bukuresht dhe në Moskë, nuk mori parasysh ç'do t'i ndodhte, pasi ajo ka qenë dhe është e bindur se një parti që mban qëndrim të drejtë, marksist-leninist, ajo do të fitojë me siguri në mos sot, nesër.

Partia jonë ka qenë e qartë edhe për çështjet organizative. Lufta kundër deviatorëve të marksizmit duhet të bëhet e hapur, pa druajtje, pa diplomaci dhe kurdoherë brenda normave leniniste, sepse kështu mbrohet marksizëm-leninizmi, kështu mbrohet internacionalizmi proletar. Ne ishim të bindur se ata që nuk ishin në rrugë marksiste-leniniste nuk do ta pëlqenin rrugën tonë, se ata do të na luftonin jo në rrugë parimore. Por ne kemi qenë dhe jemi të bindur se ata do të humbasin në orvatjet e tyre.

Ne kemi studjuar vazhdimisht me kujdes të madh vijën e udhëheqjes sovjetike për shumë probleme, si për çështje të brendshme ideologjike, politike dhe ekonomike, ashtu edhe në çështjet ndërkombëtare, jo vetëm të kampit të socializmit, po të të gjithë botës. Ne kemi ndjekur me kujdes dhe me vëmendje çdo qëndrim të udhëheqjes sovjetike, sepse, sido që jemi një Parti e

vogël kemi edhe ne përgjegjësinë që na takon për mbrojtjen dhe për zbatimin drejt të marksizëm-leninizmit.

Ne kemi ndjekur gjithashtu me kujdes e me vëmendje të madhe politikën dhe zhvillimin e Republikës Popullore të Kinës dhe të Partisë Komuniste të Kinës dhe prej kohësh kishim arritur në konkluzionin se udhëheqja sovjetike po gabonte me qëndrimet e saj, ndërsa Partia Komuniste e Kinës ndiqte një vijë të drejtë marksiste-leniniste.

Konkluzionet tona ne nuk i kemi mbajtur në xhep, por i kemi bërë të ditura se frikë nuk kemi pasur kurrë nga Nikita Hrushovi, për t'ia thënë, ashtu sikurse duhet të thuhet vërejtjet midis marksistëve. Sigurisht këtë ne e kemi bërë pa cenuar miqësinë tonë me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë e tij Komuniste Bolshevike.

Pra, në Bukuresht ne kishim bindje të plotë për çka mbronim dhe ishim kryelartë që në këtë rrugë të drejtë u ndodh edhe Partia e lavdishme Komuniste e Kinës, e cila mbronte gjithashtu marksizëm-leninizmin. Marksizëm-leninizmin e mbronte Partia jonë e vogël, po kur pamë se atë e mbronte edhe Partia e madhe Komuniste e Kinës, në Byronë tonë Politike u bindëm akoma më shumë se vija e Partisë sonë është plotësisht e drejtë. Ne jemi vërtet një parti e vogël, një popull i vogël, megjithatë edhe ne kemi të drejtë të rrojmë dhe të luftojmë në rrugën marksiste-leniniste dhe po në këtë rrugë të themi fjalën tonë.

Shumë herë imperializmi, për ato që s'ka interes, hesht ose bën shpifje në kurrizin e të tjerëve. Por ne nuk mendonim kurrë që do të vinte dita kur kështu

të vepronin kundër Shqipërisë udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik si edhe përfaqësues të disa partive komuniste, siç janë ato të vendeve socialiste të Evropës. Por e drejta nuk mbytet, ajo do të fitojë kurdoherë. Këtë ta dinë mirë edhe njerëz si Valter Ulbrihti, që shkel Deklaratën e Moskës, duke na akuzuar ne si dogmatikë. Moral komunist është ky? Jo, nuk është.

Të vërtetën, ne e thamë edhe në Bukuresht, edhe në Moskë, prandaj nuk e quajmë të nevojshme të zgjatemi. Në qoftë se qëndrimi ynë nuk i pëlqen udhëheqjes sovjetike, ne jemi të sigurt se kur populli sovjetik të mësojë të vërtetën, do të na përkrahë.

Ne jemi krenarë, të sigurt dhe të bindur për triumfin e kauzës sonë, sepse nuk jemi vetëm, se me ne është Partia e madhe Komuniste e Kinës, që ka një Komitet Qendror të vendosur me shokun Mao Ce Dun në krye.

Në Mbledhjen e Moskës delegacioni juaj ka dhënë një kontribut të madh. Fjalimet e tij ishin si «artileri e rëndë», duke filluar që nga punimet e komisionit të redaktimit e gjer në punimet e Mbledhjes së Moskës.

Pastaj ne nuk jemi vetëm dy parti që mbrojmë marksizëm-leninizmin, shumë parti të tjera janë me ne. Nuk kanë kaluar më tepër se dy muaj nga Mbledhja e Moskës dhe po shohim se ka tërmete edhe në ato parti ku udhëheqja qëndron në pozita oportuniste dhe revizioniste. Moris Torezi në Mbledhjen e Moskës thekson se rreziku kryesor për partitë tona është dogmatizmi, Kina, po tani po vëmë re se dy anëtarë të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Francës, Kazanova dhe Serveni, e mund të ketë edhe

të tjerë, janë në rrugë oportuniste dhe revizioniste. Të mos harrojmë se të dy këta njerëz janë dekoruar nga Nikita Hrushovi me çmimin e paqes «Lenin»!

Por neve na vjen shumë keq dhe jemi jashtë-zakonisht të hidhëruar që këto gjëra ndodhin sidomos në kokën e Bashkimit Sovjetik. Ne e duam Bashkimin Sovjetik, por jo ata udhëheqës të tij që nuk janë në rrugë të drejtë. Bashkimin Sovjetik ne e duam si në kohë të mira dhe ca më tepër tani, në këto kohë të vështira, prandaj do ta mbrojmë atë. Po si do ta mbrojmë? Do ta mbrojmë Bashkimin Sovjetik duke mos u pajtuar me qëndrimet e gabuara të disa udhëheqësve të tij. Sugjerimet e Kozllovit kur thotë se «po të na atakojnë shqiptarët, ne do t'u përgjigjemi», ne nuk na trembin. Luftës ne nuk i trembemi, po do të mbrojmë kurdoherë rrugën e drejtë.

Ne i hedhim poshtë «këshillat» e Kozllovit, pse këshillat e tij dhe të Hrushovit me shokë janë këshilla prej revizionistësh. Çdo ditë që kalon bindemi edhe më shumë se ata nuk janë njerëz të mirë.

Le të mos përmendim të tjerat, po të flasim vetëm për çështjen e letrës¹. Kreditë që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik janë diskutuar në një takim të përbashkët të nivelit më të lartë qysh në vitin 1958. Kemi qenë në atë takim unë e shoku Mehmet nga ana jonë dhe Hrushovi, Mikoiani e Kozllivi nga pala sovjetike. Në këtë takim kemi diskutuar për planin tonë, kërkuam kredi për ta përballuar atë dhe jo vetëm na u caktua kredia, po u nënshkrua edhe dokumenti përkatës. Më vonë u

¹ Shih në këtë vëllim f. 27 (letra e 14 janarit).

nënshkrua zyrtarisht marrëveshja përkatëse nga një zëvendëskryeministër yni. Aty janë caktuar objektet që do të na jepen, afatet, janë bërë projektet dhe është nënshkruar çdo gjë. Të gjitha këto janë në dokumente zyrtare. Atëherë përse të ngrihemi unë dhe shoku Mehmet tani, përpara Kongresit IV të Partisë dhe të shkojmë në Moskë? Apo sepse kështu dashka Nikita Hrushovi? Cili është qëllimi i Nikita Hrushovit? Sigurisht qëllimi i tij është që ne të shkojmë në Moskë dhe t'i përulemi, t'i puthim dorën, pastaj të shkruhet edhe në gazetën «Pravda», ku për më tepër se 4 muaj nuk po shkruhet asnjë fjalë për Shqipërinë. Kështu po të shkojmë ne tani atje, të thuhet që PPSH, Enver Hoxha, Mehmet Shehu e gjithë Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i PPSH u përulën. Ne këtë nuk e pranojmë. Ne i thamë hapur Nikita Hrushovit se ti je i fuqishëm ekonomikisht, po ne jemi të fuqishëm ideologjikisht, pse mbrojmë marksizëm-leninizmin. Pra në qoftë se ti merr masa ekonomike kundër nesh, populli shqiptar shtrëngon edhe rripin dhe nuk përulet.

Çështja e letrës nuk qëndron ashtu siç e ngrenë udhëheqësit sovjetikë. Përkundrazi, letra e Komitetit Qendror të Partisë sonë është një letër me frymë shoqërore, prandaj Nikita Hrushovi dhe Froll Kozllivi mbi këtë çështje shpifin. Ne do t'jua japim letrën ta lexoni për ta parë sa shoqërore është përmbajtja e saj. Por ata janë vënë në pozita shumë të vështira. Çdo qëndrim i tyre ndaj nesh është fals, sepse nuk është as në baza marksiste, as në baza miqësore.

Skandaloze dhe plot shpifje është edhe çështja e tërheqjes së specialistëve. Pesë muaj më parë ne u kër-

Bashkimit Sovjetik, as kampit të socializmit. Por ne kemi plotësisht të drejtë të themi mendimin tonë.

Udhëheqësit sovjetikë për një gjë duhet të jenë të bindur dhe të qartë: se ne nuk trembemi, dy duar, thotë populli ynë, për një kokë janë, por të ulim kurrizin dhe të shkelim marksizëm-leninizmin këtë ne nuk e bëjmë, sepse marksizëm-leninizmi për ne është jeta. Po të mos ishte Partia jonë nuk do të kishte liri për popullin tonë, ai sot do të rronte në robëri. Në qoftë se nga ne nuk zbatohet në mënyrë konsekuente marksizëm-leninizmi, në Shqipëri do të sundonin bejlerët e agallarët dhe populli do të vuante. Në saje të marksizëm-leninizmit ne po ndërtojmë socializmin, po ngrihet mirëqenia dhe kultura e popullit, po rritet besimi dhe dashuria e madhe që kanë për popullin dhe për vendin tonë komunistët dhe popujt përparimtarë të të gjithë botës. Prandaj po ta shkelnim marksizëm-leninizmin, do të ishte e pafalshme për Partinë tonë dhe katastrofale për vendin tonë.

Përse e duan populli dhe Partia Komuniste e Kinës Partinë dhe popullin tonë? I duan sepse Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë luftuar dhe qëndrojnë në pozita të drejta. Hrushovi dhe pasuesit e tij këtë e dinë fare mirë. Ne ia thamë dhe përsëri do t'ia themi pikëpamjen tonë në rast se ai vazhdon të ecë në rrugën e tij të gabuar.

Në Bashkimin Sovjetik ne kemi shumë njerëz që studjojnë, të cilët njerëzit sovjetikë i duan me gjithë shpirt. Ne kemi marrë letra nga bolshevikë të vjetër, që kanë një stazh prej 45-50 vjetësh në parti, të cilët na shkruajnë haptazi se janë plotësisht dakord me qëndrimet tona

në Mbledhjen e Moskës. «Ne, thonë ata, shprehim me letër ndjenjat e popullit dhe të Partisë së Leninit».

Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të Bashkimit Sovjetik. Ç'bëjnë ata në vendin dhe në parti në vet, është punë e tyre, po përse ata përzihen në punët tona dhe organizojnë te ne komplete? Apo sepse janë të mëdhenj? Këto veprime nuk mund t'i lejojmë në asnjë mënyrë.

Ne jemi në rrugë të drejtë dhe do të ecim në miqësi të ngushtë me shokët kinezë, me komunistët e vërtetë sovjetikë dhe me të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, sepse kemi një interes të përbashkët dhe, ca më tepër, interesin e Republikës së vogël Popullore të Shqipërisë, por kurdoherë do të ecim në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe jo në rrugën e hrushovianëve, të cilët i bëjnë presione ekonomike dhe politike vendit tonë. Ç'do të thotë të mos i japësh Shqipërisë kreditë që ke caktuar? Kjo do të thotë të çirren marrëveshjet, po marrëveshjet Hitleri dhe imperialistët i kanë çjerrë e i çjerrin dhe jo komunistët.

Çfarë ka me ne Hrushovi? Ç'u bë në Mbledhjen e Moskës? Ne i kritikuan dhe ata na kritikuan. Këtë do ta bëjmë kurdoherë kur vihen re shtrembërime, se jemi komunistë dhe problemet do t'i zgjidhim si komunistë: po të kritikova unë, edhe ti përgjigjmu dhe kështu, të sqarohemi. Mund të mbeten edhe gjëra të pazgjidhura, ato mund t'i zgjidhim nesër, po nuk është marksiste të shkojnë në popull dhe në parti, siç bënë Hrushovi me kompani dhe të thonë që «Enver Hoxha i hodhi baltë Bashkimit Sovjetik». Në të vërtetë Partia jonë nuk i hedh baltë askujt, por kritikon veprimet

antimarksiste të Hrushovit. Kurrë nuk i kam hedhur dhe nuk do t'i hedh baltë Bashkimit Sovjetik! Kështu më ka mësuar dhe më mëson Partia. Pse nuk flet hapur Hrushovi dhe të thotë që «Enver Hoxha më kritikoi mua në Mbledhjen e Moskës», se «ai kritikoi ambasadorin sovjetik», që u përpoq të përçante e të rrëzonte udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë?

Hrushovi na akuzon ne, shqiptarët, se jemi «gjaknxehetë», pse vërejtjet tona atij nuk i pëlqejnë; na akuzon se ne gjoja nuk e njohim marksizëm-leninizmin, se nuk dimë të bëjmë politikë etj.! Ne nuk pretendojmë se dimë gjithçka, po mendojmë se hapin e hedhim të matur dhe nuk nxitohemi, siç bën ai, që thotë se «Ajzenhaueri është njeri i paqes». Tani, sipas Hrushovit na paska dalë Kenedi njeri i paqes, po në të vërtetë si Ajzenhaueri, ashtu edhe Kenedi janë përfaqësues të monopoleve të mëdha të kapitalit amerikan. Pra, kur ndodhin gabime të tilla në mes nesh, ne duhet ta ngremë zërin. Prandaj nuk i pranojmë këshillat e Hrushovëve, të Kozlllovëve etj., që u vjen thartë kur ne u vëmë në dukje veprimet e ulëta e antimarksiste të tyre kundër nesh. Jo ne, por Hrushovi, Kozlllovi e Ulbrihti të mësojnë të bëjnë politikë, të njohin marksizëm-leninizmin dhe ta zbatojnë drejt atë.

Pesëmbëdhjetë radio në ditë flasin kundër Shqipërisë duke u bazuar në fjalën e Valter Ulbrihtit. E pas gjithë këtyre Froll Kozlllovi na këshillon ne që «Kongresi IV i PPSH të bëhet kongresi i miqësisë»! Miqësia tregohet me vepra e jo me fjalë. Ata flasin me fjalë për miqësinë, po nga ana tjetër të vënë thikën.

Miqësia e sinqertë është miqësia e popullit dhe e

partisë suaj. Prandaj me këtë rast dëshiroj që në emër të Komitetit Qendror të Partisë t'ju falënderoj nga zemra për pritjen shumë të ngrohtë, shoqërore dhe internacionaliste që iu bë në vendin tuaj delegacionit tonë me shokun Spiro Koleka në krye¹, për ndihmën bujare që na dha partia dhe qeveria juaj në këto momente të vështira. Kjo ka qenë dhe është një ndihmë ndërmjet vëllezërish dhe shokësh të vërtetë. Ne i kuptojmë mirë dhe vështirësitë tona, edhe tuajat, po momentet e vështira dhe të bukura, hidhërimet dhe gëzimet, bashkë do t'i kalojmë. Dhe kështu duhet të jetë miqësia e vërtetë. Një fjalë e mirë për ne në këto kohë të vështira është inkurajim i madh për popullin shqiptar, i cili kërkon vetëm miqësi të sinqertë dhe në rrugë të drejtë, marksiste-leniniste.

Vihet pyetja: me popujt sovjetikë, me Bashkimin Sovjetik si do të vejë puna jonë? Ne do të përpiqemi me të gjitha forcat që miqësia në mes Shqipërisë dhe BRSS të kalitet, sepse kjo miqësi ka rëndësi të madhe. Ne do të punojmë pa u lodhur në këtë drejtim. Natyrisht, forcimi i miqësisë varet nga ne, po varet edhe nga ata, pra nga të dyja palët. Ne nuk duam asgjë tjetër nga ana e tyre përveçse të mbajmë marrëdhënie miqësore, por në rrugë marksiste-leniniste, që ata të mbajnë angazhimet e marra. Mosmarrëveshje me udhëheqjen sovjetike ne kemi, por ato duhet t'i zgjidhim vetëm në rrugën marksiste-leniniste.

¹ Delegacioni qeveritar për çështje ekonomike i RPSH, i kryesuar nga shoku Spiro Koleka, vizitoi RP të Kinës në janar të vitit 1961.

Nga parimet ne nuk lëvizim. Edhe unitetin e kampit të socializmit, që është një çështje jetike, ne e kuptojmë vetëm mbi bazën e parimeve. Uniteti i kampit socialist nuk duhet kuptuar që mua të më sabotosh, ose t'i hapësh dyert imperializmit, të thuash fjalë të mira sot për Ajzenhauerin, nesër për Kenedin, me një fjalë, të ngopesh me lugë të zbrazët, siç thotë populli.

Ne nuk mund ta kuptojmë lënien e Kinës, që është nga fuqitë më të mëdha në botë, jashtë arenës ndërkombëtare. Mendojmë se Kina duhet të marrë medocmos të gjitha të drejtat që i takojnë në organizatat ndërkombëtare, sepse vetëm kështu forcohet kampi i socializmit dhe jo me Titon, me Nehrunë e të tjerë si këta. Në radhë të parë, ne duhet të luftojmë që të forcojmë kampin tonë se në këtë mënyrë krijohen kushte që të mbajmë pranë e të ndihmojmë vende si Indonezia e të tjera. Por një unitet me mënyrat si po vepron Hrushovi, ne nuk e kuptojmë dhe nuk e pranojmë.

A nuk është një çështje me rëndësi shumë të madhe ndërkombëtare çështja e Kinës? A nuk i mohohen sot të drejtat Republikës Popullore të Kinës? Atëherë le të mblidhemi një herë të gjithë së bashku dhe ta bisedojmë këtë çështje shumë të rëndësishme, sepse çështja kineze është jetike për tërë kampin tonë. Në një mbledhje të tillë është e domosdoshme që ne të vendosim taktikën që duhet të ndjekim bashkërisht për zgjidhjen e këtij problemi të madh ndërkombëtar. Por, me sa mund të bësh stan me lepuj, aq mund të mbledhësh edhe Nikita Hrushovin me shokë për këtë çështje. Mirëpo ç'ndodh nga një qëndrim i tillë? Duke mos i pëlqyer fjalët tona, Hrushovi me pasuesit e tij flasin

kundër nesh, sepse «shqiptarët janë me Kinën». Po, shqiptarët janë me Kinën, janë me të drejtën, me marksizëm-leninizmin, ata janë për forcimin e unitetit të kampit të socializmit. Kështu e kuptojmë ne këtë çështje. Po pikëpamjet tona nuk i pëlqejnë Nikita Hrushovit. Po atëherë si t'i themi ne Nikita Hrushovit për këto qëndrime, që «ke të drejtë»? Apo të bëjmë si thotë Gomulka? Pra ne jemi të bindur se e kemi drejt luftën që bëjmë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Ne do të përdorim në zhvillimin e kësaj lufte edhe taktikë edhe politikë, po gjithmonë atë taktikë dhe atë politikë që është në favorin tonë dhe në rrugën marksiste-leniniste.

Parimet duhet të mbeten parime. Uniteti duhet të mbështetet në parimet tona të njohura, por që të ruhet ky unitet është e drejtë që ne t'i ruajmë format e jashtme, që këto mosmarrëveshje, kur ekzistojnë mundësitë e zgjidhjes, të mbeten midis nesh, brenda komiteteve tona qendrore, kur lind ndonjë kontradiktë duhet më parë t'ia themi njëri-tjetrit. Por kjo ama gjer në një farë shkalle e për një farë kohe se edhe këtu ka një kufi, ndryshe gjendja kalbëzohet.

Ka çështje të mëdha ndërkombëtare për të cilat bien në sy kontradiktat. Ja, për shembull, tani del kjo kontradiktë midis nesh dhe revizionistëve: tjetër është qëndrimi ynë ndaj imperializmit amerikan dhe tjetër është qëndrimi i udhëheqjes sovjetike. PK e Kinës, PP e Shqipërisë e disa parti të tjera, flasin ashtu si duhet kundër Kenedit dhe kundër forcave ekonomike dhe politike që mbështet presidenti i ri amerikan, domethënë kundër imperializmit amerikan, që është bërë

sot xhandari ndërkombëtar, kurse politika zyrtare e qeverisë sovjetike në gazetën «Pravda», ose në revistën «Novoje vremja»¹ del hapur ndryshe nga qëndrimi ynë. Në «Pravda» shkruhet se Ajzenhaueri dhe grupi i tij nuk janë më në Shtëpinë e Bardhë, sepse në kolltukët e Shtëpisë së Bardhë paskan ardhur njerëz të rinj dhe me qëllime të tjera. Këto janë fjalët që propagandon i gjithë shtypi sovjetik. Ja, pra, këtu duket sheshit një nga kontradiktat tona.

Le të marrim edhe çështjen e revizionistëve jugosllavë. Dihet se këta janë agjentë të imperialistëve amerikanë. Mirëpo Hrushovi me shokët e tij nuk janë për demaskimin e tyre, në një kohë që revizionistët jugosllavë demaskohen plotësisht nga Partia Komuniste e Kinës dhe nga Partia e Punës e Shqipërisë. Këtu duket sheshit se midis partive tona dhe PK të BS e disa partive komuniste të tjera nuk ka një unitet mendimi e veprimi. Pra të mbyllim gojën edhe për këtë çështje? Jo, këtë ne nuk e bëjmë. Përsëri edhe këtu del një kontradiktë tjetër.

Hrushovi i jep Indonezisë avione, tanksa, municione me vleftë gjer në 400 milion dollarë për të çliruar Irianin Perëndimor, kurse në Shqipëri ai organizon komplete dhe na kërcënon me heqjen e bazës ushtarake-detare të Vlorës, nuk na furnizon me armatime, megjithëse ekziston një marrëveshje e tillë midis dy vendeve tona për këtë çështje. Edhe kjo është një kontradiktë.

Natyrisht, për një çështje të tillë, si për shembull,

1 «Kohët e reja».

për çarmatimin etj. ne, duke u mbështetur në gjendjen e tanishme të ngjarjeve, hëpërhë nuk do të shkruajmë në gazetë, po kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit, megjithëse udhëheqësit sovjetikë nuk flasin, ne do të shkruajmë. Prandaj në qoftë se këto kontradikta nuk do të sheshohen midis nesh, nesër mund të bëhen të rrezikshme. Rreziku kryesor rëndon mbi ne, për paqen në Ballkan dhe për vetë Bashkimin Sovjetik.

Të marrim një shembull tjetër. Hrushovi bisedon me Venizellosin, që është një borgjez liberal, shef i reaksionit grek, agjent i anglezëve. Kur kthehet Venizellosi nga Moska në Greqi, shpall të gjitha bisedimet që pat bërë me Hrushovin. Ne, pa përmendur emrin e Hrushovit, iu përgjigjëm Venizellosit se kufijtë e Shqipërisë janë të pakalueshëm, po ama njëkohësisht, me artikullin që botuam në gazetë, i dhamë përgjigje edhe Hrushovit, sado që këtë çështje ia thamë më vonë edhe në Mbledhjen e Moskës. Me një fjalë me atë artikull i ramë derës që të dëgjonte penxherja, siç thonë andej nga Gjirokastra.

Ja, pra, se si politika jo e drejtë e Nikita Hrushovit krijon kontradikta në lëvizjen komuniste, të cilat ne s'kemi si i evitojmë. Një politikë jo e drejtë, jomarksiste, me gjithë dëshirën tonë të mirë që kontradiktat të zgjidhen, shumë herë i bën ato të paevitueshme se kanë të bëjnë me çështje jetike të popullit tonë. Biseda e Hrushovit me Venizellosin ka të bëjë me një pjesë të vendit tonë, me Shqipërinë e Jugut. Kush e krijoi këtë situatë? Nikita Hrushovi.

Kjo është luftë. Në luftën tonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar,

ne duhet të bazohemi në Deklaratën e Moskës. Por unë thashë tani se ne, duke mbrojtur Deklaratën e Moskës, do të ndeshemi patjetër me Nikita Hrushovin, se ai mban qëndrime të kundërta nga kjo deklaratë. Prandaj, ne themi se ndeshja me revizionistët është e paevitueshme.

Kështu mendojmë ne. Koha do ta tregojë kush ka të drejtë, por të themi në këto situata si Mikojeni që «Gomulka është marksist-leninist i shquar», këtë s'e bëjmë kurrë dhe i themi Mikojenit: «Mbaje Gomulkën, të rruat!» Ne e dimë ç'është dhe si vepron Gomulka. Këtë e dinë edhe armiqtë e socializmit. Në fjalimin e tij të parë programatik Kenedi kishte një pikë të veçantë ku foli për miqësinë me Poloninë, kurse nga ana tjetër, në një pikë tjetër të fjalimit të tij, përmendte «çlirimin» nga skllavëria të vendeve të demokracisë popullore! Mirëpo në gazetën «Pravda» kjo pjesë e fjalimit të Kenedit, që ka të bëjë me miqësinë me Poloninë, nuk është botuar. Nga ana tjetër në gazetën polonëze flitet se «tani në Uashington fryn një erë e re» dhe kjo sipas nesh, është era e dollarëve. I tillë «marksist-leninist» i shquar është Gomulka! Kurse sovjetikët e kanë hequr atë pjesë të fjalimit të Kenedit që bën fjalë për armatimet dhe besojnë se ne nuk i kuptojmë këto që bëjnë, sikur jemi vetëm për të ngrënë bukë. Taktikën dhe strategjinë e luftës së amerikanëve dhe të Kenedit në çështjen e armatimeve ne e kuptojmë. Në lidhje me çështjen e armatimeve, në fjalimin e Kenedit, kishte një gjë interesante. Ai thoshte se «ne do të forcojmë aviacionin për transport trupash». Kjo është një pjesë e strategjisë së tij, por Nikita Hrushovi i ka hequr

vijën e kuqe dhe nuk ka lejuar të botohet. Përse e ka hequr?

Sipas silogjizmës së tij Kenedi thotë se Kina është bërë e rrezikshme. Pra, thëniet e Nikita Hrushovit dhe të të tjerëve që «Kina do luftë» i mbështet edhe Kenedi. Në këtë mënyrë prej të gjithë këtyre armiqve trumbe-tohet se «Kina është luftënxitëse dhe dogmatike». Këto, pra, janë kontradikta që nuk mund të mbulohen.

Jo më shumë se 5-6 ditë përpara, delegati ynë në konferencën e gazetarëve që u bë në Pragë, na tha se gazetarët sovjetikë kanë insistuar të mos flitej në shtyp kundër imperializmit amerikan. Iu desh një gazetari kinez të luftonte shumë për këtë çështje sa që edhe ata u detyruan ta pranonin pikëpamjen e shokut kinez, domethënë në shtypin përparimtar të shkruhet dhe të demaskohet imperializmi. Dhe ç'bëjnë ata? Rrinë një muaj pa folur kundër imperializmit, pastaj lëshojnë ndonjë glasë, shkruajnë ndonjë artikull në qoshen e ndonjë reviste, sa për të thënë se «ja, edhe ne kemi folur për këtë çështje».

Ose të marrim një çështje tjetër. A është e rregullt në një parti marksiste-leniniste që, duke punuar Deklaratën e Moskës në organizatat-bazë, të thuash «mos bëni as pyetje as diskutime, se ndaj atij që pyet ose diskuton do të merren masa»? Ja, këtë bën udhëheqja e Partisë Komuniste të Bullgarisë. Prandaj ne kemi besim se do të fitojmë me qëndrimin tonë të drejtë, dhe me siguri Teodor Zhivkovit do t'i dalë boja në mos sot, nesër.

Nejse, ne kemi besim se çdo gjë do të shkojë mirë se me ne janë miliona, me ne është e drejta marksiste-

-leniniste. Lufta kundër imperializmit, për interesat e popullit, bën që njerëzit të fitojnë të drejtat e tyre kombëtare. Por kushdo që ngrihet për të drejtat e popullit të vet nga armiqtë e popujve konsiderohet komunist, pse me komunizmin është e lidhur e drejta, e vërteta. Pra lufta me armë në dorë për shkëputjen e zinxhirëve të imperializmit i bën njerëzit realistë dhe të shkojnë me ato vende ku sundon e drejta, i bën të ndjekin rrugën e caktuar nga Marksi, nga Engelsi, nga Lenini dhe nga Stalini.

Edhe një herë, të dashur miq, unë shpreh gëzimin e madh që ndiejmë ne për ardhjen tuaj në Kongresin tonë. Jemi shumë të gëzuar sidomos për ardhjen tuaj, shoku Li, që jeni një mik i vjetër i Shqipërisë, se po vini për herën e dytë në vendin tonë¹. Me këtë rast ju do të shihni edhe ndryshimet që janë bërë brenda këtyre pesë-gjashtë vjetëve.

Shoku Li Hsien Nien, pasi falënderoi shokun Enver Hoxha për mbrojtjen e zjarrtë dhe për vlerësimin e lartë që u bëjnë PPSH, Komiteti i saj Qendror dhe gjithë populli shqiptar PK të Kinës dhe RP të Kinës, shprehu mirënjohjen e thellë dhe respektin e madh që gëzon te PK e Kinës PP e Shqipërisë për luftën e saj të drejtë, parimore e të guximshme kundër revizionistëve modernë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit. Pasi foli për gjendjen e brendshme në RP të Kinës, për vlerësimin që u ka bërë KQ i PK të Kinës

¹ Shoku Li Hsien Nien kryesonte delegacionin qeveritar të RP të Kinës që erdhi në vendin tonë në nëntor 1954 për të marrë pjesë në festën e 10-vjetorit të Çlirimit të RP të Shqipërisë.

Mbledhjes së Moskës dhe mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ai shprehu bindjen se PK e Kinës dhe PP e Shqipërisë, të mbështetura fort në parimet e marksizëm-leninizmit, do ta çelikosin më tej miqësinë dhe unitetin midis dy vendeve e dy partive dhe do të arrijnë sukses të rëndësishme në luftën e përbashkët për ndërtimin e socializmit në vendet e veta dhe për mbrojtjen e çështjes së marksizëm-leninizmit nga goditjet dhe nga shtrembërimet që i bëjnë imperialistët dhe revizionistët modernë.

Pasi e falënderoi shokun Li Hsien Nien për fjalët e ngrohta dhe për vlerësimin e lartë që ai u bëri PP të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, e mori fjalën përsëri

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht ne kemi edhe mjaft vështirësi, po me luftë dhe me punë të pandërprerë do t'i kapërcëjmë ato. Tani, i gjithë populli ynë është ngritur në këmbë për realizimin e detyrave që i ka vënë përpara Partia. Planin e dytë pesëvjeçar ne e kemi realizuar me përjashtim të bujqësisë ku u dëmtuam shumë, sidomos nga koha e keqe. Plani i janarit është tejkaluar kudo. Mbjelljet e vjeshtës te ne janë tejkaluar 130 për qind. Si këtë vit ne nuk kemi mbjellë asnjëherë grurë. Kështu Partia jonë shkon ballëhapur në Kongresin e saj.

Nuk duam t'ju lodhim më, shokë të dashur, ndaj unë mendoj kështu: Ne do të takohemi shumë herë, gjatë dhe pas Kongresit, prandaj në takimet e tjera të ardhshme ne mund të bisedojmë edhe më gjerë. Ne u gëzuar që ju do të rriini disa ditë pas Kongresit. Atëherë do të jeni edhe më të lirë, shtrohemi këmbëkryq, siç themi ne shqiptarët e bisedojmë për gjithçka kemi për të thënë.

Prandaj, të dashur shokë kinezë, duhet ta ndieni veten si në shtëpinë tuaj, si në Kinë, si në Pekin, si në Shanghai, si në komunet popullore. Mirë u pafshim!

Botohet për herë të parë me shkurtime sipas tekstit të procesverbalit që gjendet në AQP

**NE JEMI NJË PARTI E VOGËL, POR KEMI
TË DREJTË TË THEMI HAPUR
PIKËPAMJEN TONË**

*Nga biseda me delegacionin e Partisë së Punës të Koresë
që kishte ardhur për të marrë pjesë
në Kongresin IV të PPSH*

10 shkurt 1961

*Pasi u shkëmbyen përshëndetjet e rastit, fjalën e
mori*

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët, shokë të dashur! Ne jemi shumë të gëzuar që ndodheni në mes nesh në këto ditë të shënuara historike për Partinë dhe për popullin tonë dhe për nderin që na bëhet nga Partia e Punës e Koresë me ardhjen tuaj në Shqipëri. Me këtë rast ne i shprehim falënderime të përziermërta Partisë së Punës të Koresë, Komitetit të saj Qendror dhe shokut Kim Ir Sen!

Si është shoku Kim Ir Sen? Kam kohë që nuk jam takuar me të.

Miqtë koreanë, pasi transmetojnë përshëndetjet e shokut Kim Ir Sen për Partinë e Punës të Shqipërisë,

Komitetin e saj Qendror, e veçanërisht për shokun Enver Hoxha, shprehin mirënjohjen e thellë dhe respektin që gëzon te Partia e Punës dhe populli korean Partia e Punës e Shqipërisë për qëndrimin e drejtë e parimor që kjo mban në mbrojtje të marksizëm-leninizmit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemi nderit shumë për vlerësimin që i bën Partia juaj Partisë sonë!

Partia jonë dhe populli shqiptar kanë admirim për popullin korean e për luftën heroike të tij, të udhëhequr nga Partia e Punës e Koresë dhe shoku Kim Ir Sen. Ne kemi mësuar nga lufta e popullit tuaj heroik, sepse edhe ne kemi pasur dhe kemi të njëjlat vështirësi si të brendshme, ashtu edhe të jashtme. Populli korean, i udhëhequr nga Partia e Punës e Koresë, u ka rezistuar rrebesheve, ka fituar, fiton dhe po ndërton socializmin.

Populli dhe Partia jonë janë në dijeni të përparimeve që ka arritur populli heroik korean me Partinë e Punës të Koresë në krye. Partia jonë e ka për detyrë dhe e ka vënë në dijeni vazhdimisht popullin për sukseset që janë arritur në vendin tuaj.

Ditët e fundit në shtypin tonë u botua një letër që një djalë korean ia dërgonte një nëne shqiptare, që ai e konsideron si nënën e tij. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kësaj nëne shqiptare iu vranë dy djem. Kostumin e njërit djalë të saj, të vranë gjatë luftës, ajo ia dërgoi si ndihmë popullit heroik korean, që ishte angazhuar në një luftë të vështirë kundër okupatorëve amerikanë dhe të tjerë. Ky kostum iu dha për ta veshur një djali korean, prindërit e të cilit ishin vranë në luftë, prandaj ky djalë tani e konsideron veten si djalë shqip-

tar. Djaloshi korean shprehte për nënën e tij shqiptare ndjenjat më të thella të dashurisë dhe të frymës internacionaliste e të lidhjeve të ngushta vëllazërore e miqësore që ekzistojnë në mes të dy popujve tanë. Ky djalë korean i ka shkruar nënës shqiptare historinë e jetës së tij. Kjo letër e ka prekur shumë popullin tonë.

Ne kujtojmë me dashuri ardhjen e shokut Kim Ir Sen¹ për një vizitë miqësore në Shqipëri. Njerëzit tanë nëpër fabrika, uzina, kooperativa, shkolla etj. takimet e tyre me shokun Kim Ir Sen i konsiderojnë si ngjarje të rëndësishme për forcimin e miqësisë midis dy popujve dhe partive tona.

Unë personalisht kujtoj kurdoherë me dashuri kohën e shkurtër që kam qëndruar në Kore², nuk harroj dashurinë e madhe që ka populli vëlla korean për popullin shqiptar, dashurinë e madhe që kanë komunistët e Koresë për Partinë tonë; kujtoj gjithashtu vendet e betejave heroike që ka bërë populli juaj, qytetet e reja dhe fabrikat e shkatërruara që po rindërtonit atëherë. Mua më kujtohen fabrikat e mëdha të ndërtuara nga punëtorët koreanë mbi tokë dhe nëntokë, më kujtohen fushat e bukura të mbjella me oriz, më kujtohet puna e kujdesshme për ujtitjen e fushave. Kur të vij ndonjëherë tjetër në Kore, do të shoh me siguri se ajo do të jetë krejt ndryshe me ndërtimet e reja, të mëdha dhe të bukura që keni bërë ju që pas mbarimit të luftës së imponuar nga imperialistët amerikanë.

¹ Shoku Kim Ir Sen kryesonte delegacionin qeveritar të RDP të Koresë që vizitoi RPSH në qershor 1956.

² Në shtator të vitit 1956.

Kur vizituam një kooperativë, që quhej «Kooperativa bujqësore e miqësisë koreano-shqiptare», mbaj mend se kryetar i saj ishte një shok luftime që kishte gjoksin plot dekorata. Ai kishte ardhur edhe në Shqipëri. Më kujtohet gjithashtu se si atje një plakë doli nga mesi i turmës, nxori një thikë të vogël të vjetër dhe ma dha si kujtim. Atë ajo e kishte kujtim nga i shoqi që i qe vrarë në luftë.

Mua nuk më harrohet thjeshtësia e popullit tuaj, dashuria e tij e madhe për Partinë dhe për shokun Kim Ir Sen, si dhe dashuria e madhe për punën. Populli juaj është me kulturë të lashtë. Kur u ktheva nga RDP e Koresë, u kam treguar të gjithë shokëve për dashurinë e madhe të popullit tuaj për punë dhe për kulturë. Te ju pashë njerëz që punonin nëpër kanale, që ndërtonin rrugë dhe më ka mbetur në mendje pastërtia e madhe e veshjeve të tyre, sado të vështira të ishin kushtet e punës. Kjo tregon kulturën e një populli.

Tani, pas dy ditësh fillon punimet Kongresi ynë IV. Partia jonë gjatë kësaj kohe, që pas Kongresit III, ka bërë një luftë të madhe për të kapërcyer vështirësi të shumta e të mëdha. Megjithatë ajo vjen në Kongresin e ri me rezultate të kënaqshme, domethënë me plan të realizuar. Sigurisht në punën tonë ne kemi pasur edhe të meta e gabime, por sapo ato janë zbuluar, i kemi korrigjuar dhe i kemi zhdukur. Kryesorja është se Partia jonë nuk ka bërë ndonjë gabim të tillë të rëndë që të ketë penguar vrullin e popullit për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe kjo ka ndodhur për shkak se ajo ka zbatuar me vendosmëri marksizëm-leninizmin.

Rruga që ka ndjekur Partia jonë ka bërë që të ka-

litet edhe më tej uniteti i saj, të kalitet uniteti i masave rreth Partisë. Partia jonë i ka edukuar anëtarët e saj dhe masat punonjëse me frymën e internacionalizmit proletar, ajo ka kalitur në zemrën e popullit tonë dashurinë për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Partinë e madhe të Leninit e të Stalinit, ka kalitur dashurinë për popujt e vendeve socialiste dhe për të gjithë popujt që luftojnë për liri, për pavarësi dhe për progres shoqëror.

Sikurse e dini, Partia jonë e ka ndier dhe e ndien kurdoherë për detyrë të mbrojtë marksizëm-leninizmin. Në Mbledhjen e Moskës të 81 partive komuniste dhe punëtoresh Partia jonë ka bindjen se kreu detyrën e saj internacionaliste në interes të marksizëm-leninizmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, pavarësisht se disa partive motra u erdhi hidhur qëndrimi i drejtë i Partisë sonë. Marksizëm-leninizmi na mëson se midis shokësh, midis partish marksiste, në format e ligjshme organizative të përcaktuara në baza leniniste, duhet të thuhet mendimet hapur, lirisht për çdo çështje. Jashtë këtyre parimeve, jashtë normave leniniste ne nuk veprojmë dhe qëllimi ynë është që të forcohet uniteti i lëvizjes komuniste ndërkombëtare vetëm në bazë të marksizëm-leninizmit.

Ne jemi një Parti e vogël, por e kishim për detyrë ta thoshim hapur pikëpamjen tonë në Mbledhjen e Moskës. Ne e mendonim se mund të na krijoheshin dhe po na krijohen vështirësi, por këto ne i morëm parasysh, vetëm të mbrohet marksizëm-leninizmi, sepse ai e çliroi popullin shqiptar nga robëria e rëndë dhe po e çon në socializëm. Po të shkelet marksizëm-leninizmi, atëherë

dëmtohet jo vetëm populli shqiptar, por dëmtohet rëndë e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Në Mbledhjen e Moskës ne ishim krah për krah me Partinë Komuniste të Kinës, e cila ka një peshë të madhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, kishim pranë dhe shumë parti të tjera, që e mbrojtën me vendosmëri marksizëm-leninizmin. Për marksizëm-leninizmin ka rëndësi fakti që ne thamë fjalën tonë haptazi dhe ashtu si duhej në këtë mbledhje. Sigurisht, shokëve sovjetikë nuk u erdhi aspak mirë një gjë e tillë. Sipas mendimit tonë, ata nuk kanë të drejtë, përkundrazi ata janë në rrugë të gabuar, sidomos me qëndrimin që mbajnë ndaj nesh. Por ne nuk e ndryshojmë qëndrimin tonë ndaj popujve dhe ndaj komunistëve të vërtetë të Bashkimit Sovjetik. Ata i kemi dashur, i duam, prandaj i mbrojmë. Mosmarrëveshjet duhet t'i zgjidhim në rrugë komuniste, në rrugë të drejtë.

Mirëpo N. Hrushovi nuk e sheh me sy të mirë rrugën që ka ndjekur e ndjek Partia jonë. Ai ka marrë nën sqetull dhe mbron elementë jo të mirë, bile armiq të Partisë sonë. Veprime të tilla, si dhe të tjera të këtij lloji, ne nuk mund t'i lejojmë. Këtë ne ua thamë në sy Hrushovit dhe shokëve të tij, po atyre nuk u pëlqeu ky qëndrim i Partisë sonë. Por s'ka gjë, qëndrimi i delegacionit tonë në Mbledhjen e Moskës është aprovuar njëzëri nga masat e Partisë sonë, sepse ato e shohin se është një qëndrim i drejtë marksist-leninist.

Askush nuk u ndërhyr shokëve sovjetikë në punët e tyre të brendshme, kurse ata u orvatën të përzi-heshin në punët tona dhe vepruan kundër Partisë sonë. Ata kanë marrë masa kundër shumë kadrove të tyre,

që ne i njohim dhe për këtë nuk u kemi thënë asgjë. Atëherë përse ata përzihen në punët e brendshme të Partisë sonë?

Nikita Hrushovit nuk i pëlqen lufta që bën Partia jonë kundër revizionistëve jugosllavë, të cilët janë armiq të komunizmit ndërkombëtar dhe që kanë 20 vjet me radhë që po luftojnë për të mposhtur Partinë tonë. Prandaj ne s'ka si të jemi dakord me qëndrimin e shoqëve sovjetikë mbi këtë çështje, sepse nuk është i drejtë.

Pastaj, si mund të ishte dakord Partia jonë me qëndrimin që mbajti N. Hrushovi në Mbledhjen e Bukureshtit, ndaj Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, duke kurdisur kundër saj një kurth të rrezikshëm? Një qëndrim i tillë i N. Hrushovit ndaj një partie të madhe, që qëndron fort në pozita të drejta, nuk ishte aspak marksist. Në qoftë se ai kishte për të bërë vërejtje dhe kritika në adresë të Partisë Komuniste të Kinës, ato mund t'i bënte në mënyrë shoqërore dhe në baza të njohura organizative të marrëdhënies në mes partive tona. Prandaj, me atë që bëri N. Hrushovi në Bukuresht dhe e vazhdoi pastaj edhe në Moskë, Partia jonë nuk mund të ishte kurrsesi dakord.

Për problemet e mëdha të politikës ndërkombëtare është e natyrshme që të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të kenë një vijë të përbashkët të bazuar në marksizëm-leninizmin dhe në deklaratat e Moskës. Natyrisht, pikëpamjet e veçanta që mund të ketë ndonjë parti, duhet të diskutohen që të sheshohen dhe të formulohet pikëpamja e përbashkët në interes të çështjes së madhe të komunizmit. Kjo arrihet duke i bërë vërejtje e kritika shoqërore njëri-tjetrit.

Çështja e vizitës që do të bënte N. Hrushovi në RDP të Koresë nuk është një dëshirë e thjeshtë, por çështje e qëndrimit të Bashkimit Sovjetik ndaj problemit korean, është një nga problemet e politikës sonë ndërkombëtare dhe për këtë janë të interesuara të gjitha vendet e kampit socialist. Pikëpamja jonë është se Hrushovi duhet të kishte ardhur prej kohësh në Kore për t'i treguar imperializmit amerikan, që ju kërcënon vazhdimisht, se RDP e Koresë është e paprekshme, se përkrah saj qëndron i gjithë kampi socialist. Atëherë përse Hrushovi nuk e vizitoi Korenë? Mendimi im është se ai ka frikë se mos zemërohet imperializmi amerikan. Ne e kuptojmë drejt luftën që duhet të bëjmë për bashkëzistencën paqësore, por gjithmonë duke u treguar kufirin imperialistëve, me në krye ata amerikanë.

Atëherë, këto pikëpamje që kemi, është mirë t'i bisedojmë hapur, midis shokësh, apo qosheve? Jo! Marksizëm-leninizmi na mëson që mendimet tona t'i themi me guxim dhe hapur.

Partia juaj ka ndjekur një politikë të drejtë në luftën kundër imperializmit amerikan. Prandaj ajo duhet të gjejë mbështetjen e fuqishme të të gjitha vendeve socialiste e në radhë të parë mbështetjen e Bashkimit Sovjetik, sepse populli dhe partia juaj kanë meritën e madhe që bënë të tronditet imperializmi amerikan. Ju e mundët me luftë të armatosur imperializmin amerikan, pastaj u ngrit populli i Koresë së Jugut kundër regjimit kukull të Sin Man Risë dhe, me qëndrimin e tij heroik, bëri që të dështojë politika e Ajzenhauerit dhe të fitojë drejtësia e vijës së Partisë suaj.

Populli i Koresë së Jugut sheh se ç'hapa bën socializmi në pjesën veriore të atdheut të tij, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Koresë, të Komitetit Qendror me shokun Kim Ir Sen në krye, prandaj ai u çua peshë duke bërë të rrëzohet qeveria e tradhtarit Sin Man Ri dhe me dhjetëra mijëra koreanë të Veriut dhe të Jugut që ishin në Japoni e gjetkë të ktheheshin në atdheun e tyre socialist.

Ne mendojmë se duhet ndihmuar edhe më shumë RDP e Koresë e jo vetëm me ndihma materiale, por sidomos me ndihma politike, sepse qëndrimet e Partisë dhe të popullit tuaj janë një ndihmë e madhe për të gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Bashkimi Sovjetik na ka ndihmuar, këtë nuk e mohojmë. Sigurisht ai ndihmon edhe të tjerët. Por mendimi ynë është se ka mosmarrëveshje, të cilat duhen kapërcyer vetëm në rrugë të drejtë. Njëri-tjetrin ne nuk e duam për interes, për ndihmat materiale, po për arsyeën e fortë të ideve tona të përbashkëta, të marksizëm-leninizmit dhe të luftës sonë të përbashkët për ruajtjen e pastërtisë së tij. Popujt korean dhe shqiptar janë mësuar të rrojnë edhe me pak dhe këtë e kanë provuar në luftë e me punë të kryer me djersë të ballit. Çështja është që gjithçka të shihet drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Ne kemi bindjen se e drejta kurdoherë do të fitojë, marksizëm-leninizmi do të dalë kurdoherë fitimtar dhe ne do të kapërcejmë çdo vështirësi dhe do të fitojmë kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, që na pengojnë në rrugën tonë.

Miqtë e zemrës, siç jeni ju, shokë koreanë, kur vijnë në Shqipëri, ne nuk i lëmë të ikin shpejt. Prandaj

ne ju lutemi të qëndroni ca kohë, jo vetëm gjatë ditëve të Kongresit, po edhe pas tij, për të vizituar vendin tonë të vogël, të shihni të mirat dhe mungesat. Ne dëshirojmë të marrim kontakt me popullin dhe kuadrot tanë, sepse kjo do të jetë një ndihmë e madhe për Partinë dhe për popullin tonë. Populli ynë ju do me gjithë shpirt dhe miqësia e sinqertë midis popujve është një forcë shumë e madhe që neve, shqiptarëve, na shtyn përpara për ndërtimin e socializmit dhe për kapërcimin e vështirësive. Ne do të jetojmë së bashku gjatë këtyre ditëve dhe jemi në dispozicionin tuaj për gjithçka që do të dëshironi të dini mbi vendin tonë.

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime sipas tekstit të
nxjerrë nga procesverbali i
mbajtur në këtë takim
që gjendet në AQP*

**NE NUK I HAMË FJALËT, VEÇANËRISHT KUR
ESHTE ÇËSHTJA PËR TË MBROJTUR
MARKSIZËM-LENINIZMIN, VENDIN
DHE PARTINË TONË**

*Nga biseda me delegacionin e Partisë së Punonjësve të
Vietnamit që kishte ardhur për të marrë pjesë
në Kongresin IV të PPSH¹*

12 shkurt 1961

SHOKU ENVER HOXHA: Jemi shumë të gëzuar që erdhët në vendin tonë në këto ditë historike për Partinë dhe për popullin shqiptar. Si është shoku Ho Shi Min? Si janë shokët e tjerë?

SHOKU NGUYEN ZUI CIN (*kryetar i delegacionit*): Ne kemi ardhur për t'ju transmetuar juve, Byrosë Politike dhe KQ të PPSH, urimet e shokut Ho Shi Min, shëndet të mirë dhe suksese sa më të mëdha në punimet e Kongresit!

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemi nderit! Në

¹ Në këtë takim, nga pala e PPSH ndodhej edhe shoku Hysni Kapo.

Mbledhjen e Moskës nuk kishte mundësi të takoheshim me shokun Ho Shi Min, ashtu na kishin vendosur në sallë; unë isha larg tij.

Mbledhja e Moskës sipas mendimit tonë ka qenë një mbledhje shumë e nevojshme dhe e dobishme, sepse atje u morën disa vendime të rëndësishme për lëvizjen komuniste botërore, janë vënë, si themi ne, pikat mbi i-të për shumë probleme themelore ndërkombëtare. Tani puna është që këto vendime të vihen në jetë. Kjo është sot një nga detyrat kryesore për çdo parti të klasës punëtore, sepse po t'u bëhet bisht parimeve të Deklaratës së Moskës, sikurse ndodhi nga disa parti me Deklaratën e Moskës të vitit 1957, atëherë kemi shmangie nga vija e drejtë marksiste-leniniste.

Partia jonë, gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj, i është përmbajtur me konsekuencë marksizëm-leninizmit, ajo sikurse ka vepruar për Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ashtu do të vërë të gjitha forcat e saj për të zbatuar në jetë edhe parimet e Deklaratës së vitit 1960, në mënyrë të vendosur e të guximshme. Për këtë, ne do të vëmë në shërbim të gjitha forcat tona modeste, ashtu sikurse edhe të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste.

Ne jemi të armatosur si marksistë dhe marksizmin nuk e bën vetëm një njeri, siç e heq veten Hrushovi. Qenia marksist nuk varet nga forca ekonomike që ka vendi. Marksistët e vërtetë, që i qëndrojnë besnikë marksizëm-leninizmit, kanë të drejtë të pretendojnë dhe duhet pretenduar nga të gjithë zbatimi i drejtë i Deklaratës së Moskës.

Në Mbledhjen e Moskës na kritikuan përfaqësues

të disa partive. Por edhe ne i kritikuan ata. Ne mendojmë se qëndrimi ynë ka qenë i drejtë, sepse me argumente konkrete dolëm në mbrojtje të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, ndërsa ata që na kritikuan nuk u nisën nga pozita të drejta. Ne qëndrojmë në pikëpamjen se në Moskë kemi vepruar si marksistë, duke thënë hapur fjalën tonë. Ne nuk e hamë fjalën, veçanërisht kur është çështja për të mbrojtur marksizmin, vendin, Partinë tonë dhe internacionalizmin proletar. Marksizëm-leninizmi, që ka qenë dhe mbetet gjithnjë fener ndriçues në rrugën e çdo revolucionari të vërtetë, na mëson se midis shokëve, kur ka gabime, këto duhen thënë në sy, haptas, duke bërë kritikë konstruktive, parimore e shoqërore, u pëlqen apo nuk u pëlqen kjo disave.

E dimë nga praktika se çdo njeri mund të bëjë gabime. Gabime mund të bëjnë edhe komunistët, edhe partitë, qofshin këto të vogla apo të mëdha. Në qoftë se pranojmë këtë parim, çështja duhet parë objektivisht dhe të mos vepronet siç thonë udhëheqësit e sotëm sovjetikë që «prestigji i partisë sonë të madhe duhet të ruhet», se «kuadrot tanë nuk bëjnë gabime» dhe, me këtë, të preket sovraniteti i partive motra.

E gjithë bota e respekton PK të BS, mundet, gjithashtu, ta mbyllësh një sy kur ke të bësh me ndonjë gabim të vogël, por kur gabimet bëhen të mëdha, kur përfaqësuesit e PK të BS kërkojnë të hedhin në hava udhëheqjen e Partisë sonë, atëherë nuk jemi dakord, këtë nuk mund ta durojmë. Ne mund të themi se udhëheqësit sovjetikë nuk kanë dashur t'i njohin gabimet e rënda parimore që kanë bërë. Gabimet e tyre ata i

konsiderojnë si të thjeshta, por në të vërtetë ato janë gabime me rrënjë të thella ideologjike, antimarksiste.

Ne e dimë se ç'është Bashkimi Sovjetik, ashtu sikurse e dini edhe ju, shokë. Po të mos ishte Bashkimi Sovjetik, po të mos ishte Ushtria e Kuqe, fitorja mbi fashizmin do t'u kushtonte më shumë vuajtje, gjak e sakrifica popujve. Ne kemi derdhur gjakun për lirinë e atdheut dhe Bashkimi Sovjetik ka qenë faktori vendimtar i jashtëm për fitoren tonë.

Ju mund ta kuptoni mirë sa vështirë e kemi ngaqë është krijuar një gjendje e tillë dhe detyrohemi të flasin për gabimet e udhëheqjes sovjetike. Ne kemi disa vjet që i bëjmë udhëheqjes sovjetike vërejtje shoqërore për gabimet e saj, por ajo asgjë s'ka pranuar, përkundrazi ka vazhduar në rrugë të gabuar, duke dalë nga binarët e marksizëm-leninizmit. Atëherë s'kishte rrugë tjetër, veçse t'ia thoshim udhëheqjes sovjetike gabimet e saj serioze edhe përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Ashtu sikurse ata që janë parti e madhe kanë të drejtën e fjalës, këtë të drejtë e kemi edhe ne që jemi parti e vogël. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi. Ata na bënë kritika, por edhe ne kemi të drejtë t'i kritikojmë, kur konstatojmë se kanë gabime. Ne jetojmë në shekullin e leninizmit, prandaj të drejtat i kemi të barabarta. Udhëheqësit e PK të BS duhet të njohin gabimet e tyre. Ata i dinë cilat janë këto gabime, janë pikëpamjet e tyre antimarksiste për shumë çështje.

Marksistët janë më të fortë se hekuri. Shumë situata të vështira mund të krijohen, por marksistët duhet t'i kapërcejnë ato me durim dhe të luftojnë për

interesin e përgjithshëm, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, duke ditur që përpara kemi armiq, dhe bile armiq të egër, siç janë imperialistët me në krye ata amerikanë, megjithëse udhëheqës të disa partive pretendojnë ndryshe. Kështu, udhëheqësit e sotëm sovjetikë pretendojnë se tani që në Uashington kanë ardhur udhëheqës të tjerë, punët na paskan ndryshuar. Pra, imperializmi amerikan ka ndërruar natyrën e tij! Ne mendojmë se qoftë Ajzenhaueri, qoftë Kenedi që është tani në fuqi, janë e njëjta gjë dhe se ndryshimi i personave nuk do të thotë aspak se imperializmi nuk është më ai. Të mos flasim për imperializmin amerikan, të mos jemi vigjilentë, siç kërkojnë Hrushovi me shokë, këtë ne nuk do ta bëjmë kurrë, le të na gjykojnë si të duan, qëndrimin tonë do ta gjykojë koha.

Udhëheqësit sovjetikë kërkojnë gjithashtu që ne të mos flasim kundër revizionistëve jugosllavë, kurse pikëpanja e Komitetit Qendror të Partisë sonë është që të demaskohen gjer në fund këta renegatë të marksizëm-leninizmit. Kjo është e veltmja mënyrë për t'i shpartalluar ata. Ne nuk do të lejojmë që këta revizionistë të organizojnë komplete dhe t'i vënë popujt e Jugosllavisë kundër popujve të vendeve socialiste. Ne kurrë nuk do të jemi dakord me qëndrimin oportunist të Hrushovit ndaj revizionistëve jugosllavë. Këtë ne e kemi thënë disa herë.

Të gjithë e kanë të qartë punën agjenturale në favor të imperialistëve që bën grupi i Beogradit. Atëherë, ku duan të na çojnë udhëheqësit sovjetikë, që na këshillojnë të përqafohemi me njerëz të tillë? «Po t'ju

pëlqejë shkoni e përqafohuni vetë», kështu i kemi thënë në Mikojanit. «Unë do të shkoj të përqafohem edhe një herë akoma me Titon», na tha ai, dhe ne i thamë: «Shkoni, po nuk do të jemi kurrë dakord me ju. Ju askush nuk ju pengon të veproni në këtë mënyrë, por edhe ne nuk na ndaloni dot të themi pikëpamjen tonë për këtë çështje». Kështu i jemi përgjigjur ne udhëheqjes sovjetike.

Kampi socialist ka armiq të egër dhe jo të dobët. Përveç kësaj Shqipëria është një vend i rrethuar, kurse ju keni një favor, keni kufij të përbashkët me RP të Kinës, të cilën ne në Bukuresht dhe në Moskë duhet ta mbronim dhe e mbrojtëm nga sulmet dhe akuzat jo të drejta të udhëheqësve sovjetikë. Të gjithë mund të bëjnë gabime, por ashtu siç kanë vepruar udhëheqësit e sotëm sovjetikë, duke organizuar fushata kundër shokëve kinezë, nuk është aspak e drejtë. Ne nuk mund ta duronim një fushatë të tillë të shthurur, në baza anti-marksiste. Qëllimet dhe veprimet e udhëheqësve sovjetikë ishin shumë të gabuara, prandaj ne dolëm kundër këtyre qëllimeve dhe veprimeve, sepse, duke shfaqur opinionin tonë mbi këto çështje, ne mbronim, në të njëjtën kohë, PK të Kinës dhe të gjitha partitë e tjera komuniste.

Në këto çështje nuk kanë mbajtur qëndrim marksist edhe udhëheqës të disa partive të tjera. Për shembull, ne kemi pasur respekt për Moris Torezin, por ai na ka sulmuar padrejtësisht në Mbledhjen e Moskës. Për të, i ashtuquajtur i «dogmatizëm» i kinezëve dhe i shqiptarëve ishte rreziku kryesor për komunizmin! Por rreziku kryesor, siç thotë Deklarata e Moskës, është re-

vizionizmi. Ky rrezik kërcënon tani vetë PK të Francës. Oportunizmi që ka nxjerrë brirë në këtë parti, nuk është diçka e rastit, ai nuk doli tani. Ka dy vjet e gjysmë që në gjirin e PK të Francës zien lufta nga oportunistët dhe nga revizionistët. Pra Moris Torezi duhet t'i shikojë mirë këto çështje. Nuk është mirë të bësh elozhe për t'i pëlqyer Hrushovit ose dikujt tjetër dhe të shtrembërosh të vërtetën marksiste. Këtë kurrkush nuk mund ta falë. Një vit, dy, tre mund të mbulohen pikëpamjet e shtrembra, por më vonë, kur këto demaskohen, zbulohen edhe përgjegjësitë, sepse marksizëm-leninizmi, kur llogarit, thotë që një dhe një bëjnë dy dhe jo tre.

Hrushovi na akuzon se ne jemi njerëz që trazojmë të tjerët, jemi gjaknxehëtë. Jo ne nuk jemi gjaknxehëtë, por ne mbrojmë me zjarr të drejtat tona dhe, kur ngrihet lart zëri ynë kundër atyre që nuk i kuptojnë mirë këto çështje, atëherë këtë ata e konsiderojnë ofendim. Në qoftë se Hrushovi e ngre zërin kundër nesh, pa të drejtë, edhe ne e ngremë, se respekti ka një farë kufiri. Kur Nikita Hrushovi diskuton çështjen e kufijve të vendit tonë, kur ai shtron çështjen e «autonomisë» së një krahine të vendit tonë me një përfaqësues të reaksionit grek, ne i themi atij: «Ju lutemi qëndroni atje ku jeni, mos i prekni këto çështje që janë të shenjta për ne!».

Krah për krah me PK të Kinës, me partinë tuaj dhe me partitë e tjera motra, ne kemi ndier se forcat tona janë rritur. Anëtarët e partive tona janë vrarë, kanë vuajtur, ne kemi fituar lirinë me gjakun e popujve dhe të komunistëve tanë.

Nuk është e rastit që disa nga ato parti, që kanë luftuar kundër armiqve të socializmit dhe të paqes, s'janë dakord në shumë çështje me rëndësi me ato parti që mbajnë një qëndrim të butë ndaj imperializmit. Mos vallë ne nuk e duam paqen, mos vallë ne jemi për luftën? Kjo është akuza që na bëhet neve. Kjo akuzë është krejtësisht e padrejtë. Ne porsa dolëm nga lufta, bile në luftë ndodhemi çdo ditë kundër komplotëve që kurdisen kundër nesh, ndërsa ne duam të rrojmë në paqe e të shikojmë punën tonë. Kjo është absurde. Po ne ama nuk jemi partizanë të kapitullimit ndaj imperia-lizmit, ne jemi për paqen e drejtë dhe me dinjitet.

Jemi në dijeni për qëndrimet e drejta të Partisë suaj në luftën që ajo bën kundër imperializmit. S'ka si të ndodhë ndryshe, sepse partia juaj është një parti që ka dalë nga gjiri i popullit dhe nga lufta kundër armiq-ve. Partitë tona nuk kanë dalë nga sallonet, por nga llogoret. Ne kemi besim të madh në forcën e marksizëm-leninizmit, në forcën e Partisë dhe të popullit tonë, prandaj qëndrojmë të qetë, por pa ulur vigjilencën.

Në vendin tonë janë arritur mjaft suksese, por edhe ne kemi pasur gabime e të meta. Gjendja në bujqësi te ne ka qenë shumë e vështirë. Gjatë dy vjetëve të fundit, sidomos vitin e kaluar, thatësira ka qenë shumë e madhe, por ne kemi pasur ndihmën e menjëher-shme të RP të Kinës me grurë. Në rast se nuk do ta kishim këtë ndihmë, në vendin tonë sot do të kishte uri. Këtu duhet vënë në dukje se sovjetikët, duke mos na dhënë bukë, kanë dashur të na bënin presion ekonomik, ta linin popullin tonë të vuante urie. Ata e dinin mirë gjendjen tonë. Ne u kërkuam atyre 50 mijë tonë dri-

tënë, kurse ata na dhanë vetëm 10 mijë, gjysmën e të cilave do të na e dërgonin nga fundi i vitit. Pra drithin nuk na e dhanë në kohën që na duhej. Me këtë doja t'ju thoshja se situata e bujqësisë në vendin tonë nuk ka qenë e mirë. Tani këtë vështirësi e kaluam. Fillimi i këtij viti tregon se punët në bujqësi po na shkojnë mirë. Të mbjellat janë realizuar e janë tejkaluar dhe bimët janë zhvilluar në rregull.

Punët në sektorin e industrisë shkojnë shumë mirë. Aty ne i kemi tejkaluar planet. Lënda e parë për industrinë nuk na ka munguar, sepse të gjitha fabrikat e vendit tonë punojnë me lëndë të parë që e sigurojmë në vend. Ne importojmë shumë pak pambuk, vetëm me qëllim që të përmirësojmë cilësinë e tekstileve. Kjo është kura joze për Partinë dhe për popullin tonë se në Kongres do të paraqitemi me plan të realizuar, bile të tejkaluar.

Me rastin e ardhjes suaj për të marrë pjesë në punimet e Kongresit, ne dëshirojmë t'ju ftojme që të qëndroni edhe pas Kongresit, të vizitoni vendin tonë, të merrni takim me kuadrot tanë, me punëtorët dhe me fshatarët, për të krijuar përshtypjet direkte nga vendi dhe populli ynë dhe këto t'ia transmetoni shokut Ho Shi Min, udhëheqësve të tjerë dhe gjithë popullit tuaj. Unë e njoh personalisht shokun Ho Shi Min. Di se ai ka kujtime të mira nga vizita që bëri në vendin tonë, di se ai e do shumë Shqipërinë dhe popullin tonë.

Ne do të bëjmë çdo gjë të mundur, që populli ynë të njihet me përpjekjet e popullit tuaj. Sa më tepër materiale të kemi për këtë qëllim nga ju, aq më mirë do të jetë. Kjo do të shërbejë që ne ta forcojmë miqë-

sinë midis dy popujve tanë. Është një inkurajim i madh për ne kur i tregojmë popullit tonë shembuj se si ecin përpara popujt e tjerë vëllezër, që kanë luftuar dhe që luftojnë për socializmin dhe për paqen. Edhe ju për këtë qëllim keni ardhur në vendin tonë, prandaj dëshirojmë të mos ju lëmë të ikni kaq shpejt.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë takim
që gjendet në AQP*

**RAPORT NË KONGRESIN IV TË PPSH
«MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»**

13 shkurt 1961

Të dashur shokë,

Me një ndjenjë krenarie të ligjshme komunistët dhe i gjithë populli shqiptar e kanë drejtuar zemrën dhe vëmendjen e tyre te Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili po fillon sot punimet e tij. Ky Kongres është një ngjarje tjetër me rëndësi të madhe në historinë e lavdishme të Partisë sonë heroike dhe të popullit tonë të mrekullueshëm. Kongresi do të diskutojë dhe do të aprovojë direktivat e planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës, do të hapë rrugë të reja dhe perspektiva akoma më të begatshme për popullin tonë dhe do ta forcojë më shumë atdheun tonë të dashur socialist.

Kongresi IV mbledhet në përvjetorin e njëzetë të themelimit të Partisë sonë të lavdishme. Njëzet vjet kanë kaluar që nga ato ditë të vështira për atdheun tonë, kur nga gjiri i popullit të vuajtur, por trim dhe të papërkulur lindi, u themelua Partia jonë marksiste-leniniste. Vendi ynë po digjej, populli ynë ishte ngritur

kundër robërisë së pushtuesve fashistë, në dyert e Moskës së lavdishme ndodheshin hordhitë naziste të Hitlerit, Leningradi i Revolucionit të madh të Tetorit ndodhej i rrethuar e në rrezik të madh. Foshnja që lindi në Tiranë më 8 nëntor 1941, nga gjiri i popullit, nuk priti asnjë ditë, po ngriti dorën e saj të hekurt dhe goditi pa mëshirë fashistët dhe tradhtarët. Ajo rrëmbeu në duart e saj të çelikta flamurin e luftës për liri, ngriti edhe më lart traditat luftarake të popullit tonë, ringjalli me një shkëlqim të ri epopenë e lavdishme të kohërave të Skënderbeut e të rilindasve, e udhëhoqi dhe e çoi popullin tonë heroik në fitoren e plotë mbi okupatorët nazi-fashistë dhe tradhtarët e vendit; i dha atdheut lirinë dhe sovranitetin e vërtetë, i dha nderin dhe dinjitetin, i dha atij sigurinë dhe besimin e madh në forcat e veta; farkëtoi miqësinë shekullore midis popullit shqiptar dhe popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik, që ndihmuan për çlirimin e vendit tonë, midis popullit shqiptar dhe popujve vëllezër të Kinës, si dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, të kampit të socializmit. Revolucioni Popullor u krye me sukses dhe hapi epokën më të lavdishme të historisë sonë mijërvjeçare, epokën e ndërtimit të socializmit e të komunizmit në Shqipëri.

Në zjarr e në flakë, në vuajtje e në mundime, në gëzime e në fitore popull e Parti u bënë një e të pandarë kurrë. Historia e Partisë gjatë këtyre njëzet vjetëve është historia e vetë popullit shqiptar, luftërat e Partisë janë luftërat e popullit, ashtu siç janë fitoret e saj fitoret e popullit. Parti dhe popull janë lidhur te ne si mishi me koskën. Kjo është fitorja më e madhe, kjo

është siguria më e madhe për të ardhshmen e lumtur të atdheut tonë. Këto fitore i krijoi Partia që udhëhiqet në luftën dhe në punën e saj nga marksizëm-leninizmi. Këto fitore i vaditi dhe i rriti gjaku i shenjtë i dhjetëra mijëra partizanëve dhe partizaneve, që ranë e u mbuluan me lavdi në përleshje dhe në luftëra të përgjakshme për lirinë e atdheut, për demokracinë, për socializmin, për komunizmin.

Të dashur shokë,

Kanë kaluar pak më shumë se katër vjet nga koha që u mbajt Kongresi III i Partisë, por ndryshime të mëdha kanë ndodhur, si brenda vendit tonë, ashtu edhe në gjendjen ndërkombëtare. Vitet që kanë kaluar, kanë qenë vite të një pune madhështore, që ka kryer populli ynë punëtor e paqedashës nën udhëheqjen e Partisë së tij heroike për triumfin e socializmit. U realizua me sukses e para afatit plani i dytë pesëvjeçar, përfundoi detyra e transformimit socialist të fshatit, kolektivizimi i bujqësisë, u zhvillua edhe më tej revolucioni kulturor. Me këto fitore të mëdha atdheu ynë është bërë më i fuqishëm, pasuritë e vendit janë shtuar, jeta e popullit është përmirësuar. Në vendin tonë është ndërtuar baza ekonomike e socializmit dhe tani po hyjmë në një etapë të re, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Në zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare, vitet që kanë kaluar që nga Kongresi III, kanë qenë vite gjatë të cilave është rritur edhe më shumë fuqia e sistemit socialist botëror, është ngritur në një shkallë më të

lantë lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të shtypur, nën goditjet e së cilës është shpejtuar procesi i shthurjes së sistemit kolonial të imperializmit; kanë qenë vitet e zgjerimit të betejave të klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve në vendet kapitaliste kundër shtypjes dhe kundër shfrytëzimit, vitet e rënies dhe të dekompozimit të vazhdueshëm të sistemit botëror kapitalist; kanë qenë vite fitoresh të forcave të paqes dhe të përparimit mbi forcat e luftës dhe të reaksionit.

Kongresi ynë zhvillohet pas Mbledhjes së Moskës të përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore, e cila ka rëndësi të madhe për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe për çështjen e paqes në botë.

Ky Kongres do të jetë me shumë rëndësi për popullin dhe për Partinë tonë. Vendimet që do të marrë ai, do të përcaktojnë rrugën, në të cilën do të ecin Partia dhe populli ynë për fitoren e socializmit në vendin tonë, për sigurimin e paqes, për forcimin e unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Në Kongresin IV të saj Partia jonë vjen më e fortë se kurrë, e bashkuar si një trup i vetëm rreth Komitetit Qendror të saj, e lidhur ngushtë me masat e gjera të popullit dhe e vendosur për të ecur përpara, gjithmonë përpara, në rrugën e lavdishme që i ndriçon asaj marksizëm-leninizmi.

I

**GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA
E JASITME E REPUBLIKËS POPULLORE
TË SHQIPËRISË**

Karakteristikë kryesore në zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare është ndryshimi në raportin e forcave në arenën ndërkombëtare në favor të socializmit dhe të paqes dhe në dëm të imperializmit dhe të luftës.

Gjatë 43 vjetëve pas Revolucionit të Tetorit socializmi ka korrur fitore të mëdha me rëndësi historike botërore. Bashkimi Sovjetik është bërë një shtet i fuqishëm në botë. Me fitoret e tij në fushën e shkencës dhe të teknikës, ai hapi epokën e sundimit të kozmosit nga njeriu.

Suksese të mëdha kanë arritur edhe popujt e vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë. Fitoret e Republikës Popullore të Kinës në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, të cilat po e kthejnë këtë vend, me popullsinë më të madhe në botë, në një shtet të fuqishëm socialist, kanë rëndësi të madhe. Vendet e demokracisë popullore kanë krijuar një industri të zhvilluar; vendet që më parë ishin bujqësore, janë shndërruar ose po shndërrohen në industrialo-bujqësore.

Kampi i socializmit, që përfshin në gjirin e tij 12 shtete dhe një të tretën e popullsisë së botës, është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e gjendjes ndër-

kombëtare, për mbrojtjen e paqes, të lirisë dhe të përparimit të popujve. Në zhvillimin e prodhimit janë arritur ritme të tilla të larta që vërtetojnë epërsinë e sistemit botëror socialist mbi atë kapitalist.

Partia jonë e Punës e ka konsideruar kurdoherë si një detyrë të dorës së parë, për të cilën ka luftuar me të gjitha fuqitë e saj, ruajtjen dhe forcimin e vazhdueshëm të unitetit të vendeve socialiste mbi parimet leniniste të barazisë, të mosndërhyrjes dhe të respektit reciprok, të bashkëpunimit të ngushtë dhe të ndihmës reciproke vëllazërore. Në çastet më të vështira, kur reaksioni ndërkombëtar me imperializmin amerikan në krye, duke vënë në përdorim edhe të gjithë agjentët e tij, sidomos revizionistët jugosllavë, u hodhën në sulm kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër unitetit të kampit socialist, Partia dhe Qeveria jonë e kanë ngritur edhe më lart flamurin e unitetit, kanë qenë gati, janë dhe do të jenë kurdoherë gati të përballojnë çdo vështirësi dhe të kryejnë deri në fund detyrën e tyre internacionaliste, ashtu siç do ta kryejnë edhe vendet e tjera vëllezër ndaj vendit tonë në rast nevojë.

Populli shqiptar ndien një kënaqësi të ligjshme që edhe Republika Popullore e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, ka dhënë dhe jep kontributin e saj modest në këtë rritje të vrullshme të autoritetit ndërkombëtar të sistemit botëror socialist, në rritjen e vazhdueshme të epërsisë së forcave të sistemit socialist mbi forcat e sistemit kapitalist, në luftën historike për fitoren e komunizmit.

Ndërsa sistemi botëror socialist është në ngritje, në zhvillim e në lulëzim të vrullshëm dhe po tregon çdo

ditë e më shumë epërsinë e tij të padiskutueshme, sistemi kapitalist botëror është në rënie e në dekompozim; ai po tregon çdo ditë e më shumë karakterin e tij reaksionar e antipopullor, paaftësinë e tij për zgjidhjen e problemeve shoqërore të kohës. Për kapitalizmin po bien kambanat e vdekjes.

Shembja e sistemit të skllavërisë koloniale, nën grushtet e lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve, është goditja më e rëndë që ka marrë imperializmi pas formimit të sistemit socialist botëror. Nga sistemi kolonial i imperializmit deri tani janë shkëputur rreth 1 miliard e 250 milion njerëz. Një numër i madh shtetesh të reja të pavarura kanë lindur në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine. Vrulli i madh i lëvizjes nacionalçlirimtare dhe fitoret e saj historike i kanë dhënë imperializmit një goditje shkatërruese në prapavijat e tij, duke vënë në rend të ditës shkatërrimin e plotë të kolonializmit. Shturja e sistemit kolonial të imperializmit është rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së fuqishme të luftës nacionalçlirimtare të popujve, në kushtet ndërkombëtare të favorshme, që u krijuan me forcimin e socializmit dhe me dobësimin e imperializmit. Faktet hedhin poshtë versionin e imperialistëve dhe të oportunistëve se gjoja vendet koloniale dhe gjysmëkoloniale fituan lirinë politike me ndihmën e shteteve imperialiste dhe jo në sajë të luftës së vet dhe të revolucionit. Çlirimi i popujve nga skllavëria koloniale është bërë në rrugë të ndryshme, por cilatdo që të kenë qenë këto rrugë baza e çlirimit të tyre ka qenë dhe mbetet lufta revolucionare e masave të popullit në forma të ndryshme. Gjatë këtyre viteve lufta nacionalçlirimtare e popujve të shtypur nga

kolonialistët është kthyer në një stuhi revolucionare në shkallë botërore, që po shpejton shturjen e sistemit të urryer kolonial dhe po afron fundin e tij. Ajo është bërë një nga fenomenet më të rëndësishme të epokës sonë, fitorja më e madhe kundër imperializmit pas krijimit të kampit socialist. Më se 40 vende kanë thyer prangat koloriale pas Luftës së Dytë Botërore. Më 1960 vetëm në Afrikë shpallën pavarësinë 17 vende. Kolonializmi, që u solli aq mjerime e vuajtje popujve në Afrikë, në Azi dhe në Amerikën Latine, po ha grushte dhe po shembet. Fitorja e revolucionit demokratik anti-imperialist në Kubë, e cila deri dje ishte çiflik i monopoleve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lufta heroike shtatëvjeçare e popullit algjerian, ngjarjet tragjike në Kongo, luftimet në Laos vërtetojnë edhe një herë se imperialistët nuk janë larguar kurrë me vullnetin e tyre nga kolonitë.

Partia dhe populli ynë, i cili e ka njohur vetë shfrytëzimin dhe shtypjen koloriale, kanë përkrahur dhe do të përkrahin kurdoherë dhe pa rezerva luftën nacionalçlirimtare të popujve të shtypur. Këtë e quajmë detyrën tonë internacionaliste. Ne i shprehim solidaritetin tonë popullit trim e vëlla algjerian, që po lufton me heroizëm shembullor për vite me radhë dhe jemi të bindur se nuk është e largët dita kur do të përshëndetim republikën algjeriane si shtet të lirë, të pavarur e sovran, me të cilin shteti ynë i demokracisë popullore do të jetë i kënaqur të ketë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi dhe miqësie. Ne shprehim simpatinë dhe përkrahjen tonë të plotë për luftën burrërore, që po bëjnë populli i Kongos dhe populli i Laosit kundër

agresorëve imperialistë dhe veglave të tyre dhe kërkojmë që t'i jepet fund ndërhyrjes kriminale dhe të rrezikshme imperialiste në këto vende.

Ne mendojmë se intrigat dhe komplotet djallëzore të kolonialistëve, për të hedhur përsëri në dorë pozitën e humbura në ish-kolonitë, përbëjnë një kërcënim serioz për popujt e këtyre vendeve dhe për paqen e përgjithshme. Në mënyrë të posaçme, imperializmi amerikan po vepron hapur, si xhandar i reaksionit ndërkom-bëtar që është, për të shtypur luftën nacionalçlirimtare, për të zgjatur jetën e sistemit kolonial, për të hedhur përsëri në dorë ish-kolonitë. Pa dyshim, popujt e Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine, që gjatë luftës së tyre plot sakrifica kundër imperializmit dhe veglave të tij kanë fituar një eksperiencë të madhe, do të dinë t'i rezistojnë neokolonializmit amerikan. Ata do të dinë të njohin e të zbulojnë fytyrën e vërtetë të atyre që, të paguar nga imperializmi amerikan, nën maskën e miqësisë, fshehin sëpatën nën gunë, për të zbatuar detyrën: të pengojnë ose të shtrembërojnë luftën e drejtë të popujve për çlirim apo për konsolidim të pavarësisë kombëtare, të mbjellin farën e përçarjes midis tyre, t'i largojnë ata nga mbështetja e tyre e natyrshme internacionaliste, nga vendet socialiste, dhe, në praktikë, t'i lënë përsëri në mëshirën e çakejve imperialistë. Ne po e shikojmë se ç'po ngjet në Kongo, ç'po ngjet në Laos. Ne jemi dëshmitarë të agresionit amerikan kundër Kubës revolucionare. Në rast se komplotet e shëmtuara dhe agresioni i imperializmit amerikan kundër Kubës kanë dështuar dhe do të dështojnë edhe në të ardhshmen, kjo i detyrohet vendosmërisë së popullit kuban, soli-

daritetit të vendeve socialiste, të popujve të Amerikës Latine dhe të popujve të tjerë paqedashës. Nuk ka dyshim se zgjerimi edhe më shumë i luftës së koordinuar të popujve që luftojnë për liri dhe të atyreve që janë çliruar, të vendeve të kampit socialist dhe të vendeve të tjera të pavarura, që janë kundër kolonializmit, të partive komuniste e punëtoresh në metropolet dhe në vendet koloniale, si edhe në vendet e tjera, forcimi edhe më shumë i frontit të forcave antikolonialiste në botë dhe demaskimi i neokolonializmit amerikan dhe i fytyrës së vërtetë të imperializmit amerikan, do të shpejtojnë likuidimin përfundimtar të kolonializmit. Në këtë mënyrë do të hapet një periudhë e re për të gjithë ata popuj që kanë vuajtur aq shumë nën zgjedhë, do të forcohet çështja e paqes në botë.

Është e qartë, shokë, se të gjitha këto fitore madhështore të sistemit botëror të socializmit dhe të luftës nacionalçlirimtare të popujve të varur e kolonialë kanë dobësuar pozitën sunduese, influencën dhe prestigjin e sistemit kapitalist. Njëkohësisht, ato kanë ashpërsuar në një shkallë të panjohur më parë kontradiktat e gjithanshme dhe krizën e përgjithshme të kapitalizmit.

Krijimi i sistemit socialist botëror dhe shthurja e sistemit kolonial të imperializmit e kanë ngushtuar shumë sferën e sundimit të imperializmit dhe, si rrjedhim, sferën e veprimit të ligjeve të tij. Kjo ka sjellë ashpërsimin e të gjitha kontradiktave që e brejnë nga brenda sistemin kapitalist, të kontradiktave klasore e kombëtare, të brendshme dhe të jashtme. Orvatjet për të shpëtuar kapitalizmin nga kontradiktat e veta të papajteshme, për të ruajtur themelet e tij të kalbura me

anën e militarizimit të ekonomisë dhe të garës së armatimeve, po e shpien rendin kapitalist drejt greminës së pashmangshme, po e shtrëngojnë edhe më shumë nyjen e kontradiktave të tij. Ekonomia e vendeve kapitaliste është futur në një qorrrokak, nga i cili nuk del dot. Ajo po bëhet gjithnjë e më e paqëndrueshme. Krizat e herëpashershme ekonomike jo vetëm që nuk janë zhdukur, siç predikojnë ideologët borgjezë dhe kolegët e tyre revizionistë, por janë bërë edhe më të shpeshta dhe sot kërcënojnë seriozisht shumë vende kapitaliste. Kalbëzimi i kapitalizmit duket qartë në vendin më të fuqishëm kapitalist, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku papunësia e madhe është bërë kronike, ritmet e rritjes së prodhimit po ulen, gara e armatimeve ka marrë përpjesëtime të papara ndonjëherë, ku po bëhen gjithnjë e më të theksuara tendencat fashiste e raciste në jetën e vendit dhe ku qarqet militariste po përcaktojnë gjithnjë e më shumë politikën shtetërore.

Të gjitha këto flasin qartë se situata ndërkombëtare zhvillohet në favor të socializmit dhe në dëm të kapitalizmit, se socializmi forcohet, ndërsa kapitalizmi dobësohet. Kjo është karakteristika e epokës sonë. Në Deklaratën e Moskës të vitit 1957 dhe në atë të vitit 1960 thuhet se përmbajtja themelore e epokës sonë është kalimi nga kapitalizmi në socializëm, se epoka jonë është epoka e luftës midis dy sistemeve shoqërore të kundërta, epoka e revolucioneve socialiste dhe e luftërave nacionalçlirimtare, e shembjes së imperializmit dhe e likuidimit të sistemit kolonial, e triumfit të socializmit dhe të komunizmit.

Partia jonë e Punës e ka kuptuar dhe e kupton

drejt, në mënyrë marksiste-leniniste, këtë çështje. Por a do të thotë kjo se, meqë forcat e socializmit ua kalojnë atyre të kapitalizmit, imperialistëve sot u janë lidhur duart? Se ne jemi në gjendje që sot t'u imponojmë atyre vullnetin tonë, kurse ata nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë? Se ne jemi në gjendje që sot të sigurojmë paqen, kurse ata nuk janë në gjendje të shpërthejnë luftën?

Metoda dialektike, marksiste-leniniste dhe kuptimi materialist i historisë na jep përgjigjen e drejtë, se mbivlerësimi i forcave tona dhe nënvleftësimi i forcave të armiqve, nga njëra anë, ashtu si nënvleftësimi i forcave tona dhe mbivlerësimi i forcave të armiqve, nga ana tjetër, të çojnë në gabime të rënda. Rasti i parë sjell dobësimin e vigjilencës dhe të shtyn për aventura, kurse rasti i dytë të çon në gabime e në qëndrime oportuniste. Prandaj Partia jonë ka theksuar gjithnjë se raporti i forcave në botë ka ndryshuar në favor të socializmit, se forcat e socializmit janë më të mëdha se ato të imperializmit, se forcat e paqes janë më të mëdha se ato të luftës, por, në të njëjtën kohë, ajo nuk i ka nënvleftësuar forcat e imperializmit. Vija e drejtë e Partisë sonë në këtë çështje ka gjetur shprehje të saktë në qëndrimin e saj ndaj problemeve të paqes e të luftës, ndaj imperializmit etj. Partia jonë ka folur dhe lufton për mundësinë e ndalimit të luftës botërore, se lufta botërore sot nuk është fatalisht e pashmangshme, por, në të njëjtën kohë, ajo ka theksuar edhe rrezikun e luftës, sepse derisa ekziston imperializmi ekziston edhe baza për luftëra agresive. Nga njëra anë, të gjitha përpjekjet tona janë përqëndruar në forcimin e kampit socialist, në ruajtjen e në kalitjen e unitetit të

tij, në shtimin e fuqisë së tij mbrojtëse, kurse, nga ana tjetër, duke ndjekur me konsekuencë politikën leniniste të bashkekzistencës paqësore të shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, kemi demaskuar kurdoherë imperializmin dhe veçanërisht imperializmin amerikan, pre-gatitjet e tij për luftë, natyrën e tij agresive. Këtej ka lindur edhe parulla jonë: «Në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Ta shohësh ndryshe këtë problem do të thotë të kalosh në pozitat e revizionistëve, të oportunistëve të djathtë.

Ne e duam sinqerisht paqen dhe përpiqemi për ta siguruar atë, kurse imperialistët, me të gjitha mjetet, përgatitin luftën e re botërore. Ç'tregojnë faktet? Le të kujtojmë agresionin e imperializmit amerikan kundër RDP të Koresë më 1950, agresionin anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit më 1956, ndërhyrjen e armatosur amerikano-angleze në Liban e në Jordani më 1958. Le të shikojmë luftën shfarosëse të imperializmit francez dhe të bllokut të NATO-s kundër popullit heroik algjerian, ndërhyrjen brutale të imperialistëve amerikano-belgë në Kongo, atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Laos. Këto nuk janë ngjarje të vogla dhe të veçuara. Imperialistët shpërthejnë luftëra të tilla lokale agresive dhe prej tyre nxjerrin fitimet e llogaritura, që pastaj të shpërthejnë luftën botërore. Jo pa qëllim imperialistët amerikanë pengojnë bashkimin e Koresë dhe të Vietnamit në Lindjen e Largme, pasi pjesët jugore të këtyre dy vendeve ata i kanë kthyer në kryeura për agresion kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë, kundër Republikës Demokratike të Vietnamit e kundër Republikës Popullore të Kinës.

Populli shqiptar, ashtu si shumica dërrmuese e popujve të Evropës, e ka akoma të gjallë kujtimin e krimeve të panumërta të kryera nga nazistët hitlerianë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por, ndërsa popujt me të drejtë prisnin që nazizmi të mos ngrinte kurrë krye, ne shikojmë se Gjermania Perëndimore, me ndihmën dhe me nxitjen e drejtpërdrejtë të imperialistëve amerikanë e të tjerë, përsëri është armatosur deri në dhëmbë. Atje është ngjallur militarizmi revanshist gjerman. Atje sot drejtojnë të njëjtat grupe monopoliste që sollën në fuqi Hitlerin, ndërtuan dhe furnizuan makinën e tij luftarake agresive. Atje komandojnë të njëjtët gjeneralë hitlerianë që, me urë në dorë, i vunë zjarrin Evropës, që janë të lyer me gjakun e dhjetëra milion viktimave. Jo vetëm kaq, por në Gjermaninë Perëndimore sot ndodhen të përqëndruara dhe nën komandën e lartë të kriminelëve nazistë Shpaidel dhe Hoizinger, veç trupave të Bundesverit, forca të shumta të bllokut agresiv të NATO-s nga më të zgjedhurat dhe të pajisura me armët më moderne. Jo vetëm Bundesveri i Adenauerit që ngjan me Vermahtin e Hitlerit si dy pika uji, në kundërshtim me marrëveshjet e Potsdamit, po pajiset bujarisht nga imperialistët amerikanë me armë dhe me raketa, por dhe vetë Gjermania Perëndimore tani prodhon në seri armatime nga më modernet.

Tre breza me radhë, shokë, kanë derdhur gjakun si lumë në Francë për të mbrojtur vendin e tyre nga sulmet e imperialistëve gjermanë. S'ka fshat e udhëkryq në Francë pa lapidare, ku janë shkruar emrat e francezëve të rënë për atdhe në luftë kundër agresorëve

gjermanë. Po çfarë shohim ne sot? Repartet ushtarake të Bundesverit¹ në kohë paqeje dhe pa shtënë asnjë pushkë, po vendosen në truallin e Francës, të vaditur me gjakun e komunarëve të pavdekshëm, të Gabriel Perisë dhe të miliona francezëve patriotë. Dhe kjo ngjet jo vetëm në Francë, por edhe në Itali, në Greqi, në Spanjë dhe në vende të tjera.

Ekspansioni ushtarak i imperializmit gjerman po bëhet në Evropën kapitaliste me bashkëfajësinë e qarqeve drejtuese të këtyre vendeve dhe me aprovimin e imperializmit amerikan. Të mos shikosh qëllimin, për të cilin krijohen këto baza, të mbyllësh sytë dhe të heshtësh para këtyre ngjarjeve, që janë pjesë përbërëse e planeve për shpërthimin e luftës botërore nga ana e imperializmit, do të thotë jo vetëm të harrosh mësimet e historisë dhe të mos kuptosh zhvillimin e situatës, por të bësh krim ndaj popujve dhe çështjes së paqes.

Te militaristët revanshistë gjermanë imperialistët amerikanë kanë gjetur aleatët e tyre më besnikë. Gjatë këtyre viteve imperialistët amerikanë kanë vazhduar pa skrupul rimilitarizimin e Gjermanisë Perëndimore me ritme të shpejtuara dhe kërcënimi kundër paqes dhe sigurimit të popujve është rritur. Gjermania e Bonit është kthyer në një vatër të rrezikshme të agresionit dhe Berlini Perëndimor në një strofkë provokimesh të përhershme kundër Republikës Demokratike Gjermane dhe vendeve të tjera socialiste.

Ja se ku është arritur 16 vjet pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ja përsëri rreziku i militarizmit

¹ Është fjala për repartet gjermano-perëndimore të NATO-s.

gjerman kundër paqes në Evropë dhe në botë, ndërsa nuk është nënshkruar akoma as traktati i paqes me Gjermaninë. Përse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e tyre kundërshtojnë sistematikisht propozimet kaq herë të përsëritura të Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Demokratike Gjermane për zgjidhjen e problemit gjerman? Përse ata kanë interes të zvarritet sa më shumë dhe bile të mos realizohet përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë? A nuk është e qartë se këtë e bëjnë për t'i pasur duart të lira në veprimtarinë e tyre armiqësore kundër vendeve socialiste, për të fituar kohë që të përgatitin me qetësi dhe ta shpërthejnë agresionin kundër nesh, kur t'i gjykojnë kushtet e favorshme, kur të jenë gati?

Partia jonë ka demaskuar kurdoherë me forcë ringjalljen e militarizmit revanshist gjerman dhe ka tërhequr vëmendjen e popullit tonë ndaj këtij rreziku real. Ne kemi përkrahur të gjitha propozimet e Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Demokratike Gjermane për zgjidhjen paqësore të problemit gjerman. Ne mendojmë se, me qëllim që të forcohet sigurimi i Republikës Demokratike Gjermane, i kampit tonë dhe i paqes së përgjithshme, ka ardhur koha të nënshkruhet sa më parë traktati i paqes me Gjermaninë, me të dy shtetet gjermane ekzistuese. Në rast se Gjermania Perëndimore dhe aleatët e saj e kundërshtojnë këtë, vendet tona socialiste, si edhe vendet e tjera të interesuara do të nënshkruajnë traktat paqeje të veçuar me Republikën Demokratike Gjermane. Në këtë mënyrë do të prishen planet e imperializmit me taktikën e zgjatjes e të zvarritjes, do të zgjidhet edhe çështja e Berlinit

Perëndimor dhe do të bëhet një hap i madh përpara në rrugën e paqes e të sigurimit ndërkombëtar. Sa më shpejt të kryhet ky hap, aq më mirë do të jetë për sigurimin e paqes dhe për zhvillimin demokratik të Gjermanisë.

Në planet agresive të imperializmit amerikan në Lindjen e Largme Japonia duhet të luajë rolin që luan Gjermania Perëndimore në Evropë. Një hap i rëndësishëm për ta kthyer me të shpejtë Japoninë në një kryeurë agresioni imperialist në Azi, është Traktati Ushtarak Amerikano-Japonez, që iu imponua vjet Japonisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në qoftë se imperialistët amerikanë do të ishin për paqe, siç e deklarojnë për demagogji, përse atëherë nuk pranojnë likuidimin e dyanshëm të pakteve ushtarake kundërshtarë, përkundrazi i forcojnë pa pushuar paktet agresive të NATO-s, SENTO-s dhe SEATO-s, i kanë kthyer në instrumente brutale të planeve të tyre agresive? Përse i mbajnë, i zgjerojnë dhe i pajisin vazhdimisht me armë termobërthamore dhe me raketa rreth 300 bazat e tyre ushtarake që kanë ngritur në tokë të huaj, rreth e rrotull vendeve tona socialiste? Ato, siç dihet, drejtohen kundër Bashkimit Sovjetik, Republikës Popullore të Kinës dhe vendeve të tjera të demokracisë popullore në Evropë e në Azi. Imperialistët amerikanë nuk e fshchin këtë. Bazat amerikane në tokë të huaj cenojnë rëndë sovranitetin e vendeve ku janë vendosur dhe janë mjet presioni e ndërhyrjeje të vazhdueshme në punët e tyre të brendshme. Në rast agresioni imperialist ato mund të ndjellin rrebeshe vdekjeprurëse mbi vendet që i kanë pranuar.

Le të përmendim edhe një fakt tjetër: mbledhjen e nivelit të lartë. Popujt kishin shpresë se nga kjo mbledhje e kryetarëve të fuqive të mëdha do të dilnin përfitime për uljen e tensionit ndërkombëtar, për largimin e rrezikut të luftës, për zgjidhjen e problemit gjerman dhe të çarmatimit. Por, siç dihet, qeveria amerikane, duke dërguar në pragun e kësaj mbledhjeje aeroplanin spiun U-2 mbi territorin e Bashkimit Sovjetik, me këtë akt agresiv të paramenduar e hodhi në erë mbledhjen e nivelit të lartë. Dërgimi i aeroplanit U-2 nuk është një akt agresiv i veçuar, i përdorur vetëm në këtë rast të caktuar; ai duhet vlerësuar dhe duhet trajtuar si shprehje e gjithë politikës së shkeljes së sovranitetit, ndërhyrjes brutale në punët e brendshme të shteteve të tjera dhe të agresionit nga ana e imperializmit amerikan.

Partia dhe Qeveria jonë kanë qenë dhe janë kurdoherë për bisedime të nivelit të lartë. Këto kanë dobini e tyre dhe mund të ndihmojnë për çështjen e paqes e të bashkëpunimit ndërkombëtar. Por, që të kenë efekt bisedimet midis udhëheqësve të qeverive dhe të shteteve, ato duhen shoqëruar me aksione masive dhe të ndër-gjegjshme të popujve, sepse, në fund të fundit, ata që vendosin janë popujt.

Nga ana tjetër, jeta po e vërteton përditë se asnjë problem ndërkombëtar nuk mund të zgjidhet pa pjesëmarrjen e një fuqie të tillë botërore, siç është Republika Popullore e Kinës. Pjesëmarrja e Republikës Popullore të Kinës edhe në mbledhjet e nivelit të lartë është në interes të paqes dhe të zgjidhjes së plotë të problemeve më kryesore që preokupojnë njerëzimin. Dhe pjesëmarrja e Republikës Popullore të Kinës në bisedime

të tilla shtron patjetër nevojën e rivendosjes së të drejtave të saj të ligjshme në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Ne të gjithë e dimë se, në kuadrin e politikës së tij agresive kundër kampit socialist, imperializmi amerikan ka vazhduar dhe vazhdon pa ndërprerje një veprimtari të theksuar armiqësore kundër Republikës Popullore të Kinës. Humbja e Kinës ka qenë për të një grusht për vdekje. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pushtuar me forcë Tajvanin dhe ishuj të tjerë kinezë, duke kryer kështu një agresion të vazhdueshëm kundër Kinës së madhe Popullore. Ato vazhdojnë bllokadën ekonomike, provokacione të armatosura, fushata të egra dhe presione të palejueshme. Ato organizuan lëvizjen kundërrevolucionare në Tibet dhe pengojnë rivendosjen e të drejtave të ligjshme të Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ku vendin e popullit të madh kinez e mban akoma kukulla çankaishiste.

Është e kuptueshme se një nga premisat kryesore për zgjidhjen e çështjeve të mbetura pezull me anë bisedimesh, dhe në mbledhje të nivelit të lartë për këtë qëllim, është që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të detyrohen t'i japin fund kësaj politike agresive, dritëshkurtër dhe të rrezikshme kundër Republikës Popullore të Kinës, që ajo të zërë vendin e merituar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Partia dhe Qeveria jonë do t'i përkrahin kurdoherë e me vendosmëri të drejtat e ligjshme dhe politikën paqësore konsekuente të mikut tonë të shtrenjtë, Republikës së madhe Popullore të Kinës. Ne shprehim bindjen tonë të patundur se pjesë-

marrja e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në mbledhjet e nivelit të lartë do të ketë efekt të madh pozitiv për çështjen e paqes e të sigurimit ndërkombëtar. Kjo duhet parë si një betejë që duhet fituar nga forcat e paqes mbi forcat e luftës, si një betejë për të forcuar paqen.

Kur u krijua Organizata e Kombeve të Bashkuara i vuri për detyrë themelore vetes të shpëtonte popujt nga tmerret e një lufte të re dhe ata patën shumë shpresa te ajo. Kjo Organizatë do të shprehte vullnetin e popujve në qoftë se nuk do të kthehej, në shumë raste, në një vegël të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të mund të luante rolin e saj në shërbim të paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar.

Republika Popullore e Shqipërisë merr pjesë gjallërisht në punimet e OKB-së dhe jep kontributin e vet së bashku me vendet e tjera socialiste e paqedashëse. Por nuk mund të mos thuhet, njëkohësisht, se mungesa e Republikës Popullore të Kinës është një e metë organike e Organizatës së Kombeve të Bashkuara që e ul shumë aftësinë dhe autoritetin e saj. Nga ana tjetër imperialistët amerikanë ushtrojnë atje akoma një influencë shumë të madhe, qoftë nëpërmjet aparatit ekzekutiv të Sekretariatit, që është kryesisht në duart e tyre, qoftë me anën e mekanizmit të votës në organet e ndryshme të Organizatës. Kjo influencë negative pengon marrjen e vendimeve efektive në favor të lirisë së popujve, siç është rasti i Kongos dhe i Algjerisë, në favor të paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar.

Le të shohim problemin e çarmatimit. Qysh në

vitin 1946 dhe vazhdimisht gjatë këtyre 15 vjetëve, Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë, ka paraqitur propozime të panumërta, lidhur me këtë problem. Republika Popullore e Shqipërisë i ka përkrahur këto propozime. Asambleja e Përgjithshme për vite me radhë ka zhvilluar diskutime pa fund mbi këtë problem, ka aprovuar bile edhe rezoluta të shumta në favor të çar-matimit. Por ç'është bërë në praktikë? A është marrë ndonjë masë konkrete efektive? A është arritur ndonjë rezultat konkret? Asgjë. Përkundrazi, gara e armatimeve është zhvilluar me forcë më të madhe. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e tyre kanë ndjekur pa ndërprerje politikën e tensionit e të provokacionit, megjithëse, siç dihet, Bashkimi Sovjetik, Republika Popullore e Kinës dhe vendet e tjera socialiste nuk janë kufizuar vetëm në propozime konkrete, por kanë marrë edhe masa të njëanshme për të lehtësuar rrugën e marrëveshjes për këtë problem kyç të kohës sonë.

Nuk mund të mohohet se bisedimet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe jashtë saj në konferenca e organizata të ndryshme, kanë ndihmuar për të bërë të njohur politikën e drejtë paqësore të vendeve socialiste dhe njëkohësisht për të demaskuar qëndrimin negativ të SHBA-së e të fuqive perëndimore. Gjithashtu vihet re se propaganda imperialiste dhe revizioniste është munduar t'i përdorë këto bisedime të zgjatura dhe pa fund për të ngjallur iluzione e shpresa të kota në popujt, ndërsa vetë fuqitë imperialiste janë përpjekur dhe përpiqen që bisedime të tilla të zvarriten sa më shumë dhe pa rezultat, me qëllim që ato, prapa

bisedimeve boshe, të zhvillojnë sa më shumë garën e armatimeve dhe të përgatiten për agresion.

Atëherë si mund të sigurohet paqja dhe të evitohet lufta botërore? Është e qartë se, me vullnetin e tij, imperializmi nuk heq dorë nga lufta, vullnetarisht nuk i lëshon armët. Të besosh në një mundësi të tillë, do të thotë të gënjesh veten. Duhet, pra, që imperialistëve t'u bëhet e pamundur ta shpërthejnë luftën dhe kjo arrihet vetëm duke u vënë përballë forcën ekonomike, ushtarake, moralo-politike të vendeve socialiste, forcën e klasës punëtore ndërkombëtare, të lëvizjes nacional-çlirimtare, forcën e të gjithë popujve që janë kundër luftës dhe të të gjitha forcave paqedashëse në botë. Kjo është e vetmja rrugë, në qoftë se nisemi nga pozitat e marksizëm-leninizmit.

Paqja nuk sigurohet duke u bërë lëshime imperialistëve ose duke u bërë atyre lajka. Të gjitha përpjekjet e vendeve tona socialiste në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, politika e bashkekzistencës paqësore që ndjekin me konsekuencë vendet socialiste kundrejt vendeve kapitaliste, taktikat dhe kompromiset e lejueshme nga ana jonë, duhet të ndihmojnë për forcimin tonë dhe për dobësimin e armikut, për ta detyruar atë që të heqë dorë nga gara e armatimeve, nga provat dhe nga prodhimi i armëve atomike, nga krijimi i bazave ushtarake, nga përgatitja e luftës së re botërore.

Përpara nesh, si një rrezik serioz për paqen, qëndron imperializmi, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. Ai është agresiv dhe i egër, megjithëse nuk është më zot i botës, siç ishte dikur. Imperializmi nuk ka ndryshuar as lëkurën, as natyrën e tij. Ai nuk është

bërë qengj. Ujku qengj nuk bëhet, thotë një fjalë e urtë popullore. Pra, imperializmi luftëdashës nuk bëhet paqedashës. Në Deklaratën e Mbledhjes së përfaqësuesve të 81 partive theksohet: «Lufta është bashkudhëtare e përhershme e kapitalizmit», se «imperializmi është një rrezik serioz për të gjithë njerëzimin», se «sa kohë që mbetet imperializmi, mbetet edhe baza për luftëra agresive» dhe se «forca kryesore e agresionit dhe e luftës është imperializmi amerikan». Dhe kjo është e drejtë, kështu mëson marksizëm-leninizmi.

Prandaj, përpara këtij armiku të egër të të gjithë njerëzimit, që përpiqet ta hedhë botën në një luftë tjetër botërore, e cila, me armët bërthamore që ekzistojnë tani, do të sillte shkatërrime dhe mjerime të pallogaritshme, kampi socialist duhet të jetë i përgatitur si ushtarakisht, ashtu edhe politikisht e moralisht për t'i bërë ballë çdo aventure nga ana e imperializmit. Duhet të ngrihen në këmbë masat kudo në botë për t'ua ndalur dorën imperialistëve, për të demaskuar intrigat e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve, që përpiqen të përçajnë popujt, t'i mashtrojnë dhe t'i zënë në befasi, të papërgatitur. Duhet të ngrihet lart vigjilenca e popujve. Kështu dhe vetëm kështu imperialistët nuk do të mundën ta shpërthejnë luftën. Armikut nuk i zihet besë, nuk i zihet besë imperializmit, veçanërisht imperializmit amerikan.

Ekzistenca dhe lufta midis dy sistemeve botërore të kundërta, përcakton ekzistencën e dy vijave të kundërta në politikën ndërkombëtare, nga njëra anë, politikën paqësore konsekuente të vendeve socialiste, e cila gjen çdo ditë e më tepër përkrahjen e zjarrtë të popujve

të mbarë botës, dhe, nga ana tjetër, politikën luftënxitëse e agresive të fuqive imperialiste e, në radhë të parë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vënë në rrezik paqen në botë. Këto dy vija të kundërta në politikën ndërkombëtare janë shfaqur me një qartësi të madhe edhe vitet e fundit.

Atyre që përpiqen të vënë në dyshim sinqeritetin tonë në luftën për paqe, duke thënë se gjoja që të fitojë socializmi në të gjitha vendet paska nevojë për luftën botërore, u themi se ne e hedhim poshtë këtë akuzë të propagandës borgjeze për të ashtuquajturin «eksportim» të revolucionit socialist, po ashtu siç luftojmë me vendosmëri edhe kundër eksportimit imperialist të kundërrevolucionit. Në qoftë se ndokush mendon se vendet socialiste janë për paqen, sepse janë të dobëta dhe tremben për fatin e sistemit të tyre, u përgjigjemi se nuk ka asnjë dyshim se në rast se imperialistët e çmendur, pa marrë parasysh asgjë, do të shpërthejnë një luftë të re botërore, ajo do të përfundojë me shkatërrimin e plotë të imperializmit, me likuidimin e kapitalizmit si sistem shoqëror.

Lufta për bashkekzistencën paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore përbën një nga aspektet e politikës së jashtme paqësore të vendeve socialiste, krahas me forcimin e bashkëpunimit vëllazëror dhe ndihmën reciproke midis tyre, si edhe me mbështetjen e me përkrahjen e luftës revolucionare antiimperialiste e antikoloniale të popujve të robëruar.

Parimi i bashkekzistencës paqësore, i cili është përpunuar nga Lenini i madh, përcaktohet në Deklaratën e Moskës të nëntorit 1960 si i vetmi parim i

drejtë dhe i arsyeshëm në marrëdhëniet midis shteteve me sisteme shoqërore të ndryshme, në kushtet e ndarjes së botës në dy sisteme të kundërta.

Lufta për arritjen e bashkekzistencës paqësore ka-lon nëpërmjet luftës së vendeve socialiste dhe vendeve të tjera paqedashëse për zgjidhjen e problemeve konkrete të jetës së sotme ndërkombëtare me anën e bisedimeve, nëpërmjet luftës nacionalçlirimtare të popujve dhe luftës për paqe. Popujt duhet t'ua imponojnë atë imperialistëve, të cilët vullnetarisht nuk heqin dorë nga «lufta e ftohtë», nga blloqet ushtarake, nga gara e armatimeve, nuk heqin dorë nga ndërhyrja në punët e brendshme të vendeve të tjera, nga shkelja e pavarësisë dhe e sovranitetit të popujve etj.

Duke luftuar me vendosmëri e me konsekuencë për bashkekzistencën paqësore, Bashkimi Sovjetik, Republika Popullore e Kinës dhe vendet e tjera socialiste kanë marrë inisiativa të shumta për zgjidhjen e çështjeve të mbetura pezull. Këto inisiativa kanë gjetur një jehonë të gjerë në opinionin publik botëror dhe gëzojnë përkrahjen e të gjithë popujve e njerëzve paqedashës, sepse hapin rrugën për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme në botë. Por deri tani ato nuk kanë dhënë rezultatet e duhura, sepse përballë politikës paqësore të vendeve socialiste, që kanë përkrahjen edhe të vendeve të tjera paqedashëse, qëndron politika agresive e përgatitjes së luftës së re botërore, që ndjekin me këmbëngulje fuqitë imperialiste dhe, në radhë të parë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë rrugë shpalli si politikë të tij edhe presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhon Kenedi. Në mesazhin e tij, drejtuar kongresit, ai theksoi se do të ndjekë të njëjtin kurs,

atë të paraardhësve të tij, domethënë kursin e Ajzenhauerit, të «luftës së ftohtë», të garës së armatimeve, të presioneve dhe të shantazheve. Duke ndjekur gjurmët e Ajzenhauerit dhe duke shprehur ndjenjat dhe interesat e monopoleve dhe të reaksionit amerikan, Kenedi në mesazhin e tij njoftoi se do të ndjekë politikën e armatimit, të forcimit të flotës së nëndetëseve me raketa «Polaris», të shtimit të prodhimit të raketave, të forcimit të aviacionit për transportimin e armatimeve, të trupave etj. Shtimi i menjëhershëm i vlerës së aksioneve të industrisë së luftës në Shtetet e Bashkuara, që të nesërmen e deklaratës së Kenedit, tregon qartë se në interesin e kujt u bë ajo. Presidenti, Kenedi, përcaktoi qartë edhe pozitën e tij ndaj lëvizjes çlirimtare të popujve, si ndaj Kubës, Laosit etj. Ai mori hapur nën mbrojtje agresorët dhe shtypësit e popujve. Ai nuk harroi t'u «premtojë» edhe popujve të vendeve të demokracisë popullore «çlirim» nga komunizmi, gjë për të cilën do të punojë presidenti i ri në të ardhshmen. Është e qartë se Xhon Kenedi me fjalën «çlirim» kupton rivendosjen e kapitalizmit, të shtypjes dhe të shfrytëzimit, për zhdukjen e të cilëve popujt tanë de-dhën gjak. Në mesazhin e tij, Kenedi, nuk la pa sulmuar edhe politikën e Bashkimit Sovjetik e të Republikës Popullore të Kinës. Por në të njëjtën kohë, sa për të gënjyer naiyët, ai tundi edhe degën e ullirit, foli edhe për paqe e bashkekzistencë. Pa dyshim, këtu kemi të bëjmë me një bluf «ala Kenedi», sepse po të ishte i sinqertë në fjalët e tij, ai, jo vetëm nuk duhej të ëndërronte për «çlirim» e popujve të Evropës Lindore nga komunizmi, por duhej të shprehej për vendosjen e

marrëdhëniet diplomatike me 6 shtete socialiste të Azisë e të Evropës, me të cilat deri tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për fajin e tyre, për shkak të politikës së «luftës së ftohtë», nuk kanë marrëdhënie.

Është e qartë se politika e shteteve imperialiste vazhdon të jetë ajo që ka qenë, ajo që u përgjigjet interesave të monopoleve. Prandaj, vigjilenca e popujve duhet të rritet e të forcohet përditë e më shumë. Në të njëjtën kohë, vendet tona socialiste do të vazhdojnë me konsekuencë politikën e tyre paqësore, me qëllim që të sabotojnë planet e imperialistëve për një luftë të re. Dhe forca për ta ndaluar shpërthimin e saj ka. Këto forca janë popujt, lufta e tyre e vendosur, se, ashtu siç ka thënë Stalini

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹.

Në këtë gjendje ndërkombëtare të nderë e të ndërlikuar, në këtë luftë për mbrojtjen e paqes, që ka përfshirë të gjithë popujt dhe forcat paqedashëse të botës, Partia jonë, duke zbatuar me sukses vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste dhe detyrat konkrete të caktuara nga Kongresi III i saj, ka marrë pjesë gjallërisht dhe ka dhënë kontributin e saj të çmueshëm për ruajtjen dhe për forcimin e mëtejshëm të unitetit të

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

kampit socialist, për demaskimin dhe për kundërshtimin e planeve dhe politikës agresive të imperializmit amerikan dhe të gjithë armiqve të paqes e të socializmit, për largimin e rrezikut të luftës dhe për ruajtjen e paqes së përgjithshme. Këtë rrugë do të vazhdojë të ndjekë me konsekuencë edhe paskëtaj Partia e Punës e Shqipërisë.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Qeveria e RPSH në politikën e jashtme kanë zbatuar me vendosmëri dhe me sukses detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë. Pozita ndërkombëtare e Republikës Popullore të Shqipërisë është forcuar edhe më shumë. Vendi ynë vazhdimisht zgjeron marrëdhëniet e tij me vendet e tjera dhe luan një rol aktiv në fushën ndërkombëtare, në favor të paqes dhe të bashkëpunimit midis popujve, kundër politikës së luftës që ndiqet nga imperializmi dhe veglat e tij. Të gjitha rezultatet e arritura në fushën ndërkombëtare nga Republika Popullore e Shqipërisë janë dëshmi e gjallë e vijës së drejtë marksiste-leniniste të ndjekur nga Partia jonë në lëmin e politikës së jashtme.

Republika Popullore e Shqipërisë është bërë një faktor paqeje dhe përparimi në zonën e Ballkanit e të Adriatikut, pasqyrë e gjallë e epërsisë së sistemit socialist mbi atë kapitalist, pengesë e sigurt për planet agresive të imperializmit amerikan në këtë pjesë të botës. Armiqtë e Partisë dhe të popullit tonë, imperialistët dhe revizionistët, na kanë halë në sy dhe na urrejnë. Ata kanë halë në sy pozitën strategjike të vendit tonë dhe pasuritë e tij të mëdha. Ata tërbohen kur shohin se brenda në prapavijat e tyre, një vend i vogël dhe një popull heroik lufton me heroizëm dhe me këmbëngulje për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e tij dhe ndërton

me sukses socializmin. Ata egërsohen nga realizimet madhështore të arritura nga populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë në të gjitha fushat, nga patriotizmi i flaktë, ndërgjegjja e lartë politike, gatishmëria dhe vigjilenca revolucionare e popullit tonë, nga vija e papërkulur marksiste-leniniste e Partisë sonë, e cila për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e çështjes së popullit dhe të socializmit nuk ka ngurruar dhe nuk do të ngurrojë asnjëherë, pa marrë parasysh çdo sakrificë, të përballojë dhe të thyejë me sukses të gjitha stuhitë, qofshin këto nga më të fuqishmet dhe më të egrat.

Shqipëria është i vetmi vend që ndërton socializmin në kushtet e rrethimit armiqësor kapitalist. Zhvillimi i saj si shtet sovran, duke thyer vazhdimisht sulmet e pandërprera të armiqve, dëshmon aftësinë e Partisë dhe të Qeverisë sonë që zbatojnë në mënyrë krijuese, në kushtet e vendit tonë, marksizëm-leninizmin, që zbatojnë një politikë të drejtë paqësore dhe vigjilente.

Shqipëria me gjithë rrethimin gjeografik kapitalist nuk është një vend i izoluar. Ajo është vend socialist, ka miq të fortë e besnikë popujt e vendeve socialiste, ajo ka aleatë të gjithë popujt paqedashës dhe klasën e fuqishme punëtore të mbarë botës. Në të gjitha këto qëndron forca e atdheut tonë socialist që lulëzon në brigjet e Adriatikut.

Miqësia me popujt e Bashkimit Sovjetik është farkëtuar nga Partia jonë heroike në zjarrin e luftës për liri e për pavarësi kombëtare, për socializëm dhe për paqe; ajo është mbryjtur me gjakun e partizanëve tanë trimë dhe të luftëtarëve të kuq të Ushtrisë së lavdishme

Sovjetike, e cila me fitoret e saj historike kundër fashizmit, në Luftën e Dytë Botërore, krijoi kushtet dhe ndihmoi edhe për çlirimin e atdheut tonë nga kuçedra fashiste. Populli shqiptar, i edukuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, do ta ruajë e do ta kalitë dashurinë e mirënjohjen e tij ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik dhe ndaj Partisë Komuniste, Partisë së Leninit të pavdekshëm, mësimet e të cilit ndriçojnë në çdo hap udhën e Partisë dhe të popullit tonë drejt socializmit dhe komunizmit.

Miqësia dhe bashkëpunimi vëllazëror me Republikën Popullore të Kinës janë forcuar edhe më shumë nbi bazat e marksizëm-leninizmit, të luftës së përbashkët për socializmin e për paqen dhe të ndihmës reciproke vëllazërore internacionaliste, të përkrahjes dhe të mbështetjes te njëri-tjetri. Mijëra kilometra e ndajnë gjeografikisht Shqipërinë nga Kina, por e tillë është forca e marksizëm-leninizmit, sa që ne e ndiejmë shumë të afërt miqësinë dhe solidaritetin shembullor të popullit të madh kinez prej 650 milionësh dhe të udhëheqjes së tij të sprovuar, Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës që po ndërton me sukses socializmin, nën flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit. Partia dhe populli ynë janë krenarë që kanë një mik të tillë të shtrenjtë, siç është populli i madh dhe i talentuar kinez. Republika Popullore e Kinës është kështjellë e fuqishme e socializmit dhe mbështetje e sigurt e çështjes së lirisë së popujve, të paqes dhe të përparimit shoqëror në Azi dhe në botë. Ne u jemi mirënjohës popullit dhe Partisë Komuniste të Kinës për ndihmën bujare që i kanë dhënë dhe i japin popullit shqiptar.

Me të gjitha vendet e tjera socialiste populli ynë është i lidhur me një miqësi të sinqertë dhe me marrëdhënie vëllazërore në interes të socializmit e të paqes.

Shqipëria e re tërheq gjithmonë e më shumë vëmendjen e botës së jashtme. Atë e duan dhe e respektojnë proletariati ndërkombëtar dhe popujt paqedashës për luftën e saj heroike kundër fashizmit, për besnikërinë e popullit dhe të Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit dhe ndaj kampit socialist, për përkrahjen aktive të luftës nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, për politikën e saj paqësore konsekuente, për hovin e madh revolucionar që e shpuri vendin tonë nga zgjedha në liri, nga errësira në dritë, nga varfëria në rrugën e begatisë e të lumturisë, në rrugën e socializmit. Kjo na jep forca të reja për të ecur përpara në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Republika Popullore e Shqipërisë në marrëdhëniet me vendet e tjera ka ndjekur dhe do të ndjekë kurdoherë politikën e paqes e të miqësisë në bazë të parimeve të mirënjohura të bashkekzistencës paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore. Paqja është kusht i domosdoshëm për ndërtimin e jetës së lumtur për popullin tonë. Republika Popullore e Shqipërisë do të jetë kurdoherë luftëtare e vendosur në frontin e paqes dhe do të godasë kurdoherë politikën agresive të imperializmit, komplotet e armiqve të paqes.

Partia dhe Qeveria jonë u kanë kushtuar kurdoherë kujdes të posaçëm marrëdhënieve me vendet fqinje dhe në përgjithësi gjendjes në zonën e Ballkanit e të Adriatikut. Politika jonë ka synuar kurdoherë dhe synon në kthimin e kësaj zone në një zonë paqeje dhe

bashkëpunimi të frytshëm. Këtij qëllimi i shërben propozimi i bërë nga qeveritë e Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë për ta kthyer Ballkanin dhe Adriatikun në një zonë paqeje, pa baza për armë atomike dhe raketa. Duhet theksuar si faktorë negativë për gjendjen në këtë zonë, vendosja e raketave amerikane në Itali, në Greqi, në Turqi dhe vizitat e shpeshta të Flotës VI Amerikane në skelat e këtyre vendeve, si edhe në ato të Jugosllavisë.

Republika Popullore e Shqipërisë ka vazhduar përpjekjet për të zhvilluar marrëdhëniet e saj me vendet fqinje mbi parimet e barazisë, mosndërhyrjes, respektit dhe përfitimit reciprok. Me inisiativën e Qeverisë sonë u rivendosën marrëdhëniet e rregullta me Jugosllavinë. Në Kongresin III Partia jonë deklaroi se, me gjithë dëmet e mëdha që na kishte shkaktuar politika armiqësore e udhëheqjes jugosllave, ne ishim gati për marrëdhënie të drejta të fqinjësisë. Dhe ne kemi bërë përpjekje të sinqerta për të vendosur dhe për të zhvilluar marrëdhënie normale të fqinjësisë së mirë, shkëmbime tregtare, kulturore, turistike etj. Mirëpo udhëheqësit jugosllavë kurrë nuk kanë hequr dorë nga politika e tyre armiqësore ndaj vendit tonë dhe kanë vazhduar e vazhdojnë veprimet e tyre për të ndërhyrë brutalisht në punët tona, për të likuiduar Partinë tonë, pushtetin tonë popullor, lirinë dhe pavarësinë tonë kombëtare. Për këtë flasin faktet: organizimi dhe aktivizimi i grupeve të ndryshme agjenturale, dërgimi i diversantëve dhe i bandave të tëra nga Jugosllavia, provokacionet e panumërta në kufi. Udhëheqësit jugosllavë në fjalimet publike, në shtyp, si edhe me anë komedish false gjy-

qësore, të cilat janë shtuar veçanërisht kohët e fundit, nuk lënë rast pa shpifur dhe pa sulmuar Partinë, pushtetin dhe popullin tonë. Po kjo baltë u bie atyre në fytyrë.

Tragjedia e popullsisë shqiptare që jeton në Jugosllavi është e njohur nga të gjithë. Partia jonë ka ngritur dhe do të ngrejë zërin e saj kundër ndjekjeve, shpërnguljeve të shqiptarëve në Turqi dhe kundër gjithë politikës shoviniste shfarosëse, që ndiqet në Jugosllavi kundër vëllezërve tanë shqiptarë të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Partia jonë e bën këtë, duke u nisur nga pozita marksiste-leniniste, sepse e konsideron një detyrë të lartë humanitare. Ajo do ta bëjë këtë përderisa popullsisë shqiptare prej 1 milion frymësh në Jugosllavi t'i sigurohen të drejtat e plota që i përkasin si pakicë kombëtare, në bazë të parimeve dhe të së drejtës ndërkombëtare. Ashtu si deri tani, edhe në të ardhshmen ne jemi për marrëdhënie të rregullta fqinjësie mbi bazën e bashkekzistencës paqësore dhe të reciprocitetit. Në këtë drejtim, Republika Popullore e Shqipërisë është e gatshme të vazhdojë të zhvillojë marrëdhënie normale, por me kusht që Qeveria e Republikës Federative Popullore e Jugosllavisë të mos i pengojë dhe të heqë dorë sa më parë nga veprimet armiqësore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë.

Gjendja e marrëdhënieve tona me Greqinë mund të thuhet se nuk ka ndryshuar aspak, për shkak të politikës reaksionare dhe dritëshkurtër të qarqeve drejtuese greke, të cilat u janë nënshtruar symbyllazi imperialistëve amerikanë. Ne kemi bërë përpjekje të shum-

ta për të normalizuar marrëdhëniet me Greqinë, kemi marrë inisiativa të njëanshme, i kemi dhënë mundësi të njaftueshme qeverisë greke që t'u përgjigjet gatishmërisë dhe vullnetit tonë të mirë. Këtë e kemi bërë qoftë me riatdhesimin e qytetarëve grekë të strehuar në Shqipëri, qoftë me pastrimin e kanalit të Korfuzit, qoftë me propozimet tona për normalizimin e gjendjes në kufi, për shkëmbime tregtare etj. Por qeveritarët grekë kanë vazhduar udhën e provokimeve kriminale në kufi, të fushatave të çmendura mbi të ashtuquajturën gjendje lufte midis të dy vendeve dhe të pretendimeve absurde mbi Shqipërinë e Jugut, të kompleteve kundër integritetit tokësor të atdheut tonë. Natyrisht, ata kanë marrë dhe do të marrin kurdoherë përgjigjen e merituar nga ana jonë. Ne, duke mbajtur kurdoherë lart vigjilencën, do të vazhdojmë edhe në të ardhshmen politikën tonë drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë mbi parimet e mësipërme, por natyrisht, për këtë normalizim varet shumë nga qeveria greke, e cila duhet të heqë dorë sa më parë nga veprimet armiqësore kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ne ushqejmë një dashuri dhe një respekt të madh për popujt vëllezër të Jugosllavisë dhe të Greqisë dhe dëshirojmë e do të punojmë pareshtur që kjo miqësi e sinqertë që ne ndiejmë për këta popuj vëllezër e fqinjë, të forcohet. Ne jemi të bindur se ata nuk i aprovojnë dhe nuk do t'i aprovojnë kurrë veprimet kriminale të qeverive të tyre kundër një populli paqësor, që kërkon të rrojë në paqe dhe në fqinjësi të mirë me ta. Ne u bëjmë thirrje popujve fqinjë të Jugosllavisë dhe të Greqisë t'u ndalin dorën qeverive të tyre dhe t'i pengoj-

në në veprimet kundër atdheut tonë, se këto veprime mund të çojnë në prishjen e paqes në Ballkan. Ne besojmë se qeveritë e Beogradit dhe të Athinës e njohin mirë popullin shqiptar dhe pushtetin e tij popullor. Në qoftë se kundrejt dorës sonë miqësore që u nderim ato ngrenë shpatën, të jenë të sigurt se shpatën e tyre do t'ua thyejmë. Në kohën e sotme në Ballkan është përmbysur gjendja e vjetër, ashtu siç është përmbysur në botë. Në Ballkan janë tri shtete socialiste — Bullgaria, Rumania dhe Shqipëria, popujt e të cilave janë lidhur ngushtë ndërmjet tyre.

Interesat jetike të popujve të kësaj zone shtrojnë me forcë përpara vendeve socialiste dhe josocialiste nevojën e koordinimit të përpjekjeve të përbashkëta, për të siguruar paqen dhe bashkëpunimin midis shteteve mbi parimet e mosndërrhyrjes, të barazisë dhe të interesit reciprok. Ne jemi sinqerisht për politikën e fqinjësisë së mirë, me bindje se një politikë e tillë u përgjigjet si interesave të Shqipërisë, ashtu edhe interesave të vendeve fqinje. Por sunduesit e të dy vendeve fqinje me ne, të mos i gënjejë kurrë mendja se Shqipërinë do ta gjejnë në gjumë, se Shqipërinë mund ta izolojnë ose e kanë izoluar, si ëndërrojnë me sy hapur, dhe do t'i qërojnë shpejt hesapet me të. Populli shqiptar ka vuajtur shumë gjatë historisë dhe as gjumi nuk e zë, as gënjehet nga blofet e monarko-fashistëve grekë dhe të revizionistëve jugosllavë.

Shteti i sotëm jugosllav nuk është një shtet «neutral» dhe nuk qëndron «jashtë blloqeve», siç e paraqit propaganda e Beogradit, apo siç përpiqen ta paraqitin miqtë e hapur ose të maskuar të regjimit titist. Politika

ia do grupit revizionist të Beogradit, të deklarojë sot me fjalë se klauzolat ushtarake të këtij traktati «e kanë humbur vlerën». Kjo, natyrisht, nuk mund të gënjejë njeri, përveçse ata, të cilëve ua ka ënda të gënjehen dhe tërthorazi të gënjejnë edhe të tjerët për të mbështetur titizmin.

Në bazë të «Paktit të Ballkanit» janë koordinuar botërisht dhe në mënyrë të maskuar planet operative ushtarake, veçanërisht ato jugosllavo-greke, janë armatosur të dyja këto ushtri me armë moderne, të dhëna nga imperializmi amerikan haptazi, me kredi dhe falas, janë përgatitur bazat e sulmit dhe shumë herë çdo vit grupe të oficerëve të lartë të shtatmadhorive të Greqisë e të Jugosllavisë piqen dhe koordinojnë planet ushtarake, asistojnë në manovrat dhe në lojnat ushtarake që zhvillohen në këto dy territore. Greqia dhe Jugosllavia po përgatiten ushtarakisht në mënyrë të ethshme. Imperializmi amerikan financon këtë përgatitje të madhe deri edhe te autostradat me karakter ushtarak që po ndërton Jugosllavia. Është krim kundër paqes botërore, është krim kundër socializmit, është krim kundër vendeve socialiste të Ballkanit, është krim veçanërisht kundër Shqipërisë që të mos demaskohen botërisht planet agresive të titistëve dhe të mbulohen ato nën tymin e një «neutraliteti» fals, nën parullat false dhe antimarksiste, se gjoja grupi renegat titist po udhëheq ndërtimin e socializmit në Jugosllavi. Rolin djallëzor, përçarës dhe komplotet e grupit renegat titist që sundon në Jugosllavi kundër paqes, kundër kampit socialist, kundër Shqipërisë, ne i kemi demaskuar dhe do t'i demaskojmë pse e ndiejmë thellë përgjegjësinë që kemi

për mbrojtjen e paqes, të socializmit, të kampit socialist dhe të atdheut tonë.

Jugosllavia titiste, së bashku me aleaten e saj Greqinë dhe në koordinim me NATO-n dhe me Flotën VI Amerikane në Mesdhe, komploton kundër lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të atdheut tonë. Këto janë të faktuara.

Unë mund t'i deklaroj Kongresit, popullit, Partisë, se këto dy fuqi fqinje, Jugosllavia dhe Greqia, në bashkëpunim me disa tradhtarë shqiptarë, brenda vendit dhe të arratisur në Jugosllavi dhe në koordinim me Flotën VI Amerikane në Mesdhe, kishin organizuar disa muaj më parë komplotin¹ kundër Shqipërisë, me qëllim që të likuidonin Republikën Popullore të Shqipërisë. Ky komplot kriminal u dështoi fund e krye. Komplotistët dhe faktet janë në duart e drejtësisë popullore. Ky komplot i urryer dështoi pse Partia jonë heroike, pse populli ynë, ushtria jonë dhe Arma e Sigurimit të Shtetit ishin në roje e vigjilente si kurdoherë për mbrojtjen e atdheut e të popullit.

Marrëdhëniet me Italinë janë zhvilluar në mënyrë pak a shumë normale, sidomos në fushën e tregtisë. Përfundimi i marrëveshjes mbi reparacionet është një hap përpara. Por nuk mund të mos përmendet si element

¹ Është fjala për komplotin kundërrevolucionar që përgatitej nga një organizatë e fshehtë antishtetërore, në krye të së cilës ishin agentë të vjetër të zbulimeve të huaja. Plani i tyre kundërrevolucionar ishte i kombinuar edhe me një ndërhyrje të armatosur nga jashtë. Siç u vërtetua më vonë, për këtë komplot kishte dijeni edhe udhëheqja revizioniste sovjetike, e cila llogariste ta shfrytëzonte për qëllimet e veta.

negativ vendosja e raketave në tokën italiane. Ne nuk mund të mos shqetësohemi për kthimin e tokës italiane në një bazë agresioni imperialist kundër vendit tonë dhe vendeve të tjera të kampit socialist. Ne i shikojmë me shqetësim veprimet e qeverisë italiane në këtë drejtim dhe, sikundër e kemi deklaruar, nuk mund të qëndrojmë duarkryq.

Ne mendojmë se midis dy vendeve mund të zhvillohen me sukses marrëdhëniet tregtare e kulturore, si edhe komunikacionet në interes reciprok, në rast se qarqet drejtuese italiane do t'i kuptojnë në mënyrë më realiste këto çështje. Ne mendojmë se është në interesin e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve fqinje dhe të paqes në këtë zonë që Italia të pushojë së qeni strofkë për kriminelët shqiptarë të luftës, gjë që nuk pajtohet as me ekzistencën e marrëdhënieve normale midis dy vendeve.

Populli shqiptar e ka ndier kurdoherë veten të afërt me popujt arabë, me të cilët e lidhin tradita të lashta historike dhe mjaft zakone të përbashkëta, luftërat e shumta të zhvilluara krah për krah kundër të njëjtëve armiq, aspiratat e njëjta për liri, për pavarësi dhe për përparim. Populli dhe Qeveria jonë kanë përkrahur dhe do të përkrahin deri në fund luftën e drejtë për çlirim dhe për forcimin e pavarësisë kombëtare të vendeve arabe. Kur populli vëlla egjiptian u sulmua egërsisht nga agresorët imperialistë në Suez më 1956, i gjithë populli shqiptar u ngrit në këmbë kundër agresionit dhe me mijëra shqiptarë qenë gati të shkonin vullnetarë në ndihmë të popullit heroik egjiptian. Simpatia dhe solidariteti ynë kanë qenë në çastet më kritike me popujt e

Sirisë, të Irakut, të Tunizisë e të Marokut, ashtu siç janë sot me popullin trim e të pamposhtur algjerian, çështja e drejtë e të cilit ka fituar admirimin e të gjithë popujve liridashës dhe, patjetër, do të triumfojë. Ne kemi demaskuar me forcë shfrytëzimin e pashpirt që u bëjnë monopolet imperialiste pasurive kolosale të nëntokës arabe, kryesisht të naftës, dhe mbështetim vendosmërisht të drejtën e popujve arabë që të hedhin në dorë plotësisht këto pasuri, të cilat janë të tyret dhe duhet të shërbejnë për forcimin ekonomik dhe për lulëzimin e vetë vendeve arabe. Republika Popullore e Shqipërisë është e vendosur që në të ardhshmen të zgjerojë edhe më shumë marrëdhëniet e miqësisë dhe të bashkëpunimit që ka sot me vendet arabe, qoftë për probleme të interesit reciprok të drejtpërdrejtë, qoftë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për çështjen e lirisë së popujve dhe të paqes. Ne kemi interesa të përbashkëta në luftën për mbrojtjen e paqes nga imperializmi. Ne na bashkon deti Mesdhe. Me përpjekjet tona, në bashkëpunim edhe me vendet e tjera paqedashëse le ta bëjmë këtë det një urë miqësie dhe burim begatie për popujt bregdetarë.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mjaft vende aziatike e afrikane si Guineja, Gana, Etiopia, Afganistani, Indonezia, Birmania etj., që ndjekin politikën e bashkekzistencës paqësore. Gradualisht po krijohen kushtet për zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tona me këto vende.

Kemi marrëdhënie normale me Turqinë dhe jemi në bisedime për zgjerimin e tyre, kryesisht në fushën e tregtisë. Ne shpresojmë se marrëdhëniet tona me qeverinë turke, të kryesuar nga gjenerali Gursel, do të

zhvillohen në mënyrë të favorshme, për të mirën e të dyja palëve dhe të paqes në Ballkan.

Marrëdhëniet tona me Francën, me Austrinë, me Finlandën dhe me një numër vendesh të tjera janë normale. Dëshira jonë është t'i zhvillojmë më tej këto marrëdhënie në fushën e tregtisë, të shkëmbimeve kulturore, të turizmit.

Kohët e fundit ne vendosëm marrëdhënie diplomatike dhe nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi ekonomik e kulturor me Republikën e Kubës. Populli shqiptar, i cili ka qenë solidar me luftën heroike revolucionare të popullit kuban, përshëndet këtë ngjarje që hap udhën e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Kubën e re që krijon mundësi për mirëkuptim dhe për afrim midis popullit tonë dhe popujve të Amerikës Latine.

Partia dhe Qeveria jonë kanë qenë dhe janë kurdoherë për marrëdhënie normale me të gjitha vendet që dëshirojnë të kenë marrëdhënie të tilla me ne, mbi parimet e bashkekzistencës paqësore, të barazisë, të mosdërhyrjes dhe të respektit reciprok.

Republika Popullore e Shqipërisë, e rrethuar me dashurinë e zjarrtë të popujve vëllezër, zë një vend të merituar në radhët e vendeve paqedashëse. Ajo nuk kursen e nuk do të kursejë as në të ardhshmen forcat e saj për të dhënë kontributin modest për çështjen e paqes. Këtë e dëshmon veprimtaria e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në favor të çështjes së lirisë së popujve dhe të paqes, në favor të zgjidhjes së drejtë e paqësore të problemeve kryesore që e preokupojnë sot njerëzimin..

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e RPSH, në bashkëpunim me Bashkimin Sovjetik, me Republikën

Popullore të Kinës dhe me vendet e tjera të kampit socialist, si edhe me të gjitha vendet paqedashëse, do të luftojnë kurdoherë për çështjen e paqes. Le të bëhet atdheu ynë kështjellë e sigurt për paqen dhe për socializmin këtu në brigjet e Adriatikut, shembull i lavdishëm i miqësisë me vendet socialiste, shembull i forcës transformuese të socializmit, të ideve fitimtare të marksizëm-leninizmit!

II

REZULTATET E NDËRTIMIT SOCIALIST NË VENDIN TONË

Të dashur shokë,

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë, ky është qëllimi i shenjtë, realizimit të të cilit i është kushtuar gjithë veprimtaria krijuese e popullit tonë të talentuar, e klasës punëtore heroike, e fshatarësisë punonjëse dhe e inteligjencës sonë popullore, të cilat, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme, ia ndryshuan faqen atdheut tonë, në kuptimin e plotë të fjalës. Duke i raportuar Partisë dhe popullit me kënaqësi vëmë në dukje se, si rezultat i zbatimit me sukses e me besnikëri të vijës së përgjithshme politike dhe ekonomike të Partisë sonë marksiste-leniniste për ndërtimin e socializmit, *tani vendi ynë futet në një etapë të re, në etapën e ndërtimit*

të plotë të shoqërisë socialiste, në etapën e kthimit të vendit tonë nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor.

Po të sjellim ndër mend të kaluarën e mjeruar të vendit tonë, vështirësitë e pengesat e mëdha, luftën e guximshme dhe plot vetëmohim të punonjësve tanë gjatë këtyre viteve të pasçlirimit, atëherë do të duket edhe më mirë rëndësia e etapës së arritur në zhvillimin e shoqërisë sonë, heroizmi i popullit tonë të lavdishëm, merita e Partisë sonë të Punës, e cila, si kapitene e sprovuar, e udhëhequr nga busulla jonë marksizëm-leninizmi, e nxori vendin në rrugën e diturisë e të përparimit.

A. — NDËRTIMI ME SUKSES I BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT

Kushtet vendimtare për zhvillimin e vendit tonë në rrugën e socializmit u krijuan që në nëntor të vitit 1944, kur, pas triumfit të Revolucionit Popullor, u zgjidh detyra e tij strategjike kryesore: pushteti politik kaloi përfundimisht në duart e klasës punëtore dhe të masave punonjëse, të udhëhequra nga Partia e Punës e Shqipërisë. Transformimet e thella revolucionare ekonomiko-shoqërore, të kryera nga pushteti popullor pas Çlirimit të vendit, si shtetëzimi i industrisë, transportit, bankës, tregtisë së jashtme dhe i asaj të brendshme me shumicë, çuan në vendosjen e pronës shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit dhe të qarkullimit dhe krijuan mundësitë e para ekonomike për fillimin e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste.

Kalimi i vendit tonë nga një gjendje e prapambetur tekniko-ekonomike dhe gjysmëfeudale drejtpërsëdrejti në ndërtimin e socializmit, duke kapërcyer fazën e kapitalizmit të zhvilluar industrial, shtroi përpara Partisë sonë, si një ndër detyrat më jetike dhe të ngutshme, krijimin e industrisë, nëpërmjet industrializimit socialist dhe elektrifikimit të vendit.

«... Industria e madhe, thotë V. I. Lenini, duke folur për rolin e saj në ndërtimin e shoqërisë socialiste, është baza për të kaluar në socializëm, dhe nga pikëpamja e gjendjes së forcave prodhuese, domethënë nga pikëpamja e kriterit themelor të të gjithë zhvillimit shoqëror, përbën bazën e organizimit ekonomik socialist, duke bashkuar punëtorët e përparuar të industrisë, duke bashkuar klasën që ushtron diktaturën e proletariatit»¹.

Për përcaktimin dhe për zbatimin e politikës së industrializimit socialist, Partia u nis nga kushtet konkrete të vendit tonë, nga mundësitë e brendshme, nga pasuritë natyrore dhe nga bashkëpunimi ekonomik midis vendeve socialiste. Në kushtet e reja historike, për vendin tonë të vogël, me mundësi të kufizuara forcash njerëzore dhe mjetesh materiale e financiare, s'ka qenë e mundshme ngritja e të gjitha degëve të industrisë. Ritmet e larta të rritjes së prodhimit industrial, krijimi dhe zhvillimi i disa degëve të industrisë së rëndë, duke i dhënë epërsi

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 270-271.

industrisë së minierave, zhvillimi, krahas kësaj, i industrisë së lehtë, përbëjnë disa nga veçoritë karakteristike të industrializimit socialist të vendit tonë.

Nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, me mobilizimin, punën krijuese dhe vetëmohuese të masave punonjëse të qytetit e të fshatit, ne kemi krijuar tani një industri të re, të pajisur me teknikë moderne. Shqipëria është shndërruar në një vend bujqësor-industrial. Kjo është një fitore e madhe historike e Partisë dhe e popullit tonë në rrugën për krijimin e bazës materialo-teknike të socializmit, për zgjerimin dhe për forcimin e mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit dhe të marrëdhënieve socialiste në prodhim.

Krahas kësaj, Partia ka bërë një luftë të vendosur dhe ka ndjekur një politikë konsekuente leniniste për kolektivizimin e bujqësisë, e cila u kurorëzua me krijimin e bazës ekonomike të socializmit edhe në fshat. Fshatarësia jonë, me besim të patundur te Partia, përqafoi rrugën e kolektivizimit dhe vullnetarisht ecën me vendosmëri në këtë rrugë, e bindur plotësisht për epërsinë e ekonomisë kolektive ndaj ekonomisë së vogël individuale. Sot në vendin tonë, në përgjithësi, kolektivizimi i bujqësisë ka marrë fund. Sektori socialist në bujqësi mbizotëron, si nga sipërfaqja e tokës së punueshme, ashtu edhe nga prodhimi për treg.

Edhe ndaj prodhuesve të vegjël të qytetit Partia jonë ndoqi një politikë të drejtë, e cila synonte t'i vinte atë në rrugën e ekonomisë socialiste me anën e bashkimit vullnetar në kooperativat e artizanatit. Tani këto kooperativa përfshijnë shumicën dërrmuese të zejtarëve tanë.

Format socialiste të ekonomisë dhe marrëdhëniet socialiste në prodhim sundojnë në të gjitha degët e ekonomisë. Në vitin 1960 në sektorin socialist të ekonomisë u realizua rreth 90 për qind e të ardhurave kombëtare. Vitin e kaluar sektori socialist përfshinte: 99 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial, 100 për qind të tregtisë me shumicë, 90 për qind të tregtisë me pakicë, mbi 80 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor. *Kështu, në vendin tonë është zhdukur në përgjithësi ekonomia shumëformëshe dhe në vend të saj është krijuar një sistem i vetëm socialist i ekonomisë. Në këtë mënyrë baza ekonomike e socializmit është krijuar si në qytet ashtu edhe në fshat. Ekonomia kapitaliste, klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut janë zhdukur. Me këtë fitore të madhe historike vendi ynë po ecën me hapa më të shpejtë drejt ndërtimit të mëtejshëm të bazës materialo-teknike të socializmit.*

Mbi bazën e shëndoshë të marrëdhënieve të reja socialiste në prodhim është bërë zhvillimi dinamik i forcave prodhuese të vendit, është zhdukur përgjithmonë papunësia, janë rritur shumë të ardhurat kombëtare dhe është ngritur pareshtur niveli material e kulturor i masave punonjëse.

Pjesë e pandarë e revolucionit tonë socialist janë transformimet revolucionare, që janë kryer në fushën e ideologjisë, të arsimit dhe të kulturës, si edhe puna e madhe që ka bërë Partia për edukimin e punonjësve me frymën e ndërgjegjes socialiste, për ngritjen e nivelit të tyre teknik e kulturor, për krijimin e kuadrove të inteligjencës së re socialiste.

Vendosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim

ndryshoi në mënyrë rrënjësore strukturën e vjetër të klasave të shoqërisë sonë. *Tipari më karakteristik dhe themelor i strukturës së klasave të vendit tonë në etapën e sotme është ekzistenca e dy klasave mike, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, aleanca e tyre nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe forcimi mbi këtë bazë i unitetit moralo-politik të të gjithë punonjësve.*

Në punën për ndërtimin e socializmit lindi, u rrit dhe u kalit klasa jonë punëtore e re. Tani punëtorët, së bashku me familjet e tyre, përbëjnë rreth 22,5 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Por ajo që është vendimtare, është fakti se klasa jonë punëtore nuk është më një klasë e shtypur politikisht dhe e shfrytëzuar, siç ndodh me klasën punëtore në kapitalizëm, por një klasë që ka shkatërruar nga themelet pushtetin dhe aparatën burokratik feudalo-borgjez dhe mbi gërmadhat e tij ka ndërtuar pushtetin e ri, një klasë drejtuese që mban në duart e saj pushtetin politik, inisiatore dhe organizatore e të gjitha transformimeve ekonomiko-shoqërore që kryhen në shoqërinë tonë, një klasë që ngre vazhdimisht nivelin e saj politik, teknik e kulturor.

Me riorganizimin e bujqësisë mbi baza socialiste në fshatin tonë, në vend të fshatarësisë individuale ka lindur dhe po formohet një klasë e re, fshatarësia kooperativiste. Baza e ekonomisë së saj nuk është më prona e vogël private, por prona kolektive. Burim i të ardhurave dhe i mirëqenies së saj nuk janë më puna individuale dhe veglat primitive, por puna kolektive dhe teknika e përparuar. Zhvillimi dhe forcimi i mëtejshëm ekonomiko-organizativ i rendit socialist në fshat do të

jetë njëkohësisht procesi i forcimit dhe i zhvillimit të kësaj klase dhe i aleancës së saj me klasën punëtore.

Në luftën për ndërtimin e socializmit u formua inteligjenca e re socialiste, e dalë nga gjiri i popullit dhe besnike ndaj tij. Ajo ecën krah për krah me klasën punëtore dhe me fshatarësinë kooperativiste. Në saje të punës edukuese dhe politikës së drejtë të ndjekur nga Partia, kaluan në anën e popullit e të socializmit edhe njerëzit më të mirë të asaj pak inteligjence të vjetër që ne trashëguam nga e kaluara.

Partia jonë e ka shikuar dhe e shikon aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse si forcën kryesore shoqërore për ndërtimin e socializmit. Për forcimin e kësaj aleance janë vendosur dhe janë zgjeruar vazhdimisht lidhjet e reja ekonomike midis qytetit e fshatit, si në sferën e qarkullimit, ashtu edhe në atë të prodhimit.

Siç shihet, periudha që ne kemi kaluar gjatë këtyre 16 vjetëve të pushtetit popullor ka qenë një periudhë transformimesh të thella revolucionare, të kryera nën udhëheqjen e Partisë. Gjatë kësaj periudhe neve na është dashur të kapërcejmë mjaft vështirësi, pengesa dhe kontradikta. Këto vështirësi dhe kontradikta u shtuan dhe u ndërlikuan edhe më shumë nga komplotet e ndryshme të imperialistëve dhe nga ndërhyrja brutale e revizionistëve jugosllavë në punët tona të brendshme, nga veprimtaria e tyre armiqësore kundër Partisë dhe shtetit tonë, e zhvilluar në të gjitha format. Për kapërcimin e tyre, Partia jonë ka bërë një luftë të ashpër, parimore dhe konsekuente kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, kundër imperialistëve dhe shërbë-

torëve të tyre, revizionistëve jugosllavë. Në të njëjtën kohë, Partia ka goditur me vendosmëri të gjithë oportunistët, deviatorët dhe tradhtarët, që janë përpjekur të minojnë punën e Partisë dhe ta largojnë atë nga rruga marksiste-leniniste.

Në të gjithë veprimtarinë e saj për transformimin socialist të ekonomisë Partia e Punës e Shqipërisë ka zbatuar një vijë të përgjithshme të drejtë, është mbështetur gjithnjë në marksizëm-leninizmin, i ka trajtuar çështjet në mënyrë shkencore, u ka qëndruar besnike parimeve të internacionalizmit proletar, ka mundur të mobilizojë masat e gjera punonjëse dhe i ka bërë ato ndërtuese dhe mbrojtëse të ndërgjegjshme të shoqërisë së re socialiste.

Gjatë kësaj kohe, Partia ka luftuar për të zgjidhur edhe kontradiktat joantagoniste që kanë lindur nga ecja jonë përpara në ndërtimin socialist, siç janë kontradiktat midis pushtetit politik të përparuar dhe nivelit relativisht të ulët të forcave prodhuese, midis zhvillimit të shpejtë të industrisë dhe mbetjes prapa të bujqësisë, midis teknikës së përparuar dhe nevojave e nivelit të përgatitjes së kuadrove, midis nivelit të prodhimit dhe konsumit etj. Roli vendimtar në arritjen e fitoreve të mësipërme u takon përpjekjeve të mëdha, punës vetëmohuese dhe të lavdishme të popullit tonë heroik, patriotizmit socialist, talentit e vendosmërisë së klasës sonë punëtore heroike, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencës popullore, i takon vijës së drejtë dhe udhëheqjes së urtë, të guximshme dhe largpamëse të Partisë sonë të Punës, zbatimit krijues nga ana e saj të teorisë marksiste-leniniste në kushtet konkrete historike të vendit tonë.

Si faktor i jashtëm, një rol me rëndësi ka luajtur ndihma që i është dhënë gjatë kësaj kohe vendit tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet vëllezër të kampit socialist. Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës u janë dhe do t'u jenë kurdoherë mirënjohës popujve dhe partive komuniste e punëtore të këtyre vendeve për këtë ndihmë internacionaliste dhe vëllazërore.

Historia e këtyre 20 vjetëve të fundit vërtetoi amanetin e gjyshërve tanë, se «liria s'dhurohet, por fitohet me gjak». Me luftë heroike dhe me dhunë, populli shqiptar, i papërkulur në shekuj, nën udhëheqjen e Partisë së tij të lavdishme në shekullin e 20-të, në shekullin e leninizmit, theu fashistët hitlerianë dhe italianë, përmbysi dhe dërrmoi deri në fund feudoborgjezinë dhe pushtetin e saj, krijoi pushtetin e ri popullor, krijoi Shqipërinë e re dhe po ndërton me sukses socializmin. Pikërisht, sepse u zhvillua në këto forma lufta e Partisë dhe e popullit kundër imperialistëve, kundër fashizmit, kundër feudoborgjezisë për çlirimin e Shqipërisë dhe për marrjen e pushtetit, sepse u punua me hov të madh revolucionar për rindërtimin e vendit të varfër dhe të djegur nga lufta, për ndërtimin e socializmit, sepse qëndruam kurdoherë vigjilentë për të ruajtur fitoret e popullit, prandaj ne kapërcyem me sukses dallgë dhe furtuna të tmerrshme gjatë këtyre 20 vjetëve. Hovi revolucionar i popullit kurrë nuk u ndal dhe nuk do të ndalet, detyrat e caktuara u arritën dhe do të arrihen me sukses, armiqve ua shtypëm kokën dhe do t'ua shtypim kurdoherë që ata do të orvaten të prekin atdheun dhe popullin. Po të kishim shpresuar se lirinë do të na e falnin kapitalistët amerikanë, anglezë, francezë, ita-

lianë, ose Shefqet Vërlacët e Mustafa Krujët, vaj halli për fatet e popullit shqiptar. Vaj halli për fatet e popullit tonë në rast se do të punohej me kompromise kapitulluese me imperialistët, në rast se do të tregohej frikë dhe lëkundje ndaj tyre, në qoftë se këtyre do t'ua lypnim lirinë, çlirimin, paqen. Si diell pranvere shkëlqen vija marksiste-leniniste e Partisë sonë, si diell ajo ngroh atdheun dhe e bën të lulëzojë; rrezet e zjarrit të këtij dielli i verbojnë armiqtë e popullit tonë, armiqtë e marksizëm-leninizmit.

Gjashtëmbëdhjetë vjetët e pushtetit popullor kanë treguar vërtetësinë e ligjeve të përgjithshme të revolucionit socialist, të përcaktuara nga doktrina ngadhënjimtare e marksizëm-leninizmit. Ato kanë vërtetuar gjithashtu mundësinë praktike dhe reale të kalimit të drejtpërdrejtë të vendeve të prapambetura nga rendi i vjetër feudal në socializëm, duke kapërcyer etapën e kapitalizmit të zhvilluar.

B. — PLANI I DYTË PESËVJEÇAR — HAP I RËNDËSI-SHËM NË ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË EKONOMISË E TË KULTURËS SONË

Në periudhën që nga Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila koincidon me vënien në jetë të planit të dytë pesëvjeçar, është bërë një hap me rëndësi historike për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit në vendin tonë.

Kongresi III i Partisë shtroi si detyrë kryesore zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, sidomos të industrisë

minerare, kryesisht në bazë të përdorimit të plotë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese e të mobilizimit të rezervave të brendshme dhe zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, kryesisht në bazë të riorganizimit të prodhimit bujqësor mbi baza socialiste. Duke u mbështetur në këto, vihej detyra të arrihej përmirësimi i mëtejshëm i gjendjes materiale dhe ngritja e nivelit kulturor të punonjësve.

Duke bërë bilancin e punës së kryer gjatë këtyre pesë vjetëve, Partia jonë me një ndjenjë krenarie të ligjshme njofton se në përgjithësi detyra kryesore e pesëvjeçarit të dytë u plotësua para afatit.

Vëllimi i prodhimit të përgjithshëm industrial, i caktuar nga Kongresi III i Partisë për periudhën 1956-1960, u plotësua në katër vjet e nëntë muaj, i industrisë minerare në katër vjet e gjysmë, ndërsa niveli i prodhimit industrial i caktuar për vitin 1960 u arrit një vit para afatit. Në vitin 1960 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial u rrit mbi 118 për qind më shumë se në vitin 1955, kundrejt 92 për qind që ishte detyra e caktuar nga Kongresi, me një ritëm mesatar vjetor prej 16,9 për qind kundrejt 14 për qind. Prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi «A») u rrit me një ritëm mesatar vjetor prej 18 për qind kundrejt 14,8 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit (grupi «B») 16 për qind kundrejt 13,5 për qind që ishte detyra. Për të kuptuar më mirë rëndësinë e këtyre shifrave, rëndësinë e sukseseve tona mjafton të përmendim se vetëm rrethi i Peshkopisë dhe ai i Burrelit në vitin 1960 prodhuan aq sa u prodhua në vitin 1938 në të gjithë Shqipërinë, kurse qyteti i Tiranës prodhoi mbi 5 herë më shumë. Ja ç'po

bëjnë Partia jonë e lavdishme dhe pushteti popullor, ja ç'është në gjendje të bëjë populli ynë i lirë.

Para afatit u realizua edhe detyra kryesore e Kongresit III të Partisë për kolektivizimin e bujqësisë. Që në muajin korrik të vitit 1960, sektori socialist përfshinte 86,3 për qind të tokës së punuar. Në këtë mënyrë, në fshatin tonë u ndërtua baza ekonomike e socializmit. Me këtë fitore të një rëndësie të madhe historike, Partia jonë, duke pasur parasysh mësimet e pavydekshme të Leninit, zgjidhi me sukses një nga detyrat më të vështira të periudhës kalimtare.

Detyrat e caktuara në lëmin e ngritjes së nivelit material dhe kulturor të popullit u plotësuan gjithashtu me sukses. Shtimi i prodhimit industrial e bujqësor, heqja e plotë e sistemit të triskëtimit, zbritja e herëpas-herëshe e çmimeve të shitjes me pakicë etj. përmirësuan së tepërmi mirëqenien e punonjësve.

Mobilizimi dhe gatishmëria e masave punonjëse, marrja e inisiativave për zbulimin dhe për shfrytëzimin e rezervave të brendshme dhe rritja në shkallë gjithnjë e më të lartë e energjive krijuese të punonjësve, bënë të mundur rishikimin e shifrave të planit të dytë pesëvjeçar. Shtesat që iu bënë këtij plani u aprovuan nga Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë në shkurtin e vitit 1958. Ato luajtën një rol të rëndësishëm për tejkalimin e detyrave të pesëvjeçarit të dytë në shumë degë të rëndësishme të prodhimit.

Realizimi me sukses i planit të dytë pesëvjeçar është fryti i punës së madhe vetëmohuese të klasës sonë punëtore heroike, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteli-

gjencës popullore, i udhëheqjes së drejtë dhe të urtë të Partisë sonë të lavdishme të Punës.

Më lejoni tani, shokë, të raportoj mbi realizimin e detyrave kryesore që shtroi Kongresi III i Partisë për degët e veçanta të ekonomisë.

1. — Detyrat që iu shtruan industrisë, ndërtimit dhe transportit, u plotësuan para afatit

Në përputhje me detyrën kryesore të Kongresit III, gjatë viteve të pesëvjeçarit të dytë Partia dhe Qeveria i kanë kushtuar kujdes të posaçëm zhvillimit të industrisë minerare, si bazë dhe pikëmbështetje në zhvillimin e mëtejshëm të industrisë sonë të rëndë. Kjo pasqyrohet edhe në fondet e mëdha që janë investuar në këto degë shumë të rëndësishme të ekonomisë popullore, pësha specifike e të cilave përbënte 25 për qind të shumës së përgjithshme të investimeve shtetërore.

Që në vitin 1957 u arrit niveli i nxjerrjes së naftës i parashikuar nga Kongresi III i PPSH për vitin 1960. Në vitin e kaluar industria e naftës e rriti mbi 4 herë vëllimin e prodhimit në krahasim me vitin 1955.

Minatorët tanë heroikë realizuan detyrat e Kongresit III të Partisë 106 për qind, duke dhënë në vitin 1960 mbi 2 herë më shumë prodhime se në vitin 1955. Ritmet e prodhimit të mineralit të kromit janë realizuar dhe janë tejkaluar gjatë viteve të pesëvjeçarit të dytë, duke i siguruar kësaj dege një vend të rëndësishëm në ekonominë dhe në eksportimet tona. Po kështu u plotësuan në afat edhe detyrat që i shtroheshin industrisë

së qymyrgurit, duke zgjeruar kështu bazën e lëndës djegëse të vendit.

Populli dhe Partia do t'u jenë mirënjohës përjetë punëtorëve, teknikëve dhe inxhinierëve të minierave dhe të naftës, të cilët me sakrifica dhe me ndërgjegje të lartë kanë vënë gjithë energjitë e tyre për realizimin e planit, për të mirën dhe për lulëzimin e atdheut tonë të dashur.

Për arritjen e këtyre rezultateve një rol shumë të madh kanë luajtur punimet kërkuese gjeologjike. Detyrat e caktuara për zbulimin dhe për rritjen në kategori të rezervave industriale të mineraleve të dobishme, në përgjithësi, janë plotësuar. Në këtë mënyrë, janë krijuar kushtet e duhura për shtimin e prodhimit dhe për shfrytëzimin racional të minierave tona. Gjeologët tanë kanë punuar me guxim e me vendosmëri të rrallë për t'i shkëputur nëntokës sonë pasuri të vlefshme që akoma fshihen në gjirin e saj. Nga rezultatet e deritanishme del se te ne ka shumë minerale të vlefshme, shfrytëzimi i të cilave i hap perspektiva shumë të mëdha zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore. Në fakt, gjatë pesëvjeçarit të dytë, industrisë sonë minerare iu shtuan, duke u vënë në shfrytëzim, degë dhe vendburime të reja, siç janë nxjerrja e hekur-nikelit dhe pasurimi i mineralit të bakrit. Rezultatet e arritura në zbulimin e mineralit të hekur-nikelit në zonën Librazhd-Pogradec dhe rezervat e siguruara, mund të konsiderohen që tani të mjaftueshme për krijimin, në të ardhshmen, të bazës së metalurgjisë së zezë në vendin tonë. Tani ekzistojnë mundësitë që parashikimet gjeologjike të jenë më reale dhe sidomos në sektorin e

naftës ku, si rrjedhim i parashikimeve të nxituara të ekspeditave gjeologjike, detyrat e Plenumit të Komitetit Qendror të Shkurtit 1958 nuk u realizuan.

Në ngritjen e bazës energjetike dhe në elektrifikimin e vendit janë bërë transformime të dukshme. Vendi e centraleve të vogla të dikurshme e kanë zënë hidrocentrale dhe termocentrale elektrike, të pajisura me teknikë të re. Sot vetëm qyteti i Korçës prodhon mbi 70 për qind më shumë energji elektrike nga sa prodhohej në të gjithë Shqipërinë e paraçlirimit. Krijimi i sistemit unik të shpërndarjes së energjisë elektrike bëri të mundur punën e kombinuar të hidrocentraleve dhe të termocentraleve, shfrytëzimin racional të tyre, si edhe furnizimin pa ndërprerje të ekonomisë popullore me energji elektrike.

Orientimin e Kongresit III të Partisë për shfrytëzimin në thellësi të aftësive prodhuese në përgjithësi, e zbatuan edhe punonjësit e industrisë mekanike. Në vitin 1960, ata siguruan mbi 40 për qind të nevojave të ekonomisë për pjesë këmbimi, duke e rritur vëllimin e prodhimit 8 herë më shumë në krahasim me vitin 1955. Në këtë mënyrë, punonjësit e industrisë mekanike kanë dhënë një kontribut shumë të çmueshëm për sigurimin e shumë pjesëve të këmbimit në vend, për shfrytëzimin racional të makinerive dhe për pakësimin e importit të këtyre veglave, duke i sjellë kështu shtetit kursime të mëdha.

Gjatë viteve të pesëvjeçarit të dytë është punuar për zgjerimin e mëtejshëm të industrisë së materialeve të ndërtimit dhe asaj të lëndës së drurit, nga mbarëvajtja e të cilave varet shumë plotësimi në kohë dhe

me cilësi të mirë i punimeve të ndërtimit. Janë shtuar dhe janë zgjeruar aftësitë prodhuese, janë vënë në shfrytëzim zona të reja pyjore, të cilat kanë siguruar rritjen e prodhimit të lëndës së drurit, të tullave, të tjegullave, të çimentos, të pjesëve të parafabrikuara të ndërtimit etj. Punonjësit e industrisë së lëndës së drurit jo vetëm që e nxorën këtë sektor nga prapambetja, duke realizuar planin me sukses, por krijuan edhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj dege të industrisë.

Partia, duke pasur për qëllim kryesor përmirësimin e jetesës së popullit, ka marrë një varg masash të rëndësishme për zhvillimin e atyre degëve të industrisë që prodhojnë mallra të konsumit të gjerë. Janë ngritur, janë rindërtuar dhe janë pajisur me teknikë të re mjaft vepra industriale, të cilat krijuan kushtet e nevojshme për përpunimin e shumë lëndëve të para bujqësore e blegtorale.

Në industrinë e lehtë, si edhe në industrinë lokale janë krijuar kushte të përshtatshme për zgjerimin e asortimenteve, për përmirësimin e cilësisë së prodhimit dhe për shfrytëzimin më të mirë të lëndëve të para. Duke krahasuar vitin 1960 me vitin 1955, del se janë prodhuar më shumë: pëlhura të pambukta 35 për qind, këpucë 63 për qind, sheqer 88 për qind, birra 81 për qind, lëndë druri e sharruar 60 për qind, çimento 64 për qind, tulla 125 për qind.

Kooperativat e artizanatit, rrjeti i të cilave shtrihet në pjesën më të madhe të vendit, realizuan planin e dytë pesëvjeçar 9 muaj para afatit dhe 5 muaj para zotimit. Duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, zejtaret indivi-

dualë kanë hyrë vullnetarisht në kooperativat e artizanatit, të cilat po plotësojnë më mirë nevojat e përditshme të popullit me riparime e me shërbime të ndryshme, kanë përmirësuar cilësinë e prodhimit, kanë zgjeruar asortimentet dhe kanë zhvilluar degë të reja të artizanatit.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë janë bërë nga shteti investime të mëdha, të pakrahasueshme me të kaluarën, për industrializimin socialist të vendit, për zhvillimin e bujqësisë, të transportit dhe të degëve të tjera të ekonomisë e të kulturës. Politika e Partisë sonë në lëmin e investimeve ka pasur një orientim të drejtë. Investimet janë drejtuar në radhë të parë në sektorin prodhues. Mbi 47 miliard lekë, me çmimet e vitit 1958, që janë investuar gjatë pesëvjeçarit të dytë, 81,6 për qind janë investuar në sektorin prodhues. Si kurdoherë, vendi i parë i është dhënë industrisë, për zhvillimin e së cilës janë shpenzuar mbi 21 miliard lekë, ose afro 44 për qind e shumës së përgjithshme të investimeve, ndërsa në bujqësi janë investuar 66 për qind më shumë fonde se sa parashikoheshin nga Kongresi III i Partisë.

Detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë për pesëvjeçarin e dytë në investime, u plotësuan 147 për qind. Investimet e pesëvjeçarit të dytë janë 86 për qind më shumë se ato të pesëvjeçarit të parë. Është llogaritur se për të kryer të gjitha investimet e realizuara gjatë 16 vjetëve të pushtetit popullor, regjimit të Zogut do t'i duheshin mbi 530 vjet, po të ecej me ritmin e vitit 1938.

Në programin e Partisë për ndërtimin socialist të vendit, në kushtet e prapambetjes së theksuar tekniko-ekonomike të trashëguar nga e kaluara, një vend të rëndësishëm kanë zënë ndërtimet, të cilat kanë marrë

përpjesëtime të gjera. Gjatë këtij pesëvjeçari kanë përfunduar së ndërtuari dhe janë vënë në shfrytëzim mbi 250 vepra të rëndësishme ekonomike dhe sociale-kulturore, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: hidrocentrali «Karl Marks»; vijat e tensionit të lartë me gjatësi rreth 400 km, për shpërndarjen e energjisë elektrike në qendrat kryesore industriale të vendit; uzinat e përpunimit të naftës në Qytetin «Stalin» dhe në Cërrik, së bashku me vajgursjellësin; Miniera e Qymyrgurit në Alarup, e Bakrit në Kurbnesh, e Hekur-nikelit në Pishkash e në Çervenakë, e Kromit në Tropojë e në Martanesh; Fabrika e Pasurimit të Bakrit në Kurbnesh; fabrikat e tullave, të kadifesë e të qelqit në Tiranë; fabrikat e konservimit të frutave e të perimeve, të përpunimit të rrushit, të fermentimit të duhanit, si edhe shumë vepra të tjera. Përveç këtyre janë në ndërtim e sipër një sërë veprash të reja të mëdha si hidrocentralet në Shkopet e në Bisticë, kombinati ushqimor «Ali Kelmendi», fabrikat e bukës dhe Kombinati i Mishit në Tiranë etj.

Punime shumë të mëdha janë bërë për tharjen dhe për ujitjen e fushave. Krahina të tëra, si Vrina, Vurgu, Roskoveci, Myzeqeja, Tërbufi, Thumana, Zadrima etj., shpëtuan një herë e përgjithmonë nga përmbytjet. Në këto toka pjellore, që deri dje ishin bërë fole malarjeje dhe ku të vjelat ishin në mëshirën e natyrës, sot kultivohen drithërat e bukës, pambuku, agrumet. Jeta e re dhe e begatshme, pranvera e socializmit i buzëqesh sot bujkut shqiptar, që deri dje ishte i shtypur dhe në mjerim, kurse sot është zot i fryteve të punës së tij.

Punime të mëdha janë bërë e po bëhen për ngritjen e shkollave, teatrove, kinemave, kopshteve dhe çerdheve për fëmijë, spitaleve, sanatoriumeve, shtëpive për pushimin e punonjësve etj. Me punën e tyre të palodhur e fisnike ndërtuesit tanë, me duart e tyre të arta, po i japin atdheut vepra e ndërtime gjithnjë më të mira e më të bukura.

Partia i ka kushtuar një kujdes të posaçëm zhvillimit të mëtejshëm të transportit, i cili luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë, për qarkullimin e mallrave dhe për t'u shërbyer udhëtarëve. Në krahasim me vitin 1955 parku i kamionave është rritur 88 për qind, ai i rimorkiove — 6,2 herë, i vagonave — 111 për qind. Vendi ynë ka tanë flotën detare të pajisur me anije me një tonazh prej 3,7 herë më të madh se në vitin 1955.

Në saje të përpjekjeve të punonjësve të transportit, detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë për qarkullimin e mallrave, janë realizuar 104 për qind nga transporti automobilistik, — 131 për qind nga ai hekurudhor, — 414 për qind nga ai detar. Sot transporti automobilistik kryen brenda 8 ditëve atë vëllim pune që kryhej gjatë gjithë vitit 1938, ndërsa transporti detar e kryen brenda 2 ditëve.

Shumë shoferë pararojë, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, po i realizojnë me sukses zotimet e guximshme që morën për të bërë 300 000 deri 500 000 kilometra pa revizionim të përgjithshëm të automjetit. Qëndrimi dhe guximi i tyre në punë u bënë shembull për të gjithë punonjësit e tjerë të transportit.

2. — Kolektivizimi i bujqësisë është suksesi më i madh i Partisë në fshat

Politika e Partisë sonë për transformimin socialist të fshatit, e mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit, gjatë 4 vjetëve të parë të pesëvjeçarit të dytë, u vu në jetë plotësisht. Po të përjashtohen zonat me karakter të theksuar malor, në të gjitha fshatrat e zonavave të tjera janë ngritur kooperativa bujqësore. Kjo është një nga fitoret më të shkëlqyera të Partisë e të popullit tonë.

Vija e drejtë e Partisë për kolektivizimin, e shprehur në parullën e njohur «as të mos shpejtohemi, as të mos ndalemi në vend», që u zbatua në etapën e parë, bëri që shtresat e gjera të fshatarëve të varfër e të mesëm të binden në praktikë për leverdinë e madhe që ka organizimi i ekonomive bujqësore kolektive në krahasim me ekonomitë individuale. Orientimi i Plenumit të KQ i Dhjetorit të vitit 1955, për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit, siç theksoi edhe Kongresi III, shënon fillimin e një etape të re për kolektivizimin e bujqësisë në masë në të gjitha zonat kryesore të Republikës. Kështu, ndërsa në mbarim të vitit 1955 kooperativat përfshinin vetëm 14,5 për qind të tokës së punueshme të fshatarësisë, pas një viti ato kishin 30,8 për qind. Viti 1957 ka qenë viti i kthesës së madhe, sepse në kooperativat bujqësore filluan të hyjnë në masë jo vetëm fshatarët e varfër, por edhe fshatarët e mesëm dhe sipërfaqja e kolektivizuar arriti në 58 për qind. Në vitin 1960 u kolektivizuan 83,2 për qind e tokës arë

që zotëronte fshatarësia. Në këtë mënyrë u bë e mundur të plotësohet një vit para afatit detyra që shtroi Kongresi III i Partisë. Në këtë punë të madhe për transformimin socialist të fshatit, komunistët e qytetit dhe të fshatit, patriotët, aktivistët më të mirë të Frontit Demokratik dhe të organizatave të tjera të masave, klasa heroike punëtore e vendit tonë, duke e kuptuar mirë këtë detyrë që shtroi Partia, vunë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre bashkë me gjithë fshatarësinë punonjëse të vendit tonë, e cila kurdoherë e ka ndjekur dhe e ndjek me besnikëri Partinë dhe i siguruan vendit tonë këtë fitore të madhe.

Për fitoren e rendit kooperativist në fshat Partisë i është dashur të bëjë një luftë të ashpër kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, kundër kulakëve, që u munduan të pengonin futjen e fshatarësisë punonjëse në rrugën e socializmit, duke shfrytëzuar psikologjinë individualiste të pronarit të vogël të fshatit. Kulakët u përpoqën të krijonin mosbesim dhe lëkundje te fshatarët, t'i largonin ata nga rruga e drejtë që u tregonte Partia. Por të gjitha këto dështuan, fshatarësia jonë punonjëse dhe patriote, me besim të patundur te Partia, te vija e saj e drejtë, e la rrugën e kapitalizmit dhe ndoqi atë të socializmit. *Vija e Partisë sonë triumfoi në fshat dhe me këtë rast u provua edhe një herë drejtësia e saj, forca dhe uniteti i pathyeshëm i Partisë dhe i popullit, pjekuria politike e fshatarit tonë, i cili e përqafoi me bindje dhe vendosmëri rrugën që i tregoi Partia për kolektivizimin e bujqësisë, si rrugën e vetme të drejtë për të dalë një herë e përgjithmonë nga prapambetja, për të ndërtuar jetën e re në fshat.*

Fitorja e kolektivizimit të bujqësisë në vendin tonë është një dëshmi tjetër e qartë që vërteton drejtësinë e tezave të V.I. Leninit mbi politikën që duhet të ndjekin partitë marksiste për futjen e fshatarësisë punonjëse në rrugën e socializmit. Më kot mundohet klika revizioniste e Beogradit të spekulojë me «rrugën specifike», nëpër të cilën gjoja u zhvilloka «socializmi» në fshatin jugosllav. Vetëm armiqtë e leninizmit, sikurse janë revizionistët modernë, mundohen të mashtrojnë masat, duke u treguar gjoja rrugë të reja për ndërlimin e socializmit në fshat, ndërsa në të vërtetë këto «rrugë të reja» jo vetëm pengojnë socializimin e fshatit, por ndihmojnë për varfërimin e mëtejshëm të fshatarit, për proletarizimin e tij, për pasurimin e kulakëve, për blerjen e tokës nga ana e këtyre të fundit dhe për shfrytëzimin vetëm në interes të tyre të mekanizmave bujqësore, edhe sikur këto të jenë në duart e shtetit. Me këto «forma» gjoja specifike e të reja, gjoja paraprake dhe parapregatitore për një kolektivizim të ardhshëm, revizionistët modernë i bëjnë varrin socializmit në fshat, fuqizojnë kulakërinë, lejojnë të fuqizohet çdo ditë e më shumë kapitalizmi në fshat. Jeta e ka vërtetuar se e vetmja rrugë që i siguron fshatarësisë të ardhshmen e saj, që e shpëton atë një herë e mirë nga shfrytëzimi kapitalist dhe nga varfëria, është rruga e kolektivizimit të bujqësisë.

Le të shohim, shkurtimisht, si u zbatuan detyrat e pesëvjeçarit të dytë në bujqësi. Futja në shkallë më të gjerë e mekanizmave në bujqësi, kryerja e veprave të mëdha të bonifikimit dhe të ujitjes, përfundimi në përgjithësi i kolektivizimit të bujqësisë, si edhe kujdesi i posaçëm që kanë treguar Partia dhe pushteti për

zhvillimin e bujqësisë gjatë pesëvjeçarit të dytë, kanë pasur efekte shumë pozitive, si për zhvillimin e shumë degëve të bujqësisë, ashtu edhe për rritjen e prodhimit bujqësor. Kooperativat bujqësore, megjithëse të reja, jo vetëm kanë bërë përmirësime të dukshme nga ana organizative dhe ekonomike, por kanë luajtur një rol të madh për shtimin e prodhimit dhe për zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi. Sektori kooperativist, në vitin 1959, siguroi 65 për qind të prodhimit të drithërave të Republikës, — 87,4 për qind të pambukut, — 74,7 për qind të panxharit, — 88 për qind të duhanit. Në vitin 1959, për shembull, kooperativat ndanë mesatarisht 24 për qind më shumë të ardhura për ditë-pune sesa në vitin 1956, përveç 700 milion lekëve që kanë përdorur për investime. Si rrjedhim, fshati po ndryshon pamjen e tij me shpejtësi, jetesa e kooperativistit nga viti në vit po bëhet më e begatshme, po ngrihet kultura. Ideja e jetës së re socialiste që po ndërtojnë fshatarët nën udhëheqjen e Partisë, po hedh rrënjë të thella në ndërgjegjen e tyre.

Përparime të dukshme janë bërë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Ky sektor sot përfaqëson 12,6 për qind të sipërfaqes nën kulturë të Republikës, kundrejt 5,7 për qind që përfaqësonte në vitin 1955, dhe jep 15,5 për qind të mishit, — 25,5 për qind të qumshtit, — 42,4 për qind të perimeve që grumbullon shteti etj. Shumica e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore i kanë realizuar detyrat e caktuara nga plani i shtetit dhe, në përgjithësi, janë bërë ndërmarrje intensive dhe rentable. Ato e kanë furnizuar më në rregull tregun me prodhime bujqësore e blegtorale, sidomos në qytetet dhe në qendrat kryesore të punës.

Gjatë viteve pas Çlirimit dhe sidomos gjatë periudhës që po shqyrtojmë Partia dhe Qeveria kanë bërë një punë shumë të madhe për mekanizimin e bujqësisë, si edhe për tharjen, për kullimin dhe për ujitjen. Në bazë të direktivave të Kongresit III të Partisë, gjatë pesëvjeçarit të dytë për bujqësinë janë bërë investime që kapin shumën prej rreth 7 miliard e 950 milion lekë. Këto investime kryesisht janë përdorur për mekanizimin, bonifikimin dhe ujitjen. Në vitin 1960, vëllimi i punimeve të mekanizuara u rrit shumë. Mbi 65 për qind e fuqisë së përgjithshme tërheqëse në bujqësi sot përbëhet nga mjetet e mekanizuara dhe për çdo 1 000 hektarë tokë nën kulturë ka 10 traktorë të llogaritur në 15 kuaj-fuqi.

SMT-të, të organizuara dhe të drejtuara nga shteti, kanë luajtur dhe do të luajnë rolin vendimtar në bujqësinë tonë socialiste. Stalini në lidhje me këtë ka thënë:

«...përqëndrimi i veglave kryesore të prodhimit bujqësor në duart e shtetit, në duart e stacioneve të makinave dhe të traktorëve, është i vetmi mjet për të siguruar ritme të larta në rritjen e prodhimit kolkozian»¹.

Këto mësimë të Stalinit janë zbatuar në jetë në Bashkimin Sovjetik për rritjen dhe për forcimin e bujqësisë socialiste sovjetike. Drejtësia e këtyre mësimëve, si edhe e eksperiencës sovjetike janë vërtetuar edhe

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», f. 105. Tiranë, 1974.

me eksperiencën tonë, në kushtet konkrete të vendit tonë. SMT-të, duke qenë në dorën e shtetit socialist, i kanë dhënë një ndihmë efikase, të organizuar, pa ndërprerje, të disiplinuar dhe të planifikuar bujqësisë socialiste në vendin tonë. Fshatarësia jonë e ka parë të konkretizuar këtë ndihmë të drejtpërdrejtë dhe të frytshme të klasës punëtore dhe të pushtetit të saj. Mekanizmat e bujqësisë janë shfrytëzuar racionalisht, janë mënjanuar shturjet, shpenzimet dhe keqpërdorimet e materialeve, karburanteve, dhe të veglave të këmbimit, janë ndihmuar kooperativat e varfëra që kanë më pak krahë dhe kafshë pune, janë luftuar me sukses shpërdorimet, hatëret dhe është zhvilluar në mënyrë ritmike e pa ndërprerje bujqësia jonë.

Me kryerjen e veprave të bonifikimit në pjesën më të madhe të fushave të vendit, gjatë pesëvjeçarit të dytë, u përfituan 17 000 hektarë toka të reja, 43 000 hektarë u përmirësuan dhe u bënë të ujitshme 42 700 hektarë më shumë se në vitin 1955. Bujqësia është ndihmuar gjithashtu me sasi gjithnjë më të mëdha plehrash kimike dhe farërash të zgjedhura, si edhe me një numër të madh kuadrosh specialistë, që nuk i ka pasur kurrë ndonjëherë më parë vendi ynë. Të gjitha këto kanë bërë që prodhimi bujqësor të rritet me ritme të shpejta. Kështu, megjithëse plani i dytë pesëvjeçar në bujqësi nuk u realizua, vlera e prodhimit të përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin e dytë është 25,5 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë.

Më 1959 bujqësia prodhoi më shumë se më 1955: drithëra buke 3,2 për qind, pambuk 70,8 për qind, duhan 87,3 për qind, panxhar sheqeri 31,7 për qind etj. Ndërsa

më 1960, megjithëse ishte viti më i keq për bujqësinë gjatë gjithë periudhës pas Çlirimit, vlera e prodhimit të përgjithshëm bujqësor ishte 6 për qind më e madhe se në vitin 1955, që ishte një vit i mbarë. Kjo ka ardhur kryesisht nga hapja e 71 000 hektarëve toka të reja, që u vunë nën kulturë gjatë pesëvjeçarit të dytë.

Në vitin 1959 vendi ynë prodhoi më shumë se më 1938: drithëra buke 1,7 herë, patate e perime rreth 3 herë, duhan rreth 7 herë dhe pambuk 145 herë etj. Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e shpejtë të kulturës së pambukut ka luajtur vendimi i Plenumit të Komitetit Qendror në shkurt të vitit 1957. Me masat që u morën për këtë kulturë, rendimenti për hektar i pambukut në vitin 1959 u dyfishua në krahasim me vitin 1950.

Një zhvillim të kënaqshëm gjatë këtyre 5 vjetëve ka pasur sektori i frutikulturës, i ullinjve, i vreshtave dhe i agrumeve. Frytet e kësaj pune, për të cilën një meritë të madhe ka rinia jonë e lavdishme, do të duken, siç domos, gjatë viteve të ardhshme.

Duke u mbështetur në vendimet e Kongresit III të Partisë, Komiteti Qendror ka shqyrtuar dhe ka përcaktuar në mënyrë të posaçme masat e nevojshme për zhvillimin e blegtorisë. Ne mund të njoftojmë me kënaqësi Kongresin se, megjithëse sektori i blegtorisë është akoma i prapambetur, dhe për këtë duhet bërë shumë në të ardhshmen, është rritur jo vetëm numri i krerëve të gjësë së gjallë, por edhe prodhimtaria e tyre. Në krahasim me vitin 1955 në vitin 1960 u prodhua më shumë: mish 59 për qind, qumësht 41 për qind, lesh dhensh 47 për qind dhe vezë 60 për qind. Ajo që ka edhe më shumë rëndësi është fakti se kooperativat

bujqësore dhe fshatarësia punonjëse e vlerësojnë më tepër rëndësinë e madhe që ka blegtoria për ekonominë popullore dhe e kanë shtuar kujdesin për të. Me masat që janë marrë për përmirësimin e racës së blegtorisë, sidomos të delës, dhe duke siguruar bazën e nevojshme ushqimore, ka mundësi që prodhimtaria e blegtorisë, në të ardhshmen, të ngrihet më shumë.

Të udhëhequr kurdoherë nga mësimet e leninizmit për rritjen e interesit material të fshatarësisë kooperativiste dhe individuale, Partia dhe Qeveria, përveç ndihmës së gjithanshme që i kanë dhënë bujqësisë me kredit agrar, plehra kimike, farëra, fidane frutore dhe kuadro, kanë përcaktuar çmime stimuluese për blerjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale, kanë hequr sistemin e detyrimit në natyrë për shumë artikuj bujqësorë, kanë vendosur blerjen me çmime unike të disa prodhimeve dhe një sistem më stimulues të paradhënieve që i jepen fshatarësisë për drithërat, bimët industriale etj. Këto, si edhe masat e tjera që janë marrë, kanë nxitur rritjen e mëtejshme të prodhimeve bujqësore dhe i kanë dhënë mundësi fshatarësisë që të shtojë të ardhurat, duke i shitur më shumë teprica shtetit, të përmirësojë jetën e saj.

3. — Ngritja e mirëqenies materiale të masave punonjëse

Rritja e pandërprerë e prodhimit të përgjithshëm industrial dhe bujqësor, triumfi i kolektivizimit në fshat, zhvillimi i gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë popu-

llore kanë sjellë si përfundim objektiv ngritjen e mëtejshme të mirëqenies materiale dhe të nivelit kulturor të popullit. Në vendin tonë organizimi i planifikuar i procesit të prodhimit shoqëror bëhet për sigurimin e mirëqenies dhe për zhvillimin e gjithanshëm të të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

Në vitet e zbatimit të planit të dytë pesëvjeçar ngritja e mirëqenies materiale dhe e nivelit kulturor të punonjësve karakterizohet nga këta tregues kryesorë:

Në fund të vitit 1950 të ardhurat kombëtare llogariten 48 për qind më shumë se në vitin 1955.

Masa të rëndësishme janë marrë për uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave, për ngritjen e pagave dhe të pensioneve të ulëta, për rritjen e çmimeve të blerjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale etj. Këto, së bashku me ngritjen e kualifikimit të punonjësve dhe të rendimentit të punës, kanë bërë që në vitin 1959 paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve të rritet 29 për qind.

Organet e tregtisë kanë plotësuar më mirë furnizimin e popullit me mallra të konsumit të gjerë. Në krahasim me vitin 1955, vëllimi i qarkullimit të mallrave në fund të pesëvjeçarit të dytë arriti në 194 për qind. Rritje të rëndësishme ka pasur shpërndarja e mjaft artikujve si orizi, fasulet, sheqeri, patatet, yndyrnat, mishi, perimet, qumshti, djathi, pëlhurat e pambukta dhe të leshta, këpucët etj. Furnizimi i popullit me artikuj ushqimorë, që paraqitej më i vështirë në vitet e pesëvjeçarit të parë, është përmirësuar në mënyrë të kënaqshme.

Përfundimet e arritura në vitet e para të planit

të dytë pesëvjeçar në shtimin e prodhimeve industriale dhe bujqësore, krijuan kushtet për të hequr plotësisht sistemin e triskëtimit në nëntor të vitit 1957, para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë. Zbatimi me sukses i kësaj mase të rëndësishme ka qenë një fitore e madhe, që vërteton urtësinë e politikës ekonomike të ndjekur nga Partia jonë dhe që i dha një hov të mëtejshëm zhvillimit të gjithanshëm të prodhimit dhe të shpërndarjes.

Por punonjësve të tregtisë u është ngarkuar edhe detyra e rëndësishme për shtimin e vëllimit të qarkullimit të tregtisë së jashtme. Gjatë këtyre viteve janë forcuar, në radhë të parë, lidhjet ekonomike me vendet socialiste dhe është rritur shkëmbimi i mallrave me to. Ndërsa në vitin 1955 u kryen shkëmbime tregtare me 14 shtete, në vitin 1960 numri i tyre arriti në 22. Plani i dytë pesëvjeçar, i aprovuar nga Kongresi III i Partisë, u tejkalua si për eksportin, ashtu edhe për importin. Ndryshime të rëndësishme janë bërë në strukturën e eksportit dhe fuqia eksportuese e vendit tonë është rritur më se 7 herë kundrejt vitit 1938.

Gjatë viteve të planit të dytë pesëvjeçar është realizuar një program i gjerë masash për zgjerimin dhe për përmirësimin e shërbimeve komunale dhe të ekonomisë së banesave. Për këto qëllime janë shpenzuar mbi 3 miliard e 900 milion lekë, ose 143 për qind më tepër në krahasim me periudhën e planit të parë pesëvjeçar.

Një nga çështjet e jetesës së popullit, ku ne kemi përqëndruar më tepër vëmendjen, është ajo e banesave, rritja e fondit dhe mirëmbajtja e tyre. Gjatë 10 vjetëve të fundit janë ndërtuar aq shtëpi banimi sa do të mjaftonin për të strehuar popullsinë që kishin

para Çlirimit qytetet Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë dhe Elbasan, të marra së bashku. Në fshat u ndërtuan gjatë kësaj kohe mbi 47 000 shtëpi banimi. Janë rritur me shpejtësi qytetet dhe fshatrat, janë krijuar qytete dhe fshatra të reja. Tirana, kryeqyteti i atdheut tonë, nuk njihet fare, ajo dita-ditës po ndryshon dhe po zbukurohet. Janë ngritur dhe janë zgjeruar qytetet si Patosi, Cërriku, Bulqiza, Memaliaj etj. Pushteti popullor u ka siguruar dhe po u siguron dita-ditës punonjësve më shumë banesa me një qira shumë të ulët, e cila për një apartament mesatarisht llogaritet më pak se paga e një dite e gjysmë pune, gjë që nuk mund të mendohet në vendet kapitaliste ku qiratë janë jashtëzakonisht të larta.

Detyrat që caktoi Kongresi III i Partisë për sektorin e shëndetësisë janë realizuar me sukses. Për këto qëllime janë shpenzuar fonde të mëdha. Vetëm në vitin 1960 u shpenzuan 1 miliard e 620 milion lekë, kundrejt 630 milion lekëve të shpenzuara në vitin 1955. Ndihma mjekësore për punonjësit në vendin tonë jepet falas. Janë zgjeruar institucionet shëndetësore, janë pajisur ato me aparatura moderne dhe janë krijuar specialitete të reja.

Gjendja shëndetësore e popullit tonë ka pasur përmirësime të dukshme. Shtesa natyrale e popullsisë për 1 000 banorë ka qenë rreth 32 veta. Asnjëherë nuk është parë në vendin tonë një shtesë kaq e madhe e popullsisë. Në këtë drejtim, Shqipëria zë një nga vendet e para në botë. Nga 1 milion e 122 000 banorë që kishte vendi ynë më 1945, sipas të dhënave paraprake të regjistrimit të vitit 1960, arriti në 1 milion e 625 000.

Një kujdes i posaçëm është treguar për mbrojtjen e shëndetit dhe për mirërritjen e fëmijëve. Nga 353 kopshte e çerdhe që kishim në vitin 1955, sot kemi rreth 570.

Punonjësit e shëndetësisë, të edukuar me frymën e humanizmit dhe me ndërgjegjen e lartë socialiste, ashtu sikurse i ka mësuar Partia, kanë vënë të gjitha forcat dhe dijenitë e tyre shkencore për forcimin e shëndetit dhe për lumturinë e popullit tonë.

Rezultatet në ngritjen e mirëqenies së popullit janë të mëdha. Këto janë arritur jo me lehtësi, por në saje të punës vetëmohuese dhe të mobilizimit të të gjithë popullit tonë nën drejtimin e Partisë. Ne e dimë se niveli i jetesës së popullit tonë është akoma i ulët, pasi ne kemi trashëguar nga e kaluara një ekonomi të varfër, të prapambetur dhe të dëmtuar nga lufta, por populli ynë është i sigurt se, nën udhëheqjen e Partisë së tij të lavdishme, me luftën dhe me punën e tij vetëmohuese, do të arrijë që në të ardhshmen ta ngrejë me ritëm të shpejtë mirëqenien e tij materiale e kulturore.

4. — Revolucioni kulturor zhvillohet me sukses në vendin tonë

Detyrat e shtruara nga Kongresi III për zhvillimin e arsimit, të shkencës dhe të kulturës në përgjithësi janë kryer me sukses.

Vendi ynë është bërë jo vetëm një kantier ndërtimi, por edhe një shkollë e madhe ku njëri mëson në çdo pesë banorë. Sot në shkollat e ditës e të mbrëmjes

mësojnë mbi 300 000 veta. Një hap me rëndësi ka qenë ngritja e shkollave 7-vjeçare me një shtrirje të tillë, sa që janë hapur klasa edhe me 10-15 nxënës. Sot kemi 557 shkolla 7-vjeçare të ditës me më tepër se 63 300 nxënës, kundrejt 2 563 nxënësve që kishim para Çlirimit.

Arsimi i mesëm, që në të kaluarën ishte privilegj i disa shtresave të caktuara, ka marrë përpjesëtime të gjera. Janë hapur shkolla të mesme jo vetëm në qendrat e rretheve më të vogla, por edhe në disa qendra lokalitetesh. Vetëm në këtë vit shkollor në shkollat e mesme të ditës mësojnë mbi 16 000 nxënës, nga të cilët 9 500 mësojnë në shkollat e mesme profesionale dhe në shkollat pedagogjike.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë u ngrit Universiteti Shtetëror i Tiranës, qendra më e madhe mësimore-shkencore, krenaria e pushtetit tonë popullor. Në shkollat e larta brenda dhe jashtë shtetit sot mësojnë 7 800 veta, domethënë 4,6 herë më shumë studentë sesa kishte nxënës në të gjitha shkollat e mesme më 1938, ose 3 herë më shumë nga sa kishte në 7-vjeçarët (qytetëset) e atëhershme.

Në bazë të kësaj shtrirjeje të rrjetit arsimor dhe të reformimit të shkollës, sipas parimeve ideologjike e pedagogjike marksiste-leniniste, është bërë i mundur sigurimi në një masë deri diku të kënaqshme i kuadrit për sektorët e ekonomisë e të kulturës.

Sot në të gjitha degët e ekonomisë dhe të kulturës punojnë 4 245 kuadro të lartë dhe rreth 20 000 kuadro të mesëm. Tani në vendin tonë punojnë 870 inxhinierë, kundrejt 35 që kishte më 1938, — 570 agronomë, kun-

drejt 45 që kishte me 1938 dhe 478 mjekë e dentistë, kundrejt 122 që kishte gjithsejt vendi ynë. Vetëm këtë vit mbaruan studimet e larta brenda dhe jashtë vendit rreth 1 000 veta, domethënë mbi dy herë më shumë sesa ishte numri i kuadrove të lartë më 1938.

Vendi ynë, që 15 vjet më parë ishte një vend i prapambetur bujqësor, sot ka një klasë punëtore të formuar, e cila ka në radhët e saj 62 për qind punëtorë të kualifikuar. Gjatë planit të dytë pesëvjeçar, në kurset e kualifikimit, në shkollat e ulëta profesionale ose të rezervave të punës u përgatitën rreth 47 000 punëtorë të rinj, kundrejt 39 000 që parashikoheshin nga plani dhe në kurset e kualifikimit mbi 83 000, kundrejt 70 000 që parashikonte plani. Gjatë pesëvjeçarit të dytë në shkollat e ditës dhe të mbrëmjes mbaruan studimet në vend rreth 9 300 kuadro të mesëm, si edhe 2 800 kuadro të lartë brenda dhe jashtë shtetit.

A nuk flasin, shokë, këto shifra për atë revolucion të thellë që po bëhet në vendin tonë, kur mendon se në regjimet e kaluara mbi 80 për qind e popullsisë ishte analfabete dhe as nuk kishte fare arsim të lartë? Ne gëzohemi për këto rezultate jo vetëm duke i parë si shifra, por edhe nga fakti se kuadrot tanë shumica vijnë nga klasa punëtore, nga fshatarësia punonjëse, nga gjiri i popullit punonjës dhe këta kuadro, megjithëse të rinj, kanë marrë në dorë drejtimin e gjithanshëm të ekonomisë dhe të kulturës dhe, duhet ta themi, punojnë mirë. Përkrah klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, intelektualët e vendit tonë, të rinj e të vjetër, po punojnë të frymëzuar nga ndjenjat e larta patriotike dhe socialiste dhe si bij të denjë të popullit kanë vënë të gji-

tha dijete e aftësitë e tyre për begatinë e përparimin e popullit e të atdheut të tyre socialist.

Në vendin tonë, është vënë në rrugë të drejtë organizimi i punës shkencore. Janë arritur suksese të rëndësishme, veçanërisht në fushën e shkencave historiko-filologjike. Nën kujdesin e Partisë, thesari i trashëguar në fushën e kulturës materiale dhe shpirtërore, çdo gjë pozitive e përparimtare që kanë krijuar brezat e mëparshëm të popullit tonë heroik gjatë shekujve është nxjerrë dhe po nxirret vazhdimisht në dritë, është bërë pronë e popullit, është bërë një forcë e madhe mobilizuese në luftë për ndërtimin e jetës dhe të kulturës së re në vendin tonë. Kontribut i vlefshëm në këtë drejtim është hartimi i «Historisë së Shqipërisë» dhe i «Historisë së letërsisë shqipe». Studime të vlefshme janë bërë gjithashtu nga institutet shkencore për disa çështje të bujqësisë e të blegtorisë.

Për edukimin kulturor të masave tona punonjëse është krijuar një rrjet i gjerë institucionesh kulturore e artistike. Është me të vërtetë një kënaqësi dhe shprehje e atij revolucionit të thellë kulturor që po zhvillohet në vendin tonë, kur sheh radio e libra në shtëpinë e fshatarit, kinema, grupe teatrale e ansamble artistike në fshatrat tona, kur sheh se në skenat, jo më vetëm të institucioneve artistike profesioniste, por edhe të atyre amatore si dhe në skenat e kooperativave tona bujqësore të dalin të rejtat, gratë që çliroi përgjithmonë Partia e socializmi.

Një lëvizje e gjerë për një jetë më të kulturuar ka filluar të përhapet në fshatin tonë të ri. Intelektualët tanë popullorë, në mënyrë të veçantë arsimitarët e

fshatit, duke iu përgjigjur me entuziazëm dhe gatishmëri të madhe detyrave që iu ngarkuan në konferencën kombëtare të kulturës, janë bërë krahu e mbështetja e Partisë për përhapjen e kulturës në masat e popullit.

Suksese të rëndësishme janë arritur edhe në fushën e letërsisë dhe të arteve. Gjatë kësaj periudhe janë botuar rreth 700 vepra origjinale të gjinive të ndryshme. Sot ne kemi Teatrin e Operës e të Baletit, teatrot e dramës dhe 11 teatro profesioniste të estradës. U krijuan opera dhe filmat e parë artistikë shqiptarë, janë organizuar ekspozita të arteve figurative, olimpiada teatrale e festivale folkloristike, të cilat të gjitha së bashku kanë gjallëruar jetën kulturore e artistike të vendit. Shkrimtarët dhe artistët tanë, kurdoherë besnikë ndaj çështjes së madhe të klasës punëtore, me krijimtarinë e tyre i kanë dhënë një ndihmë të madhe Partisë në luftën e saj ideologjike për edukimin e njeriut të ri. Gjatë kësaj periudhe ata kanë krijuar vepra e figura artistike, ku mishërohen idealet e larta të bashkëkohësve dhe të epokës sonë të mrekullueshme.

Shokë,

Këto fitore kolosale, të pakrahasueshme me të kaluarën, janë arritur me përpjekje të mëdha, në luftë kundër pengesave dhe vështirësive. Punës së madhe për triumfin e socializmit i janë përveshur sot në Shqipërinë e re masat e gjera punonjëse, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë dhe të shembullit personal të komunistëve. Dhe këtë marshim fitimtar nuk ka forcë që ta ndalojë.

Në luftën e madhe për ndërtimin socialist të vendit lindën dhe po farkëtohen njerëzit e rinj të pajisur me vetitë e moralit komunist, të cilët, me ndërgjegje të lartë, i janë përveshur punës për të vënë në jetë fjalën e Partisë. Brenda një kohe të shkurtër emulacioni socialist që shpërtheu në gjirin e popullit punonjës, mori një hov të ri, më të madh. Sulmuesit dhe punëtorët e shumë të pararojës u pasuan nga racionalizatorët dhe nga novatorët e prodhimit, nga heronjtë e punës socialiste, nga brigadat e rinisë që u organizuan në pragun e 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe që janë shndërruar tani në brigada që luftojnë për të merituar titullin «Brigadë e Punës Socialiste» me parullën «Të punojmë, të mësojmë, të jetojmë në mënyrë socialiste».

Në frontin e punës, atje ku prodhohen të mirat materiale, këta njerëz dhe brigada të pararojës u bëjnë ballë me heroizëm vështirësive, luftojnë me vetëmohim për të realizuar detyrat e planit. Me punën e tyre heroike e të lavdishme, ata kanë fituar me të drejtë admirimin e bashkëkohësve dhe do të jenë shembull nxitës për brezat e ardhshëm. Te ata ne shohim se si brumoset nga dita në ditë njeriu i epokës sonë, i epokës së triumfit të ideve revolucionare të marksizëm-leninizmit.

Më lejoni, shokë, që në emër të Komitetit Qendror të Partisë të falënderoj përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje me të vërtetë të mrekullueshme dhe gjithë klasën punëto-re për punën e madhe fisnike që ata bëjnë për të mirën dhe për begatinë e atdheut tonë të dashur socialist.

Në mënyrë të veçantë përshëndes Heroin e Punës

Socialiste, brigadierin e dëgjuar të shpimit të puseve të naftës Petro Olldashi; minatorin e dalluar të Minierës së Qymyrgurit në Memaliaj, Heroin e Punës Socialiste Rexho Idrizi; heronjtë e punës socialiste në ndërtim, montatorin Ferit Qenska dhe muratorin Trajçe Mazniku. Më lejoni të përshtëndes gjithashtu traktoristin e dëgjuar të SMT-së së Shkodrës, Heroin e Punës Socialiste Budo Isufi, inisiatorin e lëvizjes për të lëruar 12 000 hektarë unitet hamullorë pa revizionim të përgjithshëm të traktorit; traktoristin e SMT-së së Kavajës, Heroin e Punës Socialiste Shyqyri Kanapari; shoferin Hero të Punës Socialiste Bahri Doda; Heroinën e Punës Socialiste Vita Ikonomi në kombinatin e tekstilit «Stalin», e cila mori përsipër vullnetarisht drejtimin e një brigade tjetër për ta nxjerrë atë nga prapambetja; arsimtarin e ri Omer Haxhia, drejtor i shkollës 11-vjeçare në Fier, që punon pa u lodhur për përmirësimin e cilësisë së mësimit.

Këtij vargu i duhen shtuar emrat e dhjetëra heronjve dhe brigadave të punës socialiste, si dhe të mijëra e mijëra punëtorëve të dalluar të industrisë, bujqësisë, ndërtimit, transportit, arsimit, kulturës etj., të cilët, të edukuar nga Partia, mbajnë një qëndrim me të vërtetë shembullor ndaj punës, mësimit dhe sjelljes në shoqëri.

Nuk ka dyshim se gjatë kësaj periudhe, krahas sukseseve të mëdha në punën tonë, janë vërtetuar gabime, të meta e dobësi. Të pamjaftueshme kanë qenë përpjekjet për të frenuar tendencën e dëmshme ekonomike për realizimin e njëanshëm të planit, kryesisht në sasi, pa e shoqëruar këtë me përmirësimin e cilësisë.

Nuk është luftuar kudo dhe kurdoherë për të vendosur një regjim të fortë kursimi në përdorimin e vlerave materiale dhe monetare të shtetit, për shfrytëzimin e kapaciteteve të prodhimit dhe të rezervave të tjera të brendshme që ekzistojnë pa përjashtim në të gjitha degët e ekonomisë sonë popullore.

Në bujqësi të metat dhe dobësitë kryesore ekzistojnë në punën për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore, në radhë të parë, në zbatimin e statutit dhe të parimit socialist të shpërblimit, si edhe në përdorimin e të gjitha forcave të afta për punë.

Në arsimin tonë popullor ne kemi akoma të meta të rëndësishme. Në radhë të parë, nuk ka një lidhje të ngushtë të shkollës me jetën, përparimi i nxënësve në mësim është akoma i ulët. Me gjithë sukseset e mëdha të arritura në shtrirjen e rrjetit shkollor, ai nuk u përgjigjet akoma nevojave gjithnjë në rritje të sektorëve të ekonomisë dhe të kulturës për kuadro dhe kërkesave gjithnjë më të mëdha të popullsisë për arsim.

Këto gabime, të meta dhe dobësi janë të shpjgueshme, po të marrim parasysh nivelin kulturor dhe profesional akoma të ulët të masës së punonjësve dhe të kuadrove tanë, të cilëve Partia dhe populli u ka besuar detyra aq të rëndësishme për të kryer. Ne mund të themi me bindje se ndërgjegjja e lartë në punë e punonjësve tanë, interesimi për ta kryer sa më mirë detyrën e ngarkuar, hovi revolucionar dhe entuziazmi i tyre kanë qenë karakteristika dalluese që i kanë bërë njerëzit tanë të kryejnë vepra të mëdha, ta

zbatojnë drejt vijën e Partisë, t'i njohin ku i kanë dobësitë e gabimet dhe të luftojnë për t'i ndrequr ato.

Duke marrë parasysh detyrat që u dalin përpara punonjësve të vendit tonë në këtë fazë të re të ndërtimit socialist të vendit, është e nevojshme që të përmirësohet më tej metoda e drejtimit të ekonomisë dhe stili në punë, të sigurohet me çdo kusht furnizimi i pandërprerë i ndërmarrjeve dhe i organizatave ekonomike me lëndë të parë, të vendoset kudo një regjim i rreptë kursimi, të zbulohen më tej rezervat e brendshme për të rritur rendimentin e punës dhe për të ulur koston, të shfrytëzohen edhe më mirë kapacitetet prodhuese dhe të mirëmbahen makineritë, në mënyrë që detyrat e planit të realizohen e të tejkalohen nga çdo ndërmarrje e degë prodhimi dhe në mënyrë ritmike.

Një rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet zhvillimit të inisiativës krijuese të punonjësve, grumbullimit, përgjithësimit dhe përhapjes së eksperiencës së përparuar. Organizatat e Partisë, organet ekonomike dhe organizatat e masave kanë për detyrë të ngjallin te çdo punonjës ndjenjën e krenarisë për fitoret e arritura, të farkëtojnë luftëtarë aktivë e të ndërgjegjshëm për çështjen e socializmit, të ngrenë masat punonjëse si një trup i vetëm për të bërë realitet programin madhështor të Partisë sonë.

III

**ZHVILLIMI I MËTEJSHIËM I VENDIT TONË NË BRUGËN
E NDËRTIMIT SOCIALIST**

Shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë përpunoi projektdirektivat e planit të tretë pesëvjeçar për zhvillimin e ekonomisë popullore e të kulturës. Para se këto projektdirektiva të shqyrtohen dhe të aprovohen përfundimisht, nga forumi më i lartë i Partisë, ato, siç dihet, u shtruan për diskutim në masat punonjëse. Kudo, në qendra pune e në fshatra, deri në skajet më të largëta të atdheut tonë, masat punonjëse diskutuan gjallërisht shifrat kryesore të perspektivës së shkëlqyer që i hapet vendit tonë me planin e tretë pesëvjeçar. Projektdirektivat u shqyrtuan gjithashtu hollësisht në mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje të organizatave-bazë dhe të konferencave të Partisë.

Entuziazmi që ngjallën te çdo punonjës projektdirektivat tregoi edhe një herë se shifrat e planit të tretë pesëvjeçar janë reale. Ky plan, megjithëse i ngjeshur, është plotësisht i realizueshëm dhe këtë e vërtetojnë zotimet e shumta që u morën për realizimin e tij para afatit.

Diskutimin e problemeve kryesore me masat, Partia e ka konsideruar gjithnjë si një çështje parimore në punën e saj. Në këtë drejtim ajo është udhëhequr

kurdoherë nga parimi i njohur leninist i centralizmit demokratik, që nënkupton kombinimin e harmonishëm të drejtimit të centralizuar të ekonomisë nga shteti me zhvillimin sa më të gjerë të aktivitetit krijues të masave punonjëse, me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në drejtimin e prodhimit. Këtu e ka burimin forcimi gjithnjë e më shumë i lidhjeve të Partisë me popullin, i cili sheh te Partia përfaqësuesen e vërtetë të ndjenjave dhe të aspiratave të veta shekullore.

Diskutimi popullor i projektdirektivave tregoi edhe një herë thelbin e shtetit tonë të demokracisë popullore, që është vetë populli i organizuar, i bashkuar nga ideja dhe nga interesat themelore të ndërtimit të socializmit.

Me lejoni, shokë, që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e këtij diskutimi popullor për kontributin e vlefshëm që dhanë në shqyrtimin e shifrave të projektplanit të pesëvjeçarit të tretë. Pjesëmarrja e gjerë e popullit në zbulimin e rezervave të brendshme, vërejtjet dhe propozimet e tyre kanë ndihmuar për rritjen e prodhimit, si edhe për përmirësimin e planifikimit të ekonomisë sonë popullore.

Në përcaktimin e shifrave kryesore të projektdirektivave për planin e tretë pesëvjeçar, Partia, në përputhje me programin e saj, ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist, ngritjen e forcave prodhuese në një nivel më të lartë, rritjen e potencialit ekonomik dhe fuqizimin e atdheut tonë, shtimin e pareshtur të të mirave materiale për të përmirësuar jetën e popullit.

Mbi bazën e zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese do të rritet dhe do të forcohet klasa punëtore, aleanca e saj me fshatarësinë punonjëse, si edhe baza ekonomike, politike dhe organizative e pushtetit tonë popullor.

Pesëvjeçari i tretë do të shënojë një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Vendi ynë do të ecë më shpejt në rrugën e transformimit nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor, prodhimi bujqësor do të rritet me hapa më të mëdhenj dhe, si rrjedhim, do të ngrihet më shumë niveli material dhe kulturor i masave punonjëse. Kjo është detyra kryesore e pesëvjeçarit të tretë.

Republika jonë Popullore i ka të gjitha mundësitë për ta bërë realitet këtë objektiv të Kongresit IV të Partisë. Plotësimi në përgjithësi me sukses i planeve ekonomike të shtetit, ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit, zhvillimi i pandërprerë i forcave prodhuese, ndërgjegjja e lartë dhe emulacioni socialist që ka shpërthyer në të katër anët e atdheut tonë, bënë të mundur që ne t'i shtrojmë vetes detyra të reja dhe të ecim me hapa të shpejtë në rrugën e ndërtimit socialist.

Ritmet e larta e të pandërprera të zhvillimit të prodhimit industrial janë karakteristikë dalluese edhe për pesëvjeçarin e tretë. Ato janë një tjetër dëshmi e qartë e fuqisë dhe e natyrës së ekonomisë sonë socialiste.

Madhështia e pesëvjeçarit të tretë vlerësohet edhe nga fondet e mëdha që do të investohen në ekonominë popullore dhe që gjatë kësaj periudhe do të shtoj-

në më shumë prodhimin e të mirave materiale. Gjithashtu një karakteristikë tjetër e pesëvjeçarit të tretë është fakti, se një pjesë e investimeve do të japin efektin ekonomik në vitet e para të pesëvjeçarit të katërt, duke siguruar kështu vijimin e riprodhimit të zgjeruar socialist.

Në pesëvjeçarin e tretë janë vendosur raporte të tilla të drejta, të cilat sigurojnë zhvillimin e harmonishëm të degëve të ekonomisë, në radhë të parë midis industrisë dhe bujqësisë. Me krijimin e degëve të reja të prodhimit material pesëvjeçari i tretë përmirëson strukturën e ekonomisë dhe krijon kushte më të mira për rritjen e mëtejshme të prodhimit shoqëror.

Prioriteti i rritjes së prodhimit të mjeteve të prodhimit, në krahasim me prodhimin e mallrave të konsumit është një tjetër karakteristikë dalluese e këtij pesëvjeçari. Kjo karakteristikë është rezultat i politikës ekonomike që ka ndjekur Partia jonë në industrializimin e vendit dhe në shpërndarjen e investimeve në degët e ekonomisë.

Në pesëvjeçarin e tretë procesi i industrializimit socialist të vendit ngrihet në një nivel edhe më të lartë. Industrisë sonë moderne i shtohen degë të reja, të pajisura me teknologji të përparuar. Do të bëhet një përpunim më i madh i lëndëve të para, gjë që karakterizon ngritjen e mëtejshme të nivelit të zhvillimit industrial të vendit tonë.

**1. — Vazhdimi i industrializimit socialist të vendit
— hallkë vendimtare për zhvillimin e bazës
materialo-teknike të socializmit**

Edhe në pesëvjeçarin e tretë Partia jonë e Punës e quan si detyrë të rëndësishme zhvillimin e mëtejshëm të industrializimit socialist të vendit, duke i dhënë epërsi zhvillimit me ritme të shpejta të industrisë së rëndë.

Është parashikuar që në vitin 1965 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial (duke e krahasuar me çmimet e vitit 1960) të rritet 52 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 8,7 për qind. Po këtë vit pesha specifike e prodhimit industrial kundrejt vëllimit të përgjithshëm të prodhimit industrial dhe bujqësor do të arrijë 54 për qind.

Prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi «A») do të rritet 54 për qind, ndërsa prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë (grupi «B») — 50 për qind. Më shumë së gjysmën e vëllimit të përgjithshëm të prodhimit industrial do ta zërë prodhimi i mjeteve të prodhimit.

Siç shihet, në politikën e saj ekonomike lidhur me industrializimin socialist të vendit, Partia jonë, me gjithë ekzistencën e veçorive, ka gjithnjë parasysh tezën leniniste, sipas së cilës industria e rëndë është baza e industrializimit socialist, se në këtë proces prodhimi i mjeteve të prodhimit duhet të rritet me ritme më të larta se prodhimi i mallrave të konsumit.

Një zhvillim të madh do të marrë industria minere dhe ajo e përpunimit, me qëllim që të shfrytëzohen më mirë pasuritë e vendit — mineralet e dobishme,

burimet e lëndëve djegëse dhe hidroenergjetike, pasuritë pyjore, lëndët e para bujqësore etj. Do të investohen fonde të mëdha për ngritjen e degëve të reja të industrisë së rëndë, siç janë industria kimike për prodhimin e plehrave azotike dhe fosfatike për bujqësinë, metalurgjia e ferro-kromit, elektrometalurgjia e bakrit dhe do të bëhen përgatitje për ngritjen, në të ardhshmen, të bazës së metalurgjisë së zezë¹.

Duke krijuar këto kushte, industria jonë do t'i japë një hov më të fuqishëm zhvillimit të forcave prodhuese. Do të krijohet një strukturë më efektive e ekonomisë, do të bëhet përpunimi i mëtejshëm dhe vlerësimi më i mirë i lëndëve të para të vendit, gjë që do të përmirësojë bilancin e import-eksportit.

Partia ka marrë dhe do të marrë masa të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së naftës, një nga degët kryesore dhe me perspektiva të mëdha për ekonominë tonë. Në vitin 1965, kundrejt vitit 1960, nxjerrja e naftës parashikohet të rritet rreth 51 për qind dhe përpunimi i saj 38 për qind. Prodhimi i

1 Një pjesë e veprave të reja të industrisë së rëndë, si uzina e ferro-kromit, kombinati për përpunimin e bakrit, kombinati metalurgjik, uzinat e plehrave azotike e fosfatike etj. u vendos të ngriheshin gjatë planit të tretë pesëvjeçar (1961-1965). Por për shkak të politikës antimarksiste dhe antishqiptare të revizionistëve hrushovianë e të pasuesve të tyre, të cilët organizuan bllokadën e përgjithshme kundër Shqipërisë socialiste dhe anuluan arbitrarisht të gjitha marrëveshjet e përfunduara, Qeveria e RPSH, në gjendjen e re të krijuar, vendosi shtyrjen e afatit të ndërtimit të këtyre veprave. Më pas, këto vepra u ngritën në saje të punës vetëmohuese të masave tona punonjëse dhe të ndihmës internacionaliste të RP të Kinës.

naftës që parashikohet të nxirret në vitin 1965 është i barabartë me të gjithë prodhimin e realizuar gjatë viteve 1951-1956 të marrë së bashku. Në pesëvjeçarin e tretë vëllimi i shpim-kërkimeve do të rritet 63 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë.

Punonjësve të naftës u dalin detyra të mëdha për t'i dhënë ekonomisë vendburime të reja nafte dhe gazmbajtëse. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar shpimit të shpejtë dhe me cilësi të lartë të puseve, me qëllim që të përmirësohen treguesit tekniko-ekonomikë dhe të rritet efektiviteti ekonomik i investimeve kapitale. Të vihen në zbatim metodat e përparuara dhe realizimet e shkencës për intensifikimin e nxjerrjes së naftës.

S'ka asnjë dyshim se nafta është një pasuri e madhe për vendin tonë, por njëkohësisht edhe një produkt që kërkohet shumë për eksport. Nxjerrja e naftës nga ne do t'i sigurojë të ardhura të mëdha ekonomisë së vendit tonë. Të gjithëve ju kujtohet sabotimi sistematik që i është bërë kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë sonë nga revizionistët jugosllavë. Qëllimi i tyre ishte ta mbytnin ekonominë tonë dhe ta bënë atë kryekëput të varur nga ekonomia jugosllave për të realizuar planet e tyre djallëzore, ta gjunjëzonin Partinë tonë, t'i diktonin asaj dhe popullit tonë vullnetin e tyre, të likuidonin udhëheqjen e shëndoshë të Partisë dhe ta zëvendësonin atë me tradhtarë, njerëz të shitur te ata. Ju kujtohen fare mirë përpjekjet e mikut dhe të bashkëpunëtorit të revizionistëve jugosllavë, Tuk Jakovës, i cili shumë herë në Byronë Politike dhe në Qeveri jo vetëm u përpoq të vërtetonte se ne naftë nuk kishim dhe se ajo pak që nxjerrim s'ishte rentable, por

u orvat të mbronte edhe tezën, që, natyrisht, iu hodh poshtë me neveri, se ne duhet të hiqnim dorë fare nga nxjerrja e naftës. Jeta vërtetoi se ç'kriminelë kanë qenë titistët dhe agjentët e tyre Tuk Jakova me shokët e tij. Revizionistët jugosllavë dhe agjentët e tyre ishin të bindur se vendi ynë kishte perspektiva shumë të mira për naftën dhe kjo naftë do të nxirrej, sipas llogarisë së tyre, pasi të kishin likuiduar Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj. Në këtë mënyrë ata jo vetëm do të siguronin naftën tonë për hesapin e tyre, por do të «vërtetonin» edhe «pazotësinë» e Partisë sonë dhe të udhëheqjes së saj e «zotësinë e mençurinë» e tradhtarëve si Tuk Jakova me shokë. Mirëpo ky plan nuk u eci dhe nuk do t'u ecë kurrë armiqtë të Partisë dhe të popullit tonë. Ne sot kemi krijuar një bazë të shëndoshë në naftë, dhe kemi me mijëra punëtorë, specialistë inxhinierë të lavdishëm që Partia i ka rritur me kujdesin më të madh, i ka mësuar dhe i ka edukuar në shkollat e larta, që janë pajisur me eksperiencën e madhe të jetës, dhe këta jo vetëm që realizojnë me sukses planet, por nuk mund t'ua hedhë më ndokush.

Naftëtarët tanë duhet të kenë kurdoherë parasysh se nafta nuk kullon mbi tokë, po nxirret nga thellësitë e tokës dhe, që të kemi kurdoherë sukses në këtë degë të rëndësishme, rentable dhe me perspektivë të madhe, por të ndërlikuar, duhet të vëmë në jetë të gjithë diturinë, eksperiencën, metodikën, vigjilencën dhe disiplinën që karakterizon klasën punëtoare. Kujdesi, zotësia, vigjilenca dhe kontrolli duhet të fillojë qëkur fillon studimi gjeologjik i pikës që do të shpohet dhe derisa nafta të shkojë në depo. Çdo lëshim në të gjithë

këtë proces i kushton miliona popullit. Çdo e dhënë pa përgjegjësi devijon kërkimet, çdo shpim i gabuar shtrese mbyll perspektivën e një pusi, ndodh edhe të një shtrese të tërë. Prandaj inxhinierët, specialistët, punëtorët e naftës t'i marrin pusit edhe kombin e fundit të naftës në bazë të rregullave dhe të teknikës, të vënë metodat e reja në shfrytëzimin e të gjitha puseve të vjetra, të kontrollohen dhe të rikontrollohen të gjitha të dhënat, të gjitha studimet, të gjitha dokumentet dhe çdo pus një nga një, në të gjitha ato objekte të shpuara, por të klasuara në radhën e puseve dhe të fushave që gjoja ishin jonaftëmbajtëse. Këto janë detyra me rëndësi dhe të domosdoshme. Ne mendojmë se jo vetëm në këtë mënyrë do të realizojmë në mënyrë ritmike planin që kemi caktuar, por çudi nuk do të jetë që në naftë të kemi një shpërthim që t'i tejkalojë parashikimet tona.

Realizimi i këtyre detyrave duhet të shoqërohet me përmirësimin e vazhdueshëm të metodës së drejtimit dhe të organizimit konkret të punës për ndjekjen e detyrave të mëdha dhe të rëndësishme që ka për ne industria e naftës. Të punohet më mirë për ngritjen tekniko-profesionale të punonjësve, për përhapjen e eksperiencës së përparuar, si kusht për shfrytëzimin e mirë të pajisjeve dhe të kapaciteteve prodhuese.

Mbi bazën e shtimit të prodhimit të naftës do të bëhet zgjerimi i aftësisë së përpunimit të saj. Uzinës së Përpunimit të Naftës në Cërrik do t'i shtohet impianti i riformingut, i cili do të bëjë të mundur plotësimin më të mirë të nevojave të vendit me karburante të lëngshme.

Partia është e bindur se naftëtarët, në luftë kundër vështirësive, të bashkuar dhe me entuziazmin që i karakterizon, si kurdoherë, do të mobilizojnë të gjitha aftësitë e tyre fizike dhe mendore për të prodhuar më shumë naftë për begatinë e atdheut tonë.

Gjatë viteve të pesëvjeçarit të tretë një zhvillim të madh do të marrin edhe degët e tjera të industrisë minerare. Do të ndërtohen miniera të reja dhe do të fillojë shfrytëzimi në thellësi i atyre ekzistuese. Në vitin 1965 prodhimi i përgjithshëm i industrisë sonë minerare do të jetë 49 për qind më i madh se në vitin 1960.

Në fund të pesëvjeçarit të tretë vendi ynë do të prodhojë 45 për qind më shumë qymyrguri. Kjo do të thotë se vetëm prodhimi i vitit 1965 do të jetë i barabartë me 72 për qind të të gjithë sasisë së qymyrit të prodhuar në pesëvjeçarin e parë. Për këtë qëllim do të vihet në shfrytëzim të plotë Miniera e Qymyrgurit në Alarup dhe do të kryhen punimet për ndërtimin e minierës së re në Mëzez të Tiranës.

Me ritme të shpejta do të vazhdojë të zhvillohet edhe në këtë pesëvjeçar industria e kromit, prodhimi i të cilit në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, do të jetë rreth 20 për qind më shumë, ose në vitin 1965 do të prodhohet një sasi e tillë kromi që do të jetë e barabartë me afër 90 për qind të të gjithë sasisë që është prodhuar gjatë viteve 1951-1955. Gjatë këtij pesëvjeçari do të ndërtohen dy fabrika pasurimi, si edhe uzina e ferro-kromit. Me ndërtimin e këtyre fabrikave do të vlerësohen kromitet e varfëra, për të cilat deri më sot ka pasur vështirësi tregtimi dhe do të kursehen

mjete të shumta transporti, rrjedhimisht, do t'i sigurohen popullit tonë të ardhura më të mëdha.

Në fund të pesëvjeçarit të tretë prodhimi i industrisë së bakrit do të jetë gati tri herë më i madh se në vitin 1960. Krahas shfrytëzimit më të mirë të vendburimeve ekzistuese, do të fillojnë punimet për vënien në shfrytëzim të një vendburimi të ri të mineralit të bakrit. Duhet theksuar se studimet e deritanishme janë të kënaqshme, ato tregojnë se minerali i bakrit shtrihet në shumë zona të atdheut tonë, i shoqëruar shpeshherë nga metale të tjera të rralla.

Një zhvillim të vrullshëm do të marrë industria e hekur-nikelit. Në vitin e fundit të këtij pesëvjeçari vendi ynë do të prodhojë afro gjysmë milioni ton hekur-nikel. Në këtë mënyrë ne krijojmë një pikënisje të shëndoshë që në një të ardhshme jo të largët të ngremë metalurgjinë tonë të zezë.

Në këtë pesëvjeçar do të vazhdojë shfrytëzimi i minierës së bitumit natyror dhe do të rritet nxjerrja e kaolinave, argjileve, rërave dhe mineraleve të tjera të dobishme.

Plotësimi i detyrave të mëdha, që i shtrohen në këtë pesëvjeçar industrisë sonë minerare, kërkon përmirësimin e punës për projektimin dhe përgatitjen për shfrytëzim të minierave, ngritjen e shkallës së mekanizimit e të rendimentit të punës dhe zbatimin e sistemeve të përparuara të shfrytëzimit në tregues të lartë teknikë dhe ekonomikë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e ka shikuar kurdoherë si çështje të dorës së parë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës e

të punës së minatorëve. Partia ka bindje se minatorët tanë heroikë do t'i përgjigjen me vepra këtij kujdesi të Partisë, se ata do të ngrenë vazhdimisht rendimentin e punës për të nxjerrë nga nëntoka jonë e pasur përherë e më shumë minerale të dobishme.

Ritmet e shpejta të zhvillimit të industrisë së naftës dhe të minierave, veprat e reja të metalurgjisë me ngjyra, të metalurgjisë së zezë dhe të industrisë kimike, që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të tretë dhe në pesëvjeçarët e ardhshëm për përpunimin në vend të pasurive të nëntokës, ngrenë si problem të ngutshëm sigurimin dhe zgjerimin e bazës së lëndëve të para.

Partia e konsideron të domosdoshme që edhe në këtë pesëvjeçar të zgjerohen dhe të intensifikohen punimet gjeologjike, duke u kushtuar kujdes të veçantë kërkimeve komplekse për gjetjen e vendburimeve të reja, në radhë të parë, të naftës, bitumit dhe gazit natyror, qymyrgurit, kromit, hekur-nikelit, bakrit si edhe të mineraleve të tjera të dobishme.

Me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, në vendin tonë është pregatitur dhe punon tani në sektorin e gjeologjisë një numër i madh kuadrosh të lartë e të mesëm, të cilët kanë fituar eksperiencë dhe janë në gjendje t'u përgjigjen detyrave të reja dhe shumë të rëndësishme që u shtron atyre pesëvjeçari i tretë. Punonjësit e gjeologjisë në studimet e tyre duhet të udhëhiqen nga kritere dhe nga metoda shkencore të thelluara, në mënyrë që me konkluzionet e tyre të orientojnë drejt radhën e punimeve dhe kërkimet gjeologjike në përgjithësi. Partia nuk ka kursyer dhe nuk do

të kursejë për të fuqizuar gjithnjë më shumë gjeologjinë si sektor me shumë perspektivë, por kjo nuk na lejon në asnjë mënyrë që të përdoren pa përgjegjësi dhe pa efektivitet mjetet e shumta monetare dhe materiale që janë caktuar për këtë qëllim. Njëkohësisht, duhet të forcojmë punën e laboratorëve të gjeologjisë, jo vetëm për të ngritur punën shkencore në analizat, por edhe për të rritur në maksimum gamën e analizave kimike dhe kimiko-teknologjike, që duhet të bëhen në vend, për t'i dhënë ekonomisë së vendit mundësi për një zhvillim të mëtejshëm.

Punonjësit e gjeologjisë duhet të tregohen shumë të kujdesshëm për pasurimin, për ruajtjen dhe për shfrytëzimin e dokumenteve dhe të materialeve në mënyrë shkencore, që të shërbejnë jo vetëm për tani, por edhe për brezat e ardhshëm. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet rritjes së efektivitetit të kërkimeve gjeologjike për zbulimin dhe për ngritjen në kategori të rezervave me sa më pak shpenzime.

Puna e sektorit të gjeologjisë të vlerësohet jo vetëm me vëllimin e punimeve të kryera, por edhe me sasinë dhe me cilësinë e rezervave të minéraleve të dobishme që vihen në shërbim të ekonomisë sonë popullore.

Vënia në shfrytëzim e veprave të reja që parashikohen në pesëvjeçarin e tretë, sidomos e atyre që janë konsumatore të mëdha të energjisë elektrike dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë në pesëvjeçarët e ardhshëm shtrojnë si detyrë të dorës së parë zgjerimin e mëtejshëm të bazës energjetike.

Partia ka marrë me kohë masat për t'u dalë përpara nevojave të ekonomisë për energji elektrike. Gja-

të pesëvjeçarit të tretë shteti ynë do të investojë fonde të mëdha për fuqizimin e bazës energjetike. Me ndërtimet e reja hidroenergjetike që do të vihen në shfrytëzim në vitet e para të pesëvjeçarit të tretë, si hidrocentralet e Shkopetit dhe të Bistricës, si edhe me ndërtimin e termoelektrocentralit të fuqishëm në Fier, do të rritet rreth 2,5 herë fuqia e instaluar e centraleve tona elektrike. Gjatë pesëvjeçarit të tretë do të studjohen mundësitë për të vënë në shërbim të ekonomisë rezervat e mëdha të energjisë së lumit Drin. Në vitin 1965 do të prodhohet 84 për qind më shumë energji elektrike se në vitin 1960.

Një zgjerim të madh do të marrë në këtë pesëvjeçar sistemi i përbashkët i shpërndarjes së energjisë elektrike. Mjaft rajone të reja të vendit, si Shkodra, Gjirokastra, Saranda, Delvina, Rrogözhiina etj., do të lidhen në këtë sistem.

Kjo rritje e fuqishme e bazës materialo-teknike kërkon nga punonjësit e energjetikës që të specializohen më tej për shfrytëzimin racional të kapaciteteve prodhuese dhe të plotësojnë pa ndërprerje nevojat e industrisë dhe të të gjithë konsumatorëve.

Edhe në të ardhshmen detyrat kryesore të industrisë mekanike do të jenë shtimi e zgjerimi me leverdi i nomenklaturës së prodhimit të pjesëve të këmbimit për industrinë e, në mënyrë të veçantë, për naftën, transportin automobilistik, bujqësinë dhe degët e tjera të ekonomisë popullore. Të vazhdohet puna e filluar për prodhimin e makinave të thjeshta dhe të shfrytëzohet në thellësi baza ekzistuese mekanike. Në vitin 1965 industria mekanike të plotësojë jo më pak se 50

për qind të nevojave të vendit me pjesë këmbimi. Detyra që shtron Partia për prodhimin e pjesëve të këmbimit ka një rëndësi të veçantë për vendin tonë. Realizimi i saj do të ndihmojë për shfrytëzimin dhe për mirëmbajtjen më të mirë të pajisjeve dhe të makinerive dhe do të pakësojë importin tonë.

Ne kemi bindjen e plotë se punonjësit e industrisë mekanike do ta vënë në jetë këtë porosi të Partisë. Për plotësimin e këtyre detyrave plani i tretë pesëvjeçar parashikon ngritjen e një sërë veprash të rëndësishme për zgjerimin e industrisë mekanike, siç janë uzina e prodhimit të pjesëve të këmbimit për traktorë, zgjerimi i uzinës «Enver», rindërtimi i Uzinës Mekanike në Qytetin «Stalin» etj.

Plotësimi në kohë dhe me cilësi të mirë i programit madhështor të ndërtimeve që parashikon plani i tretë pesëvjeçar, varet shumë nga mbarëvajtja dhe nga zhvillimi i mëtejshëm i industrisë së materialeve të ndërtimit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka marrë masa për të shpejtuar ritmet e zhvillimit të kësaj dege, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje t'i përgjigjet jo vetëm ritmit të ndërtimeve, por edhe të disponojë kapacitete dhe rezerva të mjaftueshme për plotësimin e të gjitha nevojave, si edhe për sigurimin e rritjes së mëtejshme të ndërtimeve.

Punonjësve të kësaj dege të industrisë u dalin detyra të mëdha, jo vetëm për t'iu përmbajtur ritmeve të larta të rritjes së prodhimit prej 79 për qind më shumë, por edhe për të përmirësuar rrënjësisht treguesit cilësorë të punës së tyre.

Shtimi dhe zgjerimi i asortimentit, përmirësimi i cilësisë dhe zhdukja e karakterit stinor të prodhimit janë detyrat kryesore për organizatat e Partisë dhe për punonjësit e industrisë së materialeve të ndërtimit.

Zhvillimi i industrisë së lëndës së drurit e ka preokupuar gjithnjë Partinë dhe Qeverinë tonë, sepse kjo industri ka të bëjë drejtpërsëdrejti me trajtimin e një pasurie të tillë të madhe siç është ekonomia pyjore. Nuk ka sektor të ekonomisë sonë popullore që të mos jetë i lidhur me përdorimin e lëndës së drurit. Për këtë arsye në pesëvjeçarin e tretë do të merren masa efektive për mirëmbajtjen dhe për shfrytëzimin racional të pyjeve, si edhe për plotësimin më të mirë të nevojave të ekonomisë me artikujt e përpunimit të lëndës së drurit. Do të bëhen investime të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve të reja prodhuese, siç janë kombinatet e drurit në Shkodër e në Milot, për hapjen e rrugëve pyjore, për ngritjen e shkallës së mekanizimit etj. Të gjitha këto do të krijojnë kushte për të shkuar, në të ardhshmen, drejt balancimit të prerjes me rritjen natyrore të pyjeve dhe drejt shfrytëzimit më racional të tyre.

Punonjësve të industrisë së lëndës së drurit dhe organizatave të Partisë u dalin detyra të mëdha për shfrytëzimin kompleks dhe racional të lëndës, për përdorimin në shkallë të gjerë të mekanizmave, për përmirësimin e cilësisë dhe për sigurimin e fuqisë punëtore të përhershme. Garanci për realizimin e këtyre detyrave është kthesa që ka filluar të bëhet në këtë degë të ekonomisë, e cila, mund të themi, doli nga prapambetja dhe po zbaton me kujdes porositë e Partisë.

Plotësimi i nevojave gjithnjë më të mëdha të popullsisë me mallra të konsumit të gjerë bën të domosdoshëm zgjerimin e mëtejshëm të industrisë së lehtë dhe asaj ushqimore. Në pesëvjeçarin e tretë i jepet rëndësi fuqizimit dhe modernizimit të këtyre degëve të industrisë, duke ndërtuar vepra të reja, të pajisura me teknikë moderne, siç janë Fabrika e Tekstileve të Leshta për prodhimin e stofave të leshta në Tiranë e Kombinati i Trikotazhit në Korçë; do të ndërtohet një kombinat tjetër i madh për tekstile të pambukta në Berat, do të mbarojë ndërtimi i fabrikës së ekstraksionit dhe të rafinimit të vajrave në Fier, do të kompletohet kombinati ushqimor «Ali Kelmendi» në Tiranë; një zhvillim të madh do të marrë industria e përpunimit të rrushit dhe të frutave.

Ndërtimi i këtyre veprave të reja, si dhe shfrytëzimi më i plotë i aftësive ekzistuese të prodhimit, do të bëjnë të mundur që të përpunohen edhe më shumë në vend lëndët e para bujqësore e blegtorale, duke kontribuar kështu në zhvillimin e këtyre degëve të bujqësisë dhe në përmirësimin e mirëqenies materiale të popullit. Si rrjedhim, prodhimet e industrisë së lehtë në vitin 1965 do të jenë 62 për qind më shumë dhe të industrisë ushqimore 43 për qind më shumë se në vitin 1960.

Shtimi dhe zgjerimi i asortimentit, përmirësimi i cilësisë, përvetësimi dhe respektimi i proceseve teknologjike të prodhimit janë detyra kryesore të punonjësve të degëve të industrisë që prodhojnë mallra të konsumit të gjerë.

Duke marrë parasysh se vendi ynë ka kushte të fa-

vorshme për gjuajtjen dhe rritjen e peshkut, edhe në të ardhshmen do t'i japim rëndësi zhvillimit të këtij sektori. Punonjësit e peshkimit duhet të sigurojnë gatishmërinë teknike të mjekteve, t'i manovrojnë ato në kohën e duhur dhe në zonat më të pasura me peshk, duke përdorur metoda të shumta peshkimi. Krahas peshkimit në det të hapur, duhet të zhvillohet gjithashtu peshkimi në ujërat e brendshme dhe të punohet për rritjen artificiale të peshkut. Kemi bindjen se ekzistojnë të gjitha mundësitë për ta nxjerrë nga prapambetja këtë degë të rëndësishme të ekonomisë sonë.

Industria lokale dhe artizanati i kooperuar, si ndihmës të industrisë kombëtare, duhet edhe në të ardhshmen të zhvillohen mbi bazën e shfrytëzimit të lëndëve të para lokale dhe të mbeturinave të industrisë kombëtare.

Mbarëvajtja e këtyre sektorëve varet shumë nga puna e organeve lokale të Partisë e të pushtetit, të cilat duhet të udhëheqin nga afër veprimtarinë e tyre ekonomiko-financiare dhe të nxitin inisiativat për të krijuar aktivitete, artikuj dhe asortimente të reja, për të plotësuar më mirë e më lirë nevojat e popullit.

Në vitin 1965 prodhimi i industrisë lokale do të rritet 23 për qind, ndërsa ai i artizanatit 69 për qind më tepër se viti 1960. Kjo është një detyrë jo e lehtë, prandaj realizimi i saj kërkon një mobilizim më të madh të punonjësve të këtyre sektorëve.

Plotësimi i nevojave të përditshme, gjithnjë më të mëdha të popullsisë për shërbime e për riparime të ndryshme, është detyrë numër një e kooperativave tonë të artizanatit. Duke u udhëhequr nga ky qëllim, këto organizata, së bashku me organet lokale të Partisë

e të pushtetit, duhet të njohin thellë nevojat e popullit për shërbime dhe sipas tyre të ngrënë aktivitetet dhe rrjetin.

Realizimi i detyrave madhështore të planit të tre-të pesëvjeçar do të arrihet në një shkallë të dukshme nga investimet e mëdha që do të bëhen për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës. Investimet e këtij pesëvjeçari do të arrijnë në 69 miliard e 500 milion lekë, ose 51 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë. Si edhe në të kaluarën pjesa dërrmuese e investimeve ose 81,9 për qind e tyre do të bëhet në sferën e prodhimit material.

Në pesëvjeçarin e ardhshëm, një peshë të madhe do të kenë punimet e ndërtimeve kapitale, për të cilat do të shpenzohen rreth 35 miliard e 700 milion lekë, me çmimet e vitit 1961, ose 60 për qind më shumë se vëllimi i ndërtimeve i realizuar në pesëvjeçarin e dytë dhe 400 milion lekë më tepër se sa janë shpenzuar gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor, duke c llogaritur me çmimet e vitit 1958.

Nga vëllimi i përgjithshëm i ndërtimeve, 72,1 për qind do të kryhen për degët prodhuese. Kjo do të bëjë të mundur ndërtimin e më shumë se 400 veprave industriale, bujqësore, sociale e kulturore etj.

Plani madhështor që ka hartuar Partia për bonifikimin e fushave, për zhdukjen e moçaleve shekullore, për vënien nën kulturë të sa më shumë tokave, do të hyjë në fazën përfundimtare të realizimit të tij.

Për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit të banesave parashikohet të shpenzohen 6 miliard e 500 milion lekë, ose 75 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dy-

të. Në çdo ditë pune do të ndërtohen rreth 13 apartamente, kundrejt 7 apartamenteve që ndërtoheshin në pesëvjeçarin e dytë.

Punime të rëndësishme do të bëhen për zhvillimin e mëtejshëm të transportit, duke shtuar rrjetin rrugor e hekurudhor, duke mekanizuar dhe duke modernizuar portet tona detare dhe veçanërisht Portin e Durrësit, i cili do të bëhet një nga portet më të mëdhenj të detit Adriatik.

Realizimi me sukses i këtij programi shtron nevojën e përmirësimit të studimeve tekniko-ekonomike dhe të projektimit të veprave për të përcaktuar leverdisshmërinë e investimeve, vëllimin e punimeve të ndërtimit, si edhe fondet që nevojiten. Është e nevojshme që të kalohet më me guxim në tipizimin e projekteve dhe në standardizimin e pjesëve të ndërtimit, si kusht i domosdoshëm për të hyrë në rrugën e industrializimit të ndërtimit, si metodë më e mirë për shpejtimin e ritmeve dhe për përmirësimin e cilësisë së punimeve. Në lëmin e urbanistikës të vazhdohet puna për hartimin dhe për zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve. Duke marrë parasysh kushtet e reja që lindin me kolektivizimin e bujqësisë, krijohen mundësitë që ndërtimet e reja në fshat të bëhen me plan. Punonjësit e urbanistikës duhet të japin ndihmën e tyre në këtë drejtim.

Punonjësve të ndërtimit u dalin detyra të rëndësishme për organizimin më të mirë të punimeve, për furnizimin e pandërprerë të fronteve të punës dhe për përqëndrimin më të mirë të forcave, me qëllim që veprat e ndryshme të përfundojnë në kohën e caktuar.

Ndërtuesit tanë duhet të nxjerrin nga duart e tyre ndërtime të cilësisë së lartë, të kursejnë sa më shumë materiale, të mekanizojnë më tej punimet, me qëllim që shpenzimet në ndërtim të ulen vazhdimisht duke zbuluar dhe duke shfrytëzuar rezervat e brendshme. Në këtë mënyrë do të gjejë zbatim të plotë parulla e Partisë: «Të ndërtojmë shpejt, mirë dhe lirë». Partia ka besim të plotë se punonjësit e ndërtimit, duke mos iu shmangur vështirësive, do të vënë të gjitha forcat për të kthyer në realitet perspektivat e shkëlqyera që i hapen vendit tonë në rrugën e socializmit.

Para punonjësve të transportit shtrohen detyra të mëdha për t'i transportuar në kohë dhe pa ndërprerje lëndët e para dhe produktet e gatshme nga sfera e prodhimit në atë të konsumit.

Në pesë vjetët e ardhshëm parashikohen masa të rëndësishme për zhvillimin e të gjitha llojeve të transportit, për shtimin e mjeteve dhe për forcimin e bazës materialo-teknike, për përgatitjen dhe për kualifikimin e kuadrove. Vëllimi i punës së transportit në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, do të rritet për transportin automobilistik të Ministrisë së Komunikacioneve — 41 për qind, për transportin hekurudhor — 105 për qind dhe për transportin detar — 2,2 herë. Për këtë qëllim parashikohen masa të rëndësishme për shtimin e kapacitetit dhe për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomikë të shfrytëzimit. Në krahasim me vitin 1960 në fund të pesëvjeçarit kapaciteti i kamionave do të rritet 21 për qind, i rimorkiove — 96 për qind, kurse flota detare do të shtojë tonazhin e saj 2 herë më tepër. Do të ndërtohet dhe do të vihet në shfrytëzim hekurudha Vorë-Milot.

Një zhvillim të mëtejshëm do të marrë ndërlihdja nëpërmjet rritjes dhe modernizimit të bazës së saj teknike, me qëllim që t'i shërbehet më mirë popullsisë dhe institucioneve të ndryshme.

Në sektorin e transportit vëmendja e organizatave të Partisë dhe e organeve ekonomike shtetërore duhet të përqëndrohet në mirëmbajtjen e mjeteve, duke rritur kujdesin për gatishmërinë e tyre.

Shokë,

Në përgjithësi këto janë detyrat që shtron Partia për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre sektorëve me rëndësi të ekonomisë gjatë planit të tretë pesëvjeçar. Sikurse shihet detyrat nuk janë të lehta. Plotësimi i tyre kërkon mobilizimin e plotë dhe të gjithanshëm të organizatave të Partisë dhe të kolektiveve punonjëse, kërkon që të përmirësohet edhe më shumë metoda e drejtimit dhe organizimi i punës, të bëhet një luftë më e vendosur për kursime, për shfrytëzimin e rezervave të brendshme dhe të mundësive që ekzistojnë në vend. Lidhur me detyrat që shtrohen në këta sektorë të ekonomisë duhet të vëmë theksin mbi disa çështje shumë të rëndësishme që Partia dhe masat punonjëse duhet t'i mbajnë parasysh e që kanë të bëjnë me përmirësimin e mëtejshëm të treguesve cilësorë të prodhimit.

a) *Në lëmin e rendimentit të punës.* Partia gjithnjë na ka mësuar se rritja e pandërprerë e rendimentit të punës, si ligj ekonomik i socializmit, është faktori vendimtar për shtimin e ritmeve të prodhimit, uljen e koston, rritjen e akumulimit socialist dhe përmirësi-

min e nivelit material dhe kulturor të masave punonjëse. Rendimenti i punës, në mëson Lenini

«... është, në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹.

Një vlerësim i tillë për këtë tregues kaq të rëndësishëm ekonomik ka gjetur mishërimin dhe konkretizimin e vet në planet tona shtetërore. Si në të gjithë veprimtarinë ekonomike, ashtu edhe në lëmin e rritjes së rendimentit të punës ne kemi arritur rezultate të kënaqshme. Detyra e caktuar nga Kongresi III i Partisë, në përgjithësi, është arritur: rreth 67 për qind e shtimit të prodhimit të përgjithshëm industrial gjatë pesëvjeçarit të dytë është realizuar në saje të rritjes së rendimentit të punës.

Detyra edhe më të mëdha shtron pesëvjeçari i tretë. Në bazë të projektdirektivave, parashikohet që rendimenti i punës të rritet në prodhimin e përgjithshëm industrial — 27 për qind, nga e cila në miniera — 25 për qind dhe në industri — 34 për qind, në transportin automobilistik — 15 për qind, në atë hekurudhor — 44 për qind dhe në atë detar — 75 për qind, ndërsa në ndërtime e në montime — 29 për qind. Rritja me të tilla ritme të larta e rendimentit të punës në pesëvjeçarin e tretë do të sigurojë rreth 62 për qind të shtimit të prodhimit të përgjithshëm industrial.

Siç shihet, këto janë detyra të mëdha, por plotë-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

sisht të realizueshme, në qoftë se do të merren masa efektive për të shfrytëzuar mundësitë e mëdha që ekzistojnë në ekonominë e vendit tonë.

Përparimi i vazhdueshëm teknik është baza materiale për rritjen e shpejtë të rendimentit të punës. V. I. Lenini vazhdimisht ka theksuar se pajisja e të gjitha degëve të ekonomisë popullore me teknikën e re, të përparuar, perfeksionimi i teknologjisë së prodhimit dhe mekanizimi i proceseve të punës janë baza materiale për rritjen e pandërprerë të rendimentit të punës.

Ndryshe nga sistemi kapitalist, që bazohet në shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, në ekonominë tonë socialiste janë krijuar mundësi të pakufizuara për futjen e teknikës në shkallë të gjerë e në mënyrë të planifikuar. Në vendin tonë rritja e rendimentit nuk bazohet në intensifikimin çnjerëzor të punës, siç ngjet në kapitalizëm. Teknika, me të cilën po pajiset vazhdimisht industria jonë, është burimi i rritjes së pandërprerë të prodhimit e të rendimentit të punës. Për këtë arsye mirëmbajtja dhe shfrytëzimi racional i makinerive, i mekanizmave dhe i pajisjeve teknike, si elementi kryesor i kapacitetit prodhues, kanë qenë dhe mbeten një nga detyrat më të rëndësishme për organizatat e Partisë dhe për organet ekonomike shtetërore.

Partia gjithnjë ka bërë të ditur se përmirësimi i shfrytëzimit të makinerisë duhet të ketë për qëllim si shfrytëzimin në gjerësi, me ngarkimin e saj në kohë sa më të gjatë pune, ashtu edhe shfrytëzimin e saj në thellësi, me ngritjen e rendimentit për njësi të kohës së punës. Zbatimi i këtyre detyrave kërkon vendosjen e

një regjimi të drejtë në punën e makinerisë, përmirësimin e ritmikës së prodhimit etj.

Pregatitja dhe kualifikimi i kuadrit është faktori vendimtar për zotërimin e teknikës dhe për rritjen e rendimentit të punës.

Zhvillimi me ritme të shpejta i industrializimit socialist, rikonstruksioni i një numri të madh ndërmarrjesh dhe pajisja e tyre me teknikën e re, si edhe zhvillimi i vrullshëm i degëve të tjera të ekonomisë sonë popullore shtrojnë në mënyrë të ngutshme përgatitjen e kuadrove të nevojshëm, jo vetëm për vënien në shfrytëzim, por edhe për përvetësimin sa më të plotë të kapaciteteve të projektuara.

Teknika, sado e mirë dhe e përsosur që të jetë, mund të mbetet diçka e vdekur, po qe se mungojnë njerëz të zot që ta përdorin atë. Prandaj edhe në këtë pesëvjeçar Partia do t'u kushtojë kujdes të posaçëm rritjes dhe aftësimin të klasës punëtore dhe kuadrove drejtues, si faktor vendimtar për zotërimin e teknikës dhe për rritjen e rendimentit të punës.

Vënia në jetë e masave efektive që parashikon pesëvjeçari i tretë në lëmin e përgatitjes tekniko-profesionale të kuadrove, do të krijojë kushtet për të ecur më shpejt drejt zhdukjes së disproporcionit që ekziston midis nevojave për kuadro dhe masës së sigurimit të tyre, nga njëra anë, si edhe nivelit të teknikës dhe përgatitjes profesionale të tyre, nga ana tjetër.

Zgjidhja e këtyre detyrave, që kanë një rëndësi të dorës së parë për rritjen e rendimentit të punës dhe për ndërtimin e socializmit, lidhet ngushtë me riorganizimin e arsimit të përgjithshëm dhe profesional.

Organizimi dhe shfrytëzimi i kohës së punës — kusht i rëndësishëm për rritjen e rendimentit. Çështjet që kanë të bëjnë me normimin dhe në përgjithësi me organizimin socialist të punës kanë një përmbajtje të thellë ekonomike, politike dhe shoqërore dhe, si të tilla, ato kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen e Partisë. Pjesëmarrja e punonjësve në punën me norma ka shkuar vazhdimisht duke u zgjeruar në të gjitha degët dhe sektorët e ekonomisë sonë. Një punë e mirë ka filluar të bëhet për revizionimin dhe për zëvendësimin e normave eksperimental-statistikore me norma teknike. Më mirë kanë punuar në këtë drejtim organizatat e Partisë dhe kolektivët punonjës të Kombinatit të Naftës në Qytetin «Stalin», të uzinës «Enver» në Tiranë etj.

Normat teknike janë një forcë e madhe mobilizuese, bazë e shëndoshë për rritjen e rendimentit. Ato vendosen mbi treguesit mesatarë të arritur, me qëllim që të tërhiqen masat e gjera të punëtorëve në nivelin e të përparuarve.

Duke marrë parasysh parimin socialist të shpërblimit të punës sipas sasisë dhe cilësisë së saj, gjatë këtij pesëvjeçari, Partia do të zbatojë një varg masash të rëndësishme që kanë për qëllim ta bëjnë sistemin e pagave një mjet edhe më të fortë nxitës për rritjen e prodhimit dhe të rendimentit të punës.

Emulacioni socialist — forcë e madhe shoqërore për rritjen e rendimentit të punës. Një nga veçoritë karakteristike të organizimit socialist të punës është fakti se te ne punonjësit janë drejtpërsëdrejti të interesuar për rritjen e rendimentit të punës. Fakti se ata

punojnë për vete, për shoqërinë dhe jo për kapitalistin, zhvillon te çdo punëtor ndërgjegjen e lartë dhe qëndrimin shembullor ndaj punës. Këtu e ka burimin lindja dhe zhvillimi i inisiativave të tilla të mrekullueshme, siç janë metoda «1+2» për kualifikimin e punëtorëve, lëvizja për plotësimin e normës nga çdo punëtor dhe, mbi të gjitha, lëvizja e madhe shoqërore e brigadave që luftojnë për të fituar titullin «Brigadë e Punës Socialiste» me parullën «Të punojmë, të mësojmë dhe të jetojmë në mënyrë socialiste».

Organizatat e Partisë e të bashkimeve profesionale kanë për detyrë të përkrahin me çdo kusht çdo inisiativë të punonjësve, ta përgjithësojnë dhe ta përhapin atë. Në këtë mënyrë ato i hapin horizont më të gjerë zhvillimit të forcave prodhuese të vendit, si faktor i fuqishëm për ngritjen me ritme edhe më të larta të rendimentit të punës shoqërore.

b) *T'i kushtohet kujdes i veçantë realizimit të planit, jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi.* Ngritja e një sërë veprash industriale, të pajisura me teknikën e përparuar, rikonstruksioni dhe modernizimi i industrisë ekzistuese, rritja e shkallës së mekanizimit të ndërtimeve, puna e bërë për përgatitjen dhe për kualifikimin e kuadrit, kanë krijuar kushte të përshtatshme dhe mundësi reale për përmirësimin rrënjësor të cilësisë. Këtij qëllimi i kanë shërbyer gjithashtu masat që janë marrë për standardizimin e produkteve, ndryshimin e metodologjisë së planifikimit, organizimin e zyrave të kontrollit teknik, të laboratorëve etj.

Ndërmarrjet industriale dhe ato të ndërtimit i kanë të gjitha mundësitë për t'i dhënë popullit mallra

dhe vepra me cilësi të lartë. Ka ardhur koha që çdo ndërmarrje apo organizatë ekonomike të përqëndrojë vëmendjen në plotësimin e treguesve cilësorë të prodhimit.

Është vënë re se vitet e fundit mjaft kolektive punonjëse kanë nxjerrë nga duart e tyre prodhime dhe ndërtime të mira, të cilat populli i ka pritur me kënaqësi, si prodhimet e kombinatit të tekstileve «Stalin», të Fabrikës së Çimentos në Vlorë, të kooperativës së punim-drurit në Pogradec e shumë të tjera. Por kjo është vetëm fillimi i punës së madhe që kemi përpara. Prandaj, organizatat e Partisë, në radhë të parë, duhet të bëjnë një luftë të ashpër dhe këmbëngulëse kundër të gjitha shfaqjeve të huaja, kundër pikëpamjeve të ngushta dikasteriale dhe frymës së lëshimeve që vërehen aty-këtu.

Lufta për rritjen e cilësisë është njëkohësisht lufta për rritjen e prodhimit dhe për ngritjen e nivelit material dhe kulturor të punonjësve, prandaj organizatat e Partisë në të ardhshmen duhet të tregojnë një kujdes më të madh për organizimin e prodhimit, për respektimin dhe për zgjerimin e standardeve shtetërore dhe të kushteve teknike, për vendosjen dhe për zbatimin e proceseve të përparuara teknologjike. Përmirësimi i cilësisë nuk mund të kuptohet pa rritur në një shkallë gjithnjë më të lartë kontrollin teknik të gjithanshëm dhe sistematik, pa rritur ndjenjën e përgjegjësisë personale të njerëzve.

c) *Të forcojmë më tej regjimin e kursimit.* Realizimi i programit madhështor të Partisë për ndërtimin e socializmit kërkon mobilizimin dhe përdorimin ra-

cional të të gjitha vlerave materiale dhe financiare, vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi në ekonominë popullore dhe në të gjithë veprimtarinë shtetërore dhe shoqërore në vendin tonë.

Partia i ka edukuar kuadrot dhe punonjësit që, duke shfrytëzuar mundësitë e mëdha objektive që ka rendi socialist, të zbulojnë dhe të përdorin rezervat e brendshme të prodhimit për rritjen e mëtejshme të burimeve financiare, t'i përdorin ato në dobi të zhvillimit të ekonomisë dhe të përmirësimit të kushteve materiale dhe kulturore të masave punonjëse.

Në këtë mënyrë u bë e mundur të vihen në jetë porositë e Kongresit III të Partisë për shtimin e prodhimit, për uljen e kostos, për uljen e shpenzimeve joproduktive, duke i dhënë ekonomisë popullore kursime mbi planin. Pas Plenumit të Dhjetorit të vitit 1959 të Komitetit Qendror të Partisë një hov veçanërisht të madh ka marrë lufta për të kursyer kudo, për të administruar mirë pasurinë dhe lekun e popullit, për të ngritur më lart ndërgjegjen socialiste në punë. Në fund të vitit 1960 në sektorin ekonomik ulja e koston i kaloi në rreth 700 milion lekë detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë. Detyrat e reja që i shtrohen ekonomisë sonë në planin e tretë pesëvjeçar, kërkojnë një mobilizim edhe më të madh të burimeve tonë të brendshme materiale e financiare. Rëndësi e posaçme për kursime duhet t'i kushtohet shfrytëzimit racional të lëndëve të para, materialeve, karburanteve etj.

Ulja sistematike e normativave të materialeve dhe, në radhë të parë të materialeve të importit, kur-

simi dhe zëvendësimi i lëndëve deficitare duhet të jenë detyra të përhershme të organeve ekonomike dhe shtetërore. Mundësitë tona në këtë drejtim janë akoma të mëdha. Zbatimi i metodave dhe i eksperiencës së përparuar, përmirësimi i cilësisë së lëndëve të para, zbatimi i normave teknike të konsumit të materialeve, janë faktorë të rëndësishëm që sigurojnë kursimin e vlerave materiale dhe monetare.

Në luftën për vendosjen e regjimit të kursimit duhet të kihet parasysh që të pakësohen shpenzimet joproductive, të shpejtohet qarkullimi i mjeteve të xhiros, të forcohet hozrashoti dhe të ulen shpenzimet e tepërta administrative.

Lufta për vendosjen dhe për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit është e lidhur ngushtë me punën e Partisë për të edukuar punonjësit me ndërgjegjen socialiste për ruajtjen e pronës së përbashkët të popullit. Dëmtimi dhe administrimi i keq i pasurisë socialiste duhet shikuar si pasqyrim i luftës së klasave. Prandaj, përveç punës edukative që duhet intensifikuar, për asnjë çast të mos pakësojmë vigjilencën tonë revolucionare.

Organizatat e Partisë, organizatat e masave, dënjtuesit e ekonomisë dhe të gjithë punonjësit duhet ta kenë të qartë se lufta për realizimin e detyrave të planit është e lidhur, në mënyrë të pashmangshme, me luftën për kurtime. Çështja e forcimit të mëtejshëm të regjimit të kursimit të bëhet çështje e masave dhe t'i nënshtrohet kontrollit të tyre. Të përkrahen dhe të nxiten inisiativat e punonjësve për uljen e shpenzimeve dhe për forcimin e regjimit të kursimit. Partia

duhet të vazhdojë të edukojë masat punonjëse me një dhemshuri të madhe për pronën socialiste e të rrënjësë te punonjësit ndjenjën e një regjimi të fortë kursimi.

2. — Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë gjatë pesëvjeçarit të tretë

Bujqësia është dega më kryesore e ekonomisë popullore, e cila në vitin 1959 zinte një peshë specifike prej 42,8 për qind në të ardhurat kombëtare. Duke u nisur nga vetë rëndësia e madhe që ka bujqësia për ndërtimin socialist të vendit dhe nga fakti se me bujqësinë merret 62,7 për qind e popullsisë, Partia kurdoherë i ka kushtuar dhe i kushton kujdes të posaçëm zhvillimit të saj, ashtu sikurse edhe gjithë ndërtimit socialist në fshat.

Pesëvjeçari i tretë parashikon një ngritje të dukshme të nivelit material dhe kulturor të punonjësve të vendit tonë. Do të zgjerohet industria në përgjithësi dhe sidomos industria e lehtë dhe ushqimore. Plotësimi me sukses i këtyre detyrave të rëndësishme në një sasi të konsiderueshme është i lidhur ngushtë me shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Prandaj masat për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë zënë një vend me rëndësi. Gjatë pesëvjeçarit të tretë *detyra kryesore në bujqësi qëndron gjithmonë shtimi i prodhimit të drithit. Krahas kësaj, duhet të shtohen edhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale në atë masë që të sigurohet një furnizim i kënaqshëm i popullit, të plotë-*

sohen mirë nevojat e industrisë me lëndë të parë dhe të shtohet eksportimi i tyre.

Duhet të merren masa që në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, të shtohen prodhimet bujqësore dhe blegtorale si vijon: drithërat e bukës 95 për qind më shumë, pambuku 65 për qind, duhani 112 për qind, panxhari 75 për qind, perimet e patatet 109 për qind, ullinjte 181 për qind, frutat dhe rrushi 90 për qind, qumshti 58 për qind, mishi (peshë e gjallë) 34 për qind, leshi 41 për qind etj.

Ku bazohet Partia që shtron detyra të tilla për ngritjen e shpejtë të bujqësisë dhe për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral gjatë pesëvjeçarit të tretë?

E para, në kushtet e reja që janë krijuar me përfundimin në përgjithësi të kolektivizimit, në rezultatet e deritanishme të kooperativave, si edhe në masat që do të merren për forcimin e tyre ekonomiko-organizativ gjatë pesëvjeçarit të tretë.

E dyta, në nivelin që ka arritur mekanizimi i bujqësisë dhe në masat e parashikuara për zgjerimin e tij të mëtejshëm. Mjafton të themi se në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, vëllimi i punimeve të mekanizuara gati do të dyfishohet, ndërsa parku i traktorëve do të rritet më se dy herë. Për këtë qëllim do të investohen 2 miliard e 600 milion lekë, domethënë afro 3 herë më shumë se në pesëvjeçarin e parë dhe 8 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë.

E treta, në bonifikimin e një pjese të madhe të fushave më pjellore të vendit, si edhe në zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme, që u kryen gjatë pesëvjeçarit të dytë. Punimet në këtë drejtim do të vazhdojnë në

shkallë të gjerë edhe gjatë pesëvjeçarit të tretë, duke investuar për këtë qëllim 3 miliard e 693 milion lekë, domethënë, 18 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë dhe 2,5 herë më shumë se në pesëvjeçarin e parë.

E katërta, në hapjen e më se 63 000 hektarëve toka të reja dhe në zhvillimin e një lufte më të vendosur nga të gjithë punonjësit e bujqësisë për rritjen e rendimenteve.

Kullimi i tokave, punimi i mirë i tyre, dhe sidomos periodikisht qilizmë, 30-40 centimetra thellë për kulturat e arave, lufta për grumbullimin dhe për përdorimin e mirë të plehrave organike, përdorimi i farërave të zgjedhura, kryerja e shërbimeve agroteknike me kohë, lufta kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në bujqësi, ngritja e nivelit agroteknik të punonjësve të bujqësisë dhe pregatitja e një numri më të madh kuadrosh specialistë dhe drejtues për kooperativat bujqësore dhe për nevojat e bujqësisë në përgjithësi, të gjitha këto masa duhet të ndiqen dhe të plotësohen me kujdes nga organet e pushtetit, nga punonjësit e bujqësisë dhe nga organizatat e Partisë, sepse janë të lidhura ngushtë me plotësimin e detyrave që i shtrohen bujqësisë gjatë pesëvjeçarit të tretë.

Në pesëvjeçarin e parë dhe të dytë si detyrë e dorës së parë ishte hapja e tokave të reja dhe zgjerimi i sipërfaqes nën kulturë, ndërsa në pesëvjeçarin e tretë, krahas hapjes së tokave të reja, si detyrë kryesore shtrohet rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore. *Prandaj, rruga kryesore për zhvillimin e bujqësisë dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore për pesëvjeçarin e*

tretë dhe për më vonë, është rritja e pandërprerë e rendimenteve, pa pushuar luftën për hapjen e tokave të reja. Në këtë drejtim, po të punohet mirë, ka rezerva të pashtershme. Duke kuptuar kështu rëndësinë e rritjes së rendimenteve, në planin e tretë pesëvjeçar është parashikuar që sipërfaqja nën kulturë të rritet vetëm 13 për qind, ndërsa vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor dhe blegtoral të rritet 72 për qind.

Detyrat për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale për pesëvjeçarin e tretë janë shumë të mëdha, por plotësimi i tyre është i mundshëm. Është, pra, e nevojshme që, duke u bazuar në kushtet tona, si vend me sipërfaqe toke të kultivuar shumë të kufizuara, të merren masa që të kalojmë kudo në një bujqësi intensive.

Shtimi i mekanizimit, zgjerimi i sipërfaqes së ujtitshme dhe bonifikimi i fushave krijojnë kushte të favorshme për intensifikimin e bujqësisë. Me përjashtim të disa zonave malore, ne duhet të luftojmë që të marrim nga sipërfaqet e mbjella dy ose tri prodhime në vit. Për tokat nën ujë kjo çështje as nuk duhet vënë në diskutim, por edhe në sipërfaqet e paujitshme, në mos qoftë e mundshme të merren dy herë në vit prodhime të tilla si drithi, është plotësisht e mundshme që brenda vitit, pas drithit ose kulturave të tjera të rregullta, të mbillen edhe kultura foragjere, sikurse e ka theksuar vazhdimisht Partia. Organet shtetërore dhe ato të bujqësisë, organizatat e Partisë dhe punonjësit e bujqësisë, sidomos agronomët dhe specialistët, duhet ta konsiderojnë marrjen e dy dhe tri prodhimeve në vit nga çdo hektar tokë si një detyrë shumë me rëndësi për

zhvillimin e bujqësisë dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Intensifikimi në shkallë të gjerë i bujqësisë, marrja e dy dhe tri prodhimeve në vit nga e njëjta tokë, mbajtja e më shumë bagëtive për çdo 100 hektarë tokë, shtimi i të ardhurave për çdo hektar nën kulturë etj. janë të lidhura ngushtë me shfrytëzimin e rezervave të mëdha që ka toka.

Është e domosdoshme që punonjësit, dhe sidomos specialistët e bujqësisë, të njohin, të përvetësojnë dhe të vënë në jetë eksperiencën e përparuar të vendit tonë dhe të vendeve të huaja, sidomos të atyre ku toka nën kulturë është e kufizuar. Kështu, për shembull, në Kinën Popullore e në Kore, jo vetëm marrin nga 2-3 prodhime në vit, nga e njëjta sipërfaqe are, por edhe tokat e mbjella me kultura frutore i shfrytëzojnë rregullisht me kultura të dyta dhe marrin prodhime të bollshme. Ne duhet të fillojmë në shkallë të gjerë të mbjellim kultura të dyta edhe në toka e në zona me kultura drunore, sidomos me ullinj, që zënë sipërfaqe të mëdha e që pothuaj nuk shfrytëzohen fare.

Nga masat më të rëndësishme që do të merren gjatë pesëvjeçarit të tretë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka zgjerimi i sipërfaqes së ujitshme. Në fund të vitit 1960 aftësia ujitëse ishte 135 000 hektarë, ndërsa në vitin 1965 do të arrijë mbi 200 000 hektarë. Plenumi i Komitetit Qendror i muajit Nëntor të vitit 1959 analizo i në mënyrë të hollësishme problemin e ujitjes në bujqësi dhe përcaktoi drejt masat që duhen marrë për zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme. Çështja është që ky problem kaq i madh për bujqësinë tonë të gjejë

zgjidhje sa më parë. Ne duhet të luftojmë jo vetëm për t'i realizuar veprat e ujitjes të caktuara në vendimin e Komitetit Qendror, por çdo rreth, lokalitet dhe fshat të shfrytëzojë të gjitha mundësitë dhe mjetet që ka në vend, të gjitha burimet ku mund të ndërtohen vepra ujitëse për të rritur aftësinë ujitëse brenda pesë-vjeçarit me 65 600 hektarë tokë, deri sot të paujitshme. Sa më parë t'i bëjmë këto, aq më mirë do të jetë për bujqësinë tonë.

Shumë kooperativistë dhe punonjës të bazës kërkojnë të shtojnë sipërfaqen e ujitshme vetëm duke ndër-tuar vepra të mëdha ujitëse, me motopompa e elektro-pompa, objekte këto që kërkojnë investime të mëdha, duan shumë kohë të vihen në shfrytëzim dhe janë të lidhura me importin. Në kushtet tona kjo tendencë nuk është e drejtë. Objekte të mëdha ujitëse janë ndër-tuar dhe do të ndërtohen edhe në të ardhshmen, pompa janë importuar dhe do të importohen edhe në të ardhshmen, natyrisht, aq sa lejojnë mundësitë që ka shteti. Por puna është të shfrytëzohen të gjitha mundësitë dhe mjetet që ekzistojnë në vend për të zgjeruar sipërfaqen e ujitshme, të vihen në lëvizje të gjitha forcat e kooperativave bujqësore për të ndërtuar puse-çikrike, prita, hauze, rezervuare e vija, qoftë edhe të vogla, puse arteziane të thjeshta, ashtu si bëjnë, për shembull, disa kooperativa të Korçës. Organizatat e Partisë, specialistët dhe punonjësit e bujqësisë, fshatarësia kooperativiste në përgjithësi duhet ta konsiderojnë si një fitore të madhe vënien nën ujë, qoftë edhe të një hektari mbi detyrat e caktuara.

Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet

t'i mësojnë kooperativistët jo vetëm si duhet të ndërtojnë vetë vepra ujitëse të thjeshta, por edhe si t'i mirëmbajnë ato që kanë ndërtuar vetë ose që ka ndërtuar shteti, të mësojnë metodat e përparuara të ujitjes. Duhet të merren masa për sistemimin dhe punimin e tokave në atë mënyrë që të sigurojmë ujitjen me metoda të përparuara dhe të kursejmë ujin që është aq i vlefshëm për bujqësinë tonë.

Duhet të bëhet një luftë e vendosur për ruajtjen e pjellorisë së tokës, duke zbatuar një agroteknikë të lartë, duke siguruar plehra të mjaftueshme, duke studjuar renditjen e kulturave që duhen mbjellë në të njëjtën tokë, duke e mbrojtur këtë nga ujërat e shumta dhe gërryerjet. Kujdes i veçantë duhet treguar sidomos për tokat që kanë pjerrësi të madhe, të cilat, po të mos merren masa, fare lehtë mund të dëmtohen nga erozioni.

Kusht i domosdoshëm për shtimin e prodhimit bujqësor është sigurimi i farërave të zgjedhura. Nëse ne deri tani kemi rendimente akoma të ulëta, këtu kanë influencuar mjaft edhe farërat e papërshtatshme që janë përdorur. Masat për organizimin e prodhimit dhe për administrimin e farërave janë përcaktuar drejt në vendimin e posaçëm që kanë marrë Byroja Politike dhe Qeveria vitin e kaluar. Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, sidomos punonjësit e ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore, që janë caktuar për prodhim farërash, duhet të vënë në jetë të gjitha detyrat që u janë ngarkuar për zgjidhjen e problemit të farërave.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë përpara punonjësve të bujqësisë shtrohen detyra të mëdha për zhvillimin e

bimëve industriale. Përpjekje shumë të mëdha duhet të bëhen në vitet e ardhshme për shtimin e prodhimit të pambukut dhe të panxharit për çdo hektar. Në vitin 1965 duhet të merren 4,5 kuintalë pambuk dhe 104 kuintalë panxhar për hektar më shumë se në vitin 1960, ndërsa për shtimin e prodhimit të duhanit duhet të luftohet si për marrjen e rendimenteve të larta, ashtu edhe për zgjerimin e sipërfaqes nën kulturë. Për realizimin e këtyre detyrave dhe sidomos për përmirësimin e cilësisë së prodhimit kërkohet më shumë kujdes dhe më shumë përpjekje se deri sot. Këto kultura e shpërblejnë shpejt çdo mundim dhe u sjellin të ardhura të mëdha ekonomike që i kultivojnë.

Duke marrë parasysh nevojat e popullsisë për perime, nevojat e industrisë, si edhe leverdisshmërinë shumë të madhe që ka eksportimi i tyre, prodhimit të perimeve duhet t'i kushtohet një kujdes i veçantë. *Ekonomitë bujqësore shtetërore, si edhe kooperativat bujqësore që kanë detyra për prodhim perimesh, duhet të marrin të gjitha masat për realizimin e planit, duke caktuar tokën më të përshtatshme dhe duke kultivuar llojet më të mira të perimeve, me pjekje sa më të hershme dhe me cilësi të lartë. Të gjitha ekonomitë bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe individuale, veçanërisht ato që janë pranë qyteteve dhe qendrave të punës, të marrin masa që të sigurojnë për veten e tyre dhe për treg sasi të nevojshme të perimeve.*

Perspektiva të mëdha ka vendi ynë për zhvillimin e frutikulturës. Këtë punë që e kemi filluar duhet ta vazhdojmë më me guxim gjatë viteve të ardhshme. Por nuk do të ishte e drejtë dhe as ekonomike po të

përqëndrohej vëmendja në mbjellje të reja dhe të mos tregohej kujdes, në radhë të parë, për përmirësimin e gjendjes së ullinjve, pemëve frutore dhe të vreshtave ekzistuese. Prandaj duhet të tregohet më shumë kujdes për mirëmbajtjen e pemëve ekzistuese dhe për shtimin e prodhimit të tyre, e sidomos të ullinjve.

Zgjerimi i mëtejshëm i kulturave drunore-frutore për qëllime industriale duhet bërë, në radhë të parë, pranë zonave ku janë ngritur ose do të ngrihen fabrikat e përpunimit të rrushit dhe të frutave. *Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet krijimit të blloqeve me pemë frutore, ullinj e vreshta nëpër kodrinat e në zona me prozhme dhe të papërshtatshme për kulturat e arave. Blloqe të mëdha me agrume duhet të krijohen sidomos në zonën e Sarandës e të Vlorës dhe gradualisht kjo kulturë të shtrihet në rrethet e tjera të rajonizuara për këtë kulturë. Një kujdes i veçantë duhet treguar për zgjedhjen e llojeve të agrumeve që duhen mbjellë, që këto të jenë nga më të mirat, me vlerë të lartë ushqimore e shije, që kërkohen si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në tregun e jashtëm. Me qëllim që kjo punë të bëhet e kontrolluar, çdo rreth të caktojë ndërmarrjet shtetërore ose kooperativat bujqësore që duhet të prodhojnë fidanet frutore për nevojat e rrethit. Një masë e tillë do të garantojë jo vetëm plotësimin e nevojave për çdo rreth, por edhe kontrollin mbi llojet më të mira që do të mbillen në të ardhshmen.*

Për mbjelljen e kulturave drunore dhe zhvillimin e frutikulturës në përgjithësi, organizata e rinisë, e cila si kurdoherë e ka kryer me nder çdo detyrë që i ka ngarkuar Partia, duhet të japë një ndihmë të madhe.

Organet e bujqësisë dhe kooperativat bujqësore duhet t'i japin të gjithë ndihmën dhe përkrahjen rinisë për çdo aksion që ajo merr përsipër.

Për zhvillimin e blegtorisë, gjatë pesëvjeçarit të tretë, janë përcaktuar detyra të hollësishme në vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror të Nëntorit të vitit 1958. *Rezultatet e arritura deri tani nga disa rrethe dhe shumë kooperativa bujqësore dëshmojnë se detyrat që cakton ky Plenum për shtimin e blegtorisë, të cilat në përgjithësi janë përfshirë në planin e tretë pesëvjeçar, janë plotësisht të realizueshme.*

Në cilat drejtime duhet përqëndruar kujdesi për blegtorinë?

Së pari, vëmendja duhet të përqëndrohet në rritjen e prodhimit të sëmës së kafshëve, duke krijuar kushte të përshtatshme për këtë. Në radhë të parë, duhet që të gjitha forcat e specialistëve, drejtuesve të ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore, kuadrove të Partisë, të pushtetit dhe të gjithë punonjësve të bujqësisë të drejtohen në shfrytëzimin e të gjitha rezervave për sigurimin e bazës ushqimore. Shembuj të mirë në këtë drejtim ka në shumë ekonomi bujqësore. Me punën e madhe që bëri Partia, silazhimi, për shembull, po bëhet mbështetja kryesore e bazës ushqimore të lopëve për periudhën e dimrit.

Së dyti, në zhvillimin e të gjitha llojeve, por sidomos të gjedhit, të dërrit, të shpendëve dhe të bletëve, sepse në këtë drejtim kemi mungesa të ndjeshme.

Punonjësit e blegtorisë duhet të bëjnë një punë të madhe për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, pa qenë aspak nevoja që për këtë të bëhen menjëherë dhe

kudo investime, të cilat e rëndojnë ekonominë, sikurse kanë vepruar ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe disa kooperativa bujqësore. Të organizohet më mirë shërbimi për blegtorinë dhe luftimi i sëmundjeve dhe të merren masa efektive për rritjen e pjellshmërisë, ku ekonomia jonë ka humbje të mëdha.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të racës së deles dhe të gjedhit. Rezultatet e punës në këtë drejtim nuk duhet të maten, si deri tani, me numrin e krerëve të ndërzyera, por me rezultatet e kryqëzimit, domethënë me shtimin e prodhimit dhe të treguesve cilësorë.

Zbatimi i këtyre detyrave, kërkon që të ngrihet në një shkallë më të lartë niveli i punës drejtuese nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit, të bëhet një punë më e organizuar për përgatitjen e kuadrit, për njohjen dhe për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar. Kjo do t'u japë mundësi kooperativave bujqësore që të realizojnë masën e caktuar nga Plenumi i Nëntorit i KQ të vitit 1958 për bagëtitë kolektive, që ato do të kenë në vitin 1965, duke rritur në krahasim me gjendjen e sotme numrin e lopëve mbi 3 herë, të dhenve — 2 herë, të dosave më se 1,6 herë dhe të shpendëve — 7-8 herë.

Detyra të mëdha vihen para punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Ata duhet të përmirësojnë punën e tyre në mënyrë të gjithanshme, të shfrytëzojnë sa më mirë tokën dhe mjetet e tjera të shumta që u ka vënë shteti në dispozicion, të luftojnë për të marrë sa më shumë prodhime e me kosto sa më të ulët, të bëhen shembull prodhimtarie të lartë, përhapëse të

eksperiencës së përparuar dhe të sukseseve të shkencës në bujqësi.

Shokë,

Dëshiroj të ndalem, veçanërisht, në çështjen e kooperativave bujqësore. Ato sot pothuajse përbëjnë gjithë bujqësinë e vendit. Nga mbarëvajtja e tyre varet shumë plotësimi i detyrave që shtron plani për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe të blegtorisë dhe për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral. Në pesëvjeçarin e dytë Partia korri një fitore historike me përfundimin në përgjithësi të kolektivizimit të bujqësisë, por ne nuk mund të qetësohemi dhe të mendojmë se tani punët në bujqësi do të zgjidhen lehtë, pa përpjekje të mëdha e pa kokëçarje.

Ekonomitë e mëdha që janë krijuar, duhen drejtuar me nikoqirllëk të madh, që të bëhen ekonomi me të vërtetë të përparuara, ku të jenë zhvilluar të gjitha degët në mënyrë të harmonizuar. Kooperativat tona bujqësore janë shumë larg një niveli të tillë, prandaj, nëse gjatë pesëvjeçarit të dytë lufta e Partisë në fshat dhe e organeve shtetërore u përqëndrua në përfundimin e kolektivizimit të bujqësisë në përgjithësi, në pesëvjeçarin e tretë *detyra kryesore është forcimi ekonomiko-organizativ i kooperativave bujqësore që t'i bëjmë ato ekonomi të forta me rentabilitet të lartë.*

Kjo detyrë nuk është e thjeshtë dhe nuk zgjidhet as me vendime e dekrete, as me agjitacion e propagandë. Kjo kërkon që të studjohen me vëmendje gjendja e secilës kooperativë, kushtet dhe mundësitë që kanë për

të zhvilluar degët e ndryshme të ekonomisë, si dhe perspektivën e secilës prej tyre.

Të gjitha këto probleme të mëdha duhet të studjohen në mënyrë komplekse. Nuk mund të përcaktohet drejtimi i kooperativës ose zhvillimi i degëve të saj pa marrë parasysh kushtet e tokës dhe të klimës, krahët dhe mjetet e punës, leverdisshmërinë që ka zhvillimi i njërës apo i tjetrës degë etj. Zhvillimi në mënyrë të harmonizuar i degëve në kooperativat bujqësore duhet të shihet kurdoherë nën prizmin e leverdisshmërisë që ka kooperativa dhe të detyrave që i ngarkon plani i shtetit.

Duhet të tregohet një kujdes i posaçëm për kooperativat e zonave malore dhe gjysmëmalore. Deri sot ato kanë një zhvillim të njëanshëm. Anëtarët e tyre sigurojnë të ardhura të pakta edhe kur bëjnë shumë ditë-punë, megjithëse shpesh ndodh që krahët e punës nuk përdoren. Këtyre kooperativave duhet t'u jepet një ndihmë e veçantë, nga afër. Duhet të studjohet mirë çdo ekonomi dhe të përcaktohen jo vetëm degët që duhet të zhvillojë, por edhe llojet e kulturave që rriten më mirë dhe i sjellin të ardhura më të mëdha si kooperativës, ashtu edhe shtetit.

Krahas punës që duhet bërë për forcimin ekonomik-organizativ të kooperativave bujqësore, gjatë pesëvjeçarit të tretë organet shtetërore, sidomos ato të bujqësisë, dhe organizatat e Partisë në rrethe duhet të mbajnë kurdoherë parasysh zhvillimin perspektiv të fshatrave, të cilat duhet të jenë jo vetëm qendra ekonomike bujqësore, por dhe qendra me rëndësi banimi, qendra kulture dhe arsimit, që me të vërtetë të paraqitin fshatin e ri socialist.

Duke e parë nën këtë prizëm të ardhshmen e fshatit tonë, tani që kooperativat bujqësore dhe anëtarët e tyre, sidomos në zonat fushore, kanë të ardhura të mira për të bërë ndërtime, banesa etj., është e nevojshme që të gjitha këto investime të bëhen të studjuara, që të vlejné si bazë e fshatit të ardhshëm.

Puna që ka filluar për bashkimin e kooperativave të vogla në njësi më të mëdha, duhet të vazhdojë me kujdes edhe gjatë viteve të ardhshme. Sidomos në zonat fushore Partia duhet të punojë për bashkimin e kooperativave të vogla në një të vetme, por në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohen kooperativat me më tepër se 700 - 1 000 hektarë tokë. Kjo do ta bënte shumë të vështirë drejtimin dhe në vend që bashkimet të sillnin përfitime, do ta dëmtonin punën. Në zonat malore bashkimet duhet të bëhen shumë të matura, atje ku shihet e domosdoshme, kur kooperativat janë shumë të vogla dhe afër njëra-tjetrës.

Bashkimi i kooperativave të vogla ka rëndësi të madhe për të ardhshmen e bujqësisë, pse kështu krijohen mundësi për shfrytëzimin më të mirë të rezervave që ka ekonomia bujqësore, kombinohet më mirë zhvillimi i degëve të bujqësisë, përdoren më drejt investimet për zhvillimin e ekonomisë, bëhet një ndarje më e drejtë e forcave dhe e mjeteve të punës, kufizohen shpenzimet e shumta që bëjnë sot kooperativat e vogla bujqësore, si për aparatin administrativ, ashtu edhe për qëllime të tjera.

Për çdo rast, duhet parë mirë edhe kuadri që do të drejtojë kooperativën e zmadhuar. Në krye të ekonomive të bashkuara duhen vënë kadro të aftë, të zgje-

dhur, që kanë eksperiencë pune në parti ose në pushtet, si edhe nga ata që mësojnë në shkollat e larta ekonomike ose të Partisë. Ngritja dhe perfeksionimi i aftësive drejtuese të kuadrove ekzistues në kooperativat bujqësore mbeten edhe në të ardhshmen detyra të rëndësishme, që duhet të ndiqen nga organizata e Partisë dhe nga organet shtetërore.

Kushte të domosdoshme për mbarëvajtjen e kooperativave bujqësore janë: zbatimi i statutit, organizimi dhe shpërblimi i drejtë i punës, sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë të të gjithë kooperativistëve të aftë për punë në ekonominë e përbashkët. Tani që kemi grumbulluar eksperiencën e nevojshme, ka ardhur koha të futim më gjërë, por me kujdesin e duhur, disa forma të reja, më të perfeksionuara për organizimin, shpërblimin dhe për planifikimin e punës. Kështu, për shembull, caktimi i fondeve të ndryshme, sidomos ai i ndihmës shoqërore, si edhe ndarja e të ardhurave duhen bërë në mënyrë të tillë që të nxiten më shumë kooperativistët për shtimin e prodhimit bujqësor dhe për rritjen e pjesëmarrjes në punë. Në disa kooperativa, ku janë krijuar mundësitë, mund të fillojë gradualisht dhënia e pensioneve për ata anëtarë që janë të paaftë për punë, e lejeve shëndetësore, ndihma për nënat me shumë fëmijë etj. Minimumi i detyrueshëm i ditëve të punës duhet të caktohet jo vetëm për çdo vit, por për çdo muaj. Të organizohet më mirë ngritja e çerdheve, e kopshteve për fëmijë dhe e furrave kolektive, të rritet roli i përfaqësive, sidomos në kooperativat e zmadhuara, i brigadave, i kryesive dhe i komisioneve të revizionimit. Këto, si edhe çështje të tjera, duhet të studjohen mirë dhe të pasqyrohen siç

duhet në statutin tip dhe në atë të çdo kooperative. Krahas këtyre, duhet të studjohen me hollësi dhe të shtrohen në kongresin e ardhshëm të kooperativave bujqësore, që duhet të mbledhet brenda këtij viti, edhe disa forma të tjera shpërblimi, të cilat janë të zbatueshme në kushtet e ndryshme të çdo kooperative dhe të kuptueshme nga të gjithë.

Për të zgjidhur me sukses të gjitha problemet e forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore një rol të rëndësishëm luan kuadri drejtues. Pregatitja dhe kualifikimi i kuadrove të kooperativave bujqësore vazhdon të mbetet një nga detyrat më me rëndësi. Prandaj duhet forcuar edhe më tepër puna në shkollën e kooperativave bujqësore, në teknikumet bujqësore, në institutin bujqësor, si edhe në institucionet e tjera arsimore.

Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë në tërësi, dhe, veçanërisht, i disa degëve që qëndrojnë akoma prapa, siç janë, për shembull, blegtoria e frutikultura, është i lidhur ngushtë me një kompleks masash të rëndësishme, për të cilat detyrat në projektplanin e tretë pesëvjeçar janë përcaktuar drejt. *Punonjësit e bujqësisë dhe të Partisë duhet të mbajnë kurdoherë në qendrën e vëmendjes dhe ta bëjnë çështje të masave shfrytëzimitin e mirë të mekanikës bujqësore, përfundimin me kohë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e drejtë të veprave të bonifikimit, realizimin me sukses të planit të pyllëzimeve, ekonomizimin e lëndës së drurit dhe mbrojtjen e tokave nga erozioni.*

Partia ka zbatuar kurdoherë një politikë të drejtë marksiste-leniniste ndaj fshatarësisë. Këtë politikë ajo

do ta zbatojë me vendosmëri edhe në të ardhshmen. Gjatë pesëvjeçarit të tretë, përveç investimeve të mëdha që do të bëjë shteti për mekanizimin e bujqësisë, për kryerjen e veprave të bonifikimit dhe të ujitjes, fshatarësisë do t'i jepen edhe ndihma të ndryshme për zhvillimin e bujqësisë, sikurse janë krediti agrar, plehurat kimike, farërat e zgjedhura, fidanet frutore etj. që vlerësohen në miliarda lekë.

Detyra të mëdha shtrën pesëvjeçari i ri para punonjësve të grumbullimit. Duke u bazuar në planet e prodhimit, vëllimi i grumbullimeve rritet shumë. Kjo punë kërkon që organet e tregtisë dhe të grumbullimit të forcojnë edhe më shumë lidhjet e tyre me fshatin dhe të organizojnë më mirë punën për blerjen e prodhimeve të parashikuara në plan me anën e sistemit të kontraktimit.

Punonjësit e Partisë, pushtetit dhe të bujqësisë duhet të luftojnë me këmbëngulje për realizimin e detyrave që shtrohen para ekonomisë sonë bujqësore. Prapambetja që kemi trashëguar, vështirësitë e natyrës, shirat e tepërta që zakonisht këmbehen me periudha të gjata thatësire, si edhe kushtet e veçanta tokësore, na vënë përpara vështirësive të mëdha. Megjithëkëtë, klima e butë, ujërat e bollshme, mundësitë që kanë tokat tona për rritjen e pjellorisë, eksperiencia e gjerë që kemi fituar në luftën për ngritjen e nivelit të bujqësisë, gatishmëria dhe puna e palodhur e kuadrove dhe e gjithë punonjësve të bujqësisë, si edhe ndihma e vendeve socialiste janë garanci për plotësimin me sukses të detyrave që i shtrën Partia bujqësisë për të ardhshmen. Partia ka besim të plotë se organet e pushtetit, specia-

listët dhe të gjithë punonjësit e bujqësisë do të vënë të gjitha forcat dhe dijenitë e tyre për realizimin me sukses të detyrave të mëdha që shtrun para tyre ky Kongres.

3. — Detyrat e pesëvjeçarit të tretë për mirëqenien materiale të masave punonjëse

Të udhëhequr nga ligji themelor ekonomik i socializmit, në këtë pesëvjeçar, ne do të marrim masa të rëndësishme për të ngritur në një nivel më të lartë mirëqenien materiale dhe nivelin kulturor të masave punonjëse, për ta bërë jetën e popullit më të mirë, më të bukur dhe më të begatshme.

Mbi bazën e rritjes së vëllimit të prodhimit industrial dhe bujqësor, në fund të vitit 1965, kundrejt vitit 1960, të ardhurat kombëtare do të shtohen 56 për qind, në të njëjtën kohë paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve do të rritet 30 për qind dhe të ardhurat reale të fshatarësisë — 35 për qind. Ngritja e pagës reale është parashikuar të realizohet kryesisht nëpërmjet rritjes së pagës nominale dhe zbritjes së çmimeve të mallrave me pakicë. Pra, të ardhurat reale të punonjësve do të shtohen, do të rritet kështu fuqia e tyre blerëse. Në këto kushte *punonjësit e tregtisë shtetërore dhe kooperative gjenden përpara detyrave shumë të rëndësishme për të shpërndarë pa ndërprerje mallrat nga prodhuesi te konsumatori. Ata, duke njohur më thellë nevojat e popullit, duhet të nxitin më tej prodhimin industrial dhe bujqësor me cilësi gjithnjë më të lartë.*

Organet e Partisë dhe ato të ekonomisë duhet të punojnë më shumë për të ngritur nivelin e shërbimit, të teknikës dhe të kulturës tregtare, duke pasur parasysh se në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, qarkullimi i mallrave do të jetë 38 për qind më i madh. Nëpërmjet rrjetit të tregtisë do t'i shiten popullit më shumë: sheqer 126 për qind, yndyrna 68 për qind, mish 83 për qind, peshk 124 për qind, fasule 96 për qind, oriz 118 për qind, perime 40 për qind, patate 122 për qind, lëndë druri e sharruar 73 për qind, çimento 117 për qind, gozhdë 73 për qind, xhame 183 për qind, tekstile të pambukta 61 për qind, tekstile të leshta 53 për qind, këpucë dhe sandale 113 për qind etj. Një vëmendje më e madhe do t'i kushtohet zgjerimit të prodhimit e të tregtimit të materialeve të ndërtimit, të artikujve për fëmijë dhe të atyre që lehtësojnë punën e gruas. Gjatë planit të tretë pesëvjeçar organet e bujqësisë, të grumbullimit dhe të tregtisë duhet të sigurojnë plotësimin e nevojave të popullsisë me perime dhe me patate dhe të përballojnë më mirë kërkesat për mish dhe për qumësht.

Fitorja e socializmit në fshat kërkon që kooperativat e konsumit të gjallërohen si organizata ekonomike masash dhe në këtë mënyrë ato t'u shërbejnë në kohë anëtarëve dhe t'u plotësojnë më mirë kërkesat e tyre.

Partia i porosit punonjësit e tregtisë të jenë të gatshëm për të vënë në shërbim të popullit të gjitha aftësitë e tyre. Ka ardhur koha që punonjësit e tregtisë të zotërojnë më mirë zanatin dhe të perfeksionohen në punën e tyre. Duhet kuptuar mirë se tregtia jonë socialiste, ashtu sikurse ka thënë J. V. Stalini

«. . . është puna jonë, një punë që e kemi krijuar ne, një punë bolshevike, dhe se punonjësit e tregtisë, duke përfshirë këtu edhe shitësit e dyqaneve të vogla, kur punojnë ndershëmërisht, bëjnë punën tonë, revolucionare, bolshevike»¹.

Në këtë pesëvjeçar çështjet e tregtisë së jashtme marrin një rëndësi të posaçme. Punonjësit e këtij sektori vihen përpara detyrash të mëdha. Vëllimi i tregtisë së jashtme do të rritet rreth 65-70 për qind kundrejt pesëvjeçarit të dytë, nga i cili eksporti rreth 90-95 për qind dhe importi rreth 50-55 për qind. Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë lidhjet ekonomike e tregtare me vendet socialiste. Duke respektuar parimet e njohura të leverdisë reciproke dhe të mosndërrhyrjes në punët e brendshme, do të zhvillojmë shkëmbime tregtare me vende kapitaliste, që dëshirojnë të kenë marrëdhënie të tilla me shtetin tonë.

Mallrat e eksportit duhet të shtohen vazhdimisht si sasi dhe asortiment. Perspektiva të mëdha i hapen eksportimit të mineraleve, të cigareve dhe të duhanit, produkteve të industrisë ushqimore, konservave, verës, frutave dhe zarzavateve të freskëta. Prodhuesit tanë dhe organet e tregtisë së jashtme duhet të sigurojnë që këto prodhime të jenë të një cilësie të lartë. Ata duhet të punojnë për të ruajtur dhe për të përhapur më shumë markën e fabrikës dhe kjo duhet të bëhet një çështje nderi.

Pakësimi i importimeve duhet të preokupojë të gji-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 329-330.

thë punonjësit e vendit tonë. Me këtë punë duhet të merren më mirë të gjitha organet ekonomike shtetërore dhe të Partisë. Punonjësit e tregtisë së jashtme duhet të sigurojnë porositë, kontraktimin dhe ardhjen në kohën e duhur të artikujve të importit.

Gjatë viteve të planit të tretë pesëvjeçar ne parashikojmë të zgjerojmë edhe më shumë bazat turistike, pasi bukuritë e natyrës dhe kushtet klimatike na lejojnë.

Perspektiva të gjera hapen për ndërtimin dhe për zgjerimin e fondit të banesave gjatë planit të tretë pesëvjeçar. Për këtë qëllim do të shpenzohen rreth 6 miliard e 500 milion lekë ose 75 për qind më shumë sesa në periudhën e planit të dytë pesëvjeçar. Do të ndërtohen rreth 1 milion e 360 000 metra katrorë sipërfaqe banesash, të cilat përfaqësojnë afërsisht fondin e bancave sa për 5 qytete të reja si Vlora e sotme. Në duart e masave punonjëse është vënë një pasuri e madhe socialiste, që sa vete po rritet, prandaj është detyrë e të gjithëve ta mirëmbajmë dhe ta ruajmë si sytë e ballit.

Masa të rëndësishme do të merren për zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve komunale. Gjatë pesëvjeçarit të tretë do të ndërtohen ujësjellës të rinj dhe do të zgjerohet rrjeti ekzistues. Një zhvillim të madh do të marrë elektrifikimi i mëtejshëm i qyteteve dhe sidomos i fshatrave. Fonde të konsiderueshme do të shpenzohen për sistemimin dhe për zbukurimin e qyteteve dhe të qendrave të tjera të banuara. Pa dyshim, si deri më sot, populli ynë do të japë kontributin e vet për zgjidhjen e problemeve të shumta komunale. Organet e Partisë do të dinë t'i organizojnë drejt inisiativat e masave

në qytet e në fshat për të lulëzuar atdheun tonë të dashur.

Partia edhe në të ardhshmen do të tregojë një kujdes edhe më të madh për ruajtjen dhe për forcimin e shëndetit të popullit, për zgjatjen e jetës së njeriut. Për t'i shpënë më tej rezultatet e mira që janë arritur, është e nevojshme të forcohet kujdesi për përmirësimin e punës në të gjithë sektorët e shëndetësisë dhe në mënyrë të veçantë për higjienën dhe për profilaksinë, për përhapjen e edukatës sanitare në masat punonjëse. Në vitin 1965 do të kemi 6,5 shtretër për 1 000 banorë. Do të shtohet shumë personeli mjekësor dhe në fund të pesëvjeçarit do të kemi 1 mjek për çdo 1 600 banorë.

Zbatimi i këtij programi do të ngrejë jetesën e popullit tonë në një nivel më të lartë dhe do të krijojë kushtet për ta bërë jetën më të gëzueshme dhe më të këndshme në familjen e çdo punonjësi.

4. — Prgatitja e kuadrit dhe zhvillimi i arsimit, i kulturës e i shkencave në pesëvjeçarin e ardhshëm

Zhvillimi i gjithanshëm i vendit tonë në rrugën e ndërtimit të socializmit, përparimi i teknikës dhe i shkencës nxjerrin në plan të parë nevojën e rritjes së nivelit arsimor dhe kulturor të masave, nevojën e sigurimit të kuadrove për të gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës. Prandaj, problemi i kuadrit, prgatitja e tij me një ritëm më të shpejtë e në mënyrë proporcionale për të gjithë sektorët, zhvillimi i arsimit, përhapja e rrjetit të shkollave dhe forcimi i tyre, puna për ngrit-

jen arsimore-kulturore e ideoprofesionale të punonjëseve, janë nga çështjet më aktuale dhe më të rëndësishme që shtrohen sot para Partisë. Nga zgjidhja e tyre me sukses varet shumë realizimi i detyrave për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës jo vetëm për këtë pesëvjeçar, por edhe për të ardhshmen.

Pesëvjeçari i tretë do të shënojë një kthesë të rëndësishme për përgatitjen e kuadrit, sepse tani janë rritur mundësitë për të përballuar më mirë e më shpejt nevojat e mëdha në këtë drejtim.

Sipas planit të tretë pesëvjeçar, në vitin 1965 do të kemi 9 700 kuadro të lartë, kundrejt 4 245 që kemi tani dhe 35 100 kuadro të mesëm, kundrejt 20 000 që kemi tani. Do të përgatiten gjithashtu mbi 57 000 punëtorë të rinj të kualifikuar dhe në të njëjtën kohë do të ngrihen aftësitë e jo më pak se 115 000 punëtorëve specialistë.

Në përcaktimin e detyrave për përgatitjen e kuadrit Komiteti Qendror dhe Qeveria kanë pasur kujdes të ruajnë një proporcion të drejtë në mes të sektorëve të ekonomisë e të kulturës, duke mbajtur parasysh sektorët më të prapambetur, më jetikë në këtë periudhë, si edhe perspektivat e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm në të ardhshmen.

Kështu, për shembull, do të rritet shumë numri i inxhinierëve, nga 870 që kemi në 2 290. Ndërsa në vitin 1955 në industri e në miniera kishte një kuadër të mesëm e të lartë për 31 punëtorë, sot në miniera ka një të tillë për 13 punëtorë dhe në vitin 1965, me gjithë rritjen e klasës punëtore, do të ketë një për 5 punëtorë, kurse për çdo kuadër të lartë do të ketë 2-3 kuadro të mesëm.

Bujqësia do të ketë 1 150 agronomë nga 570 që ka sot. Në vitin 1965, në përgjithësi, do të arrihet që të kemi një agronom të lartë për çdo 600 hektarë, ndërsa sot kemi një për 1 200 hektarë dhe një teknik të mesëm bujqësor për çdo 330 hektarë, ndërsa sot kemi një për 650 hektarë.

Masa të rëndësishme janë parashikuar për përgatitjen e kualifikimin e kuadrit të shëndetësisë, të arsimit, të shkencave, të arteve dhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë e të kulturës.

Me gjithë këto ritme të larta në përgatitjen e kuadrit dhe në parashikimin në maksimum të mundësive tona, ne jemi akoma prapa, po të marrim parasysh nevojat e shumta që kemi për kuadro. Duhet pasur parasysh se, me gjithë masat që janë marrë, në vitin 1965 do të kemi pa plotësuar vendet e punës, ku kërkohet përgatitja me arsim të lartë e të mesëm për 11 235 kuadro, që është baras me 24 për qind të nevojave për kuadro.

Duhet shënuar se, me gjithë masat e veçanta që janë marrë, për arsye të deficiteve që janë krijuar, nuk ka qenë e mundur të arrihen normat që u caktuan për kuadrin e lartë në Plenumin e Komitetit Qendror të PPSH të Korrikut të vitit 1957 për kuadrin, sidomos për arsimin, mjekësinë etj. *Prandaj, realizimi i plotë, në përgjithësi e veç e veç për çdo sektor dhe rreth, i detyrave të planit të tretë pesëvjeçar për përgatitjen e kuadrit, është i domosdoshëm, është hallka më e rëndësishme për realizimin e planit në përgjithësi, për ngritjen e rendimentit në punë, për përvetësimin e teknikës dhe për organizimin e prodhimit.*

Zgjidhja e problemit të kuadrit, zbatimi i detyrave për përgatitjen e kualifikimin e tij kërkohet që me këtë punë të merret konkretisht e gjithë Partia dhe të gjitha organet shtetërore.

Kongresi III i Partisë tërhoqi vëmendjen e organizatave të Partisë dhe atyre shtetërore, që në punën për përgatitjen e kuadrit të kishin mirë parasysh disproporcionin midis nivelit të lartë të teknikës dhe nivelit të ulët të punëtorëve tanë. Me gjithë rezultatet e arritura, disproporcioni në këtë drejtim vazhdon të ekzistojë. Arsyeja kryesore është se organizatat e Partisë e drejtuesit e ndërmarrjeve kujdesen pak për ngritjen nga praktika të vetë punëtorit në detyrën e teknikut të mesëm dhe për kualifikimin, në radhë të parë, të atyre punëtorëve që luajnë rolin më vendimtar në procesin e punës e të prodhimit.

Është për t'u vënë në dukje se shkollat e rezervave të punës, si forma më e organizuar për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar, kanë mbetur prapa e përgatitin një numër të paktë punëtorësh të kualifikuar. Gjatë pesëvjeçarit të dytë në shkollat e rezervave të punës janë përgatitur çdo vit mesatarisht 5,5 për qind e punëtorëve të rinj të kualifikuar. Përgatitja e punëtorëve të rinj të kualifikuar duhet të organizohet në sistemin e shkollave të ulëta profesionale, siç do të quhen tani shkollat e rezervave të punës, ku duhet të zhvillohen programe që t'i përgjigjen konkretisht teknikës së re që po hyn në ekonominë tonë.

Për të ndihmuar për përgatitjen dhe për kualifikimin e kuadrit është e nevojshme të organizohet më mirë puna për propagandimin e njohurive mbi përpari-

min teknik, të kombinohet sa të jetë e mundur më shumë arsimi i përgjithshëm me atë të të rriturve e kualifikimin e tyre, të merren masa, veçanërisht, për riorganizimin e kurseve agroteknike me rininë fshatare, në mënyrë që t'u jepet atyre mundësi të fitojnë njohuritë e nevojshme për një teknikë të ulët bujqësore.

Partia ka theksuar gjithmonë se arsimi i mbrëmjes e me korrespondencë për të rriturit është një rezervë e madhe për përgatitjen e kuadrit dhe për ngritjen e aftësive të tij. Megjithëse në këtë drejtim janë arritur rezultate të kënaqshme dhe meritojnë të përgëzohen qindra e mijëra kuadro që kanë ngritur nivelin e tyre arsimor, pa u shkëputur nga puna, ju e kuptoni, shokë, se sa shumë përpjekje duhet të bëjmë akoma në këtë drejtim për t'iu përgjegjur më mirë ritmeve të zhvillimit të shpejtë të ekonomisë e të kulturës së vendit tonë.

Burimi për plotësimin e nevojave për punëtorë të kualifikuar dhe kuadro specialistë dhe për të ngritur në përgjithësi nivelin arsimor e kulturor të masave punonjëse është zhvillimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i arsimit popullor.

Në kompleksin e masave për shtrirjen e arsimit *hallka më e rëndësishme në pesëvjeçarin e tretë është zgjerimi i arsimit 7-vjeçar dhe më vonë 8-vjeçar*, i cili siguron kontingjentet e nevojshme për të gjitha kategoritë e tjera të shkollave. Në fund të pesëvjeçarit të tretë ne duhet të përfshijmë në klasën e pestë të shkollës 8-vjeçare 80 për qind të fëmijëve që mbarojnë shkollën fillore dhe të krijojmë kushtet që brenda

dhjetëvjeçarit të ardhshëm të realizojmë arsimin e përgjithshëm të detyrueshëm 8-vjeçar. Në arsimin e mesëm gati do të dyfishohet numri i nxënësve dhe do të venë 60 për qind e fëmijëve që mbarojnë shkollën 7-vjeçare. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet zgjerimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke hapur gjatë pesëvjeçarit të tretë 24 shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm, që do të shtrihen në të gjitha qendrat e rretheve, ndërmarrjet e mëdha industriale dhe qendrat e disa lokaliteteve me popullsi të madhe. Në bazë të këtyre masave do të krijohen mundësitë reale që të plotësohen më mirë nevojat e prodhimit me kuadro të mesëm dhe të rriten kontingjentet që përgatiten në shkollat e larta brenda e jashtë vendit. Në vitin 1965 numri i studentëve do të arrijë në 7 000, kundrejt 4 300 që është sot, pa përfshirë studentët e mbrëmjes e me korrespondencë.

Fakti që në vitin 1965 në vendin tonë do të kemi 410 000 nxënës, kundrejt 313 000 që kemi tani, domethënë afro një e katërta e popullsisë do të mësojë, dhe fakti që në të ardhshmen 80 për qind e popullsisë do të ketë arsim 7-8-vjeçar, flasin për atë revolucion të thellë kulturor që po bëhet në vendin tonë, nga populli ynë, jo vetëm trim, jo vetëm punëtor, por edhe arsimdashës e përparimtar.

Kongresi III i Partisë shtroi detyrë përmirësimin e punës mësimore-edukative në shkolla, kapërcimin e shkëputjes së shkollës nga jeta, futjen graduale të arsimit politeknik dhe edukimin e nxënësve me dashuri për punën. Realizimi i kësaj detyre kërkon ndryshime rrënjësore në sistemin arsimor. Siç e dini, disa kohë më

parë te ne u zhvillua një diskutim i përgjithshëm popullor mbi nevojën e riorganizimit të sistemit arsimor. Masat tona punonjëse, mësuesit dhe prindërit i aprovuan njëzëri tezat¹ e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Ministrave për riorganizimin e shkollës dhe me vërejtjet e propozimet e tyre ndihmuan për përcaktimin e drejtë të vendimeve që mori Plenumi² i Komitetit Qendror të PPSH për këtë çështje.

Pas Reformës Arsimore të vitit 1946, që demokratizoi thellësisht sistemin tonë arsimor dhe hapi rrugën për krijimin e shkollës së re socialiste, riorganizimi i sistemit tonë arsimor, i bazuar në parimin themelor marksist-leninist të lidhjes së mësimin me punën prodhuese, është hapi më i madh dhe më i rëndësishëm në lëmin e arsimit.

Siç vendosi Plenumi i Komitetit Qendror, riorganizimi i shkollës do të fillojë të zbatohet gradualisht nga viti shkollor 1963-1964. Por është e qartë se shkolla jonë që sot duhet të përgatitet dhe të fillojë të ecë në bazë të parimeve të rëndësishme të riorganizimit të përcaktuar nga Partia jonë. Zgjidhja e këtyre detyrave kërkon që të merren në kohën e duhur masat e nevojshme ekonomike, organizative dhe pedagogjike. Ministria e Arsimit që tani duhet të marrë masa për hartimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore, si edhe për përpunimin e dokumenteve dhe udhëzimeve të reja që do t'i nevojiten shkollës së riorganizuar. Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me njerëzit e prodhimit,

¹ «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. III, f. 321. Tiranë, 1970.

² Po aty, f. 410.

organet e arsimit dhe organizatat e Partisë duhet të mendojnë për sigurimin e frondeve të punës në prodhim për nxënësit, për sigurimin e personelit mësimor dhe teknik. Është e nevojshme që organet e arsimit, nën kujdesin e komiteteve të Partisë, të studjojnë me kujdes eksperiencën e grumbulluar nga shkollat eksperimentale dhe të marrin masat për përhapjen e kësaj eksperiencë.

Krahas me përgatitjen dhe me zbatimin e riorganizimit të shkollës një problem shumë i madh i ditës për ne është përmirësimi i cilësisë së mësimit, që shprehet në ngritjen e përparimit real të nxënësve. Përparimi i ulët i nxënësve në mësim është një problem tjetër i madh. Kjo gjendje në një farë shkalle, mund të shpjegohet me zgjerimin dhe me rritjen e vullshme të arsimit në vendin tonë, me një farë mbetje prapa të zhvillimit në thellësi dhe në cilësi të arsimit nga zhvillimi i tij në gjerësi dhe në sasi. Por shkaqet kryesore të tij duhen kërkuar në punën e shkollës, në punën e personelit mësimor. Problemin e ngritjes së përparimit të nxënësve në mësim mund dhe duhet ta zgjidhin, në radhë të parë, mësuesit. Partia dhe populli ynë i kanë rrethuar arsimtarët me kujdes dhe nderim të veçantë. Ata e çmojnë shumë punën fisnike që mësuesit kanë bërë dhe bëjnë për përhapjen e arsimit edhe në skajet më të largëta të vendit tonë për edukimin komunist të brezit të ri, për përhapjen e kulturës në masa. Por nga mësuesit tanë kërkohet një punë edhe më e madhe. Arsimtarët nuk duhet të harrojnë se çdo ditë, çdo orë edukojnë e përgatitin brezin tonë të ri, kanë në duart e tyre pothuaj një të pestën e popullsisë së vendit,

pajisjen e saj me kulturë. Ky mision i lartë fisnik i ndëron ata, por njëkohësisht i ngarkon me përgjegjësi para popullit dhe atdheut. Prandaj nga tribuna e këtij Kongresi ne u bëjmë thirrje edhe një herë arsimtarëve tanë që të mobilizohen në punë me të gjitha forcat për të ngritur nivelin e punës mësimore-educative, për të siguruar një përparim të lartë të nxënësve në mësim, për forcimin e mëtejshëm të shkollës sonë. Kjo detyrë nuk mund të zgjidhet menjëherë dhe vetvetiu. Zgjidhja e saj kërkon nga arsimtarët qëndrim edhe më këmbëngulës ndaj punës dhe më shumë përpjekje për ngritjen e tyre ideoprofesionale.

Në kompleksin e përgatitjes së kuadrit, në përgjithësi, përgatitja e kuadrit arsimor është një nga problemet më serioze dhe urgjente. Ky është në të vërtetë problemi kyç, hallka vendimtare për zgjidhjen e të gjitha detyrave kryesore në arsim. Gjatë pesëvjeçarit të tretë në arsim numri i mësuesve nga 11 000 që është sivjet do të arrijë në 17 000. Në sistemin e arsimit pedagogjik, gjatë pesëvjeçarit të tretë, do të kalojnë rreth 21 000 veta, kurse vetëm në institutet pedagogjike dyvjeçare do të kalojnë mbi 4 000 studentë. Një numër i madh arsimtarësh duhet të përgatitet, sidomos, për dhënien e mësimit të shkencave të natyrës, të matematikës, të fizikës, të kimisë, për dhënien e mësimit të punës dhe për dhënien e lëndëve të përgjithshme teknike. Vështirësia që paraqitet në sigurimin e kuadrit arsimor është e lidhur jo vetëm me numrin e tyre, por edhe me nivelin përkatës arsimor, sepse, siç dihet, ne jemi shumë prapa në këtë drejtim dhe veçanërisht në shkollat 7-vjeçare. Prandaj, në vitin 1965, numri i arsimtarëve me

arsim përkatës në shkollat e arsimit fillor do të arrijë në 90 për qind nga 50 për qind që është sot, në 7-vjeçarët nga 24 për qind që është sot — në 63 për qind dhe në shkollat e mesme nga 63 për qind — në 90 për qind. Numri i pedagogëve me arsim të lartë do të arrijë nga 1 000 që është sot, në më se 2 000, domethënë disa qindra më shumë se ç'kishte gjithsejt mësues në regjimet e kaluara.

Pregatitja, pra, e këtyre mijëra mësuesve të rinj dhe ngritja e nivelit arsimor në shkallën e duhur duhet të jetë një aksion i madh, jo vetëm për Ministrinë e Arsimit dhe organet e saj në bazë, por edhe për shtetin dhe Partinë, për organizatën e rinisë, të bashkimeve profesionale e të gruas.

Çështja e arsimit në shoqërinë tonë socialiste është një problem i përgjithshëm shtetëror dhe shoqëror, një çështje e përgjithshme popullore. Prandaj Partia duhet të krijojë në fushën e arsimit një front të përgjithshëm dhe unik përpjekjesh, ta bëjë arsimin problem të prindërve dhe të të gjithë shoqërisë.

Ndërtimi socialist i vendit tonë, zhvillimi i mëtejshëm i bazës materialo-teknike të prodhimit, zgjidhja e problemeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese dhe shpejtimi i ritmit të përgatitjes së kuadrove të lartë *kërkojnë një punë më të madhe e këmbëngulëse nga ana e kuadrove tanë të lartë dhe e të gjithë punonjësve shkencorë për të zgjeruar bazën e zhvillimit të shkencave në vendin tonë.*

Organizimi i Universitetit Shtetëror të Tiranës krijoi kushte edhe më të favorshme për ngritjen në një shkallë më të lartë të përgatitjes së kuadrove dhe për

zhvillimin e punimeve shkencore në fusha të gjera të diturive.

Por, me gjithë sukseset e arritura në fushën e kërkimeve shkencore, sidomos në këto vitet e fundit, zhvillimi i punës shkencore nuk është akoma në nivelin e nevojave të kohës dhe ecën me një ritëm të ngadalshëm në krahasim me kërkesat e ndërtimit të socializmit.

Për të kapërcyer këtë prapambetje dhe për ta zhvilluar më tej punën shkencore, në baza më të shëndosha, kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë aprovoi planin 10-15-vjeçar të kërkimeve shkencore në vendin tonë. Për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve shkencore shtrohet detyra që krahas zhvillimit të shkencave humanitare e bujqësore të zhvillohen me ritme më të shpejta shkencat natyrore e teknike, në mënyrë që të realizohet studimi i burimeve natyrore të vendit tonë dhe shfrytëzimi i tyre sa më i madh.

Në fushën e shkencave natyrore puna kërkimore duhet të orientohet në studimin kimik dhe fizik të mineraleve të dobishme të vendit dhe në shfrytëzimin e tyre praktik, në ligjësinë e vendosjes e të shpërndarjes së kromiteve, bakrit etj., në inventarizimin e bimëve të dobishme dhe të florës së Shqipërisë etj.

Puna e kërkimeve shkencore në fushën e shkencave teknike duhet të zhvillohet në studimin e rajonizimit e të tipizimit të ndërtimeve e të konstruksioneve prej betonarmeje, e burimeve hidroenergjetike të lumenjve, e modelimit të veprave hidroteknike dhe në studimin e elektrifikimit të vendit.

Zhvillimi i mëtejshëm i studimeve bujqësore duhet të përqëndrohet, në radhë të parë, si edhe deri tani, në

problemet e shtimit të drithërave, të ngritjes së rendimentit dhe të cilësisë së bimëve industriale, në problemet e frutikulturës, të bazës ushqimore si edhe në përmirësimin e racës së bagëtive etj.

Detyrë kryesore në fushën e shkencës mjekësore është studimi klinik i sëmundjeve të përhapura në vendin tonë, si edhe i masave për pakësimin ose për zhdukjen e tyre.

Në këtë fazë të zhvillimit të shkencave historiko-filologjike, detyrë e rëndësishme është studimi dhe thellimi i problemeve kyçe të historisë sonë, të gjuhës letrare shqipe, të historisë së letërsisë shqipe etj. Sikurse është theksuar edhe në vendime të ndryshme të Komitetit Qendror të Partisë, duhet të zgjerohet puna në fushën e historisë së kulturës materiale, sidomos në drejtim të kulturës ilire dhe të hershme shqiptare, të historisë së arteve, të mbrojtjes dhe të restaurimit të monumenteve.

Në fushën e shkencave ekonomike, juridike dhe të filozofisë puna kërkimore të përqëndrohet në problemet kryesore, si veçoritë e kalimit nga kapitalizmi në socializëm në Republikën Popullore të Shqipërisë, studimi i lindjes dhe i zhvillimit të shtetit dhe i së drejtës sonë socialiste, ligjësia e ndërtimit të shoqërisë socialiste në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Organizimi i punës shkencore mbi baza të shëndosha, duke bërë një punë të përqëndruar e duke organizuar studime komplekse, si edhe realizimi me sukses i detyrave të mëdha që shtrohen në fushat e shkencave për një të ardhshme 10-15-vjeçare, kërkon, në radhë të parë, përgatitjen e një kolektivi të gjerë punonjësish

shkencorë, sidomos në fushën e shkencave natyrore e teknike, dhe një punë me perspektivë për ngritjen dhe për organizimin në të ardhshmen të instituteve shkencore për degë të veçanta të shkencave, si bazë kryesore për zhvillimin me sukses të punës shkencore kërkimore. Duhet bërë përpjekje për kombinimin e mirë të të gjitha forcave shkencore me mjetet materiale që disponohen. Puna shkencore, që i shërben ndërtimit me ritme të shpejta të socializmit, duhet të përkrahët pa ngurrime nga ana e drejtuesve të dikastereve e të qendrave të prodhimit, duke e konsideruar si një detyrë të rëndësishme shtetërore, e cila është e lidhur organikisht me detyrat e tyre konkrete për ndërtimin e socializmit.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se njerëzit e shkencës, ashtu si të gjithë punonjësit e vendit tonë, do të vënë të gjitha forcat për ta çuar përpara punën shkencore, për të zgjidhur probleme të rëndësishme të prodhimit e të ndërtimit socialist të vendit. Ata në punën e tyre fisnike, si kurdoherë, do të kenë ndihmën dhe përkrahjen e pakursyer të Partisë dhe të pushtetit popullor, në mënyrë që të përparojë e të lulëzojë shkenca jonë e re socialiste.

Detyrat e mëdha ekonomike të planit të tretë pesëvjeçar, ritmet e shpejta të ndërtimit të socializmit kërkojnë të ngrihet në një shkallë më të lartë kultura e masave, me qëllim që të arrihet një mobilizim më i madh dhe më i ndërgjegjshëm i tyre në luftën për ndërtimin e socializmit. Forcimi ekonomik i shtetit tonë dhe ngritja e mirëqenies ekonomike e kulturore të masave kanë bërë të mundur që gjatë këtij pesëvjeçari të me-

rren masa të rëndësishme për t'iu përgjigjur kërkesave kulturore gjithnjë më të mëdha të punonjësve, duke u kujdesur që institucionet dhe veprimtaria kulturore të përfshijnë masat deri në skajet më të largëta të vendit tonë.

Puna kulturore, si në qytet ashtu edhe në fshat, e kombinuar me punën politike të Partisë dhe me detyrat konkrete të ndërtimit socialist, duhet të përfshijë në sferën e veprimtarisë së saj masat e gjera të punonjësve, t'i edukojë ato me frymën e ideologjisë së Partisë, të rritë entuziazmin politik dhe t'i mobilizojë në luftën për realizimin e detyrave të ndërtimit socialist të vendit. Një punë e gjallë kulturore duhet bërë veçanërisht kundër mentaliteteve të vjetra e zakoneve prapanike që ndrydhnin energjitë krijuese të masave dhe pengojnë punën e vrullshme të tyre për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës.

Në luftën për zhvillimin e kulturës, Partia duhet të mbështetet fuqimisht në inteligjencën tonë popullore, e cila është treguar kurdoherë në lartësinë e misionit të saj fisnik patriotik, ka dhënë prova të shumta aftësie, vetëmohimi dhe besnikërie për çështjen e madhe të popullit dhe të Partisë sonë, për çështjen e socializmit. Të inkurajohen me të gjitha format dhe mjetet inisiativat e shkëlqyera të intelektualëve tanë për t'u dhënë masa-ve dhe veçanërisht fshatit, më shumë kulturë, për ta nxjerrë atë sa më parë nga prapambetja dhe për ta futur në rrugën e gjerë të përparimit.

Nën udhëheqjen e Partisë, duhet, shokë, jo vetëm të punojmë për të çuar kulturën në masa, por të arrijmë që të zhvillohet një lëvizje popullore, kulturore e artis-

tike e paparë, me pjesëmarrjen e vetë masave të gjera për zhvillimin e traditave të mrekullueshme të krijimtarisë së popullit tonë të talentuar.

Në luftën për ndërtimin e socializmit, në këtë lëvizje të masave për zhvillimin e kulturës, një rol me rëndësi u takon punonjësve të artit dhe letrarëve të vendit.

Para letërsisë dhe arteve tona të realizmit socialist shtrohen detyra të reja dhe mjaft të rëndësishme. Ato duhet të militojnë më shumë dhe më mirë në luftën për edukimin e masave dhe për mobilizimin e tyre drejt fitoreve të reja në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Për të kryer me sukses këtë detyrë fisnike, në kushtet e sotme, kur niveli kulturor është ngritur dhe kur kërkesat estetike të popullit janë rritur, punonjësit krijues të këtij sektori të rëndësishëm ideologjik duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t'u lidhur më ngushtë me jetën e popullit, për ta njohur atë më thellë, për t'i studjuar nga pozitat e marksizëm-leninizmit proceset dhe transformimet e mëdha në jetën e klasës punëtore, të fshatarësisë dhe të inteligjencës sonë popullore. Kjo është një nga kërkesat kryesore që shtron para shkrimtarëve e artistëve koha, Partia dhe vetë zhvillimi i letërsisë dhe i arteve. Futja në gjirin e popullit është burimi kryesor i frymëzimit të vërtetë, është garancia më e madhe për sukseset e ardhshme të letërsisë dhe të arteve. Në punën e tyre krijuese, njerëzit e letërsisë e të arteve, do të kenë kurdoherë mbështetjen e Partisë dhe dritën e pashuar e jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit.

Partia ka besim se shkrimtarët, artistët, kompozi-

torët, piktorët, skulptorët, artistët e skenës do të punojnë e do të krijojnë edhe në të ardhshmen me atë frymëzim të lartë patriotik që i ka karakterizuar gjithmonë, do të çojnë përpara trashëgiminë e pavdekshëm të gjenisë krijuese të popullit, të bijve të tij të paharruar, Naimit, Migjenit e shumë të tjerëve, do të pasurojnë letërsinë e artet tona me vepra të kësaj periudhe të re të lavdishme të jetës së popullit tonë, që zënë një vend nderi në radhën e realizimeve të tjera ekonomiko-kulturore të Shqipërisë socialiste.

Shokë,

Perspektivat e shkëlqyera që i hapen vendit tonë me planin e tretë pesëvjeçar bazohen në politikën e drejtë ekonomike marksiste-leniniste që ka ndjekur vazhdimisht Partia jonë.

Detyrat e mëdha që i shtrojmë vetes janë rezultat i një studimi të thelluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë dhe shumë aktive të specialistëve tanë dhe të masave punonjëse. Ato janë matur shumë mirë, pra, janë edhe plotësisht të mundshme për t'u realizuar në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe ata socialë-kulturorë.

Garanci për këtë janë pasuritë e mëdha të nëntokës sonë, burimet e lëndëve djegëse dhe hidroenergjetike, prodhimet bujqësore, blegtorale, pyjore etj. Në vendin tonë janë krijuar kushte të favorshme, që lehtësojnë së tepërmi shfrytëzimin e këtyre pasurive të mëdha, sepse ne kemi ngritur industrinë e re moderne me teknologji të përparuar, kemi fuqizuar mekanikën bujqësore etj.

Ne kemi një popull të mrekullueshëm, të talentuar dhe plot entuziazëm, të bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë së tij.

Kuadrot tanë, të dalë nga gjiri i popullit, të farkëtuar në zjarrin e luftës dhe të punës ndërtimore, po përvetësojnë me të shpejtë teknikën dhe ne jemi të bindur se, si kurdoherë, ata do të zbatojnë me nder të gjitha porositë e Partisë.

Garanci për të gjitha fitoret është Partia jonë e lavdishme, forca udhëheqëse dhe mobilizuese e popullit tonë, është uniteti i pathyeshëm i Partisë, lidhjet e saj me masat, vija e drejtë që bazohet gjithnjë në shkencën ngadhjimtare të marksizëm-leninizmit.

Në emrin tuaj, në emër të të gjithë Partisë sonë, më lejoni t'i drejtohem klasës punëtore heroike, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencës popullore e t'u bëjmë thirrje: Përpara, gjithnjë përpara, për ta bërë atdheun tonë të dashur edhe më të bukur, edhe më të fuqishëm, edhe më të pasur, për të krijuar për fëmijët tanë, për brezat e ardhshëm një jetë më të begatshme dhe më të lumtur!

Një faktor i rëndësishëm është edhe ndihma internacionaliste dhe vëllazërore që do të na japin për plotësimin e nevojave të këtij pesëvjeçari vendet e kampit socialist — Bashkimi Sovjetik, Kina e madhe dhe vendet e tjera të demokracisë popullore.

Në emrin tuaj më lejoni që të falënderoj gjithashtu me gjithë zemër Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partinë Komuniste të Kinës dhe partitë e tjera komuniste dhe punëtore të vendeve të kampit të socializmit!

IV

MBI DISA PROBLEME TË FORCIMIT TË PARTISË

Shokë,

Faktori vendimtar i të gjitha sukseseve që kemi arritur dhe i atyre që do të arrijmë në të ardhshmen, është Partia jonë e Punës, roli i saj organizues e drejtues, politika e saj kurdoherë e drejtë. Mbarë populli ynë, të gjithë komunistët tanë krenohen me Partinë e tyre, sepse vetëm nën udhëheqjen e saj të urtë, largpamëse e të guximshme janë bërë e po bëhen realitet ëndrrat më të bukura të punonjësve tanë.

Lufta e madhe heroike, puna e palodhur e vetëmohuese e kalitën dhe e çelikosën Partinë tonë, e bënë atë trime e të pamposhtur, udhëheqëse të zonjën, që gëzon besimin e plotë të mbarë masave punonjëse të vendit tonë. Forca e Partisë sonë qëndron në besnikërinë e saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit, në unitetin e saj, në lidhjet e saj të pazgjidhshme me popullin që e lindi dhe e rriti. Si një trup i vetëm, është grumbulluar e gjithë Partia jonë rreth Komitetit Qendror të saj. Uniteti i çeliktë, kompaktësia e radhëve të Partisë kanë qenë dhe mbeten kurdoherë një nga karakteristikat dalluese të Partisë sonë të Punës. Kurdoherë, e në mënyrë të veçantë, në çastet më të rëndësishme të historisë së Partisë dhe të popullit tonë, është shfaqur me gjithë forcën e vet uniteti i pathyeshëm i gjithë Partisë

dhe mbarë popullit rreth saj, gatishmëria e të gjithëve për të zbatuar me vendosmëri dhe pa lëkundje vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Gjithë Partia e ka ruajtur si sytë e ballit unitetin e radhëve të saj, duke luftuar me të tëra forcat e pa më të voglin ngurrim kundër çdo armiku, që është őrvatur ta cenojë sado pak këtë unitet. Shumë e kujdesshme dhe e matur është treguar Partia jonë kundrejt atyre komunistëve që kanë gabuar dhe që kanë njohur gabimet e tyre. Por me armiqtë e marksizëm-leninizmit, me dezertorët dhe me përçarësit e unitetit ajo është treguar e ashpër dhe e pamëshirshme dhe e tillë ka për të qenë kurdoherë. Në unitetin qëndron forca jonë, në unitetin qëndron pathyeshmëria jonë, në unitetin qëndron garancia e të gjitha sukseseve tona.

Forcimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i Partisë është një nga detyrat tona kryesore, sepse Partia është forca drejtuese, organizuese dhe udhëheqëse e gjithë jetës së vendit tonë, sepse

«...te ajo, siç ka thënë i madhi Lenin, ne shohim mendjen, nderin dhe ndërgjegjen e epokës sonë»¹.

Revizionistët jugosllavë, që kanë ngritur një «teori» të tërë për dobësimin e rolit të partisë dhe «shuarjen» e saj në kushtet e ndërtimit të socializmit, synojnë pikërisht këtu, që të godasin zemrën, trurin, kokën e lëvizjes sonë. Fakti që imperialistët dhe shërbëtorët e

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 303.

tyre, revizionistët, kanë drejtuar goditjet e tyre kryesore kundër Partisë na bën edhe një herë të bindemi, se duhet akoma shumë e më shumë ta forcojmë Partinë, ta rritim rolin e saj drejtues dhe organizues.

Nga Kongresi III në Kongresin IV është forcuar mjaft puna organizative e Partisë. Në veprimtarinë e gjithanshme për zbatimin e detyrave që shtroi në këtë fushë Kongresi III i Partisë është rritur roli organizues i Partisë, është përmirësuar përbërja e saj, është ngritur niveli i organizatave-bazë të Partisë, është përmirësuar metoda e punës e të gjitha organeve të Partisë dhe janë gjallëruar e janë aktivizuar më mirë organizatat e masave. Këto kanë ndihmuar përgjithësisht për zgjidhjen me sukses të detyrave të rëndësishme që shtronte para popullit tonë plani i dytë pesëvjeçar.

Por kushtet e reja, detyrat madhështore, që shtron ky Kongres historik i Partisë sonë, kërkojnë të ngrihet edhe më lart niveli i punës organizative të Partisë.

Po ndalem në disa çështje kryesore:

1. — Përbërja e Partisë — tregues i rëndësishëm i forcës së saj

Detyrat që na ngarkoi Kongresi III për forcimin e përbërjes së Partisë janë realizuar në përgjithësi në mënyrë të kënaqshme. Tani, në efektivin e Partisë kemi 53 659 komunistë (50 802 anëtarë dhe 2 857 kandidatë për anëtarë partie) ose 5 015 më shumë se në Kongresin III.

Por ndryshimi nuk është kaq i madh në shtimin numerik sesa në treguesit cilësorë të përbërjes së Par-

tisë dhe kjo është kryesorja. Transformimet e mëdha në ekonominë e vendit tonë dhe ndryshimet rrënjësore që janë bërë në strukturën e klasave, e sidomos, rritja dhe kalitja e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, kanë bërë që edhe Partia të shtohet e të forcohet me elementë të shëndoshë, të dalë nga radhët e më të mirëve të këtyre klasave.

Duke e krahasuar gjendjen e sotme shoqërore të Partisë me atë që kishim në Kongresin III të Partisë, kemi këtë pasqyrë:

Nr.	Gjendja shoqërore	1.IV.1956	1.I.1961	Diferenca ±
1.	Punëtorë (të sektorëve shtetërorë dhe të kooperativave të artizanatit).	19,76%	29,66%	+ 9,90%
2.	Anëtarë të kooperativave bujqësore.	10,02%	23,62%	+ 13,60%
3.	Fshatarë individualë. . .	21,42%	3,15%	- 18,27%
4.	Nëpunës.	45,20%	41,94%	- 3,26%
5.	Të ndryshëm (nxënës, studentë, shtëpiake). . .	3,58%	1,62%	- 1,96%

Pra, në radhët e Partisë është rritur në mënyrë të dukshme numri i punëtorëve: nga 19,76 për qind të efektivit të Partisë që zinin në Kongresin III punëtorët e sektorëve shtetërorë dhe të kooperativave të artizanatit, tani ata zënë 29,66 për qind, me një shtesë prej 9,90 për qind, që mund të konsiderohet e kënaqshme.

Komiteti Qendror, duke e konsideruar përmirësimin e përbërjes së Partisë si një faktor shumë të rëndësishëm të forcës së saj, e ka drejtuar me kujdes vëmën-

djen në këtë drejtim, në radhë të parë, duke përmirësuar punën për pranimin e anëtarëve të rinj, duke bërë një shpërndarje më të drejtë të forcave të Partisë, si edhe duke punuar më mirë për edukimin dhe për kalitjen e efektivit.

Duke marrë parasysh ndryshimet e bëra në strukturën e klasave në vendin tonë me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, Komiteti Qendror i Partisë mendon se ka ardhur koha të rishikohen kërkesat që ekzistojnë në Statutin e Partisë për pranimin e anëtarëve të rinj në Parti në përshtatje me përbërjen e tyre shoqërore. Për periudhën që kaloi, këto kërkesa ishin krejt të domosdoshme, sepse edhe ato, bashkë me masat e tjera, ndihmonin për të bërë një politikë më të drejtë për pranimin në Parti. Por, ruajtja e këtyre kërkesave të diferencuara për kategoritë e ndryshme, edhe për kohën e sotme, kur kushtet kanë ndryshuar, do të ishte një anakronizëm pa vend.

Në kushtet e sotme nuk ka asnjë arsye përse bijtë e punëtorëve dhe të anëtarëve të kooperativave bujqësore, të cilët mbarojnë shkollat tona, bëhen intelektualë ose nëpunës në kohën e pushtetit popullor, të vihen në kushte më të vështira se të tjerët për pranimin në Parti. Prandaj i propozohet Kongresit që të anulohet paragrafët e Statutit që kanë të bëjnë me këtë çështje dhe të caktohet në Statut ky rregull i përgjithshëm për pranimin në Parti: *«Çdo njeri që kërkon të pranohet në Parti duhet të paraqitë rekomandimin e 3 anëtarëve të Partisë. të cilët të kenë stazh partie prej jo më pak se 3 vjetësh dhe ta njohin të rekomanduarin në punë të përbashkët të paktën një vit».*

Heqja e kërkesave të diferencuara, që kanë të bëjnë me rregullat për pranimin në Parti të punonjësve të ndryshëm, nuk do të thotë aspak se, që tani e tutje, Partia do të qëndrojë indiferente kundrejt përbërjes sociale të të pranuarve. Përkundrazi, si më përpara, ashtu dhe tani e në të ardhshmen Partia duhet të drejtojë e të udhëheqë me shumë kujdes pranimet në Parti, duke sjellë në radhët e saj elementë të shëndoshë, para së gjithash nga radhët e punëtorëve dhe pastaj nga anëtarët e kooperativave bujqësore, të përgatitur në të gjitha drejtimet e në gjendje të mbajnë me nder e të papërlyer titullin e anëtarit të Partisë. Prandaj del e nevojshme që për të ardhshmen orientimi i përgjithshëm për pranimet në Parti të jetë si vijon: *Shumicën dërrmuese të të pranuarve në Parti ta përbëjnë njerëzit e prodhimit (të qytetit e të fshatit), ndër ta vendin e parë ta zënë punëtorët, kryesisht punëtorët e industrisë, të minierave, të transportit dhe pastaj anëtarët e kooperativave bujqësore. Ndaj nëpunësve dhe ndaj shtresave të tjera të ketë kërkesa më të larta.*

Çështja e shtimit të rregullt të radhëve të Partisë është gjithashtu një problem shumë i rëndësishëm. Kjo kërkon një punë shumë të kujdesshme për edukimin dhe për aktivizimin e vazhdueshëm të masave, një punë të dendur individuale nga çdo komunist me njerëzit, një kujdes të vazhdueshëm nga çdo organizatë-bazë partie për ngritjen e rolit të anëtarëve të Partisë.

Në këto drejtime, me gjithë përmirësimet, bëhet akoma një punë e pamjaftueshme, gjë që duket posaçërisht nga pranimi i pakët i grave në Parti.

Për asnjë çast, nuk duhet harruar, ajo që vazhdi-

misht ka theksuar Partia, se burim i pashtershëm forcash të reja, të gjalla e të devotshme për çështjen e Partisë, duhet të konsiderohet organizata e rinisë. Të rinjtë dhe të rejat tona, të edukuara me kujdes nga Partia, qëndrojnë kudo në ballë të punës së madhe ndërtimore që zhvillohet në vendin tonë. Kudo rinia dallohet për vrullin dhe për entuziazmin e saj, për gatishmërinë dhe për vendosmërinë e saj, për mendjen e saj të nprehtë e krijuese. Ku ka pasur nevojë Partia dhe s'është hedhur me zjarr e guxim rinia jonë heroike? Ku e ka thirrur Partia e s'është ngritur në këmbë e tërë rinia jonë e mrekullueshme? Një rini e tillë është vepër e kudhrës së Partisë. Por edhe Partia te një rini e tillë ka garancinë e plotë për të nesërmen e saj, sepse në radhët e rinisë pregatiten vazhdues të denjë të revolucionit, të socializmit dhe të komunizmit, që do ta mbajnë kurdoherë lart e të papërlyer flamurin e lavdishëm të Partisë sonë heroike.

2. — Problemi kryesor sot në çështjet organizative të Partisë është forcimi i rolit dhe ngritja e nivelit të punës së organizatave-bazë të Partisë

Duke vlerësuar gjithnjë drejt rolin e organizatave-bazë si themelin e Partisë, Komiteti Qendror i Partisë dhe komitetet e Partisë të rretheve edhe gjatë kësaj kohe kanë treguar një kujdes të madh për forcimin e gjithanshëm të punës së tyre. Tani kudo ndihet forca e organizatave-bazë të Partisë dhe roli i tyre për zgjidhjen e të gjitha detyrave. Në bazë të porosive të Kongresit III

është përmirësuar shtrirja dhe shpërndarja e forcave të Partisë. Tani në të gjithë sektorët kemi 3 336 organizatave-bazë partie, ose 188 më tepër dhe 6 082 komunistë në prodhim më shumë se në Kongresin III të Partisë. *Kështu mund të themi se sot shtrirja dhe shpërndarja e forcave të Partisë u përgjigjet plotësisht detyrave që kemi.* Ky fakt dhe ndihma e vazhdueshme e Komitetit Qendror dhe e komiteteve të Partisë në rrethe e në qytete, si edhe lufta për realizimin e vijës së Partisë e kanë ngritur edhe më shumë nivelin e punës së organizatave-bazë të Partisë.

Por, duke marrë parasysh detyrat e mëdha që shtrohen para nesh, del nevoja të përmirësohet edhe më shumë puna e organizatave-bazë të Partisë, të rriten aftësitë e tyre.

Pikësëpari, duhet të përmirësojmë edhe më shumë punën e organizatave-bazë të Partisë në ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativiste për drejtimin e prodhimit. Tani për çdo organizatë-bazë që punon në prodhim janë krijuar kushte të reja, si me kërkesat e reja, që shtrohen për përmirësimin e gjithë treguesve cilësorë të prodhimit, ashtu edhe me zgjerimin e me zhvillimin e madh të kooperativave bujqësore. Prandaj, këto organizata duhet të bëjnë një punë më të thelluar e konkrete, që të mund të influencojnë efektivisht në shtimin dhe në përmirësimin e prodhimit. Puna në këtë drejtim ka filluar mirë. Kjo punë duhet vazhduar e duhet çuar deri në fund. Këtu vëmendja e Partisë duhet të përqëndrohet në tri drejtime kryesore: të tërhiqet mendimi kolektiv i Partisë, bile dhe i masave pa parti, për të gjetur pikat e dobëta në punën e ndërmarrjes apo të koopera-

tivës dhe rrugët për zhdukjen e tyre; të organizohet si duhet puna me njerëzit, të sqarohen të gjithë për detyrat e tyre, të punohet për rritjen e aftësive tekniko-profesionale të tyre, për përvetësimin e eksperiencës së përparuar etj.; të sigurohet një kontroll më i efektshëm nga ana e organizatave-bazë të Partisë mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes.

Duke vënë para përgjegjësisë administratat e ndërmarrjeve për dobësitë që vihen re, duke mos i lënë ato të pajtohen me të metat e me mungesat dhe duke mobilizuar si duhet masat për kapërcimin e këtyre vështirësive, do të sigurohet realizimi me sukses i të gjitha detyrave të planit. Natyrisht, këtu duhet pasur kujdes që të mos spostohen e të mos zëvendësohen organet ekonomike e të pushtetit nga organizatat-bazë të Partisë, gjë që do të ishte shumë e dëmshme si për punën, ashtu edhe për kuadröt, por ato të vihen mirë para përgjegjësisë për detyrat që u takojnë, të ndihmohen dhe të kontrollohen vazhdimisht për zbatimin e tyre.

Kushti më i rëndësishëm për forcimin e kontrollit të organizatës-bazë mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes dhe përgjithësisht për rritjen e rolit udhëheqës të Partisë në prodhim, është të shtohet më shumë interesimi i të gjithë komunistëve për fatin e punëve në ndërmarrje, për realizimin e të gjitha detyrave.

Një kujdes më i madh duhet treguar gjithashtu edhe për përmirësimin e punës së organizatave-bazë të Partisë në administratat shtetërore e në institucionet kulturore, arsimore dhe shkencore. Në këto organizata militon një numër i madh komunistësh, nga puna e të cilëve varet shumë edhe puna e bazës. Duhet thënë se shpesh-

herë mungesat që influencojnë për mosrealizimin e detyrave të planit nga ndërmarrjet e ndryshme, janë të lidhura edhe me dobësitë e aparatit qendror në punën për të drejtuar dhe për të ndihmuar bazën. Prandaj duhet punuar që të rritet roli i organizatave të Partisë të këtij aparati për përmirësimin në përgjithësi të punës së tij. Në këtë drejtim, organizatat-bazë që punojnë në dikasteret dhe në institucionet e tjera qendrore, si edhe ato të komiteteve ekzekutive e të administratave të tjera në shkallë rrethi, duhet ta zgjerojnë më shumë sferën e çështjeve, me të cilat merren, duke synuar kryesisht në luftën kundër burokratizmit, në forcimin e punës operative drejtuese për një ndihmë më të madhe e më të efektshme bazës.

Në punën për ngritjen e përgjithshme të rolit të organizatave-bazë dhe të nivelit të tyre duhet t'i jepet gjithashtu rëndësi e dorës së parë forcimit të jetës së brendshme të Partisë. Zhvillimi i jetës së brendshme të shëndoshë në Parti duhet të shërbejë për të kalitur komunistët, për t'i spastruar e për t'i zhveshur ata nga të metat, nga mbeturinat e nga mentalitetet e shtresave prej nga vijnë, si edhe për të forcuar në ta virtytet e larta të moralit komunist. Kudhra e Partisë duhet të kalitë të tillë njerëz që gëzojnë besimin dhe dashurinë e madhe të të gjithë punonjësve, me të cilët jetojnë e punojnë.

Në këtë drejtim ne duhet t'i japim rëndësi të dorës së parë diskutimit të mirë e kurdoherë parimor të çështjeve që shtrohen në organizatat-bazë dhe sidomos zhvillimit të kritikës dhe të autokritikës.

Një problem shumë serioz për organizatat e Partisë është edhe forcimi i vigjilencës revolucionare. Ne kemi

një eksperiencë të pasur në luftën kundër armiqve, qofshin këta brenda radhëve të Partisë, qofshin jashtë radhëve të saj. Në mënyrë të veçantë ne kemi bërë një luftë konsekuente, parimore, të drejtë kundër revizionizmit jugosllav. Në luftë me armiqtë është forcuar Partia jonë, janë kalitur anëtarët e saj. Por armiqtë nuk e kanë pushuar veprimtarinë e tyre kundër Partisë dhe vendit tonë, ashtu si edhe kundër kampit socialist e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Dhe s'ka dyshim se ata do ta vazhdojnë këtë luftë derisa të kenë jetë. Prandaj, në këtë çështje, nuk na lejohet asnjë iluzion oportunist. Ruajtja e Partisë nga elementët armiq është, në radhë të parë, detyrë e çdo komunisti, ashtu si edhe lufta kundër çdo armiku të Republikës është detyrë e çdo komunisti dhe e çdo patrioti të vendit tonë. Prandaj duhet ta ngremë më lart vigjilencën e komunistëve, vigjilencën e popullit. Ne jemi të fortë dhe forcohemi dita-ditës, por kjo nuk na lejon aspak që të mbyllim sytë, të flemë mbi dafina. Eksperienca na mëson se çdo dobësim, sado i vogël, i vigjilencës sonë është një plus për armikun.

3. — Të përmirësojmë edhe më shumë metodën e punës së komiteteve të Partisë

Kongresi III i Partisë vuri detyrën që të vazhdohet lufta kundër metodave burokratike, kundër drejtimit nga zyra, me letra e me vendime dhe të forcohet puna e gjallë me bazën, me njerëzit. Dhe në këtë drejtim, gjatë periudhës në shqyrtim, janë shënuar mjaft përpime. S'ka dyshim se sukseset e arritura në vendin tonë

që nga Kongresi III i Partisë e këtej janë rezultat në një masë të rëndësishme edhe i përmirësimit të metodës së punës, drejtimit më të mirë nga ana e të gjitha organeve të Partisë. Masa me shumë rëndësi, që ndihmuan për një drejtim më operativ, për një ndihmë më të afërt dhe më të kualifikuar për bazën, për një lidhje më të shëndoshë të punës politike e organizative të Partisë me detyrat ekonomike, ishin masat e marra nga Komiteti Qendror si ndarja e re administrative, prishja e qarqeve dhe krijimi i rretheve, zgjerimi i kompetencave dhe forcimi i rretheve me kuadro, si edhe organizimi i aparateve të Partisë pranë komiteteve të rretheve.

Një kujdes i veçantë për përmirësimin e metodës së punës së Partisë gjatë kësaj periudhe i është kushtuar kryesisht rritjes së rolit të komiteteve të Partisë për drejtimin e përgjithshëm dhe posaçërisht për një drejtim më të mirë të ekonomisë. *Periudha që na ndan nga Kongresi III mund të konsiderohet me plot të drejtë si periudhë e një rritjeje të dukshme cilësore në punën e plenumeve dhe byrove të komiteteve të Partisë.* Në këtë drejtim kanë influencuar, nga njëra anë, ndihma e vazhdueshme dhe e gjithanshme që ka dhënë Komiteti Qendror i Partisë dhe, nga ana tjetër, përmirësimi i përbërjes dhe i nivelit arsimor e tekniko-profesional të anëtarëve të plenumeve. Tani, në plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve marrin pjesë shumë më tepër njerëz të prodhimit sesa në periudhën e Kongresit III dhe konkretisht 53 për qind më shumë punëtorë dhe 82 për qind më shumë anëtarë të kooperativave bujqësore, ndërsa niveli arsimor i tyre është rritur në mënyrë të dukshme. Numri i anëtarëve të plenumeve me arsim

të lartë e të lartë të pambaruar, në krahasim me vitin 1956 është rritur 528 për qind, me shkollë të mesme — 96 për qind e me 7-vjeçare — 70 për qind. Kjo gjendje, natyrisht, pasqyrohet dhe në byrotë e komiteteve të Partisë. Me shumë rëndësi është fakti që pothuaj të gjithë sekretarët e parë të komiteteve të Partisë, diku edhe sekretarët e tjerë, kanë mbaruar shkollë të lartë partie.

Edhe në aparatet e Partisë, në këto vite është shënuar një përmirësim i dukshëm përsa i përket ngritjes së nivelit arsimor të kuadrove. Në krahasim me vitin 1956 ne kemi sot këto ndryshime:

Në aparatet e Komitetit Qendror, ku kishim me shkollë të lartë e të mesme 41,4 për qind të punonjësve, sot kemi 83,3 për qind, ndër ta 57,4 për qind me arsim të lartë. Në aparatet e komiteteve të Partisë të rretheve, ku kishim me arsim të lartë e të mesëm rreth 9 për qind të punonjësve, sot kemi mbi 38 për qind. Sipas vendimeve që janë marrë në fund të vitit 1965 në aparatet e Komitetit Qendror do të kemi rreth 80-90 për qind të të gjithë punonjësve me shkollë të lartë, ndërsa në aparatet e rretheve rreth 20 për qind me shkollë të lartë dhe 80 për qind me shkollë të mesme. Këto të dhëna, përsa i përket nivelit arsimor të kuadrove të aparateve të Partisë, flasin vetë, jo vetëm për punën e madhe që është bërë në këtë drejtim, por edhe për ngritjen e nivelit të punës së komiteteve të Partisë dhe të aparateve të tyre.

Por puna e drejtimit në përgjithësi dhe veçanërisht drejtimi i mirë e si duhet i ekonomisë nga komitetet e Partisë është një detyrë e përhershme dhe një çështje që kërkon dhe do të kërkojë kujdes të vazhdueshëm. Pra, ku duhet ta përqëndrojmë kryesisht vëmendjen tonë?

Së pari, duhet që plenumet dhe byrotë e komiteteve të Partisë në mbledhjet e tyre të merren kryesisht me çështjet më të rëndësishme që preokupojnë sektorët e ndryshëm të punës në rreth, me çështjet themelore, sidomos të punës ideologjike, politike dhe organizative të Partisë, si edhe me problemet vendimtare të prodhimit, duke braktisur gjërat e vogla praktike, për të cilat duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë e t'i zgjidhin organet dhe kuadrot e ngarkuar për to. Kjo kërkon, nga njëra anë, rritjen e kujdesit kolektiv të udhëheqjes së Partisë në rreth për zgjidhjen e çështjeve kyç të të gjithë sektorëve të jetës, përpunimin e masave konkrete lidhur me mbarëvajtjen e punës kudo. Nga ana tjetër, kjo kërkon rritjen e përgjegjësisë personale, të inisiativës së organeve dhe të kuadrove përgjegjës për punën e ngarkuar dhe tok me to forcimin e kontrollit për zbatimin e mirë, me kohë e drejt të të gjitha detyrave.

Së dyti, duhet që organet e Partisë dhe aparatet e tyre të braktisin punën burokratike dhe të forcojnë lidhjet me organizatat-bazë, me komunistët, me masat. Forcimi i lidhjeve, dhe veçanërisht i ndihmës që duhet t'i jepet bazës, mbetet edhe për të ardhshmen një detyrë e dorës së parë. Në këtë drejtim kemi akoma dobësi. Shumë shokë vazhdojnë të kalojnë «fluturimthi» në bazë. «Vizita» të tilla për të hedhur një sy të përgjithshëm mbi punimet dhe për të dhënë udhëzime po të përgjithshme, në këmbë, nuk japin rezultatet e duhura. Për të dhënë ndihmë të efektshme, sot duhet të hyhet thellë në proceset e prodhimit, duhet biseduar me njerëzit, duhen rrahur mendimet në organizatë dhe, mbi të gjitha, duhet të mësohen njerëzit si të punojnë. E kjo s'bëhet:

as nga makina, as duke qëndruar një ose dy orë në kooperativë apo në ndërmarrje.

Ndihma më e mirë, që mund t'i jepet bazës dhe përgjithësisht çdo sektori, është organizimi i një kontrolli sistematik, të shpeshtë dhe të kualifikuar. Ky ndihmon si për vetë zbatimin e vendimeve, sepse bën që ato të mos lihen në harresë, por të mbahen kurdoherë parasysh, ashtu edhe për vetë kuadrot, sepse i paralajmëron ato për mossukseset, i shkund nga plogshitia, u tërheq vëmendjen me kohë për të metat.

Së treti, duhet të forcohet edhe më shumë drejtira dhe roli i sekretarëve të komitetit të Partisë në zonën, për të cilën përgjigjen, duke mbajtur gjithashtu në nivelin e duhur edhe përgjegjësinë si pjesëtarë të udhëheqjes kolegjiale të Partisë. Në praktikë vihen re të meta në të dy drejtimet. Diku i kushtohet kujdes vetëm anës funksionale të detyrave dhe lihet pas dore puna në zonë për të ndihmuar instruktorët dhe organizatat-bazë për të gjitha problemet. Diku ngjet e kundërta. Organizimi i ri, siç e ka treguar edhe eksperiencia deri sot, në përgjithësi, mund të themi, është më i përshtatshmi për kushtet e tanishme, sepse i përgjigjet më mirë kërkesës kryesore të kohës: rritjes së ndihmës për bazën dhe forcimit të përgjegjësisë në aparatit e komitetit të Partisë. Por çështja e kombinimit të drejtë të përgjegjësisë funksionale me atë zonale përbën një nga pikat e dobëta të tij. ku kërkohet të tregohet kujdes i veçantë. Komiteti Qendror i Partisë, duke vendosur në komitetet e Partisë përgjegjësinë e sekretarit për një zonë të caktuar, u nis nga qëllimi që t'i sigurohej bazës një ndihmë më e afërt dhe më e kualifikuar. Këtë lindnin për sekretarin

e komitetit të Partisë dy detyra kryesore. E para, të ndihmoheshin vazhdimisht e nga afër instruktorët e zonës së tij. Instruktori është bërë tanimë figura qendrore e aparatit të Partisë, ai është edukator i organizatave-bazë të Partisë dhe jo vetëm i organizatave-bazë të Partisë, por edhe i këshillit të fshatit, i organizatave të masave, i drejtuesve të ekonomisë etj. Prandaj, që të mund të mësojë të tjerët, ai duhet të mësojë vazhdimisht për vete. Pra, sekretarët e komiteteve të Partisë duhet ta konsiderojnë si një nga detyrat e tyre me rëndësi ndihmën për të rritur horizontin dhe për të ngritur aftësitë e instruktorëve të komiteteve të Partisë. E dyta, të ndihmoheshin nga afër organizatat-bazë të Partisë për organizimin më të mirë të punës në përgjithësi.

Por krahas me kryerjen e mirë të kësaj detyre duhet të ndiqen, gjithashtu, në shkallë rrethi edhe detyrat e sektorit funksional, duhet ndër, gjithashtu, edhe përgjegjësia për gjithë punën në rreth. Prandaj, edhe në këtë drejtim duhet të gjenden forma e metoda pune që të sigurojnë si ndjekjen e detyrave, ashtu edhe zbatimin e tyre me sukses.

4. — Të rritim kujdesin e organeve dhe të organizatave të Partisë si edhe të organeve shtetërore për edukimin e kuadrove të rinj

Duke vënë në jetë porositë e Kongresit III të Partisë, si edhe detyrat që shtroi Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH i Korrikut 1957 për punën me kuadrin, janë shënuar edhe në këtë drejtim përparime të duk-

shme. Tanimë politika e kuadrit është plotësisht në duart e Partisë dhe të gjitha organet e organizatat e Partisë e kanë rritur përgjegjësinë e tyre për këtë problem kaq të rëndësishëm.

Nën kujdesin e Partisë janë rritur dhe kanë përparuar shumë kuadrot tanë. Ne me të drejtë mund të krenohemi jo vetëm me numrin, por edhe me cilësitë e larta të kuadrove tanë, që janë përgatitur e janë kalitur në këtë periudhë të shkurtër.

Zgjidhja e problemit të kuadrit përbën një nga hallkat më të rëndësishme për realizimin e detyrave që kemi përpara. Dhe këtë detyrë kaq të madhe është e aftë ta zgjidhë vetëm Partia. Prandaj, edhe në të ardhshmen organet dhe organizatat e Partisë duhet të rritin kujdesin, të merren vazhdimisht dhe rregullisht me punën e kuadrit. Duhet të forcohet kontrolli mbi tërë politikën e kuadrit, duke zbatuar plotësisht udhëzimet dhe vendimet e Partisë. Organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë sa herë që shqyrtojnë probleme të ndryshme, të shohin cilët janë njerëzit që do të kryejnë këtë ose atë detyrë, sa të aftë e sa të ndërgjegjshëm janë ata, të marrin masa në këtë drejtim dhe jo të mendojnë që, së herë u dalin pengesa në punë, të shtojnë organikat ose të kërkojnë t'u dërgohen kuadro nga lart. Të lidhet më mirë puna për kontrollin e zbatimit të vendimeve me punën e kuadrit. Kontrolli ynë është, mbi të gjitha, ndihmë dhe kjo u jepet njerëzve e, në radhë të parë, kuadrove.

Vëmendja kryesore e komiteteve të Partisë duhet të përqëndrohet në këto drejtime:

Së pari, një detyrë shumë e rëndësishme e punës

së Partisë me kuadrot është edukimi komunist i tyre, edukimi i tyre me idetë fitimtare të marksizëm-leninizmit, me vijën e Partisë sonë të lavdishme, me cilësitë më të mira të moralit komunist. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur dhe luan Shkolla e Partisë «V. I. Lenin», si edhe format e tjera të edukimit marksist-leninist që kemi në Parti. Që nga themelimi i Shkollës së Partisë e deri tani kanë mësuar dhe vazhdojnë të mësojnë 2 850 kuadro të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave, të ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shkolla e Partisë «V. I. Lenin» është institucioni më i lartë arsimor që ka Partia jonë dhe ajo i ka kryer e po i kryen me nder detyrat që i ka ngarkuar Komiteti Qendror i Partisë.

Edhe në të ardhshmen ne duhet ta përmirësojmë më shumë punën në Shkollën e Partisë. Të ngrihet niveli i dhënies së mësimit e, veçanërisht, i lëndëve të marksizëm-leninizmit dhe të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, duke shtuar kërkesat për studimin e veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit. Të përmirësohet, gjithashtu, puna për studimin më të thellë të çështjeve të drejtimit të ekonomisë dhe të sektorëve të tjerë nga ana e Partisë, si edhe të çështjeve të ekonomisë konkrete dhe të bujqësisë.

Së dyti, të rritim kujdesin e Partisë për shkollat dhe për kurset. Të forcohet roli i organizatave-bazë të Partisë në to, si për vijimin e përparimin, ashtu edhe për edukimin komunist të nxënësve dhe të pedagogëve. Nga ana e organizatave-bazë të Partisë dhe e komiteteve të Partisë në rrethe duhet të përmirësohet puna për zgjedhjen e njerëzve që dërgohen në shkolla dhe në kurse,

duke mbajtur parasysh besimin politik, cilësitë personale të kandidatëve dhe nevojat që kemi. Nga ana tjetër, të luftohet për të ruajtur kontingjentet në të gjithë sistemin e përgatitjes së kuadrove, në të gjitha shkollat ku deficitet gjatë pesëvjeçarit të dytë nuk kanë qenë të vogla. Prandaj, duhet të rritet kujdesi i organizatave të Partisë dhe i organeve të pushtetit, për të plotësuar e për të tejkaluar kontingjentet e planifikuara për të gjitha shkollat dhe kurset, veçanërisht me të reja nga fshati, sidomos nga zonat e Veriut.

Së treti, duhet të zgjerojmë dhe të përmirësojmë punën tonë në të gjitha format e arsimit për të rriturit pa shkëputje nga puna. Deri tani kanë mbaruar shkollat e mbrëmjes e me korrespondencë, që nga fillorja deri te të lartat, 20 140 veta. Por duhet thënë se ne nuk e shfrytëzojmë akoma mirë këtë rezervë të rëndësishme për përgatitjen e kuadrove. Duhet kuptuar mirë, si nga organizatat e Partisë dhe nga ato të masave, si nga organet shtetërore dhe nga vetë kuadrot se kjo ka një rëndësi shumë të madhe, jo vetëm sepse kjo rrugë është më pak e kushtueshme, por edhe sepse kuadrot që kemi, të cilët kanë fituar një eksperiencë kaq të gjatë në punë, duhet të marrin edhe arsimin përkatës për vendet që mbajnë, në bazë të vendimeve të Partisë, për t'u bërë më të aftë për realizimin e detyrave që u janë ngarkuar.

Siç jeni në dijeni, Komiteti Qendror i Partisë ka caktuar nivelin arsimor që duhet të kenë kuadrot deri në fund të vitit 1965 për poste e sektorë të caktuar. Kjo detyrë nuk mund të plotësohet vetëm me kontingjentet që dalin nga shkollat e rregullta. Nga ana tjetër, Komiteti Qendror ka caktuar detyra për arsimin që duhet të

kenë deri në fund të vitit 1965 jo vetëm kuadrot, por edhe komunistët në përgjithësi. Është vendosur që komunistët e fshatit duhet të kenë, si minimum të domosdoshëm shkollën fillore, kurse ata të qytetit shkollën 7-vjeçare. Kjo është e lidhur me ngritjen e mëtejshme të rolit të komunistëve. S'ka dyshim se edhe në këtë drejtim ne kemi mjaft përparime në krahasim me gjendjen që kishim në Kongresin III të Partisë. Nga 27,8 për qind që zinin atëherë komunistët me arsim 7-vjeçar e lart në efektivin e Partisë, tani ata zënë 43,5 për qind. Por akoma ky nivel nuk mund të konsiderohet i kënaqshëm dhe këtë gjendje duhet ta kalojmë, në radhë të parë, duke bërë që të ndiqen më në rregull shkollat e mbrëmjes e me korrespondencë e duke e vënë këtë çështje nën kontrollin e drejtpërdrejtë të organizatave-bazë të Partisë. Vetë kuadrot dhe komunistët duhet ta kuptojnë marrjen e arsimit përkatës si një detyrë të rëndësishme ndaj vetes dhe ndaj Partisë.

Së katërti, ashtu si deri tani, një shkollë e madhe për përgatitjen e kuadrove të rinj është vetë jeta, praktika, lufta për realizimin e vijës së Partisë. Në këtë drejtim ne kemi një eksperiencë të pasur, e cila duhet të shfrytëzohet sa më mirë. Në veprat e mëdha që do të ndërtohen gjatë këtij pesëvjeçari të gjithë kuadrot dhe punëtorët, që do të punojnë në to, duhet të kalojnë një shkollë të vërtetë. Aty duhet të përgatitim kuadro, jo vetëm për t'i ndërtuar e për t'i shfrytëzuar këto vepra, por edhe për sektorë të tjerë.

Në radhët e klasës punëtore kemi shumë punëtorë të përparuar të kategorive të larta, që e zotërojnë mirë zanatin me praktikë. Këtyre njerëzve, duke i vënë pranë

inxhinierëve e teknikëve, nëpërmjet formave të shkur-tëra, t'u japim edhe teorinë e t'i bëjmë teknikë të me-sëm. Por ne duhet të ngremë, si edhe deri tani, nga radhët e klasës punëtore, nga njerëzit e prodhimit në përgjithësi, edhe kuadro drejtues në të gjitha organet e Partisë, të pushtetit dhe të organizatave të masave. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe praktike dhe pari-more, sepse është e lidhur me përmirësimin e përbërjes shoqërore të kuadrove tanë. Këtë çështje nuk e shtrojmë për herë të parë, këtë e ka pasur gjithnjë parasysh Par-tia jonë dhe rezultate kemi pasur mjaft. Por tani janë krijuar kushte më të favorshme për të siguruar rezul-tate edhe më të mira, sepse tani kemi një klasë punëtore të mrekullueshme, më të madhe në numër, me stazh të gjatë pune, me nivel shumë më të lartë, kemi punëtorë të pararojës që me shpikjet, me racionalizimet dhe me iniciativat e tyre të përparuara, i kanë sjellë përfitime të mëdha ekonomisë popullore.

Komiteti Qendror i Partisë, siç jeni në dijeni, gjatë kësaj kohe ka marrë një sërë masash të rëndësishme për edukimin dhe për ngritjen e grave në përgjegjësi. Sot nuk ka sektor ku të mos marrin pjesë gratë dhe kudo ato po punojnë mirë e me ndërgjegje. Edhe përsa i përket nivelit arsimor, sidomos vajzat, nuk mbeten shumë prapa shokëve të tyre. Prandaj ekzistojnë mundë-sitë që tani e tutje të punohet më mirë e më me kuj-des për plotësimin e radhëve të kuadrove me gra, për ngritjen e tyre në përgjegjësi.

Duke i hedhur një sy politikës së kuadrit, duhet të themi se del nevoja ta përmirësojmë edhe më shu-më punën tonë për ngritjen e kuadrove të rinj drejtues.

Pa dyshim, edhe deri tani është bërë shumë në këtë drejtim, sidomos për kuadrin specialist, teknik. Me shumë kurajë ne u kemi besuar kuadrove të rinj detyra të rëndësishme dhe faktet kanë treguar se ata e kanë merituar këtë besim. Por, në punën për rritjen e kuadrit drejtues, veçanërisht në disa rrethe e sektorë, ka një farë ngurrimi dhe në zgjedhjen e në vendosjen e kuadrit nuk mendohet me perspektivë. Vihet vërdallë rreth disa kuadrove të njohur dhe në disa raste bëhet një vlerësim jo i drejtë i kuadrit, duke u marrë për bazë, pothuajse vetëm e kaluara e tij, dhe me të kaluarën kuptohet në shumë raste vetëm periudha e Luftës Nacionalçlirimtare. Pa dyshim, në jetën e popullit tonë kjo periudhë është shumë e rëndësishme dhe nuk mund të mos mbahet parasysh në vlerësimin e kuadrit. Por s'duhet harruar në asnjë mënyrë edhe qëndrimi i mbajtur prej tij gjatë këtyre 16 vjetëve pas Çlirimit. Kjo periudhë, posaçërisht në kushtet që ka kaluar vendi ynë, ka qenë gjithashtu shumë e rëndësishme për të provuar besnikërinë e kuadrit ndaj Partisë dhe popullit, ndaj marksizëm-leninizmit. Prandaj, krahas punës për avancimin e kuadrove të vjetër, të punohet njëkohësisht për të ngritur me guxim kuadro të rinj, besnikë ndaj çështjes së popullit dhe të Partisë.

Një pengesë serioze për avancimin dhe për pregatitjen e kuadrove është edhe puna pa perspektivë që bëhet disa herë. Duke u nisur nga kërkesat e çastit dhe nga interesat e ngushta të sektorit, nuk mendohet seriozisht për vendosjen e kuadrit dhe bëhen lëvizje të tepërta e pa vend. Ne kemi ndryshime të dukshme në këtë drejtim, në krahasim me kohën para Kongresit III të

Partisë, por është e nevojshme të themi se duhet bërë një luftë më e vendosur kundër lëvizjeve të tepërta, sepse sa më shumë shkojmë përpara, sa më shumë specializohen sektorët e punës, aq më të dëmshme bëhen lëvizjet e pastudjuara, veçanërisht ato jashtë sektorit të punës. Po kështu është e nevojshme që veçanërisht dikasteret dhe organet ekonomike të heqin dorë nga formalizmi në përgatitjen e kuadrove dhe të bëjnë një punë më me perspektivë. Kjo do të thotë që jo vetëm të kenë planet përkatëse, të studjuara mirë, por të caktojnë e të ndjekin me kujdes të gjitha format e punës për përgatitjen e kuadrit, të ndjekin vetë kuadrot si në punë, ashtu dhe në kurse apo në shkolla. Këto çështje të zënë një vend të rëndësishëm në tematikën e problemeve që shqyrtohen dhe në praktikën e punës të të gjitha organeve dhe organizatave të Partisë dhe të shtetit, e veçanërisht të kuadrove kryesorë.

5. — Të forcojmë punën e Partisë për rritjen e mëtejshme të rolit të organizatave të masave

Duke punuar për zbatimin e detyrave që shtroi Kongresi III i Partisë, të gjitha organizatat e masave, gjatë kësaj kohe, e kanë ngritur mjaft nivelin e punës së tyre.

Bashkimet profesionale, të udhëhequra nga Partia, kanë bërë përmirësime të dukshme në punën e tyre për tërheqjen e masës së punëtorëve, inxhinierëve, teknikëve e nëpunësve në zgjidhjen me sukses dhe me entuziazëm të problemeve të prodhimit, në luftën për

rritjen e rendimentit të punës, uljen e kostos, shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për shtimin e prodhimit dhe për zhvillimin e mëtejshëm të inisiativës dhe të veprimtarisë krijuese të klasës punëtore. Në mënyrë të dukshme është rritur gjatë kësaj kohe edhe kujdesi i organizatave profesionale për ngritjen e nivelit politik, kulturor e tekniko-profesional, si edhe për përmirësimin e kushteve të punës e të jetës të masës së punëtorëve.

Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Partisë, ka zhvilluar gjatë kësaj kohe një punë më të mirë e më të efektshme për edukimin komunist të rinisë, ka zgjeruar format dhe ka përmirësuar përmbajtjen e gjithë punës në këtë drejtim, duke kontribuar kështu shumë për përgatitjen e njeriut të ri të shoqërisë sonë socialiste, duke e bërë rininë tonë një forcë të madhe e të gatshme kudo dhe kurdoherë për të plotësuar detyrat që i ngarkon Partia.

Organizata e gruas, e udhëhequr nga Partia, zbatoi me sukses detyrën e rëndësishme të tërheqjes së masës së grave të qytetit e të fshatit në prodhim. Tani ajo po lufton gjithashtu mirë për rritjen e nivelit kulturor e profesional të grave, për ngritjen e tyre në vende me përgjegjësi. Bashkimi i Grave të Shqipërisë është dalluar për kujdesin që të njohë dhe të studjojë nga afër problemet e veçanta të gruas dhe në përshtatje me to të praktikojë forma pune dhe veprimtari interesante.

Fronti Demokratik ka dhënë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm për edukimin politik dhe patriotik të popullit, si edhe për mobilizimin e tij në disa aksione ekonomike të interesit të përgjithshëm.

Por puna me masat, lidhja e rregullt dhe e orga-

nizuar e Partisë me to, është një nga çështjet kryesore, detyrë e përhershme për ne, prandaj edhe në të ardhshmen duhet ta forcojmë edhe më shumë punën e organizatave të masave, si edhe punën e Partisë me to.

Në radhë të parë, duhet të kujdesemi që organizatat e masave të kryejnë si duhet funksionin e tyre, si «leva», si «rripa transmisioni», që lidhin Partinë me masat. Në këtë kuptim, këto organizata, jo vetëm duhet të shpicien në masat vijën e Partisë e t'i mobilizojnë ato për zbatimin e përpiktë të saj, gjë që tani bëhet më mirë dhe që duhet bërë edhe më mirë në të ardhshmen, por edhe të bien në Parti vazhdimisht e rregullisht mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e masës, të ushqejnë Partinë me zërin dhe me kërkesat e masës, gjë që i jep më shumë mundësi Partisë të drejtojë më mirë, të mbajë vazhdimisht parasysh kërkesat e masave dhe të kontrollojë edhe vetë drejtësinë e vendimeve të marra.

«... ne mund të qeverisim vetëm atëherë, ka thënë Lenini, kur shprehim drejt atë që ndien populli»¹.

Edukimi i masave është një nga detyrat kryesore të Partisë. Duke marrë parasysh nivelin dhe kërkesat e ndryshme të çdo shtrese të popullsisë së vendit tonë, si edhe problemet e detyrat konkrete që qëndrojnë para tyre, duhet që edhe puna edukuese e Partisë me to të bëhet e diferencuar.

Me gjithë punën e madhe që është bërë deri tani

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 336.

për edukimin e klasës punëtore, duhet që edhe në të ardhshmen të forcojmë kujdesin tonë në këtë drejtim. Bashkimet profesionale janë shkolla e komunizmit, pra ndaj ato duhet ta forcojnë më tej punën për ngritjen ideopolitike të punëtorëve, për rritjen e ndërgjegjes së tyre, për përvetësimin e teknikës. Vëmendjen tonë kryesore për edukimin e klasës punëtore duhet ta përqëndrojmë në edukimin e saj me qëndrimin socialist ndaj punës dhe ndaj pronës shoqërore, me frymën e kolektivizmit, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke, me shpirtin e novatorizmit dhe të papajtueshmërisë me çdo gjë të vjetër, me kuptimin e drejtë të interesave personale dhe shoqërore, të normave komuniste të sjelljes në jetë dhe në shoqëri. Në masat e fshatit puna jonë duhet të synojë në edukimin e njerëzve me disiplinën socialiste në punë, kundër dembelizmit, me një qëndrim të drejtë ndaj ekonomisë kolektive si baza e jetës dhe e së ardhshmes së fshatarit, me botëkuptimin e drejtë shkencor, kundër paragjyqimeve, besimeve të kota e zakoneve të dëmshme, me ndjenjën e së resë kundër konservatorizmit, për një jetë më të kulturuar në fshat. Rininë duhet ta edukojmë me normat e moralit komunist, me qëndrimin e papajtueshëm ndaj shfaqjeve të ideologjisë borgjeze, ta bëjmë që të zgjerojë dijet e saj politike e tekniko-profesionale, të ushqehet vazhdimisht me traditat e lavdishme të popullit tonë dhe me heroizmin e ditëve të sotme, të edukohet me qëndrimin socialist ndaj punës e ndaj pronës shoqërore, me dashurinë për atdheun dhe me besimin e patundur në triumfin e çështjes së socializmit dhe të komunizmit. Në masat e grave duhet të luftohet më mirë kundër fanatizmit dhe

zakoneve prapanike, kundër nënvleftësimit të forcave të tyre, kundër disa qëndrimeve të padrejta që mbahen disa herë ndaj tyre nga ana e burrave, që çojnë në shkeljen e të drejtave të tyre dhe i pengojnë ato për të marrë pjesë sa më gjallërisht në gjithë jetën e vendit. Nga ana tjetër, duhet forcuar puna për ngritjen e ndërgjegjes dhe të nivelit kulturor e profesional të grave, me qëllim që ato vetë, dhe sidomos të rejat, të luftojnë më mirë për të drejtat dhe për vendin që u takon në shoqëri.

Një problem tjetër me rëndësi ku Partia duhet të përqëndrojë vëmendjen e organizatave të masave, për të ardhshmen, sidomos të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë dhe të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, është çështja e zbulimit, e studimit dhe e përhapjes së eksperiencës së përparuar në prodhim.

Në kushtet tona, kur punonjësit e dinë dhe e ndiejnë se punojnë për veten e tyre, për lumturinë e fëmijëve të tyre, lindin mjaft inisiativa të reja, që kanë për qëllim organizimin më të mirë të punës në prodhim, shfrytëzimin më të mirë të kohës së punës, rritjen e prodhimit, uljen e kostos, me një fjalë, zhvillimin me ritme më të shpejta të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Çështja është të dish t'i kapësh që sapo lindin këto lëvizje, t'i përkrahësh, t'u hapësh rrugën që të gjejnë zhvillim të plotë dhe të ndihmosh për zbatimin e tyre, kudo që ekzistojnë kushtet.

Në këtë drejtim bashkimet profesionale dhe organizatat e rinisë duhet ta ndihmojnë shumë Partinë. Gjatë periudhës midis dy kongreseve, mund të themi, se është bërë një punë e mirë përse u përket përkrahjes

dhe përhapjes, deri diku të gjerë, të lëvizjeve të reja, shumë të rëndësishme, siç janë: ajo e brigadave të punës socialiste, lëvizja «1 + 2» për edukimin e kuadrit, lëvizja e kohëve të fundit për realizimin e normave nga çdo punëtor, e realizimit dhe e tejkalimit të 300 ditë-punë në kooperativat bujqësore etj. Duhet të lavdërohen posaçërisht organizatat e Partisë e të bashkimeve profesionale në qytetin e Tiranës dhe të Shkodrës për ndërmarrjet ekonomike dhe organizatat e Partisë e të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë në Lushnjë e në Fier për fshatin, të cilat kanë bërë një punë më të mirë për studimin, për përkrahjen dhe për përhapjen e iniciativave të reja. Por duhet thënë se në këtë drejtim jemi akoma në fillimin e një pune të mirë.

Shpeshherë konsiderohet si eksperiencë përparimtare e rëndësishme e që duhet përkrahur e përhapur ajo e disa njerëzve të dalluar në tërë Republikën, të cilët kanë arritur rezultate rekord. S'ka dyshim se shembulli i heronjve të punës socialiste duhet t'i frymëzojë mbarë punonjësit e vendit tonë. Treguesit e arritur prej tyre në realizimin e detyrave të planit duhet të bindin çdo punonjës për atë se ç'është në gjendje të japë puna e tyre. Por eksperiencën përparimtare nuk duhet ta kërkojmë vetëm në punën e këtyre pak njerëzve të shkëlqyer. Në çdo ndërmarrje e në çdo kooperativë, në çdo brigadë e në çdo skuadër ka punëtorë që realizojnë me sukses e që tejkalojnë detyrat e ngarkuara, që organizojnë mirë punën, shfrytëzojnë kohën si duhet, nxjerrin prodhime të cilësisë së lartë dhe kursejnë shumë. T'i bëjmë të gjithë njerëzit e skuadrës apo të brigadës të punojnë si këta, të ngremë në nivelin e më të mirëve

në reparte apo në skuadër gjithë masën e punonjësve — kjo është një rezervë jashtëzakonisht e madhe për realizimin e planeve tona.

Më në fund, në punën me organizatat e masave duhet të na preokupojë, çështja e gjallërimit të jetës së tyre të brendshme, kryesisht rritja e ndjenjës së përgjegjësisë të çdo anëtar i këtyre organizatave për mbarrëvajtjen e punëve të përgjithshme. Në këtë drejtim rëndësi të dorës së parë ka krijimi nga çdo organizatë i një rrjeti të gjerë aktivistësh, njerëzish të gjallë, të ndërgjegjshëm e të papërluar për të kryer detyra shoqërore. Lufta për kryerjen e detyrave shoqërore rrit ndërgjegjen politike të njerëzve, i bën ata patriotë të flaktë të vendit të tyre, luftëtarë të paepur për çështjen e Partisë. Prandaj, duhet të tregohet shumë kujdes për t'i ngarkuar aktivistët me detyra konkrete si dhe për edukimin e vazhdueshëm të tyre.

6. — Forcimi i mëtejshëm i pushtetit popullor — kusht i domosdoshëm për realizimin me sukses të të gjitha detyrave që qëndrojnë para nesh

Vendosja e pushtetit popullor është fitorja më e madhe që ka korrur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Pushteti popullor e bëri popullin tonë zot të fateve të tij. Duke u bazuar kurdoherë në mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, Partia jonë ka punuar me të gjitha fuqitë për forcimin, për përsosjen dhe për demokratizimin e mëtejshëm të pushtetit popullor, për ta bërë këtë një armë gjithnjë e më të efektshme, si për

përforcimin e fitoreve të arritura, ashtu edhe për ta çuar gjithnjë më përpara ndërtimin socialist të vendit.

Bashkë me rritjen dhe me zhvillimin e përgjithshëm të vendit tonë, është rritur e përsosur edhe shteti ynë i demokracisë popullore, si formë e diktaturës së proletariatit. Si rezultat i ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, i vendosjes së marrëdhënieve socialiste, si në qytet ashtu dhe në fshat, i likuidimit të klasave antagoniste, i rritjes së klasës punëtore dhe përgjithësisht i rritjes së ndërgjegjes të të gjitha masave punonjëse të vendit tonë, është forcuar dhe është zgjeruar shumë baza socialiste e diktaturës së proletariatit. Këto, pa dyshim, kanë bërë që të zhvillohen, në përshtatje me kushtet e reja, edhe detyrat e funksionet kryesore të brendshme të shtetit tonë.

Forcimi e zhvillimi i mëtejshëm dhe i shpejtë i ekonomisë socialiste dhe ngritja e nivelit material e kulturor të masave punonjëse qëndrojnë në vargun e detyrave të shtetit. Në këtë drejtim duhet të rritet si aftësia, ashtu edhe përgjegjësia e organeve të pushtetit, që nga lart deri poshtë, për zgjidhjen me kohë dhe drejt të problemeve që lindin në këtë fushë të veprimtarisë. Këtu gjen shprehje funksioni kryesor ekonomiko-organizues dhe kulturor-edukues i shtetit tonë.

Detyra tjetër, po aq e rëndësishme, e shtetit tonë është mbrojtja e fitoreve të arritura, kundër çdo përpjekjeje të armiqve të jashtëm e të brendshëm. Këtu shteti ynë kryen funksionet e tij të shtypjes së veprimtarisë armiqësore dhe të mbrojtjes së atdheut. Edhe në të ardhshmen këto funksione mbeten si funksione shumë të rëndësishme të shtetit tonë, ndërsa funksioni i shtyp-

jes, në të ardhshmen do të vijë duke e ngushtuar sferën e veprimit të tij, sepse, nga njëra anë, klasat shfrytëzuese u likuiduan dhe, nga ana tjetër, zhvillimi i ekonomisë e i kulturës, ngritja e vazhdueshme e mirëqenies së masave punonjëse dhe puna e madhe politiko-edukuese e Partisë pakëson vazhdimisht kriminalitetin. Funkzioni i shtypjes ruhet edhe për faktin se rreth vendit tonë ekzistojnë armiq të tërbuar, imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, të cilët bëjnë çmos për të zhdukur ose të paktën për të dëmtuar Republikën Popullore të Shqipërisë. Bile, faktet flasin se në vendin tonë në periudhën e tanishme veprimtaria kryesore armiqësore zhvillohet në formën e spiunazhit apo të diversionit, e drejtuar kryesisht nga imperialistët dhe këlyshët e tyre. Partia e ka pasur gjithnjë parasysh këtë funksion të rëndësishëm të shtetit tonë, si edhe faktin që ne e ndërtojmë socializmin të rrethuar gjeografikisht nga armiq të tërbuar. Prandaj ne i kemi kushtuar një kujdes të veçantë forcimit të organeve të diktaturës dhe, duhet të themi, se këto organe, nën udhëheqjen e Partisë, i kanë kryer shumë mirë e me sukses funksionet që u janë ngarkuar. Të gjitha përpjekjet e armiqve, që nga themelimi i shtetit tonë të demokracisë popullore e deri sot, në çdo formë që janë bërë nga të gjithë armiqtë e jashtëm e të brendshëm, janë zbuluar me kohë dhe janë goditur e janë shpartalluar, ashtu siç e kanë merituar.

Forcat tona të armatosura, ushtria jonë trime, nën udhëheqjen e vazhdueshme të Partisë, është forcuar e është modernizuar dhe është plotësisht e aftë për të mbrojtur Republikën Popullore të Shqipërisë, fitoret e

popullit tonë. Ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe gjeneralët tanë, plotësisht të ndërgjegjshëm për të kryer detyrat e tyre ndaj atdheut dhe ndaj socializmit, janë bërë mjeshtra në përdorimin e të gjitha llojeve të armëve nga më modernet që disponojmë.

Organet e Sigurimit të Shtetit dhe të Policisë Popullore, nën udhëheqjen dhe nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, janë forcuar dhe janë rritur kualitativisht në shkallën e nevojshme për të kryer detyrat e caktuara. Të karakterizuara nga fryma e partishmërisë dhe gjithnjë vigjilente, ato kanë dërrmuar të gjitha përpjekjet e armiqve dhe të elementëve të tjerë keqbërës. Ato janë bërë tmerr për armiqtë dhe një armë shumë e dashur për popullin, i cili i përkrah dhe i ndihmon në gjithë veprimtarinë e tyre.

Kufijtë tanë janë bërë të pakapërcyeshëm, ata ruhen dhe mbrohen me heroizëm e krenari nga kufitarët tanë trima në bashkëpunim të ngushtë me popullin. Forcat e kufirit, sipas mësimëve të Partisë e nën kujdesin e saj të vazhdueshëm, të edukuara me patriotizmin e flaktë dhe me frymën e internacionalizmit proletar, i kanë kryer kurdoherë me nder detyrat për ruajtjen e kufijve të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Partia jonë edhe në të ardhshmen do të vazhdojë të rritë kujdesin për të forcuar organet e diktaturës. Ne duhet të forcojmë edhe më shumë forcat tona të armatosura, ushtrinë tonë trime. Të modernizojmë dhe të përsosim të gjitha llojet e armëve. Ministria e Mbrojtjes Popullore, të gjithë komandantët, organet politike dhe organizatat e Partisë në ushtri duhet të punojnë me të gjitha forcat për të përsosur artin ushtarak, për të forcuar punën

politiko-edukuese dhe gjithë punën e Partisë në ushtri, të shtojnë dijet e trupave dhe të shtabeve, të bëhen që të gjithë mjeshtra të vërtetë të armëve të tyre.

Të forcojmë punën e Partisë në organet e punëve të brendshme (sigurim — polici — kufij), të rritim aftësitë e tyre profesionale, të mprehim gjithnjë e më shumë vigjilencën e tyre revolucionare, në mënyrë që ato të jenë kurdoherë gati e në lartësinë e detyrave që u janë ngarkuar. Të forcojmë gjithnjë e më shumë lidhjet e këtyre organeve me popullin.

Detyrat që kemi përpara kërkojnë që të forcohet edhe më shumë puna e organeve qendrore të pushtetit dhe të aparateve të tyre. Ka ardhur koha për të shtuar kërkesat ndaj aparateve qendrore, për një punë me cilësi më të mirë, për një studim më të thellë e me kohë të gjërave dhe për një ndihmë më të efektshme për bazën, si për ndërmarrjet vartëse, ashtu edhe për komitetet ekzekutive të këshillave popullorë. Aparatet qendrore duhet të shkëputen nga gjërat e vogla e të përditshme, të luftojnë vendosmërisht kundër zgjidhjes burokratike të çështjeve, të merren më seriozisht me planifikimin e furnizimin e drejtë, me kontrollin për treguesit kryesorë dhe të zgjidhin drejt e shpejt kërkesat dhe propozimet e bazës që janë të lidhura me prodhimin.

Baza e pushtetit tonë popullor janë këshillat popullore, duke filluar që nga ato të fshatit, të lagjeve në qytet e deri te rrethi. Si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe pas Çlirimit, këshillat tona i kanë kryer kurdoherë me nder detyrat që u janë ngarkuar. Nëpërmjet këshillave popullore ne kemi siguruar gjithnjë një pjesëmarrje aktive dhe të gjerë të masave në çështjet e push-

tetit. Tani këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive të tyre, u kanë hyrë më thellë si çështjeve të prodhimit, ashtu edhe problemeve sociale-kulturore.

Zgjerimi i sektorit socialist të ekonomisë, si në qytet, ashtu edhe në fshat, ka rritur shumë përgjegjësinë e këshillave popullore. Nga ana tjetër, përmirësimi i punës në dikasteret qendrore kërkon lehtësimin e tyre nga drejtimi i drejtpërdrejtë i disa ndërmarrjeve e sektorëve. Për këtë nevojitet që të zgjerohen kompetencat e pushtetit lokal. Prandaj ne duhet ta forcojmë shumë punën e këshillave popullore, veçanërisht në këto drejtime kryesore:

Nga njëra anë, organet dhe organizatat e Partisë, si edhe vetë organet e pushtetit duhet t'i kushtojnë shumë kujdes forcimit organizativ të këshillave popullore, funksionimit të rregullt të tyre, aktivizimit të plotë të komisioneve, të masës së gjerë të anëtarëve të këshillave, tërheqjes gjithnjë e më shumë të masave punonjëse në problemet e pushtetit.

Nga ana tjetër, duhet përmirësuar metoda e punës e të gjitha instancave të organeve lokale të pushtetit, të rritet inisiativa e tyre brenda kompetencave që u jep ligji.

Duhet ndihmuar shumë në këto drejtime që thammë, veçanërisht, këshillat popullore të fshatrave. Me kolektivizimin e bujqësisë është krijuar një gjendje e re për punën e këshillave popullore të fshatit, prandaj duhen mësuar ato se si të punojnë. Me bashkimin e kooperativave bujqësore po krijohen edhe njësi administrativo-shtetërore për dy e më shumë fshatra. Ky proces është i drejtë dhe duhet të vazhdojë. Por këshillave

popullore të këtyre fshatrave të mëdha u del detyra të kujdesen si për punën në qendrat e banimit (ish-fshatrat e mëparshme), ashtu edhe për prodhimin. Këshilli popullor është autoriteti i vetëm, më i lartë, i pushtetit në fshat, prandaj ai duhet të jetë në dijeni e të kujdeset për gjithçka. Në këtë drejtim duhet luftuar kundër rasteve të spostimit që u bëhet ngandonjëherë këshillave popullore, si nga kryetarët e kooperativave bujqësore, ashtu edhe nga organet më të larta të pushtetit.

Gjithashtu duhet të përmirësohet puna e këshillave popullore të lokaliteteve. Në disa zona, ku është përfunduar bashkimi i kooperativave, duke qenë se mbeten pak njësi ekonomiko-administrative në vartësi të lokaliteteve, këto të fundit janë shkrirë. Kjo gjë është e drejtë dhe duhet të çohet deri në fund. Por, atje ku ruhen akoma lokalitetet, nuk duhet të dobësohen e të spostohen ato në asnjë mënyrë, po të ndihmohen e të aktivizohen që të forcohet puna e këshillave popullore në fshat, të forcohen kooperativat bujqësore e gradualisht të bëhet bashkimi i tyre, gjë që do të shpjerë, nga ana e saj, në suprimimin e lokaliteteve.

Për këshillat popullore të qyteteve duhet të merren masa që të forcohen dhe të rriten e të zgjerohen gradualisht kompetencat e tyre.

Forcimi i mëtejshëm i pushtetit popullor kërkon njëkohësisht edhe forcimin e ligjshmërisë socialiste. Ne, në këtë fushë, kemi shënuar suksese të mëdha. Por edhe në të ardhshmen nga të gjitha organet duhet të tregohet kujdes i madh për zbatimin e drejtë e të përpiktë të ligjeve tona. Ato janë ligjet e popullit në fuqi, prandaj janë të paprekshme e të detyrueshme për t'u

zbatuar nga të gjithë. Organet e drejtësisë e të kontrollit, ashtu si edhe deri tani, duhet të mbikëqyrin me kujdes dhe të kërkojnë, pa lëshimin më të vogël, respektimin e plotë të ligjshmërisë sonë socialiste.

Shokë,

Forcimi i punës organizativo-drejtuese të Partisë sonë është një detyrë e përhershme dhe e të gjithëve: e çdo komunisti, e çdo kuadri, e çdo organizatë dhe forumi të Partisë. Prandaj të vëmë të gjitha forcat për të ngritur edhe më lart nivelin e punës së Partisë për të forcuar e çelikosur gjithnjë e më tepër unitetin monolitik të radhëve të saj rreth Komitetit Qendror e të masave rreth Partisë, për të ngritur gjithnjë e më shumë lavdinë e saj.

V

LUFTA NË FRONTIN IDEOLOGJIK DHE DETYRAT E PARTISË

Shokë,

Zgjidhja me sukses e detyrave të ndërtimit socialist është e lidhur drejtpërsëdrejti me punën ideopolitike të Partisë, me edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të masave, me zbatimin krijues e me

besnikëri të parimeve të ideologjisë sonë fitimtare, marksizëm-leninizmit.

Partia i ka kushtuar gjithnjë kujdes të madh edukimit të komunistëve e të masave me idetë e marksizëm-leninizmit, sepse, marksizëm-leninizmi është bësulla që orienton Partinë në të gjithë veprimtarinë e saj. Ai u jep njerëzve mundësinë të njohin ligjet e zhvillimit të shoqërisë, të kuptojnë thellë ngjarjet e të veprojnë drejt në çdo situatë. Prandaj studimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit nuk është i domosdoshëm vetëm për një rreth të kufizuar kuadrosh të aparateve të Partisë, por për të gjithë komunistët, për të gjithë kuadrot, qofshin këta me parti ose pa parti, të sektorëve më të ndryshëm të ekonomisë, të artit apo të kulturës, të ushtrisë apo të arsimit.

Partia jonë ka qenë kurdoherë e ndërgjegjshme se çdo dobësim i ideologjisë së Partisë, çdo nënvleftësim i saj, siç thotë Lenini i madh, sjell në mënyrë të pashmangshme forcimin e ideologjisë borgjeze, gjë që përbën një rrezik serioz për vetë fatet e socializmit. Prandaj Partia e ka parë gjithnjë punën ideopolitike si një nga sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së saj.

Në periudhën që na ndan nga Kongresi III në punën ideologjike të Partisë janë arritur një sërë suksesesh. Puna ideologjike ka ndihmuar për arritjen e rezultateve si në ndërtimin socialist, në edukimin komunist të masave, në çelikosjen e unitetit të Partisë, ashtu edhe në forcimin e gjithanshëm të rendit tonë shoqëror e shtetëror socialist.

Gjatë këtyre viteve është bërë një punë e mirë

për të realizuar detyrën e caktuar nga Kongresi III i Partisë që puna ideologjike të lidhet ngushtë me jetën, t'i shërbejë luftës për shtimin e prodhimit e për ngritjen e mirëqenies së punonjësve.

Në punën ideologjike të Partisë një vend me rëndësi kanë zënë studimi i veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe i historisë së Partisë sonë, lufta për demaskimin e imperializmit, njohja e studimi i taktikës dhe i strategjisë së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, lufta kundër revizionizmit modern, sidomos kundër revizionizmit jugosllav. Në luftën për demaskimin e armiqve të socializmit, si edhe në luftën e përditshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë janë kalitur ideologjikisht njerëzit tanë, është ngritur niveli politik i komunistëve dhe i masave, është forcuar karakteri luftarak i punës ideologjike të Partisë. Gjatë gjithë kohës që na ndan nga Kongresi III, Partia jonë ka bërë një luftë të vendosur për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe në këtë luftë është bërë i pathyeshëm uniteti i saj për vënien në jetë të vijës së përgjithshme të Partisë.

Rezultate të mira janë arritur si në rrjetin e arsimit të Partisë, ashtu edhe në arsimin politik të rinisë dhe në edukimin e intelektualëve. Rrjeti i arsimit në Parti është bërë më elastik e më i gjithanshëm, janë përmirësuar mjaft programet dhe tekstet. Këtë vit në sistemin e arsimit të Partisë studjojnë 38 773 veta, nga të cilët 11 864 pa parti; Shkollën e Partisë ditën dhe me korrespondencë e ndjekin 940 veta, pa llogaritur këtu ata që kalojnë në kurset e ndryshme të Partisë. Në qoftë se do të kemi parasysh se, veç këtyre, edhe

20 703 komunistë ndjekin shkollat e ndryshme të kulturës së përgjithshme, atëherë mund të themi se mbi 90 për qind e të gjithë anëtarëve e të kandidatëve të Partisë sonë, në një formë ose në një tjetër, i janë përveshur punës për ngritjen e nivelit të tyre teorik e kulturor. Kjo, shokë, është një fitore e shkëlqyer, është një tjetër tregues i rëndësishëm i forcimit të mëtejshëm të Partisë, i rritjes së nivelit të saj ideopolitik e kulturor, një shprehje e qartë e përpjekjeve të mëdha që bëjnë komunistët tanë për të qenë plotësisht të denjë për rolin e tyre si udhëheqës të masave.

Një punë e mirë është bërë gjatë këtyre viteve edhe në fushën e botimeve të letërsisë politike. Tani në gjuhën shqipe kemi veprat kryesore të klasikëve të marksizëm-leninizmit. Janë botuar «Vepra të zgjedhura» të Marksit e të Engelsit në dy vëllime; po kështu në dy vëllime kemi «Vepra të zgjedhura» të V. I. Leninit, ndërsa po vazhdon përkthimi dhe botimi i veprave të plota të tij; ne kemi në shqip veprat e plota të Stalinit; janë botuar tekste të ndryshme, si mbi filozofinë marksiste e ekonominë politike, «Historia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik», materiale studimi për Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë etj. Shumë e rëndësishme është puna që ka filluar me botimin e dokumenteve e të materialeve të ndryshme të Arkivit të Partisë dhe të Shtetit. Të gjitha këto tregojnë se sa rëndësi të madhe u jep Partia jonë çështjeve të edukimit ideologjik, çështjeve të propagandës marksiste-leniniste.

Por ne nuk duhet të kënaqemi me sukseset e arritura. Detyrat e mëdha të kohës, si edhe kërkesat

gjithnjë e më të mëdha të njerëzve tanë, me Parti e pa parti, kërkojnë forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë, ngritjen e saj në një nivel më të lartë.

1. — Puna ideopolitike e Partisë duhet t'u përgjigjet detyrave të ndërtimit socialist të vendit, t'i shërbejë edukimit komunist të punonjësve

Vendi ynë po hyn tani në një periudhë të re historike. Përpara nesh shtrohen detyra të mëdha për ndërtimin me hapa të shpejtë të bazës materialo-teknike të socializmit, të shoqërisë së plotë socialiste. Kryerja me sukses e programit tonë të ndërtimit socialist kërkon një mobilizim të gjerë, një hov dhe entuziazëm të madh të punonjësve, kërkon ngritjen në një shkallë më të lartë të të gjithë veprimtarisë së tyre krijuese. Kjo mund të arrihet vetëm me anën e një pune të gjerë e të vazhdueshme për edukimin e tyre, për ngritjen e ndërgjegjes së tyre socialiste. Socializmi është vepër e masave dhe pjesëmarrja aktive e tyre në këtë vepër varet drejtpërsëdrejti nga shkalla e ndërgjegjes socialiste.

Parimi më i lartë i punës ideologjike të Partisë është lidhja e saj me jetën, me praktikën e ndërtimit socialist, me detyrat konkrete për zgjidhjen e të cilave luftojnë masat. Forca e pathyeshme e marksizëm-leninizmit si një doktrinë gjithnjë e gjallë krijuese, si një udhëheqje në veprimtarinë praktike për transformimin e botës qëndron pikërisht në lidhjen e saj të pandarë me jetën, me praktikën revolucionare. Por, në të njëjtën

kohë, Partia ka theksuar se ta lidhësh teorinë me jetën, me praktikën, nuk do të thotë aspak që t'i japësh rëndësi vetëm praktikës dhe të nënvleftësosh rolin e teorisë. Klasikët e marksizëm-leninizmit gjithnjë kanë dënuar spontaneitetin në lëvizjen punëtore dhe kanë theksuar nevojën e madhe të teorisë revolucionare për njohjen dhe për transformimin e botës. Ata kanë theksuar se, kur teoria bën për vete masat, ajo shndërrohet në një forcë materiale, se pa teori revolucionare nuk mund të ketë as lëvizje revolucionare. Në të gjithë veprimtarinë e saj Partia jonë është udhëhequr dhe udhëhiqet nga ideja se teoria dhe praktika janë të lidhura ngushtë e të pandara, se teoria e shkëputur nga praktika është e vdekur, kurse praktika që nuk ndriçohet nga teoria revolucionare është e verbër. Shkëputja e teorisë nga praktika është po aq e dëmshme sa edhe shkëputja e praktikës nga teoria.

Puna ideologjike e Partisë nuk është qëllim në vetvete, ajo është mjeti, arma e fuqishme e Partisë për arritjen e qëllimeve të saj — ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë; prandaj efikasiteti i saj matet me rezultatet konkrete në këtë apo në atë sektor të ndërtimit socialist.

Tani të gjitha mjetet e format e punës ideologjike të Partisë — propaganda, agjitacioni, shtypi dhe veprimtaria kulturore — duhet të përqëndrohen me të tëra forcat në sqarimin e punonjësve që këta të njohin detyrat e mëdha të planit të tretë pesëvjeçar, perspektivat e shkëlqyera që hapen përpara vendit tonë dhe t'i mobilizojnë ata për arritjen e rezultateve sa më të mëdha në ndërtimin e socializmit.

Gjatë këtyre viteve, në saje të transformimeve të mëdha revolucionare në të gjitha fushat e jetës dhe në saje të punës edukative të Partisë dhe të shtetit tonë, ka ndryshuar shumë edhe figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjja dhe botëkuptimi i tij, marrëdhëniet e tij me kolektivin e shoqërinë, qëndrimi i tij ndaj punës e ndaj pronës shoqërore, ndaj shtetit e ndaj atdheut socialist. Me të drejtë ne sot krenohemi për sukseset e mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat e jetës. Këto suksese do të kishin qenë të pamundura, po të mos kishin treguar punonjësit tanë një ndërgjegje të lartë në punë, një vendosmëri të madhe për të kapërcyer vështirësitë e pengesat e shumta, një besnikëri e pakufishme ndaj atdheut e ndaj çështjes së socializmit.

Por, me gjithë sukseset e arritura, mbetet shumë për të bërë në luftën për edukimin komunist të punonjësve, për formimin e ndërgjegjes së tyre socialiste, për edukimin e njeriut të shoqërisë së re socialiste. Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste nuk mund të kuptohet pa krijuar njëkohësisht edhe një njeri të ri, me ide e mendime të reja, me cilësi e virtyte të larta morale. Mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve janë një pengesë serioze në rrugën për fitoren e plotë të socializmit në vendin tonë. Kontradikta midis bazës së re socialiste dhe mbeturinave kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve është një nga kontradiktat e rëndësishme të jetës sonë, për kapërcimin e së cilës duhet bërë një punë e madhe.

Rëndësi të veçantë për kushtet e sotme të vendit tonë merr edukimi i punonjësve për një qëndrim socia-

list ndaj punës e ndaj pronës shoqërore. Puna është baza e jetës së shoqërisë. Ajo është burimi më i rëndësishëm i të gjitha pasurive materiale e shpirtërore. Puna është mjeti kryesor për realizimin e idealeve të socializmit e të komunizmit; në të shprehet sot patriotizmi i vërtetë popullor dhe internacionalizmi proletar. Ajo është shkolla më e mirë e edukimit komunist të masave. Vetëm në punë, ka thënë V. I. Lenini, njeriu mund të bëhet komunist i vërtetë.

Lufta për formimin dhe për forcimin e qëndrimit socialist ndaj punës, lufta për vënien në jetë të parimit «kush nuk punon, nuk ha», lufta kundër dembelëve e parazitëve që përpiqen të rrojnë në kurriz të shoqërisë, edukimi i punonjësve me ndjenjën e kolektivitetit dhe të ndihmës reciproke në punë dhe lufta për ruajtjen, për forcimin e për zhvillimin e pronës shoqërore si bazë materiale e rendit tonë socialist, duhet të zënë një vend të dorës së parë në gjithë punën ideologjike të Partisë.

Transformimet socialiste dhe të gjitha sukseset në ndërtimin e socializmit, vetë jeta, realiteti ynë socialist influencojnë drejtpërdrejt në edukimin komunist të masave, pra, edhe në edukimin me qëndrimin socialist ndaj punës. Por formimi i ndërgjegjes socialiste të punonjësve nuk është një proces spontan. Përveç faktorit objektiv, material, një rol vendimtar luan faktori subjektiv, i ndërgjegjshëm, puna edukative e Partisë, e shtetit dhe e institucioneve të ndryshme kulturoro-arsimore. Vetëm duke i marrë të dy këta faktorë së bashku mund të kuptohet drejt procesi i formimit të ndërgjegjes socialiste.

E madhe është forca edukuese e kolektivit dhe e shembullit pozitiv. Kolektivi i kritikon njerëzit për të metat dhe për dobësitë e tyre, i mëson dhe i ndihmon ata se si të mbajnë një qëndrim të lartë socialist në punë dhe në jetë.

Një rëndësi të veçantë për edukimin me qëndrimin socialist ndaj punës ka organizimi i mirë i punës, vendosja e rregullit shembullor në punë, ushtrimi i një kontrolli të rreptë për zbatimin e detyrave, vendosja e drejtë e normave dhe e kategorizimit të punëtorëve, respektimi me përpikëri i parimit të shpërblimit sipas sasisë e cilësisë së punës, zhvillimi i gjithanshëm i stimeve moralë në punë etj.

Në kushtet e vendit tonë një rëndësi të madhe ka propaganda ateiste shkencore, lufta kundër paragjy-kimeve fetare, besimeve të kota e zakoneve prapanike për formimin e një botëkuptimi të drejtë shkencor materialist të punonjësit. Këto mbeturina, pasojë e prapambetjes së madhe kulturore të trashëguar nga e kaluara, janë një pengesë serioze për përhapjen e kulturës së re socialiste në masat, për edukimin e tyre ideologjik dhe për pjesëmarrjen aktive e të ndërgjegjshme në luftën për ndërtimin e socializmit.

Në saje të transformimeve të mëdha ekonomiko-shoqërore që janë bërë në vendin tonë dhe të ngritjes së nivelit ideologjik e kulturor të punonjësve, një pjesë e madhe e popullsisë, sidomos rinia, është çliruar si nga zakonet prapanike, ashtu edhe nga paragjykimet fetare etj. Megjithëkëtë influenca e tyre ndihet akoma, e veçanërisht në fshat. Prandaj propaganda dhe gjithë puna edukative e Partisë duhet të veprojë me energji

në këtë drejtim, duke luftuar, në radhë të parë, kundër atyre paragjytimeve e zakoneve që dëmtojnë më shumë ndërtimin e socializmit, që pengojnë pjesëmarrjen e njerëzve në punë, që dëmtojnë ekonominë e shëndetin e njerëzve, që çojnë në shkeljen e të drejtave të grave dhe që pengojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në prodhim e në gjithë jetën e vendit.

Çrrënjësia e paragjytimeve fetare, e besimeve të kota dhe e zakoneve të dëmshme është një punë e vështirë dhe delikate. Ato nuk mund të zhduken menjëherë, as me dekrete, as me mitingje. Kjo është një punë që kërkon durim, zgjuarsi dhe takt. Organizatat e Partisë duhet të mbajnë kurdoherë parasysh porosinë e Partisë në qëndrimin ndaj besimtarëve. Por të mos i bëjmë lëshime ndonjë kleriku të pandërgjegjshëm, apo kujtdo tjetër që kërkon të ushtrojë presion mbi masat, t'i mashtrrojë ato nën maskën e fesë dhe t'i vërë kundër interesave të shtetit e të popullit.

Duke i dhënë rëndësi punës edukuese dhe fjalës bindëse të Partisë për zhdukjen e zakoneve të dëmshme, Partia duhet të bëjë një punë të gjerë edukative për të mbajtur gjallë dhe për të zhvilluar më tej zakonet e mira e virtytet e larta që ka trashëguar brez pas brezi populli ynë, si dashurinë për atdheun, trimërinë, besën, mikpritjen, nderin, bujarinë etj.

Për këtë punë, duhen aktivizuar më mirë të gjitha format e propagandës së Partisë, institucionet tona kulturore, arsimtarët dhe intelektualët, shtypi dhe radioja; letërsia dhe artet, të cilat luftën për edukimin e punonjësve me moralin e botëkuptimit të ri komunist, duhet ta shohin si një nga detyrat e tyre kryesore.

2. — Të forcohet puna për propagandimin e parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe lufta për ruajtjen e pastërtisë së tij

Sot në botë zhvillohet një luftë e ashpër midis marksizëm-leninizmit dhe ideologjisë borgjeze e të gjitha shfaqjeve të saj për të pushtuar mendjet e njerëzve. Përballë sukseseve madhështore të socializmit dhe përhapjes së ideve të marksizëm-leninizmit në të gjithë botën, borgjezia imperialiste, klasat shfrytëzuese kudo që janë zhvillojnë një propagandë të tërbuar për të përhapur me të gjitha mënyrat ideologjinë e antikomunizmit, shtrembërojnë në mënyrë të përbindshme marksizëm-leninizmin, shpifin në mënyrë trashanike kundër rendit shoqëror socialist, falsifikojnë politikën e qëllimet e komunistëve. Në këto përpjekje të borgjezisë imperialiste një rol të turpshëm, si ndihmës të saj, luajnë krerët e djathtë të socialdemokracisë, revizionistët e marksizmit dhe oportunistët e ngjyrave të ndryshme.

Në këto kushte një rëndësi të veçantë merr lufta në frontin ideologjik për mbrojtjen e pastërtisë së doktrinës ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, për sqarimin e drejtë dhe të thellë të problemeve të zhvillimit të sotëm botëror, për propagandimin e parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe të vijës së drejtë që ka ndjekur e ndjek Partia e Punës e Shqipërisë lidhur me këto probleme.

Për të kuptuar drejt fenomenet shoqërore dhe ndryshimet që janë bërë dhe bëhen sot në botë, Partia jonë është nisur kurdoherë nga kuptimi materialist i

historisë, nga analiza klasore e raportit të forcave, nga studimi i thellë dhe objektiv i gjendjes reale që ekziston sot. Kjo është metoda e vetme e drejtë që mëson marksizëm-leninizmi, është metoda që të ruan nga gabimet në veprimtarinë politike. Çdo largim prej kësaj metode dialektike të çon në metafizikë e në idealizëm, të çon në revizionizëm e oportunistizëm, të bën që t'i vlerësosh ngjarjet e situatat e ndryshme së prapi.

Karakteristikë kryesore e të gjithë oportunistëve e revizionistëve, si atyre të vjetërve, ashtu edhe të kohëve të tanishme, është, pikërisht, mohimi i këtyre parimeve themelore të marksizëm-leninizmit. Këtu është edhe burimi i të gjitha pikëpamjeve të tyre të shtrembra, i të gjithë veprimtarisë së tyre armiqësore e të rrezikshme në fushën e ideologjisë e të praktikës. Lenini i madh ka thënë se në themel të të gjitha pikëpamjeve të revizionistëve qëndron ideja e bashkëpunimit të klasave me interesa të kundërta. Duke e revizionuar teorinë marksiste mbi klasat e luftën e klasave, revizionistët e shpallin marksizmin të vjetruar, mohojnë parimet e tij themelore, i paraqitin në dritë të shtrembër të gjitha problemet e mëdha të kohës sonë, heqin dorë nga lufta ideologjike e politike kundër armikut të klasës, kapitullojnë përpara tij. Natyrisht, për t'u maskuar, sepse hapur askush nuk do t'u besonte profkave të tyre, revizionistët kërkojnë t'i shesin pikëpamjet e tyre si fjalën e fundit të marksizmit «krijues». Por frazat e tyre të bukura nuk mund të gënjejnë njeri e aq më pak komunistët, marksistë-leninistët, të cilët, kur gjejnë për ndonjë parti apo person, nuk gjejnë vetëm nga fjalët, nga guna, por kryesisht nga veprat, nga puna e tyre.

Ata gjykojnë nga fakti se kujt i shërbejnë këto pikëpamje, se në interes të cilës klasë janë ato. Në këtë çështje partitë marksiste dhe çdo komunist udhëhiqen nga mësimet e Leninit, se

«Njerëzit kanë qenë kurdoherë dhe kurdoherë do të jenë viktima naive të mashtrimit dhe të vetëmashtrimit në politikë, derisa të mësohen që prapa frazave, deklaratave dhe premtimeve të ndryshme morale, fetare, politike dhe sociale, të shohin interesat e këtyre ose atyre klasave»¹.

Revizionistët e sotëm mohojnë kontradiktat kryesore të kohës sonë, prapa të cilave qëndrojnë klasa dhe forca shoqërore të caktuara. Si rrjedhim, duke spekuluar me fraza gjoja marksiste, revizionistët përhapin iluzione të rrezikshme për shumë çështje të rëndësishme të kohës sonë. Kështu, për shembull, kur flasin për epokën tonë e paraqitin atë si një epokë qetësie dhe harmonie të përgjithshme, «ku sistemi shoqëror kapitalist në formën e tij klasike i përket së kaluarës», ku mund të flitet për një «integrim të përgjithshëm» të mbarë botës, bile edhe të vetë kapitalistëve në socializëm, ku probleme të tilla si ai i luftës midis proletariatit e borgjezisë, midis socializmit e kapitalizmit, midis forcave të lirisë e të skllavërisë, midis demokracisë e reaksionit, midis forcave të paqes e të luftës, janë zhdukur fare. Dhe, po të mendosh sipas logjikës revizioniste, kjo

¹ V. I. Lenin, Veprat, vëll. 19, f. 9.

është fare e natyrshme, sepse për ata, si rezultat i ndryshimit të raportit të forcave në arenën ndërkombëtare, kapitalizmi dhe imperializmi kanë pësuar ndryshime rrënjësore, nuk janë më as shfrytëzues, as agresorë, as burim luftërash dhe shtypjeje. Bile, revizionisti Kardel «argumentoi» edhe teorikisht se rreziku i luftës në të vërtetë vjen nga vendet socialiste, e veçanërisht nga Kina e Shqipëria! Ja deri në çfarë absurditetesh arrijnë armiqtë e marksizmit, ja deri ku i çon ata zelli i madh për t'i shërbyer sa më mirë padronit të tyre, borgjezisë imperialiste!

Revizionistët modernë, duke u larguar nga koncepti klasor i analizës së situatës dhe duke dashur të gënjejnë masat, bëjnë demagogji kur flasin për politikën e bashkekzistencës paqësore apo edhe për çështjet e luftës e të paqes. Edhe këto çështje ata i shohin së prapi, me syze antimarksiste. Politikën e bashkekzistencës paqësore, parimet themelore të së cilës, për të parën herë, i ka formuluar Lenini, ata e shikojnë si politikë të pajtimit me imperializmin, për hir të së cilës duhet hequr dorë nga çdo lloj lufte klasash, sipas parimit «të mos e zemërojmë xhaxhanë e pasur», i cili tanimë është dobësuar dhe po falimenton vetvetiu. Sipas revizionistëve, politika e bashkekzistencës paqësore nuk shtrihet vetëm në marrëdhëniet midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore, por edhe në marrëdhëniet midis klasave brenda vendeve kapitaliste, si edhe midis popujve të shtypur e shfrytëzuesve kolonialistë. Revizionistët predikojnë se asnjë luftë ideologjike dhe politike nuk duhet bërë kundër imperializmit, për demaskimin e politikës së luftës e të agresionit. Këto koncepte

antimarksiste, që janë krejt në kundërshtim me interesat e klasës punëtore e të socializmit, kanë si qëllim t'u imponojnë vendeve socialiste e partive komuniste një politikë oportuniste, politikë lutjesh e përkëdheljes, politikë lëshimesh e kompromisesh të dëmshme, duke u dhënë mundësi armiqve të socializmit, imperialistëve dhe borgjezisë reaksionare, që të realizojnë më lehtë politikën e tyre të luftës dhe të terrorit, të shtypjes dhe të shfrytëzimit. Por partitë e vërteta komuniste dhe vendet socialiste nuk mund të ndjekin këshillat e konceptet e revizionistëve, po mësimet e pavdekshme, kurdoherë fitimtare të marksizëm-leninizmit. Partia jonë e Punës ka luftuar dhe do të luftojë edhe në të ardhshmen kundër pikëpamjeve revizioniste për këto çështje dhe do të zbatojë kurdoherë me besnikëri mësimet dritëdhënëse të marksizëm-leninizmit.

Duke u larguar nga pozitat klasore, revizionistët e sotëm hedhin poshtë si «të vjetruara» mësimet parimore të marksizëm-leninizmit mbi revolucionin socialist dhe mbi diktaturën e proletariatit, si kusht i domosdoshëm për kalimin nga kapitalizmi në socializëm. Baza e të gjitha arsytimeve oportuniste të revizionistëve të sotëm është teza se gjoja shteti i sotëm kapitalist po e humbet çdo ditë e më tepër karakterin e tij klasor, se ai gjoja mund t'i shërbejë njëlloj si borgjezisë, ashtu edhe proletariatit. Sipas logjikës revizioniste, sistemi i demokracisë borgjeze mund të shërbejë «si kuadër juridik dhe politik i fazave fillestare të zhvillimit socialist». Duke u nisur nga koncepte të tilla, oportunistët e djathtë e absolutizojnë dhe bile e konsiderojnë si të vetmen rrugë të mundshme rrugën paqësore të kalimit nga ka-

pitalizmi në socializëm. Këtë kalim paqësor ata e paraqitin si një evolucion, si një ndërrim të thjeshtë në qeveri, ku në vend të disa njerëzve vijnë disa të tjerë.

Marksistë-leninistët nuk e mohojnë mundësinë e rrugës paqësore të kalimit në socializëm, por ata nuk e kuptojnë aspak atë si mohim të luftës së klasave, si sigurim të thjeshtë të shumicës në parlamentin borgjez pa shkatërruar nga themeli aparatit e vjetër shtetëror borgjez dhe pa e zëvendësuar atë me organet e diktaturës së proletariatit, të afta për të kryer transformime të thella socialiste dhe të gatshme në çdo çast për të shtypur me vendosmëri çdo rezistencë të mundshme të borgjezisë. Marksistë-leninistët udhëhiqen në këtë çështje nga mësimet e pavdekshme të të madhit Lenin, i cili thotë:

«Zotërinjtë oportunistë, duke përfshirë dhe kautskianët, si për t'u tallur me teorinë e Marksit, e «mësojnë» popullin kështu: në fillim proletariati duhet të fitojë shumicën me anë të së drejtës së përgjithshme të votimit, pastaj të marrë, në bazë të një votimi të tillë të shumicës pushtetin shtetëror dhe pastaj, mbi këtë bazë të demokracisë «konsekuente» (disa e quajnë: «të kulluar»), të organizojë socializmin.

Kurse ne, në bazë të teorisë së Marksit dhe të eksperiencës së revolucionit rus, themi:

në fillim proletariati duhet ta përmbysë borgjezinë dhe t'i sigurojë vetes pushtetin shtetëror, dhe pastaj këtë pushtet shtetëror, domethënë diktaturën e proletariatit, ta përdorë si

armë të klasës së vet për të fituar simpatinë e shumicës së punonjësve»¹.

Nga ana tjetër, partitë marksiste, siç theksohet në Deklaratën e Moskës të vitit 1960, nuk e konsiderojnë aspak rrugën paqësore si të vetmen formë të mundshme të kalimit në socializëm. Përkundrazi, ato nuk harrojnë për asnjë çast se klasat sunduese, siç na mëson eksperiencia e deritanishme historike, kurrë nuk e dorëzojnë vullnetarisht pushtetin, prandaj partitë revolucionare marksiste-leniniste përgatiten paralelisht, në të njëjtën kohë, si për rrugën paqësore, ashtu edhe për marrjen e pushtetit me kryengritje të armatosur, duke i mbajtur armët kurdoherë të mbushura e barutin e thatë, që të mos zihen në befasi në rast se borgjezia përdor dhunën kundër klasës punëtore që është ngritur në revolucion. Mësimet e Leninit për këtë çështje janë të qarta dhe të prera:

«Një klasë e shtypur, thotë ai, e cila nuk përpiqet të mësojë përdorimin e armëve, të ketë armë, kjo klasë e shtypur nuk meriton gjë tjetër veçse të trajtohet si skllave»².

Në qoftë se përgatitesh mirë për kryengritjen e armatosur, krijohen mundësi të favorshme edhe për marrjen e pushtetit me rrugë paqësore.

Ky është i vetmi qëndrim i drejtë marksist-leninist

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 294.

² V. I. Lenin. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 400. Tiranë, 1974.

në këtë çështje kaq të rëndësishme e jetike për klasën punëtore dhe për gjithë punonjësit, qëndrim të cilit i është përmbajtur dhe i përmbahet kurdoherë Partia jonë. Teoritë revizioniste mbi «shndërrimin evolucionar e paqësor» të kapitalizmit të sotëm në socializëm, synojnë t'i largojnë partitë komuniste e punëtore nga rruga e drejtë revolucionare, t'i largojnë masat punonjëse nga lufta për përmbysjen e borgjezisë. Ato kanë për qëllim të ruajnë të paprekur e të përjetësojnë rendin kapitalist.

Shumë të rrezikshme e në kundërshtim flagrant me mësimet e marksizëm-leninizmit janë edhe tezat oportuniste e kapitulluese të revizionistëve të sotëm lidhur me shtetin dhe ndërtimin socialist. Duke përsëritur argumentet bajate se gjoja shteti socialist, diktatura e proletariatit dhe demokracia janë dy gjëra krejt të papajtueshme me njëra-tjetrën, duke akuzuar shtetin socialist për «despotizëm burokratik» dhe duke manovruar me parullën e të ashtuquajturit demokratizim, revizionistët e sotëm predikojnë «shuarjen», likuidimin e shtetit socialist qysh tani. Për partitë marksiste-leniniste është e qartë si drita e diellit, se jo më likuidimi i shtetit socialist, por edhe dobësimi më i vogël i organeve të diktaturës së proletariatit, liberalizimi i saj, në një kohë kur ekziston imperializmi, i cili kurrë nuk ka hequr dhe nuk ka për të hequr dorë nga qëllimet dhe orvatjet e tij të tërbuara për të shkatërruar rendin socialist, do të ishte vetëvrasje për vendet tona socialiste. Këtë e vërtetoi më së miri edhe eksperiencia e hidhur e kundërrevolucionit në Hungari.

Për marksistë-leninistët nuk ka dhe nuk mund të

ketë asnjë dyshim për faktin se shteti socialist, duke qenë diktaturë kundër klasave të përmbysura shfrytëzuese dhe kundër çfarëdo armiqsh të klasës punëtore e agjentësh të imperializmit, siguron, në të njëjtën kohë, demokracinë më të gjerë për punonjësit, për popullin. Këto gjëra janë elementare të teorisë marksiste-leniniste. Partia jonë e ka quajtur dhe e quan si një detyrë të saj të përhershme perfeksionimin e pandërprerë të rendit shtetëror socialist, luftën kundër çfarëdo shfaqjeje të burokratizmit. Por ajo nuk harron për asnjë çast se, përderisa ekziston rreziku i agresionit imperialist dhe i veprimtarisë minuese të imperializmit kundër vendit tonë dhe kampit socialist, nuk është aspak e lejueshme që me pretekstin e «demokratizimit» të dobësohen sado pak organet e diktaturës së proletariatit. Përkundrazi, ato duhen mbajtur kurdoherë të mprehta e të gatshme për të likuiduar çdo orvatje të mundshme të armikut të brendshëm e të jashtëm.

Eksperienca e ndërtimit të socializmit në një sërë vendesh socialiste ka vërtetuar saktësinë e teorisë marksiste-leniniste mbi ekzistencën e një vargu ligjesh të përgjithshme, të domosdoshme për çdo vend që hyn në rrugën e zhvillimit socialist. Sukseset e vendit tonë dhe të çdo vendi socialist janë arritur pikërisht në saje të zbatimit të drejtë të këtyre ligjeve të përgjithshme të ndërtimit socialist, duke marrë parasysh kushtet konkrete dhe veçoritë historike të secilit vend, si dhe interesat e socializmit në tërësi.

Revizionistët e marksizmit i shtrembërojnë dhe i mohojnë këto ligje. Shteti socialist, sipas tyre, duhet të

heqë dorë nga funksionet e tij ekonomiko-organizative, sepse ndryshe zhvillohen tendencat «burokratike», shteti shndërrohet në një forcë që qëndron «mbi shoqërinë» etj. Për të shpëtuar nga të gjitha këto, ata predikojnë decentralizimin e drejtimit të ekonomisë, «vetadministrimin e prodhuesve». Duke predikuar dobësimin e vazhdueshëm të rolit ekonomik të shtetit socialist, revizionistët ngrihen kundër parimit shumë të rëndësishëm të ndërtimit socialist dhe të organizimit shtetëror socialist — parimit të centralizmit demokratik — dhe përpiqen ta zëvendësojnë atë me zhvillimin e pavarur dhe të lirë të forcave ekonomike, domethënë me spontaneitetin mikroborgjez që i lë fushë të lirë anarkisë në prodhim.

Jeta, praktika i ka hedhur poshtë të gjitha këto pikëpamje të revizionistëve të sotëm, të cilat u shërbejnë vetëm armiqve të klasës, dëmtojnë seriozisht çështjen e ndërtimit socialist dhe krijojnë rrezikun e restaurimit të kapitalizmit. Partia jonë ka luftuar dhe do të luftojë me vendosmëri kundër të gjitha këtyre pikëpamjeve, ajo u përmbahet me rreptësi mësimëve të marksizëm-leninizmit për ndërtimin e socializmit.

Gjatë këtyre viteve të fundit Partia jonë dhe parti të tjera marksiste-leniniste kanë luftuar me sukses kundër pikëpamjeve të revizionistëve modernë, si dhe kundër veprimtarisë së tyre përçarëse ndaj kampit socialist e ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Por, me gjithë grushtet dërrmuese që ka ngrënë dhe disfatat që ka pësuar, revizionizmi nuk është shpartalluar ideologjikisht, ai nuk është shkatërruar përfundimisht. Revizionizmi, si një nga format e influencës së ideologjisë

borgjeze mbi proletariatin, si pasqyrim i ideologjisë borgjeze në teori dhe në praktikë, mbetet rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Një rrezik serioz për unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për çështjen e paqes e të çlirimit të popujve, përbën grupi tradhtar revizionist i Titos, që është një repart agresiv e i rrezikshëm i revizionizmit të sotëm ndërkombëtar, një agjenturë e regjur e imperializmit, në radhë të parë e imperializmit amerikan. Partia jonë e Punës ka bërë kurdoherë një luftë të vendosur kundër pikëpamjeve dhe veprimtarisë armiqësore të revizionistëve të Beogradit, duke e konsideruar këtë luftë si kusht të domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të atdheut tonë, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për forcimin e unitetit dhe të kompaktësisë së kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për zhvillimin me sukses të luftës kundër imperializmit dhe për ruajtjen e paqes. Ajo e ka quajtur dhe e quan këtë luftë si detyrën e saj të lartë internacionaliste.

Udhëheqësit jugosllavë janë tradhtarë të regjur të marksizëm-leninizmit e të klasës punëtore. Pikëpamjet e tyre thellësisht oportuniste, siç thuhet edhe në Deklaratën e 81 partive komuniste e punëtore, janë sanksionuar në programin famëkeq që u adoptua në Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, i cili është kodi, shprehja e koncentruar e pikëpamjeve të revizionizmit të sotëm ndërkombëtar.

Partia jonë ka një eksperiencë të gjatë lufte kundër revizionistëve jugosllavë, ajo e njeh mirë fytyrën e tyre të vërtetë prej antimarksistësh, shovinistësh e agjen-

tësh të regjur të imperializmit. Gjithë historia e marrëdhënieve midis Partisë sonë dhe udhëheqjes jugosllave, midis RPSH dhe RF të Jugosllavisë është historia e kompleteve të vazhdueshme të klikës titiste për nënshtrimin e Partisë sonë, për likuidimin e pavarësisë së vendit tonë, është historia e rezistencës heroike të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar kundër planeve djallëzore të kësaj klike, kundër presioneve dhe shantazheve të ndryshme të saj.

Me qëllim që të mbrohen nga lufta jonë parimore marksiste-leniniste dhe që të denigrojnë Partinë tonë, revizionistët jugosllavë kanë bërë e bëjnë kundër nesh lloj-lloj sulmesh e shpifjesh, duke na akuzuar herë si «nacionalistë», herë si «dogmatikë» e «sektarë» dhe herë të tjera si njerëz që «s'kanë haber fare nga marksizmi». Kjo është një taktikë e njohur e oportunistëve dhe e revizionistëve të të gjitha kohërave për të luftuar kundër marksizmit revolucionar.

Zakonisht revizionistët jugosllavë, duke dashur të mashtrojnë popujt e tyre dhe naivët, flasin me terma «marksiste», paraqiten si luftëtarë e partizanë të vendosur të lirisë së popujve kolonialë, të bashkekzistencës paqësore, si përkrahës të propozimeve sovjetike për çarmatimin e, më në fund, bëjnë be e rrufe se ndërtojnë socializmin. Deklarata e Moskës e 81 partive komuniste e punëtore thekson se revizionistët jugosllavë në fakt nuk janë as për paqen, as për socializmin. E si mund të thuhet, se revizionistët jugosllavë janë kundër imperializmit, kur, siç theksohet në Deklaratë ata zhvillojnë veprimtari minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare? Si mund të thuhet se Jugos-

llavia është një shtet socialist e ndërton socializmin kur, siç theksohet në Deklaratë, revizionistët jugosllavë kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, e kanë vënë Jugosllavinë në vartësinë e lëmoshave të imperialistëve amerikanë e të imperialistëve të tjerë, kur ata ia kanë kundërvënë Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe luftojnë me tërbim për ta shkatërruar këtë lëvizje?

Partia jonë qëndron vendosmërisht në pozitën e Deklaratës së 81 partive komuniste e punëtore të vitit 1960 se demaskimi i mëtejshëm i udhëheqësve të revizionistëve jugosllavë dhe lufta aktive për ta ruajtur lëvizjen komuniste ndërkombëtare nga idetë antileniniste të revizionistëve jugosllavë vazhdojnë të mbeten një detyrë e domosdoshme e të gjitha partive marksiste-leniniste. Ajo mendon se kundër revizionizmit duhet bërë një luftë e vendosur e pa kompromis deri në shpartallimin e tij të plotë. Çdo ulje e vigjilencës revolucionare kundër tij, çdo dobësim i luftës parimore kundër tij, çdo lëkundje në këtë luftë, nën çfarëdo preteksti qoftë, shpie në mënyrë të pashmangshme në gjallërimin dhe në aktivizimin e tendencave revizioniste që e dëmtojnë rëndë çështjen tonë të madhe. Pa demaskuar pa mëshirë revizionizmin, e në radhë të parë, klikën revizioniste të Beogradit, nuk mund të bëhet si duhet demaskimi i imperializmit. Pa dalluar qartë e prerë kufirin e pikëpamjeve revizioniste nga marksizëm-leninizmi nuk mund të luftohen me sukses e nga pozita të drejta dogmatizmi e sektarizmi. Lufta për shpartallimin e plotë ideologjik e politik të kësaj klike renegatësh është një ndihmë internacionaliste për vetë popullin jugosllav.

Duke luftuar me vendosmëri kundër revizionizmit, si rrezik kryesor, Partia jonë ka luftuar dhe do të luftojë edhe kundër çdo shfaqjeje të dogmatizmit apo të sektarizmit, i cili gjithashtu është i rrezikshëm për fatet e socializmit. Partia e Punës e Shqipërisë gjatë gjithë veprimtarisë së saj e ka pasur dhe do ta ketë parasysh këtë çështje, sepse vetëm kështu ne do të jemi të garantuar nga çdo gabim në luftën tonë të madhe për socializmin e për komunizmin.

Problemet më të rëndësishme të zhvillimit të sotëm botëror dhe të luftës në frontin ideologjik janë trajtuar gjerësisht nga pozitat e marksizëm-leninizmit në të dyja mbledhjet e Moskës të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore — më 1957 e më 1960 dhe kanë gjetur pasqyrimin e tyre në deklaratat historike të aprovuara në këto mbledhje. Partia jonë marksiste-leniniste i ka aprovuar këto dokumente. Ajo ka luftuar me vendosmëri për vënien në jetë të parimeve të drejta, marksiste-leniniste të Deklaratës së vitit 1957 dhe për mbrojtjen e tyre nga çdo shtrembërim. Partia jonë u qëndron besnike edhe parimeve të Deklaratës së vitit 1960 dhe lufton me guxim për zbatimin e mbrojtjen e tyre. Konkluzionet dhe parimet e kësaj Deklarate janë një vërtetim i vijës së drejtë të përgjithshme marksiste-leniniste, që me besnikëri ka mbrojtur dhe ka vënë në jetë Partia jonë.

Në lëvizjen komuniste nuk ka parti «udhëheqëse» dhe të «udhëhequra». Siç theksohet në Deklaratë, të gjitha partitë janë të barabarta e të pavarura. Ato ndërtojnë vetë politikën e tyre, duke u udhëhequr nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe në përshtatje me kushtet historike të vendit të tyre. Partitë marksiste ja-

në të lidhura me njëra-tjetrën si parti të një klase, të një ideje, të një qëllimi, prandaj i japin një ndihmë reciproke vëllazërore njëra-tjetrës në luftën e përbashkët për triumfin e çështjes së madhe të proletariatit dhe shkëmbejnë eksperiencën e grumbulluar në këtë luftë.

Partia jonë e Punës ka luftuar kurdoherë me vendosmërinë më të madhe dhe ka dhënë kontributin e saj për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare mbi bazat e çelikta të marksizëm-leninizmit. E udhëhequr nga parimet e internacionalizmit proletar, ajo kurdoherë ka qenë dhe është e ndërjegjeshme se në sukseset tona përfshihen edhe sukseset e fitoret e luftës së klasës punëtore dhe të popujve të vendeve të tjera, se solidariteti dhe ndihma e klasës punëtore ndërkombëtare, e partive motra dhe e popujve vëllazër, ka qenë dhe është për ne një faktor shumë i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve tona. Për këtë Komiteti Qendror i Partisë sonë, gjithë komunistët shqiptarë u janë mirënjohës lëvizjes komuniste ndërkombëtare, klasës punëtore dhe partive motra të vendeve të ndryshme dhe i sigurojnë ato se si deri tani, edhe në të ardhshmen, do të jenë kurdoherë solidarë e besnikë. Partia jonë do të luftojë si gjithnjë për forcimin e mëtejshëm të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare; për zhvillimin e solidaritetit internacionalist dhe të lidhjeve vëllazërore me të gjitha partitë motra. Duke kryer me nder e besnikëri detyrat e saj internacionaliste, këtu në Shqipëri, Partia jonë do të mbajë kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, flamurin e socializmit fitimtar.

Lidhur me këto çështje, një ndër detyrat e rëndësishme të propagandës së Partisë është që edhe në të ardhshmen të punojë për edukimin e komunistëve dhe të të gjitha masave të popullit me parimet marksiste-leniniste të internacionalizmit proletar, me frymën e miqësisë vëllazërore me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste, me ndjenjën e unitetit dhe të solidaritetit vëllazëror, me luftën e klasës punëtore, të partive komuniste dhe të popujve të vendeve të tjera.

Propaganda e Partisë duhet ta bëjë të qartë, si në komunistët, ashtu edhe në masat e popullit, se në luftën tonë për ndërtimin e socializmit, ne mbështetemi fort në përkrahjen e masave të gjera popullore brenda vendit, kurse në arenën ndërkombëtare mbështetemi në ndihmën dhe në përkrahjen e vendeve socialiste, në solidaritetin e klasës punëtore e të partive komuniste dhe të popujve të vendeve të ndryshme. Pa solidaritetin dhe pa përkrahjen internacionaliste të lëvizjes revolucionare, të klasës punëtore ndërkombëtare dhe të partive komuniste motra nuk mund të arrijmë qëllimet e mëdha që kemi përpara, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Shokë,

Partia e Punës e Shqipërisë ka kaluar një rrugë të vështirë, por në të njëjtën kohë heroike, gjatë së cilës ajo është rritur e është forcuar. Në këtë rrugë të vështirë, në këtë luftë të ashpër kundër armiqve të shumtë, ajo është kalitur, është çelikosur uniteti i radhëve të

saj, janë bërë të pathyeshme lidhjet e Partisë me popullin. Në këtë rrugë të vështirë dhe luftë të ashpër, e ndriçuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe e edukuar me besnikërinë e pafund ndaj tij, Partia jonë përpunoi vijën e saj të drejtë të përgjithshme, fitoi pjekurinë që të orientohet drejt edhe në situatat më të vështira, që të tregojë guxim e vendosmëri sa herë është puna për të mbrojtur interesat e atdheut e të socializmit, për të ruajtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Qysh nga themelimi i saj, kundër Partisë dhe vijës së saj të përgjithshme kanë ngritur dorën elementë të ndryshëm oportunistë e revizionistë, kapitullantë dhe dezertorë, të cilët janë përpjekur ta pengojnë ecjen tonë përpara, t'ia përshtatin vijën tonë të drejtë vijës së armiqve tanë, të rrezikojnë fatet e atdheut e të popullit tonë me tendencat e tyre të gabuara oportuniste e anti-marksiste. Sillni ndër mend elementët, duke filluar që nga Sadik Premtja te Koçi Xoxe, që nga Tuk Jakova te Panajot Plaku, që nga Liri Gega te Liri Belishova dhe para jush do të keni një grup njerëzish egoistë e ambiciozë, karrieristë e oportunistë, disa prej të cilëve kanë përfunduar deri në tradhti ndaj popullit e atdheut, një grup njerëzish pa pikën e parimit dhe të moralit komunist.

Historia e Partisë sonë është historia e luftës dhe e fitores kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të popullit tonë, është historia e luftës dhe e fitores së Partisë sonë marksiste-leniniste për pastërtinë e marksizëm-leninizmit, kundër oportunitizmit e revizionizmit të jashtëm dhe të brendshëm. Këtë histori duhet ta

njohë mirë çdo komunist e punonjës i vendit tonë. Studimi i historisë së Partisë duhet të jetë në qendër të vëmendjes së propagandës së Partisë. Ajo duhet të tregojë qartë rrugën e vështirë, heroike dhe të lavdishme të Partisë, duke vënë mirë në dukje drejtësinë e vijës së ndjekur nga Partia jonë në çdo etapë të zhvillimit të saj, besnikërinë ndaj marksizëm-leninizmit dhe luftën e vendosur e të guximshme kundër armiqve imperialistë dhe shërbëtorëve të tyre revizionistë.

Partia jonë, kurdoherë ka triumfuar dhe ka korrur fitore të mëdha në të gjitha drejtimet, sepse u ka qëndruar kurdoherë besnike interesave jetike të popullit dhe i ka mbrojtur me vendosmëri ato, sepse është mbështetur kurdoherë te populli, te forca dhe aftësitë krijuese të tij, sepse ka vendosur lidhje të ngushta me popullin dhe e ka bashkuar atë fort rreth vijës së saj të drejtë.

Populli, masat e gjera punonjëse, klasa jonë punëtore në aleancë me fshatarësinë, janë ajo forcë vendimtare që realizoi transformimet e mëdha politike e shoqërore në vendin tonë, që çliroi atdheun dhe ndërton sot socializmin. Ishin masat e gjera të popullit, punëtorët, fshatarët punonjës, rinia dhe intelektualët tanë popullorë, që bënë Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare. Partia u tregoi atyre se çdo gjë, pavarësia e atdheut dhe e ardhshmeja më e mirë, ishin në duart e tyre dhe ata u ngritën peshë, mbushën radhët e ushtrisë, luftuan me heroizëm. Armiqtë nuk e kuptonin dot atëherë se ku qëndronte forca e Partisë sonë, si munda ajo të organizonte luftën çlirimtare, të krijonte një ushtri të fuqishme dhe të çlironte vendin.

Më vonë, kur Shqipëria doli nga lufta e shkatërruar dhe e varfër, e rrethuar apo e «izoluar», siç u pëlqente armiqve tanë të thoshin, ata, duke na kërcënuar e duke u tallur, na bënë pyetjen: Po tani, si do të bëni, me se do të rroni, si do të jetoni? Por armiqtë u gëzuan para kohe dhe i bënë hesapet pa hanxhinë, pa popullin tonë heroik, që i kishte marrë fatet në duart e veta dhe ishte bërë zot i vendit të vet. I udhëhequr me urtësi nga Partia e tij, populli ynë përveshi krahët, kreu me sukses dhe brenda një kohe të shkurtër transformime të thella ekonomiko-shoqërore, duke kapërcyer me vetëmohim e me këmbëngulje të gjitha vështirësitë, shëroi plagët e tmerrshme të luftës, bëri rindërtimin e vendit dhe përgatiti kushtet për të filluar në shkallë të gjerë ndërtimin e bazave të socializmit në atdheun tonë.

Shpesh edhe miq, që kanë vizituar Shqipërinë ose që nga larg ndjekin me interesim realizimet e vendit tonë, habiten dhe bëjnë pyetjen: Si u qëndroi Shqipëria e vogël gjithë atyre rrebesheve, si doli ajo ngadhënjimtare në luftën e pabarabartë me okupatorët fashistë dhe tradhtarët, si u reziston kërcënimeve e presioneve të panumërta të imperialistëve, të shovinistëve e të klikës tradhtare të Beogradit, si i kapërcen vështirësitë dhe arrin suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat e ndërtimit socialist? Ne u përgjigjemi, se faktori vendimtar për arritjen e të gjitha fitoreve historike të vendit tonë është vetë populli, lufta dhe puna e tij, vija e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila ka ditur t'i bëjë masat të ndërgjegjshme dhe t'i mobilizojë në luftën për çlirimin dje, dhe në luftën për mbrojtjen e

pavarësisë dhe për ndërtimin e socializmit sot, lidhja e pathyeshme e popullit me Partinë. Ne u përgjigjemi se një faktor tjetër i rëndësishëm është mbështetja, ndihma dhe miqësia e popujve vëllezër të vendeve socialiste, përkrahja e gjithë proletariatit ndërkombëtar. Partia jonë e ka lidhur popullin me një miqësi e dashuri të pathyeshme me popujt e vendeve të tjera, me popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik, të Kinës Popullore dhe me popujt e tjerë që ndërtojnë socializmin. Armiqtë tanë gjithnjë janë përpjekur ta cenojnë këtë miqësi, por ata nuk kanë për t'ia arritur qëllimit kurrë. Le të marrim miqësinë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Atë e ka rrënjosur thellë në zemrat e gjithë shqiptarëve Partia jonë qysh në ditët më të vështira, qysh atëherë, kur popujt sovjetikë ishin angazhuar në Luftën e madhe Patriotike, qysh atëherë, kur Shqipëria vuante nën thundrën e çizmes fashiste. Në luftë e në gjak, në vëllazërim armësh, në luftë për jetën, për lirinë, për të ardhshmen, u kalit miqësia jonë e madhe, e cila u forcua e u çelikos edhe më shumë gjatë këtyre 16 vjetëve të pasçlirimit. Bashkimi Sovjetik me fitoren e tij mbi fashizmin ndihmoi për çlirimin e popullit tonë; gjithashtu ndihma dhe përkrahja e Bashkimit Sovjetik kanë qenë një faktor i rëndësishëm, i jashtëm, për arritjen e fitoreve tona të mëdha në fushën e ndërtimit socialist.

Populli ynë është trim, punëtor, liridashës, besnik dhe përparimtar. Partia jonë, e edukuar me mësimet e marksizëm-leninizmit, mishëron në veten e saj edhe këto tradita të larta të popullit tonë. Le të jemi të sigurt, shokë, se me një popull të tillë të mrekullueshëm dhe me Partinë tonë, besnike e të patundur ndaj marksizëm-

-leninizmit e ndaj internacionalizmit proletar, në miqësi të ngushtë me popujt vëllezër e partitë motra të botës, vendi ynë do të ecë përpara, kurdoherë përpara, se nuk ka dallgë e as stuhi që ta trembin atë, nuk ka forcë në botë që të ndalojë marshimin tonë fitimtar drejt triumfit të socializmit dhe të komunizmit.

Shokë,

Viti në të cilin kemi hyrë është viti i një përvjetori të madh, viti i 20-vjetorit të lavdishëm të themelimit të Partisë sonë heroike. Njëzet vjet të jetës së Partisë sonë janë vite fitoresh historike, të cilat e nxorën popullin e atdheun tonë nga robëria në liri, nga errësira në dritë, nga padija e prapambetja në rrugën e diturisë dhe të përparimit.

Suksese të mëdha, fitore të reja, perspektiva madhështore do të kemi përpara. Me punën tonë të pakursyer, në një unitet të çeliktë të radhëve tona, le të mobilizohemi të gjithë, le të ngremë peshë mbarë popullin shqiptar, klasën punëtore heroike, fshatarësinë punonjëse, inteligjencën tonë, rininë e lavdishme dhe gratë e vendit tonë për të kryer me nder detyrat e mëdha që shtron plani i tretë pesëvjeçar, për ta bërë atdheun tonë edhe më të bukur, edhe më të pasur, edhe më të fortë, për të ndërtuar shoqërinë socialiste!

Le ta bëjmë vitin 1961, vitin fillestar të planit të tretë pesëvjeçar, vitin e përvjetorit të madh të Partisë sonë, një vit suksesesh e fitoresh të reja, ashtu siç i ka hije gjithmonë Partisë sonë heroike!

Lavdi popullit tonë heroik dhe Partisë së tij të

Punës, organizatores dhe udhëheqëses të të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit, shkencës sonë fitimtare!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 39 (3883), 14 shkurt 1961

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LAVDI NË SHEKUJ GJERGJ DIMITROVIT!

*Fjala e ndërhyrjes me rastin e dorëzimit si dhuratë
të bustit të Gjergj Dimitrovit*

15 shkurt 1961

Në fund të përshëndetjes së tij, kryetari i delegacionit të Partisë Komuniste të Bullgarisë i dhuroi Kongresit IV të PPSH një bust të Gjergj Dimitrovit. Në këtë kohë, midis duartrokitjesh të stuhishme dhe ovacionesh të gjata për nder të Gjergj Dimitrovit, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Shokë delegatë,

Unë e kam njohur personalisht të lavdishmin Gjergj Dimitrov, mikun e shtrenjtë të popullit shqiptar. Ai e donte popullin tonë me gjithë zemër, siç e do populli bullgar, siç e do partia e lavdishme e Bllagojevit dhe e Dimitrovit. Edhe ne e duam me gjithë zemër popullin bullgar, me të cilin na lidh një miqësi e fortë dhe luftarake.

Të ndjekim me besnikëri këshillat e Gjergj Dimitrovit! Ne i duam popujt që luftojnë për liri, për pavarësi e për demokraci, ashtu siç i ka dashur i paharruari Dimitrov.

Besoj se shpreh vullnetin tuaj të falënderoj Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë për këtë dhuratë të çmueshme që i bën Kongresit tonë.

Lavdi në shekuj Gjergj Dimitrovit, nxënësit besnik të V.I. Leninit, bashkëpunëtorit të ngushtë dhe të vendosur të J. V. Stalinit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 41 (3884), 16 shkurt 1961

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE ZGJEDHIM NJË UDHËHEQJE TË ÇELIKTË, ASHTU SIÇ IA DO ZEMRA PARTISË

*Fjala në emër të përfaqësisë në Kongresin IV
të PPSH*

20 shkurt 1961

Shokë, përfaqësia në mbledhjet e saj hartoi listën e kandidaturave për anëtarë dhe për kandidatë të Komitetit Qendror që do t'i paraqiten Kongresit IV të Partisë për shqyrtim dhe për aprovim dhe pastaj të kalojmë në votime.

Përfaqësia u udhëhoq nga pikëpamja e rëndësishme që në udhëheqjen e Partisë të vihen shokët më të mirë dhe më besnikë, ata që kanë një të kaluar të pastër, që kanë treguar zotësi gjatë luftës së çlirimit dhe gjatë periudhës së jetës së lirë të popullit tonë, që ndërton socializmin. Me një fjalë për të vënë në listë ata shokë që kanë besimin e plotë të të gjithë Partisë, si edhe garancitë për të zbatuar me përpikëri vijën e saj, për mbrojtjen e Partisë, të popullit dhe të marksizëm-leninizmit.

Mund të themi se Partia jonë ka kalitur kuadro të

tillë që, jo një, po disa komitete qendrore mund të nxjerrë. (*Duartrokitje të stuhishme dhe brohoritje të gjata «Parti e Punës — Parti e Punës»*). Kjo është një forcë e madhe e Partisë sonë. Edhe shokët e rinj që vijnë në Komitetin Qendror, janë shokë që nuk kanë ndryshime të mëdha nga qindra e qindra shokë të tjerë, të cilët nuk janë në udhëheqje. Ky është rezultat i luftës njëzetvjeçare të Partisë sonë, e cila jo vetëm ka zbatuar në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, por, duke luftuar me një heroizëm të tillë si për çlirim e atdheut, ashtu edhe për ndërtimin e socializmit, ajo vazhdimisht ka kalitur, ka edukuar dhe ka rritur kuadro të tillë të çeliktë.

Në një mbledhje ndërkombëtare të shtabeve të ushtrive të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës në Moskë, gjatë një pushimi, një gjeneral i një shteti të demokracisë popullore të Evropës në bisedë me një oficer të ushtrisë sonë, që mbante në gjoks dhjetë dekorata, e pyeti se ku i kishte marrë gjithë ato dekorata. «Në luftë», iu përgjigj oficeri ynë. «Po atëherë përse nuk të bëjnë gjeneral?», i tha ai. «Po sikur të më bëjnë gjeneral, u përgjigj ushtaraku ynë, në vendin tonë duhet të kishte me mijëra të tillë». (*Duartrokitje të vazhdueshme*).

Mbledhja e përfaqësisë e gjeti të arsyeshme që të gjithë shokët e mëparshëm të Komitetit Qendror, anëtarë e kandidatë, në bazë të punës, të vendosmërisë dhe të besnikërisë së tyre ndaj Partisë t'i paraqitë përsëri në listën që do t'ju lexohet juve, shokë delegatë. (*Duartrokitje*).

Kjo nuk do të thotë se të tërë shokët e mëparshëm i kanë kryer si duhet të gjitha detyrat që u ka ngarkuar

Partia jonë. Janë vërtetuar edhe të meta e gabime. Por një gjë duhet thënë, se shokët e Komitetit Qendror kanë vënë të gjitha forcat dhe dituritë e tyre për të kryer me nder detyrat që u ka ngarkuar Partia.

Momente të vështira kemi kaluar. Sidomos këto kohët e fundit kemi kaluar prova jashtëzakonisht të rënda dhe përpara këtyre provave si e gjithë Partia, ashtu edhe shokët e Komitetit Qendror, kanë mbajtur një qëndrim shembullor, marksist-leninist. *(Thirrje «Rroftë Komiteti Qendror i Partisë sonë me shokun Enver Hoxha në krye!» dhe duartrokitje të gjata).*

Disa nga delegatët e huaj që ndodhen në Kongresin tonë, thirrjet e delegatëve për Partinë dhe për udhëheqjen e saj i interpretojnë se te ne ka kult të individit. Por ata duhet të kuptojnë se në Partinë tonë nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë kult të individit. Para qëndrimeve jo të drejta dhe intrigave të disave prej atyre që kërkojnë ta shpartallojnë Partinë tonë, Kongresi u tregua i fortë dhe i bashkuar si grusht. As Partia, as ju, as udhëheqja, as unë, për asnjë moment, nuk do të lejojmë që të zhvillohet kulti i individit në Partinë tonë, po ata që nuk e duan Partinë tonë, le të shohin se ç'unitet ka në të.

Ata që propozohen të vijnë të rinj në Komitetin Qendror, nga mosha janë «me mjekër» (të qeshura), megjithëse disa janë edhe të rinj, por Partia duhet të mendojë për të forcuar radhët e saj, prandaj në çdo kongres duhet t'i silltë udhëheqjes gjak i ri, domethënë të zgjidhen në Komitetin Qendror edhe shokë të rinj me perspektivë, sepse edhe ne më të vjetrit, njerëz jemi, vitet shkojnë dhe plakemi *(duartrokitje, thirrje*

«Rroftë sa malet shoku Enver Hoxha!», «Rroftë Komiteti Qendror i Partisë!»), prandaj të përgatitim vazhdimisht për Partinë njerëz të rinj për në udhëheqje të saj, të cilët të fitojnë stazh dhe udhëheqja e Partisë të ketë vazhdimësi, domethënë të ketë në udhëheqje njerëz jo vetëm të kalitur në punët e veçanta që bën secili, por edhe për udhëheqje.

Edhe në Kongresin III u sollën në udhëheqje shokë të rinj që, po t'i krahasosh nga stazhi, janë shumë më të rinj nga qindra e nga qindra shokë që ka Partia jonë, që kanë dhënë prova të mëdha për Partinë. Por ata e kanë merituar besimin e Partisë. Prandaj, edhe të rinjtë që propozojmë, atje ku punojnë kanë vënë të gjitha forcat dhe kanë treguar me të vërtetë ndërgjegje të lartë në detyrë dhe në perspektivë ata do të bëhen udhëheqës të kalitur në një shkallë më të lartë. Kjo është detyra e kongreseve të Partisë.

Shokët që do të propozojmë njihen të gjithë. Megjithatë, ne kemi përgatitur të dhëna biografike për ta. Të kemi parasysh që të zotërojmë mbi të gjitha interesin e Partisë. Këtu jemi në Kongres, prandaj çdo delegat duhet të thotë haptazi dhe pa druajtje pikëpamjen e tij për çdo kuadër, t'i bëjë kritikë cilitdo qoftë prej kandidatëve kur në mendjen e tij e gjykon se duhet bërë, në mënyrë që Komiteti i ri Qendror të jetë një udhëheqës i denjë për Partinë tonë të lavdishme marksiste-leniniste. Me siguri, Kongresi ynë do të tregojë edhe një herë unitetin e çeliktë të të gjithë Partisë, prandaj ta zgjidhim këtë problem me rëndësi ashtu si ia do zemra Partisë dhe udhëheqja të jetë e çeliktë si kurdoherë, në unitet të plotë.

Tani po ju lexoj konkretisht emrat ngadalë, ju mbani shënim dhe pastaj fillojmë nga shqyrtimi i çdo kandidature një e nga një. Por, më parë se të paraqit listën, të aprovojmë numrin. Në Plenumin e mëparshëm të Komitetit Qendror kishim 65 veta, 43 anëtarë dhe 22 kandidatë. Tani propozojmë që i gjithë Plenumi i Komitetit Qendror të përbëhet prej 82 vetash, nga të cilët 53 anëtarë dhe 29 kandidatë.

Keni vërejtje për numrin? Partia jonë tani është zmadhuar, punët janë shtuar, prandaj ka plot arsye që të shtohen radhët e Plenumit të Komitetit Qendror.

Kongresi, pasi votoi për numrin, shqyrtoi një për një listën emërore për përbërjen e Plenumit të ri të Komitetit Qendror, që e paraqiti shoku Enver Hoxha në emër të mbledhjes së përfaqësisë dhe pastaj u procedua në zgjedhjet me votim të fshehtë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë Kongres që gjendet në AQP

**NE KEMI PËRGJEGJËSI TË DYFISHTË, TË RËNDË
POR TË LAVDISHME: SI ANËTARË PARTIE
DHE SI UDHËHEQËS**

*Fjala në Plenumin I të KQ të PPSH të zgjedhur
në Kongresin IV të PPSH¹*

20 shkurt 1961

Shokë, mbledhjen e parë e hapim, shumica e shokëve që u zgjodhën sot nga Kongresi për në Plenumin e KQ janë të pranishëm.

Tani fjalë shumë nuk duhen. Këtë e them se kemi pak kohë në dispozicion dhe delegatët e Kongresit na presin t'u japim rezultatin e mbledhjes së parë të Plenumit.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm, jo vetëm për ndërin e madh që na bëri Partia jonë e mrekullueshme, por edhe për përgjegjësinë dhe për barrën e rëndë që kemi tani në supet tona. Prandaj edhe ne, më shumë se kurdoherë, të vëmë të gjitha forcat tona atje ku na

¹ Në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje ishte: Zgjedhja e Byrosë Politike, e Sekretariatit dhe e Sekretarit të Parë të KQ të PPSH.

ka caktuar Partia, për t'i kryer me nder detyrat si udhëheqës, të mbrojmë vijën e Partisë si sytë e ballit, sepse Partia është gjithë jeta jonë. Prandaj të punojmë që edhe gjithë populli ynë të zbatojë me vendosmërinë më të madhe vijën e Partisë sonë dhe ta mbrojë këtë vijë të drejtë nga çdo shtrembërim, nga e djathta ose nga e majta.

Të ruajmë unitetin e Partisë si jetën tonë, sepse uniteti i Partisë është gjithçka, se nga uniteti varen të gjitha fitoret tona, ndërtimi i mëtejshëm i socializmit, jeta e popullit tonë. Uniteti i çeliktë i Partisë sonë u duk qartë gjatë punimeve të Kongresit. Delegatët e Partisë në këtë Kongres manifestuan një unitet të çeliktë që nuk është parë asnjëherë në historinë e Partisë sonë. (*Duartrokitje të stuhishme*). Prandaj ta ruajmë dhe ta kalitim këtë unitet.

Një çështje tjetër që dua të theksoj dhe që ka rëndësi të madhe është ajo se gjithë kjo forcë, gjithë kjo drejtësi e madhe që tregoi Kongresi ynë, duhet të jenë në dorën e çdo anëtarit të Partisë dhe sidomos të çdo udhëheqësi të Partisë, flamur me të cilin të punojmë dhe të luftojmë. Të vëmë të gjitha forcat mendore, fizike dhe organizative për t'i realizuar me sukses planet tona ekonomike. T'i japim popullit ato që u vendosën nga Kongresi, ta bëjmë popullin tonë të lumtur e të gëzuar, ky është qëllimi më i lartë i Partisë sonë dhe e gjithë veprimtaria e Partisë sonë në këtë objektiv duhet të përqëndrohet. Prandaj ne kemi përgjegjësi të dyfishtë, të rëndë, por të lavdishme, si anëtarë partie dhe si udhëheqës, por kemi besim të plotë se do t'i kryejmë ato. (*Duartrokitje*).

Të jemi të mobilizuar si kurdoherë në luftë kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern, atij jugosllav dhe çfarëdo revizionizmi tjetër.

Ju, shokë, patë shumë gjëra në Kongres. Ne do të kemi rast të mbledhemi përsëri, po dua të theksoj që të mbajmë kurdoherë lart vigjilencën revolucionare, duke dërrmuar të gjitha orvatjet e revizionistëve modernë për të përçarë Partinë tonë, ashtu sikurse i dërrmoi Kongresi ynë. *(Duartrokitje të vazhdueshme).*

Tani, mbledhjes së parë të Plenumit i bie detyra e madhe për të zgjedhur Byronë Politike dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror. Unë mendoj se ka ardhur koha që Byroja Politike e Komitetit Qendror të zgjerohet pak, të mos jetë më prej 9 vetash, po prej 11 vetash. *(Duartrokitje).* Tani Partia jonë ka kalitur kua-dro të tillë dhe ajo ka kurdoherë parasysh që të sjellë në Byronë Politike njerëz nga më të mirët e Partisë, shokë të sprovuar, të sjellë gjithashtu si kandidatë të Byrosë Politike shokë me perspektivë që të edukohen e të stërviten me këtë punë nga më të rëndat e me shumë përgjegjësi, por të lavdishme, siç është qenia në Komitetin Qendror dhe në Byronë Politike.

Pra propozojmë që Byroja Politike të përbëhet nga 11 anëtarë dhe 4 kandidatë. Keni vërejtje?

I gjithë Plenumi njëzëri aprovoi propozimin që Byroja Politike të përbëhet nga 11 anëtarë dhe 4 kandidatë. Pastaj shoku Enver Hoxha paraqit listën emërore dhe shtoi:

Si doni të bëhet votimi një nga një apo me listë. *(Plenumi aprovoi njëzëri propozimet e bëra nga shoku Enver Hoxha).*

SHOKU MEHMET SHEHU: Para se të zgjedhim Sekretariatin propozoj që shoku Enver Hoxha të jetë Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH.

Plenumi shpërtheu në duartrokitje të stuhishme. Shoku Enver Hoxha u zgjodh Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH. Pastaj u zgjodh Sekretariati i KQ të PPSH dhe përmes duartrokitjesh të zjarra shoku Enver Hoxha deklaroi të mbyllur mbledhjen e parë të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë Plenum që gjendet në AQP

**TË SHPIEM NË ORGANIZATAT-BAZË DHE
NË POPULL FRYMËN LUFTARAKE
TË KONGRESIT IV**

Fjala e mbylljes në Kongresin IV të PPSH

20 shkurt 1961

Të dashur shokë delegatë dhe delegate,

Sot po përfundojmë punimet e Kongresit tonë IV, Kongresit që do të shënohet në historinë e Partisë e të popullit tonë si një nga ngjarjet më të mëdha. Në Kongres u shpreh fare qartë pjekuria marksiste-leniniste e Partisë sonë të lavdishme, guximi dhe trimëria e saj, u shpreh unanimiteti i saj i çeliktë, i pathyeshëm dhe vendosmëria për ta forcuar atë edhe më shumë, si garanci e dorës së parë për të arritur fitore të reja edhe më të mëdha për të mirën e atdheut, për begatinë dhe për lumturinë e popullit, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së Republikës sonë Popullore, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Diskutimet e gjalla dhe në një nivel të lartë si dhe entuziazmi e optimizmi i papërsHKruar, që karakterizuan punimet e Kongresit, janë një garanci e madhe se Partia jonë he-

roike do të zbatojë në jetë, do të bëjë realitet detyrat madhështore që vendosi ky Kongres, se do të plotësojë me siguri detyrat që rrjedhin nga plani i tretë pesëvjeçar.

Popullin dhe atdheun tonë, shokë dhe shoqe, i presin një e ardhshme e mrekullueshme, i presin perspektiva të shkëlqyera. Me planin e tretë pesëvjeçar ne po futemi në një etapë të re historike të zhvillimit të shoqërisë sonë, në etapën e ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit. Në marshimin tonë të vrullshëm drejt fitoresh të reja, do të kemi edhe vështirësi e pengesa. Por kështu siç dëshmoi Kongresi ynë, ne mund të themi me siguri se nuk ka e nuk do të ketë vështirësi e pengesa që të mos i kapërcejnë me sukses Partia jonë dhe populli ynë i lavdishëm, nuk do të ketë kështjellë që ne komunistët shqiptarë të mos ta marrim. Ne do të çajmë përpara, do të ndërtojmë socializmin e komunizmin, sepse kemi një Parti heroike, revolucionare, monolite e të pjekur. Partia jonë është Partia që organizoi dhe që udhëhoqi me heroizëm luftën për çlirimin e atdheut dhe pas çlirimit luftën për ndërtimin e socializmit, është Partia që ripërtëriti e ngriti edhe më lart dinjitetin, nderin dhe lavdinë e popullit tonë heroik, traditat e tij të shquara patriotike. Partia jonë është Partia e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut tonë, është Partia që lufton me guxim e me vendosmëri kundër armiqve të lirisë dhe të sovranitetit të popullit tonë, kundër armiqve të marksizëm-leninizmit.

Kongresi ynë i mrekullueshëm e luftarak tregoi fare qartë se edhe në të ardhshmen Partia jonë do të

luftojë me guxim e trimëri, ashtu si deri tani, pa iu shmangur, për asnjë arsye, këtyre qëllimeve fisnike. Entuziazmi, me të cilin zhvilloi punimet Kongresi ynë dhe u aprovuan detyrat tona të ardhshme, do të përshkojë të gjitha masat punonjëse të popullit tonë, do t'i çojë peshë ato, do t'u japë krahë e besim për të realizuar me sukses detyrat madhështore të planit të tretë pesëvjeçar, për ta bërë vendin tonë më të fortë, më të pasur, më të bukur dhe jetën e popullit më të mirë. Ju, shokë delegatë, udhëheqës të organizatave të Partisë e të pushtetit, ju shokë delegatë, përfaqësues të klasës sonë të lavdishme punëtore, të rinisë sonë heroike, të grave të vendit tonë, të inteligjencës popullore, ju shokë punëtorë e kooperativistë, duke dhënë kurdoherë shembullin tuaj personal, duhet të bëheni flamurtarët, organizatorët dhe drejtuesit e inisiativave të mëdha, të mobilizimit të përgjithshëm të popullit tonë, të vrullit të paparë ndonjëherë në historinë e vendit tonë, që duhet të përfshijë të gjithë punonjësit për të vënë në jetë detyrat që caktoi Kongresi ynë. Ju duhet të çoni kudo, në qendrat e punës, në fshatrat, në institucionet kulturore e arsimore, në të katër anët e atdheut tonë, entuziazmin e madh, optimizmin revolucionar dhe besimin e patundur në fitoren që u shpreh kaq me qartësi në Kongresin tonë historik. Ju, shokë delegatë, e në mënyrë të veçantë, ju, shokë që përfaqësoni organizatat e Partisë në forcat e armatosura të popullit tonë, duhet të çoni në organizatat tuaja, në masat e gjera të popullit, në repartet e ndryshme, deri te postat më të veçuara të kufirit, frymën luftarake të Kongresit tonë, vendosmërinë që u shpreh këtu për të mbrojtur, qoftë edhe me

jetën tonë, lirinë e pavarësinë e atdheut, fitoret e shkëlqyera të revolucionit tonë socialist. Ju, shokë delegatë, duhet të forconi në masa edhe më tej vigjilencën revolucionare, për t'i mbyllur çdo shteg veprimtarisë së armiqve, të cilët nuk kanë hequr dhe nuk do të heqin dorë nga veprimet e tyre kriminale për të komplotuar kundër atdheut tonë, për të përçarë popullin dhe Partinë tonë heroike. Kongresi ynë i Partisë, unanimiteti i tij i çeliktë, e tregoi mirë vendosmërinë e Partisë sonë të lavdishme për të luftuar me guxim për mbrojtjen e fitoreve të popullit tonë, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë sonë kombëtare, për mbrojtjen e unitetit të pathyeshëm të Partisë sonë heroike dhe të vijës së saj të përgjithshme, kundër çdo armiku nga çdo anë që të vijë.

Flamuri i të gjitha fitoreve të Partisë sonë kurdoherë ka qenë, është dhe do të jetë flamuri fitimtar i ideologjisë së pavdekshme të marksizëm-leninizmit. Mësimet e marksizëm-leninizmit qëndrojnë në themelin e vijës së përgjithshme të Partisë sonë, në themelin e të gjitha fitoreve tona. Kongresi ynë tregoi më së miri besnikërinë e patundur të Partisë sonë ndaj doktrinës sonë ngadhënjimtare, tregoi vendosmërinë tonë të pafund për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese. Partia jonë, duke u udhëhequr nga vendimet dhe nga fryma luftarake e Kongresit tonë historik, ashtu si deri tani edhe në të ardhshmen duhet të luftojë me guxim, me vendosmëri, pa u lodhur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga çdo shtrembërim. Duke luftuar me guxim për mbrojtjen e paqes, për demaskimin e luftënxitësve imperialistë, e veçanërisht kundër imperialistëve amerika-

në, si armiku kryesor i njerëzimit, ashtu siç e tregoi edhe Kongresi ynë, ne duhet të luftojmë edhe në të ardhshmen po aq me guxim e me vendosmëri edhe kundër revizionistëve modernë, që u shërbejnë qëllimeve të imperializmit amerikan, armiq të betuar të socializmit e të unitetit ndërkombëtar të lëvizjes komuniste dhe punëtore, armiq të vendosur të lirisë dhe të pavarësisë së popullit dhe të Partisë sonë. Kjo ka qenë dhe është vija e Partisë sonë, e cila u aprovua unanimisht nga Kongresi IV, kjo do të jetë edhe në të ardhshmen vija jonë, të cilën e vendosi unanimisht Kongresi ynë dhe që do të zbatohet me vendosmëri, pa asnjë lëkundje, si më parë, gjithë Partia jonë dhe Komiteti i ri Qendror që zgjodhi ky Kongres. Ky është vullneti i gjithë Partisë, i gjithë popullit që u shpreh me aq forcë nga delegatët e saj në këtë Kongres, dhe për ne, për të gjithë komunistët shqiptarë, vullneti i Partisë është ligj absolut, i paprekshëm, i papërkulshëm.

Kongresi ynë ishte shprehja më e qartë e frymës së thellë internacionaliste të Partisë sonë, shprehja e frymës së solidaritetit të pathyeshëm të Partisë dhe të popullit tonë me të gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, me të gjithë popujt që luftojnë për paqen, demokracinë, pavarësinë kombëtare dhe socializmin. Partia jonë, si një repart i lëvizjes së komunizmit botëror, është edukuar me ndjenjat e thella të internacionalizmit proletar, me ndjenjat e dashurisë, respektit dhe të solidaritetit me të gjithë komunistët e të gjitha kontinenteve, me të gjithë popujt e të gjitha vendeve që luftojnë kundër shtypjes dhe kundër shfrytëzimit. Këtë frymë të lartë internacionaliste Partia jonë do ta

ruajë e do ta zhvillojë edhe në të ardhshmen ashtu siç e shprehu këtë Kongresi. Në punimet e Kongresit tonë morën pjesë edhe përfaqësues të 24 partive të ndryshme komuniste e punëtore dhe dërguan mesazhe përshëndetjeje edhe 12 parti të tjera. Ne, komunistët shqiptarë, e konsiderojmë këtë fakt si një shprehje të miqësisë, të solidaritetit internacionalist dhe të dashurisë që kanë për Partinë dhe për popullin tonë këto parti. Prandaj më lejoni, të dashur shokë, që në emrin tuaj, në emër të të gjithë Partisë dhe të gjithë popullit tonë t'u shpreh falënderimet më të mira partive komuniste, që dërguan përfaqësuesit e tyre në Kongresin tonë ose mesazhe, për solidaritetin internacionalist që treguan ndaj Partisë e popullit tonë. Më lejoni, nga ana tjetër, të siguroj në emrin tuaj dhe të gjithë Partisë e popullit tonë, partitë komuniste e punëtore se Partia jonë e Punës do të jetë edhe në të ardhshmen, ashtu si deri tani, një luftëtare e vendosur për të mbrojtur marksizëm-leninizmin. Partia e Punës e Shqipërisë do të plotësojë me nder të gjitha detyrimet e saj internacionaliste ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare në këtë skaj të Ballkanit. Ne i sigurojmë miqtë dhe shokët tanë, se ashtu siç e tregoi Kongresi, ne do të luftojmë për vënien në jetë të vijës sonë të përgjithshme që u aprovua njëzëri pa asnjë hezitim, pa u trembur nga asnjë vështirësi, nga asnjë pengesë dhe do të dalim fitimtarë. Siç e tregoi qartë Kongresi ynë, Partia jonë e Punës dhe gjithë populli shqiptar, që si një trup i vetëm është bashkuar me Partinë, janë të vendosur të ecin krah për krah me popujt vëllezër drejt fitores së socializmit dhe të komunizmit.

Shokë delegatë,

Garancia e të gjitha fitoreve të Partisë sonë kurdoherë ka qenë uniteti i çeliktë i radhëve tona, uniteti i pathyeshëm i Partisë me masat e gjera punonjëse, uniteti që në mënyrë madhështore u shpreh në Kongresin tonë IV. Para këtij uniteti janë dërrmuar e janë bërë thërrime përpjekjet e ndryshme të armiqve të Partisë dhe të popullit tonë, janë shpartalluar tentativat e tyre për të dëmtuar interesat e Partisë dhe të popullit, për të nxjerrë nga rruga e saj e drejtë Partinë tonë të lavdishme, për të penguar ndërtimin socialist të atdheut tonë.

Detyra jonë është që këtë unitet, unitetin e radhëve të Partisë si dhe unitetin me masat e popullit ta forcojmë gjithnjë e më shumë, ta bëjmë çelik dhe të pathyeshëm, ashtu siç u tregua çelik dhe i pathyeshëm uniteti i Kongresit tonë historik. Kjo do të prishë të gjitha llogaritë e armiqve dhe do të bëjë që populli dhe Partia jonë, duke zbatuar me vendosmëri vendimet historike të Kongresit IV, të ecë përpara nga fitorja në fitore. Të shkojmë, shokë, me forca të shumëfishuara në organizatat tona, në masat e gjera të popullit, të çojmë te ato frymën e këtij Kongresi, entuziazmin dhe optimizmin, që u shpreh këtu, vendosmërinë dhe besimin për fitore të reja dhe të vëmë në jetë vendimet e Kongresit për të siguruar suksese të reja në ndërtimin socialist të vendit. Ne ju premtojmë dhe ju betohemi se Komiteti Qendror i ri që u zgjodh nga ky Kongres, me punën dhe me luftën e tij do të meritojë plotësisht besimin e madh të Partisë dhe do të luftojë me të gjitha

forcat e tij për të zbatuar me besnikëri, me guxim e me trimëri vendimet që u aprovuan, duke mbajtur kurdoherë lart dhe pa njollë nderin e Partisë sonë, emrin e Partisë sonë, flamurin tonë fitimtar.

Përpara shokë, nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike, nën flamurin e marksizëm-leninizmit fitimtar, drejt suksesesh të reja gjithnjë e më të mëdha, për lumturinë dhe për begatinë e popullit tonë të mrekullueshëm!

Rroftë Kongresi IV i Partisë sonë!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës!

Rroftë populli ynë heroik!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 46 (3889), 21 shkurt 1961

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SHPIFJET DHE PRESIONET NUK NA FRIKËSOJNË — NE NUK GJUNJËZOHEMI

*Nga biseda me delegacionin e Partisë Komuniste
të Bashkimit Sovjetik që mori pjesë
në Kongresin IV të PPSH¹*

20 shkurt 1961

Në fillim foli P. Pospjellovi², i cili tregoi se qëllimi i kërkesës së delegacionit sovjetik për këtë takim ishte «për të biseduar mbi disa çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet reciproke shoqërore». Ai, pasi tha se vërtet «në Kongresin tuaj u fol shumë për forcimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit sovjetik», por kemi të dhëna se «në Shqipëri mohohet roli i Bashkimit Sovjetik», «specialistët sovjetikë nuk trajtohen mirë», «po shahet udhëheqja sovjetike» e bëri një sërë shpifjesh e presionesh kundër Partisë së Punës të Shqipërisë

¹ Pas Kongresit IV të PPSH, shoku Enver Hoxha priti në selinë e Komitetit Qendror delegacionin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me të cilin zhvilloi një bisedë.

² Kandidat i Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kryetar i delegacionit.

dhe udhëheqjes së saj. Pasi shokët tanë dëgjuan me durim e me gjakftohtësi përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e mori fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: I dëgjuam me shumë vëmendje fjalët tuaja, shoku Pospjellov. Përsa u përket dashurisë dhe besnikërisë së Partisë dhe të popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, këtë e kemi treguar në jetë me vepra. Ne dëshirojmë miqësi të ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në rrugën marksiste-leniniste. Mos mendoni se kujtojmë që kjo miqësi e ngushtë do të forcohet me «frymën e shenjtë». Ne e dimë se kjo miqësi mund të realizohet duke zbatuar drejt dhe me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Ne kurrë nuk i kemi dashur dhe nuk i duam të keqen Bashkimit Sovjetik. Përkundrazi, e kemi dashur dhe e duam Bashkimin Sovjetik. Kush të dojë le të mos u besojë këtyre ndjenjave të zjarrta të popullit dhe të Partisë sonë, ne ecim në rrugën që na mëson marksizëm-leninizmi e Partia jonë.

Ka në botë njerëz që thonë fjalë dashurie për Bashkimin Sovjetik dhe për popullin sovjetik. Po një fjalë e urtë e popullit tonë thotë: «Kur ka shporta fiq, të gjithë të bëhen miq», kurse ne, shqiptarët, miqtë i duam si në kohë të mira, ashtu edhe në kohë të vështira. Po të ndodhë gjë e keqe kundër Bashkimit Sovjetik, po të krijohet një situatë e vështirë për të, jemi ne nga ata që do të hidhen të parët për ta mbrojtur dhe jo Gomulkat me shokë. Nikita Hrushovi mua më ka thënë se «Gomulka vepron si fashist», kurse nga ana tjetër Mikoiani më ka

thënë se «shoku Gomulka është një marksist-leninist i shquar!». Gomulka lëshoi gjithë ato poshtërsi në adresë të Partisë sonë, të delegacionit dhe personit tim që përfaqësonim Partinë tonë në Mbledhjen e Moskës. Ai ka thënë se çështjen e Shqipërisë do ta shikojmë në Traktatin e Varshavës. Vetë ju treguat këtu se Gomulka e të tjerë si ai thonë shumë gjëra kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj. Informacione për thëniet e tij neve na vijnë nga shumë shokë të partive të tjera, por ai dhe kushdo qoftë ta dinë mirë se ne nuk jetojmë nën hijen e Gomulkës. Unë them se fjalët që lëshojnë njerëz të tillë, duke akuzuar Partinë tonë sikur ne nuk e duam Bashkimin Sovjetik, nuk kanë asnjë bazë.

Tani është fakt se ne kemi mosmarrëveshje me udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik. Kjo është e qartë. Kritikat tona, ashtu sikurse na mëson Partia jonë, ashtu sikurse na ka mësuar Lenini, kur erdhi rasti, ne jua thamë haptazi. Mirëpo puna është se këto kritika nga ana juaj u panë shtrembër, ju erdhi hidhur.

Neve as na ka shkuar, as na shkon ndër mend ajo që thatë ju se ne «ndërhyjmë në punët e brendshme të udhëheqjes sovjetike». Kjo nuk është aspak e vërtetë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik janë zot në shtëpinë e tyre, prandaj ne nuk kemi ndërhyrë e nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të Partisë suaj. Por ne gjithashtu nuk lejojmë, në asnjë mënyrë, që udhëheqja sovjetike të ndërhyjë në punët e brendshme të Partisë sonë. Çdo parti është zot në shtëpinë e vet.

Po a duhet të zgjidhen këto mosmarrëveshje që ek-

zistojnë midis partive tona? Ne mendojmë se ato duhen zgjidhur medoemos, por vetëm në rrugë marksiste-leniniste. Tjetër rrugë për ne nuk ka. Kjo është në interesin si të Partisë e të popullit tonë, ashtu dhe në interesin e Partisë Komuniste e të popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të të gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Kemi zhvilluar edhe bisedime dypalëshe për t'i zgjidhur këto mosmarrëveshje. Takimi i fundit është ai që u zhvillua midis përfaqësuesve të të dyja partive tona në Moskë¹. Në këtë takim, nga pala juaj ishin Mikoiani, Kozilovi dhe Andropovi. Udhëzimet që na ka dhënë Komiteti Qendror i Partisë sonë janë që ne të ecim përpara, në rrugën marksiste-leniniste. Për ne nuk ka rrugë tjetër.

Ju mund të keni mendimin tuaj, por edhe ne kemi mendimin tonë. Mendimi ynë është se mosmarrëveshjet që kanë lindur midis dy partive tona nuk mund të zgjidhen në një ditë. Po të mendohet se ato mund të zgjidhen brenda një dite do të gënjenim veten. Prandaj ne duhet të vëmë vullnetin tonë të përbashkët dhe t'i zgjidhim mosmarrëveshjet gradualisht, në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në barazi të plotë. Në këtë mënyrë duhet të kapërcehen ato.

Mirëpo Mikoiani dhe Kozilovi i pritën me këmbët e para shokët e delegacionit të PPSH, bile ata arritën

¹ Është fjala për bashkëbisedimet që u zhvilluan në Moskë më 20 nëntor 1960 pas fjalimit të shokut Enver Hoxha në Mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore. Këto bashkëbisedime u zhvilluan midis delegacionit të PPSH që përbehej nga shokët Mehmet Shehu e Hysni Kapo dhe delegacionit të PK të BS. Takimi u bë me kërkesën e udhëheqjes sovjetike.

deri atje sa t'u thonë shokëve tanë: «Do ta shikoni ç'situata të vështira do të ndodhin në Partinë dhe në popullin tuaj me këtë kthesë që ju po bëni në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik!». Neve na duket se qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë përpara dorës sonë miqësore ka qenë një qëndrim i gabuar dhe gjykimi i çështjeve nga ana e tyre ka qenë gjithashtu shumë i gabuar. Ata duhet ta njihnin mirë Partinë dhe popullin tonë, vijën dhe ndjenjat e popullit e të Partisë sonë. Marrëdhëniet në mes të dy vendeve tona nuk mund të trajtohen në atë mënyrë siç bënë ata.

Të marrim ndihmat ekonomike. Sipas mendimit të Kozllovit dhe të Mikojanit këtu qëndronte e gjithë çështja. Kjo u duk sidomos me qëndrimin që u mbajt ndaj delegacionit tonë ekonomik që erdhi në Bashkimin Sovjetik. Ky delegacion u sorrollat për muaj të tërë në Moskë. Njerëzit tanë shkojnë në Moskë, vijnë rrotull dhe s'përfundojnë dot asgjë me ju, për shkak të qëndrimit që mbani ndaj tyre. Si kujtoni ju nuk i kuptojmë ne qëndrimet tuaja përbuzëse? Drejt e tha pak më parë shoku Mehmet se, kur vijnë jugosllavët, ju i përfundoni bisedimet brenda dhjetë ditëve! Po kështu, në Moskë erdhi edhe ministri i luftës i Indonezisë, të cilit i dhatë menjëherë kredi të mëdha për armatime, kurse Shqipëria e vogël, që është në grykë të ujkut, me të cilën keni nënshkruar marrëveshje dhe që udhëhiqet nga një parti marksiste, lihet mënjanë.

Qeveria sovjetike vë në dyshim edhe ndihmat në kredi që na ka akorduar Bashkimi Sovjetik për pesë-vjeçarin e tretë, për të cilat janë nënshkruar akte zyrtare. Puna arriti gjer aty saqë qeveria sovjetike me

notë zyrtare është përpjekur t'u imponojë Partisë dhe Qeverisë sonë të dërgojë në Moskë një delegacion të nivelit më të lartë «për t'i rishikuar» këto marrëveshje. Natyrisht, për Partinë dhe për Qeverinë tonë një qëndrim i tillë nga ana juaj është i papranueshëm, jomiqësor dhe aspak i drejtë.

Arsyet që ne nuk pranuan ta bëjmë këtë takim ia kemi thënë të gjitha Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me një letër shumë shoqërore. Por duhet theksuar se, fill pas Mbledhjes së Bukureshtit, letrat që Komiteti ynë Qendror i ka drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kanë mbetur të gjitha pa përgjigje. Kjo nuk është korrekte, as e drejtë, as miqësore. Ju thatë se u qenkeni përgjigjur letrave tona, por ne ju themi: shikoni se mund t'ju kenë mbetur nëpër sirtaret e zyrave tuaja, sepse ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Edhe rregullat më të thjeshta të marrëdhënieve midis partive e kërkojnë që letrës duhet t'i përgjigjesh me letër¹ por, e përsëris, përgjigje nga ju ne nuk kemi marrë.

Nga ana juaj nuk po u jepet përgjigje gjithashtu edhe letrave të Qeverisë sonë për shumë probleme të tjera, veçanërisht për probleme të ushtrisë, të cilat janë të lidhura me mbrojtjen e vendit tonë dhe me stërvitjen e ushtrisë, të bazuara, natyrisht, në marrë-

¹ Udhëheqja revizioniste sovjetike evitonte t'i përgjigjej me letra Komitetit Qendror të Partisë sonë, sepse nuk donte që përgjigjet e saj zyrtare të mbeteshin dokumente në Arkivin e Partisë sonë.

veshjet që kemi me qeverinë sovjetike. Ne mendojmë se për të gjitha këto çështje, qoftë pozitivisht, qoftë negativisht, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste dhe qeveria sovjetike duhet t'u ishin përgjigjur Komitetit Qendror dhe Qeverisë sonë. Ne kemi nevojë për ndihmën e shoqi-shoqit dhe kjo ndihmë duhet të ketë një përmbajtje thellësisht internacionaliste.

Dëgjohen fjalë se gjoja ne shqiptarët nuk jemi të kënaqur nga ndihmat që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik! Ne e kemi thënë dhe e themi se Bashkimi Sovjetik i ka dhënë ndihmë popullit tonë. Asnjëherë nuk ia kemi fshehur dhe nuk do t'ia fshehim popullit tonë ndihmën që na ka dhënë dhe na jep Bashkimi Sovjetik. Dua të theksoj gjithashtu se ne e konsiderojmë të dobishme dhe shumë të nevojshme ndihmën që Bashkimi Sovjetik na ka akorduar për pesëvjeçarën e tretë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit tonë. Ne kemi nevojë për ndihmë edhe në të ardhshmen, por këtë ndihmë nuk e lypim. Ndhimën e kërkojmë vetëm në rrugë marksiste nga cilido. Unë ia thashë në sy Nikita Hrushovit se parimet nuk i shkelim, se jemi gati të shtrëngojmë edhe rripin, po vetëm të rrojmë si marksistë. Në qoftë se udhëheqja sovjetike nuk dëshiron të na japë ndihmë, ne nuk mund ta detyrojmë.

Ndihmat e Bashkimit Sovjetik për vendin tonë kanë rëndësi jo vetëm nga ana ekonomike, po edhe nga ana politike. Ne duam që udhëheqja sovjetike të mos e bëjë një gabim të tillë në dëm të Shqipërisë, ajo duhet ta rishikojë këtë çështje. Prandaj, ju lutemi, edhe një herë, ua transmetoni pikëpamjet tona Nikita Hrushovit dhe shokëve të tjerë të udhëheqjes sovjetike.

Nuk është e drejtë që ju vini kusht të zhdukim një herë mosmarrëveshjet politike dhe ideologjike e pastaj të na jepni ndihmat. Ne e kemi nënshkruar bashkërisht marrëveshjen e kredive, jo vetëm në parim, po edhe e kemi detajuar për të gjitha objektet. Mbi këtë bazë erdhën këtu specialistët sovjetikë, u bënë projektet etj. Kurse ju tani kërkonit që ne të vijmë në Bashkimin Sovjetik për t'i rishikuar edhe një herë marrëveshjet! Përse?

Në Mbledhjen e Moskës ju përdorët taktikën, në takime, bile edhe nëpër korridore, të bindnit delegacione të ndryshme se udhëheqësit shqiptarë nuk duan të bisedojnë me ne. Edhe tani po e vazhdoni këtë taktikë, por kjo nuk pi ujë. S'është nevoja ta përsëritim, ne jua kemi thënë qartë arsyen përse nuk vijmë te ju. I thoni Nikita Hrushovit se ne qëndrojmë në të njëjtat pozita.

I thoni gjithashtu Nikita Hrushovit se ne nuk jemi kundër takimeve në nivel të lartë për çfarëdo çështje, me pëlqimin e të dyja palëve. Por qeveria sovjetike kërkon që të shkojë në Moskë një delegacion i nivelit të lartë i Partisë dhe i Qeverisë sonë «për të rishikuar» çështjen e kredive. Vihet pyetja: për cilat kredi? Këto kredi na janë dhënë me protokoll të nënshkruar prej të dyja palëve nga udhëheqës të nivelit të lartë. Për këtë qëllim na dërguan në Moskë mua dhe shokun Mehmet Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë. Pastaj kreditë u detajuan, atje thuhet si do të përdoren ato, afatet kur ato do të jepen, si dhe objektet që do të ndërtohen. Pra, për ne problemi i kredive konsiderohet i zgjidhur. Ne kemi një notë me shkrim të qe-

verisë sovjetike dhe këtu nuk mund të luhet verba volant. Atëherë përse të vijmë ne në Moskë? Vetëm për kredinë prej 70 milion rublash, për të cilën na njoftuat zyrtarisht, të shkonim në Moskë përpara Kongresit të Partisë? Kjo nuk ishte e arsyeshme. Për këtë ne përsëri ju njoftuam zyrtarisht. Marrëveshje për këtë nuk kishim, prandaj caktuam një zëvendëskryeministër për bisedime, ndërsa nga ana juaj u caktua ministri i Tregtisë së Jashtme, Patoliçev, i cili, siç na thatë qysh përpara Mbledhjes së Moskës, do të vinte në Shqipëri për të biseduar, po ai nuk erdhi. Pastaj ne caktuam një zëvendëskryeministër të vinte në Moskë për këto çështje, po ju akoma edhe sot nuk na jeni përgjigjur. Duam të dimë përse nuk na keni dhënë përgjigje?

Ju flitni shumë gjëra kundër nesh, sepse bazoheni në të thënat e njerit dhe të tjetrit. Por në qoftë se do të veprojmë kështu edhe ne, atëherë mund të nxjerrim libra të tërë. Por për hir të miqësisë në mes të popujve tanë thashethemet që dëgjohen poshtë e lart, duhet të kontrollohen me kujdes dhe në frymën miqësore si nga ne, ashtu edhe nga ana juaj. Ç'kanë thënë shumë njerëz sovjetikë për udhëheqjen tonë dhe për mua? E ç'nuk kanë thënë! Shumë nga këta njerëz janë bile me përgjegjësi të larta te ju. Kritika që i bën Partia jonë udhëheqjes sovjetike është thellësisht parimore. Enver Hoxha, Mehmet Shehu dhe udhëheqës të tjerë shqiptarë, kurrë nuk e shajnë Bashkimin Sovjetik. Duke vënë në dukje gabime e faje të disa udhëheqësve sovjetikë, kjo nuk do të thotë se ne flasim kundër Bashkimit Sovjetik. Këtë e them këtu, e kemi provuar

në jetë dhe do ta provojmë kurdoherë që të jetë nevoja. Ne themi me plot gojën se shqiptarët janë miq të ngushtë e besnikë të Bashkimit Sovjetik dhe në saje të kësaj miqësie ne duhet ta rregullojmë çdo gjë në rrugën marksiste-leniniste, jo në rrugë tjetër. Në qoftë se ka në udhëheqjen sovjetike shokë që vazhdojnë të flasin keq, të shpifin për udhëheqjen ose Partinë tonë, ata gabojnë rëndë.

Ju thoni se keni rrugën që na ka caktuar Deklarata e Moskës dhe Kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Edhe ne mbështetemi në Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit të kaluar, bile e zbatojmë atë me konsekuencë, por përsa i përket Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në Mbledhjen e Moskës ne folëm haptazi se me cilat çështje nuk jemi dakord. Por ju, në vend që të pranoi kritikën shoqërore që ju bëjmë, na akuzoni se jemi prishës të miqësisë me Bashkimin Sovjetik! Nuk është nevoja të them se ç'miqësi të madhe dhe të sinqertë kemi pasur ne me njerëzit sovjetikë. Janë kua-dro e udhëheqës sovjetikë që i kanë vënë minat miqësisë që ekzistonte midis nesh. Ne e thamë edhe në Mbledhjen e Moskës se këtë situatë e ka prishur, në radhë të parë, ish-ambasadori i BRSS në Shqipëri, V.I. Ivanovi. Ky i trubulloi punët. Këtë le ta dijë edhe ambasadori i ri Josif Shikin, i cili ka mundësi të vërë të gjitha forcat që situatën jonormale që është krijuar midis dy vendeve tona ta përmirësojmë së bashku. Nga ana jonë do të bëjmë gjithçka është e mundur në këtë drejtim. Duam të besojmë se edhe shoku ambasador do të veprojë kështu, sepse edhe për atë është jo vetëm

një detyrë, po edhe një nevojë e ngutshme që marrëdhëniet tona të shkojnë duke u përmirësuar dhe mosmarrëveshjet gradualisht të eliminohen në rrugë marksiste-leniniste.

Tani të vijmë në disa çështje të tjera që na parashtruat. Nga ana jonë ne nuk i pranojmë akuzat tuaja lidhur me specialistët sovjetikë në vendin tonë. Ju «çuditeni» përse ne «kontrolluam sirtaret e tavolinave të gjeologëve». T'jua shpjegoj si qëndron kjo çështje, për të cilën ju keni bërë edhe një notë qeveritare. Njerëzit tanë, që ushtruan kontroll mbi ruajtjen e sekretit, nuk e bënë këtë as në mënyrë demonstrative, as me qëllim që të poshtërojnë specialistët sovjetikë. Në shtetin tonë ka një rregull të vënë nga Partia, sipas të cilit herë pas here duhen bërë kontrole. Një rregull të tillë, sigurisht, e keni edhe ju, bile ne nga ju e kemi marrë këtë eksperiencë. Qëllimi është që të ruhen sekretet shtetërore dhe të Partisë. Kontrole të tilla ne bëjmë dy-tri herë në vit në të gjitha aparatet e shtetit dhe të Partisë. Ky ishte një kontroll i tillë i zakonshëm. Ju e dini se as njerëzit tanë nuk janë engjëj, po as tuajt nuk janë engjëj. Por është konstatuar se ka edhe nga njerëzit tanë edhe nga tuajt që dokumentet i lënë nëpër tavolina, bile ka pasur shokë sovjetikë që kanë varur dokumente edhe nëpër mure. Ne jetojmë të rrethuar, kemi rreth e rrotull armiq të betuar, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë. Kemi të dhëna se janë aktivizuar agjenturat e shteteve imperialiste në Shqipëri. Prandaj Partia dhe shteti ynë kujdesen që sekretet të ruhen me rreptësinë më të madhe. Nga ky kontroll që u bë në ndërmarrjet

e naftës, iu dërgua Komitetit Qendror një raport, me të cilin u vu në dijeni se përgjegjësi i specialistëve sovjetikë të naftës ishte lajmëruar qysh më parë për këtë kontroll, i ishte thënë me ç'qëllim bëhej dhe ai ka qenë dakord. Po të doni mund t'ju japim edhe emrin e tij.

Ne nuk i kemi bërë çështje këto gjëra, po unë mund t'ju them edhe një gjë tjetër që ka një karakter shumë më të rëndë. Njerëzit sovjetikë kanë një plan pune. Mirëpo, një gjeolog sovjetik, në vend që të punonte në bazë të planit të caktuar nga qeveria, bënte harta me një shkallë tjetër nga ato që i kërkohehin dhe, kur e pyetën shokët tanë dhe shokët e tij sovjetikë, ai u përgjigj se «këtë hartë unë e punoj për një akademik sovjetik!». E, ç'janë këto gjëra? Shokut ambasador disa specialistë i janë qarë për kontrollin që bëjnë ne, po a i kanë thënë atij çështjen që një nga gjeologët sovjetikë u ka deklaruar njerëzve tanë se «kot i ruani këto dokumente si sekrete, sepse ato janë si në Leningrad, ashtu edhe në Beograd!»? Ku e di ai që këto dokumente janë edhe në Beograd dhe si kanë shkuar këto sekrete gjer atje? Prandaj, notës suaj për këtë çështje ne do t'i përgjigjemi zyrtarisht.

Një oficer sovjetik, që punon në bazën tonë në Vlorë, mblodhi një ditë oficerët tanë dhe u tha se «deklarata që bëri Enver Hoxha mbi komplotin kundër Shqipërisë është një bluf!». Me këtë rast ne duam t'ju themi se ky komplot nuk është një bluf, po një gjë jashtëzakonisht e rrezikshme. Opinioni shqiptar dhe ai botëror do t'i marrin vesh qëllimet dhe rreziqet e këtij komploti. Qeveritarët e Greqisë dhe të Jugosllavisë,

bashkë me agjenturat e tyre në Shqipëri, civilë e ushtarakë, dhe në bashkëpunim me Flotën VI Amerikane, organizuan këtë komplot për të sulmuar Shqipërinë. Por organet tona e zbuluan dhe të gjithë komplotistët janë në duart e organeve të drejtësisë sonë dhe do të japin llogari. Tani është në mbarim procesi dhe, kur do të marrë fund kjo punë, ne do ta vëmë patjetër në dijeni dhe me hollësi ambasadorin sovjetik J.V. Shikin.

Përsa i përket çështjes së bazës detare në Vlorë, mund t'ju them se nga ana jonë atje tani nuk ka asnjë problem. Bile edhe më parë nuk ka pasur ndonjë problem nga ana jonë. Dëshirojmë që kështu të ndodhë edhe nga ana juaj. Ne jemi plotësisht dakord që shokët tanë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe gjeneral Andrejevi të bisedojnë për këtë çështje. Ju kërkoni që këto bisedime të zhvillohen në praninë time. Unë jam gati të dëgjoj jo një gjeneral si Andrejevin, hero i BRSS, po edhe një marinar të thjeshtë sovjetik, sepse njerëzit sovjetikë ne i konsiderojmë si vëllezërit, si miqtë, si shokët tanë, por mendoj se nuk është e nevojshme me doemos prania ime. Ne duam që në bazën detare të zotërojmë harmonia dhe dashuria me njerëzit sovjetikë, sepse kjo bazë është e nevojshme për interesat e të gjithë kampit tonë socialist dhe jo vetëm për ne. Këtë ne ia thamë edhe Nikita Hrushovit.

Po unë mund të them edhe diçka për çështjen e bazës. Ju atje nuk jeni në rregull me planin e ndërtimeve, të armatimit dhe të dorëzimit të objekteve. Të gjitha planet dhe vendimet, që janë marrë për ndërtime në bazë dhe për furnizimin me materiale, janë pezulluar nga ana juaj. Neve na duket se një çështje e

tillë duhet rishikuar sa më shpejt nga ana e qeverisë sovjetike.

Çështja që tha këtu shoku Pospjellov se një njeriu ynë u paska folur përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Kubës dhe të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë kundër udhëheqjes sovjetike, nuk është e vërtetë, megjithatë, ne do ta hetojmë. Si është e mundur të bëhet një gjë e tillë, kur ne kemi qenë dhe jemi plotësisht dakord me atë që ka thënë Nikita Hrushovi se po të sulmohet Kuba, Bashkimi Sovjetik do të hedhë raketa kundër agresorit për ta mbrojtur Kubën? Prandaj mendojmë se kjo është një shpifje. Pse e them këtë? E them se Baraku¹ ka ardhur në Kongresin IV të PPSH me qëllime shumë të këqija dhe ai sillet me përbuzje ndaj Partisë dhe njerëzve tanë. Derisa ai na ka ardhur në shtëpinë tonë, ne e kemi mik dhe e respektojmë sipas traditave tona. Këto mund t'ia thoni ju, shoku Andropov, se ne nuk ia themi këtu, por, kur të bëhet ndonjë mbledhje e komunizmit ndërkombëtar, unë nuk do ta lë pa ia thënë. Baraku duhet ta dijë mirë se ne nuk trembemi prej tij.

¹ Rudolf Baraku, ish-anëtar i Byrosë Politike të KQ të PK të Çekosllovakisë, zëvendës i parë i kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe ministër i Brendshëm i Republikës Socialiste Çekosllovake, kishte ardhur në Kongresin IV të PPSH me qëllime armiqësore. Koha e vërtetoi se ai ishte agjent i imperialistëve dhe i revizionistëve sovjetikë. Në shkurt të vitit 1962, KQ i PK të Çekosllovakisë u detyrua ta shkarkojë nga të gjitha funksionet në parti e në pushtet, ta përjashtojë nga Partia dhe ta arrestojë si armik të rrezikshëm dhe «vjedhës të valutës së vendit».

Ne po vëmë re se Baraku po përbuz anëtarët e Byrosë Politike të Partisë sonë. Kishim menduar që ai, si përfaqësues i Partisë Komuniste të Çekoslovakisë, të përshëndeste Kongresin tonë pas Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Por, kur një shoku ynë iu lut t'i thoshte se kur e kishte gati fjalimin e përshëndetjes, Baraku jo vetëm s'denjoi të fliste, por i tha me mospërfillje: «Kush je ti?». Shoku ynë, ndaj të cilit Baraku u soll në këtë mënyrë, u tregua modest dhe nuk i foli se e kishte mik, por kur Baraku i tha «kush je ti», megjithëse e njihte kush ishte, mund t'i ishte përgjigjur se «unë kam në gjoks 15 dekorata, që i kam fituar në luftën kundër fashizmit dhe trupin e kam me plagë. Po ti kush je?», mund ta kishte pyetur shoku ynë. Por shoku ynë nuk e bëri këtë se e kishte mik në shtëpi dhe respektoi zakonet e popullit tonë.

Kështu, shokët tanë, ndaj këtyre gjesteve të Barakut kanë mbajtur gjakftohtësinë më të madhe. Baraku e puthi delegatin e Partisë Komuniste të Greqisë, kur shoku Mehmet Shehu me të drejtë, pas vendimit që mori Byroja Politike, e cilësoi atë ashtu siç ishte. Kë quajti provokator delegati i Partisë Komuniste të Greqisë, Mehmet Shehun, gjeneralin më të lavdishëm të ushtrisë sonë, të cilit Partia jonë i dha urdhër për të mbrojtur kufijtë jugorë të Shqipërisë kundër monarko-fashistëve grekë dhe Van Flitit, që ishin lëshuar si bisha kundër partizanëve grekë? Dhe përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Greqisë vjen në Kongresin e Partisë sonë jo si mik, po për të thënë se nuk është dakord me Enver Hoxhën për çështjen e Venizellosit,

këtij armiku të Shqipërisë, që ka qenë dhe është për copëtimin e atdheut tonë. Këto nuk i themi kot, ne i njohim mirë se kush janë monarko-fashistët grekë, të cilët i kemi fqinj. Prandaj Baraku të mos shpejtohet, se, kur i kemi njohur ne ata, ai i binte maces me lugë. I ati i Sofokli Venizellosit, Elefter Venizellosi, ka dje-gur Shqipërinë e Jugut, kurse përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Greqisë vjen në Kongresin tonë dhe na i mbron. Atëherë, ç'është ky qëndrim, a nuk është një provokacion?

Komiteti Qendror i Partisë sonë i ka thënë ambasadorit tuaj në Tiranë se, në qoftë se je besnik i atdheut dhe i partisë tënde, duhet t'u raportosh drejt, qoftë edhe diçka të hidhur, asgjë nuk duhet t'u fshehësh partisë dhe qeverisë, ndryshe ke bërë një politikë shkatërruese për partinë dhe për atdheun tënd. Ivanovin ne e kemi konsideruar si mik të ngushtë, po ai nuk e ka merituar besimin tonë.

Unë ju siguroj, shokë, në emër të Komitetit Qendror, se përsa i përket palës sonë, ne do të luftojmë që miqësinë dhe dashurinë me Bashkimin Sovjetik t'i forcojmë edhe më shumë në popullin dhe në Partinë tonë. Ne duam që mosmarrëveshjet midis partive dhe vendeve tona të zgjidhen me kohë dhe në rrugë marksiste-leniniste. Ne do të luftojmë me të gjitha mundësitë që unitetin tonë ta forcojmë. Ne kurrë nuk do të japim as rast, as shkak që të priset ky unitet, po do të punojmë që të kalitet çdo ditë e më shumë. Pikëpamjet tona do t'i mbrojmë në bazë të Deklaratës së Moskës, në bazë të marksizëm-leninizmit, pa marrë parasysh çka mendojnë të tjerët se ne gjoja qenkemi

inJORANTË nga marksizëm-leninizmi. Kështu mendojnë për shembull shokët italianë. Kur ishte në Shqipëri Nikita Hrushovi, duke bërë aluzion kundër Titos, tha se nuk është e vërtetë që shokët shqiptarë nuk e dinë marksizmin, bile në Shqipëri edhe fëmijët janë marksistë. Ndërsa italianët na kanë thënë: «Lexoni Marks-in e Leninin!». Ne u themi atyre se mësuesit tanë të lavidishëm jo vetëm i lexojmë, por punojmë dhe luftojmë në bazë të mësimeve të tyre.

Por ne këto nuk i bëjmë çështje. Politikë edhe ne mund të bëjmë, po me shokët sovjetikë nuk bëjmë diplomaci, ato që kemi i themi haptazi. Këtë kije parasysh, shoku ambasador, midis nesh nuk do të përdorim diplomacinë, po do të flasim hapur e në mënyrë shoqërore.

Unë do t'ju them një gjë. Për shkak të qëndrimit tuaj ne do të jemi të detyruar të shkurtojmë racionet e ushqimit dhe programet e qitjeve në ushtrinë tonë, po ne nuk dorëzohemi. Ju e patë Kongresin se si u paraqit dhe po ta marrim këtë masë që na imponohet nga ju, ushtarët dhe oficerët tanë do të pyesin, përse u mor kjo masë? Atëherë ç'duhet të bëjmë ne, të mos flasim? Jo, ne nuk do ta mbyllim gojën, do t'u themi njerëzve tanë se shokët udhëheqës sovjetikë kërkojnë të gjunjëzojnë Partinë dhe Qeverinë tonë, se udhëheqja sovjetike po i shkel marrëveshjet e nënshkuara, duke vepruar në mënyrë të njëanshme, dhe refuzon të na ndihmojë, dhe do të bëjmë thirrje: shtrëngoni rripat, qëndroni vigjilentë në mbrojtje të atdheut dhe të kampit socialist, jini të durueshëm! Partia dhe populli ynë i kuptojnë këto gjëra në një nivel shumë të lartë.

Gaboheni rëndë kur thoni se ne mohojmë rolin e Bashkimit Sovjetik. Ne kurrë nuk e kemi mohuar dhe nuk e mohojmë rolin e Bashkimit Sovjetik dhe gjakun që ka derdhur Ushtria Sovjetike për çlirimin e vendeve të okupuara nga nazistët gjermanë, duke përfshirë dhe Shqipërinë, pavarësisht se te ne nuk erdhi Ushtria e Kuqe. E dini kush e mohon rolin e Bashkimit Sovjetik? Ne nuk jemi aspak dakord me Barakun e shokët e tij kur thonë se në Çekoslovakia pushteti është marrë pa u derdhur gjak, kurse në të vërtetë për çlirimin e Çekoslovakisë kanë derdhur gjakun si lumë bijtë e popullit sovjetik. Prandaj me këtë pikëpamje të Barakut, që e shprehu edhe në Kongresin tonë, ne nuk jemi aspak dakord. Po të mos ishte Ushtria e Kuqe, që komandonte J. V. Stalini, Karlovi Varin, ku ne kemi vajtur të pushojmë verës, nuk do ta kishte sot Çekoslovakia.

Kush i armatosi punëtorët çekë më 1948 që dolën bulevardëve dhe vepruan kundër grushtit të shtetit që po përgatitej? Neve na dhëmb zemra kur mohohet roli shpëtimtar i Ushtrisë Sovjetike dhe këtë ne e themi drejt në sy. Këtë ua kemi thënë drejtpërsëdrejti Nikita Hrushovit dhe Mikojanit.

Ndërmjet nesh ka mosmarrëveshje politike dhe ideologjike, por ne nuk ndërhyjmë në punët tuaja të brendshme dhe nuk lejojmë gjithashtu që as Hrushovi dhe as kurrkush tjetër të ndërhyjë në punët tona të brendshme. Mos u mundoni të përçani udhëheqjen tonë, siç ka bërë ish-ambasadori juaj, përfaqësuesi i qeverisë dhe i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri.

*J. ANDROPOVI*¹: Në këtë takim ne nuk jemi në kushte të barabarta me ju. Ju jeni këtu udhëheqësit e Partisë suaj, kurse ne jemi vetëm një delegacion partie, pra njerëz jo me kompetenca. Këtë e them se shoku Enver na foli këtu për një numër çështjesh më të gjera nga rrethi i çështjeve që mendonim ne. Sidoqoftë ne këto do t'ia raportojmë udhëheqjes sonë.

SHOKU MEHMET SHEHU: Mos harroni t'i thoni N. Hrushovit se ç'kanë thënë njerëzit tuaj për shokun Enver Hoxha. Për çfarë miqësie flitni, kur ju i bëni përpunim agjentural delegacionit të Partisë sonë, kur ju në ambasadën tonë në Moskë keni vënë plot aparate përgjimi? Na jepni ju të parët shembullin se doni ta forconi miqësinë, po kur ju bëni veprime të tilla jomiqësore, kur ju i shkurtoni ndihmat ekonomike për vendin tonë, kur pezulloni furnizimin e ushtrisë sonë me armatime, si mund të prisni afrim nga ana jonë?

SHOKU HYSNI KAPO: Si i konsideroni ju këto veprime? Përse ndodh që shumë mallra apo makineri, armatime etj., që duhet të kishin ardhur 6 muaj më parë në Shqipëri, ju nuk i dërguat? Në marrëveshjet tona ekonomike ose ushtarake ka afate se në ç'kohë duhen bërë furnizimet. Atëherë përse janë shkelur këto marrëveshje nga ana juaj?

SHOKU ENVER HOXHA: Në rast se udhëheqja sovjetike do të na kuptojë drejt dhe do të ushqejë për popullin dhe për Partinë tonë atë dashuri të madhe dhe të sinqertë që ka i gjithë populli sovjetik dhe Par-

¹ Drejtor i Drejtorisë së Jashtme për vendet socialiste pranë KQ të PK të BS.

tia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, çdo mosmarrëveshje midis nesh do të ndreqet. Çështjet e tjera i sqaruar në Mbledhjen e Moskës. Atje i thamë gjërat siç janë. Ju thoni se në atë mbledhje ne e errësuar Hrushovin. Unë them se e kritikova atë për gabimet dhe fajet që ka, kurse ju kritikën tonë e interpretuat keq, sikur unë i hodha baltë Bashkimit Sovjetik. Ne ju themi, lexojeni edhe një herë më me vëmendje fjalimin tim në Moskë.

Besoj se mbaruar. Ju lutemi shumë t'ua transmetoni përshëndetjet si dhe pikëpamjet tona, ashtu siç folëm këtu, haptazi dhe sinqerisht gjithë shokëve të udhëheqjes suaj.

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime sipas proces-
verbalit të mbajtur gjatë bise-
dës që gjendet në AQP*

**VETËM QËNDRIMET TONA TË VENDOSURA
KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT
MODERN DO TË BËJNË QË T'U HAPEN SYTË
ATYRE QË U JANË ERRËSUAR**

*Nga biseda me delegacionin e Partisë Komuniste të
Kinës që mori pjesë në Kongresin IV të PPSH*

25 shkurt 1961

*Midis shokëve Enver Hoxha e Mehmet Shehu nga
njëra anë dhe shokut Li Hsien Nien e miqve të tjerë
kinezë, nga ana tjetër, pasi bëhen përshëndetjet e ras-
tit, zhvillohet një bisedë e përzemërt.*

SHOKU ENVER HOXHA: Kongresi IV i Partisë
sonë përfundoi me sukses. Ç'përshtypje keni për
Kongresin tonë? Si kaluat me vizitat nëpër Shqipëri?

SHOKU LI HSIEN NIEN: Në Kongres ne pamë se
në të njëjtat pikëpamje qëndron si udhëheqja ashtu
edhe masa e Partisë suaj.

Pas Kongresit ne vizituam mjaft qytete si Kava-
jën, Lushnjën, Beratin, Fierin dhe Vlorën dhe vumë
re ndryshimet e mëdha që janë bërë në krahasim me

vitin 1954, kur kam qenë radhën tjetër në Shqipëri. Si industria, ashtu edhe bujqësia juaj kanë ecur shumë përpara dhe niveli i jetesës së popullit shqiptar është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Entuziazmi i popullit tuaj pasqyrohet kudo i plotë dhe dashuria e masave punonjëse për Partinë tuaj dhe për shokun Enver Hoxha është e jashtëzakonshme. Udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë, Komiteti Qendror, me shokun Enver Hoxha në krye, janë plotësisht në rrugë të drejtë. Të gjitha ato që kam parë në vendin tuaj, janë pasqyrim i vijës së drejtë të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne mendojmë se Kongresi IV i Partisë sonë shkoi shumë mirë dhe i mbylli me sukses punimet. Atje u vërtetua më së miri uniteti i çeliktë i Partisë sonë, vija e saj e drejtë konsekuente marksiste-leniniste. Kjo na bind më tepër se, ashtu si deri tani, edhe në të ardhshmen, Partia jonë do t'i kryejë më së miri detyrat e mëdha që ka përpara popullit për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar dhe për mbrojtjen me vendosmëri të marksizëm-leninizmit, kundër të gjithë deviatorëve të jashtëm apo të brendshëm.

Disa momente kryesore të Kongresit, i cili përfaqëson gjithë Partinë tonë, treguan se Partia jonë është orientuar drejt në këto situata të vështira që po kalojmë jo vetëm ne, po e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare. Dua të them se qëndrimet e drejta të Kongresit vërtetuan edhe një herë se Partia jonë e kupton se kush është në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe kush është në rrugë të shtrembër oportuniste, revizioniste. Reagimet e Kongresit tonë ishin të tilla që në këto momente shumë delikate diti të ruajë kufirin në mes të

dashurisë e miqësisë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste Bolshevike të Leninit nga njëra anë dhe Hrushovit e pasuesve të tij nga ana tjetër, të cilët mund t'i quajmë me plot gojën oportunistë e revizionistë, si dhe të grupeve e të elementëve të tjerë që kanë ardhur në udhëheqje të partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste të Evropës. Dua të them se Kongresi ynë diti të manovrojë me pjekuri.

Gjithashtu, Kongresi manifestoi shumë mirë besnikërinë dhe kompaktësinë me Partinë Komuniste të Kinës dhe me të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtore, sidomos me ato të Azisë e të Amerikës Latine, që janë konsekuente dhe të vendosura për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për vijën e tyre të drejtë dhe për mbrojtjen e Deklaratës së Moskës. Këtë Kongresi e tregoi qartë.

Në të njëjtlën kohë, Kongresi tregoi besimin e plotë se ne mund të rezistojmë me sukses dhe të fitojmë kundër rrymës së rrezikshme revizioniste që ka shpërthyer një sulm të egër të madh në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Kjo ka një rëndësi të madhe për ne. Sigurisht ne si udhëheqje e kuptojmë një gjë të tillë, por kur këtë e kupton edhe gjithë masa e Partisë, kjo i forcon jashtëzakonisht më shumë pozitat e drejta të Partisë dhe të Republikës sonë Popullore.

Partinë ne e kemi mbajtur kurdoherë në dijeni të këtyre çështjeve dhe kështu kemi vepruar në çdo situatë. Partinë e informuam menjëherë mbi zhvillimin e ngjarjeve në Bukuresht, i thamë haptazi edhe të mirat, edhe të këqijat, si na shanë në Bukuresht dhe në Moskë dhe si na mbrojtën Partia Komuniste e Kinës e parti të

tjera. Kështu, para se të vinin në Kongres, delegatët ishin të përgatitur dhe me një sens politik shumë të zhvilluar. Partia jonë është vënë gjithashtu në dijeni të përmbajtjes së fjalimeve të shokut Ten Hsiao Pin¹ etj. Kështu jo vetëm udhëheqja po edhe masa e Partisë është mirë në dijeni të këtyre çështjeve.

Delegatët e Kongresit, megjithëse nuk dinin ç'poshtërsira bënin disa nga delegacionet e huaja, në prapaska, po vetëm duke parë qëndrimet provokuese në Kongres, i nuhatnin qëllimet e tyre, prandaj reagues në mënyrë të drejtë dhe shumë politike.

Ju e konstatuat edhe vetë, po ne mendojmë se si delegacioni sovjetik, ashtu edhe ai çek, në bashkëpunim me shumë nga delegacionet e tjera nuk kishin ardhur në Kongres me qëllime miqësore, që të ndreqej pak situata në marrëdhëniet midis partive tona, përkundrazi ata kishin ardhur me qëllime që ta sabotonin Kongresin tonë. Kështu mund të themi edhe për delegacionin grek, polonez, francez, gjerman, italian, bullgar e të tjerë. Qëllimet e tyre ishin:

Së pari, në platformën ndërkombëtare, të godisnin Partinë tonë, të godisnin pikëpamjet e drejta të saj dhe të mundnin të gjenin disa momente për të na akuzuar se ne po shkelim Deklaratën e Moskës.

Së dyti, dhe qëllimi imediat i tyre ishte që të krijonin në Kongresin tonë përcarje, të ndanin udhëheqjen nga Kongresi, domethënë nga Partia, ose, po të mos ia arrinin dot kësaj, të krijonin konfuzione në Kongres

¹ Mbajtur në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë, nëntor 1960.

për të gjetur në të ardhshmen mbështetje për punën e tyre minuese.

Së treti, të mund të provokonin në Kongres, domethënë të gjenin një shkak për të bërë ndonjë skandal dhe pastaj të largoheshin.

Ne i kishim parasysh të gjitha këto orvatje të tyre. Por rëndësi të madhe ka fakti që Kongresi e kuptoi mirë këtë situatë. Satisfaksioni i udhëheqjes sonë është se asaj nuk iu desh fare të ndërhynte e të influenconte mbi delegatët, Kongresi reagoi vetë, nuk pati nevojë për asnjë direktivë të brendshme.

Në krye të kësaj pune jomiqësore ishte delegacioni sovjetik. Intriganti më kryesor ishte Andropovi. Por rolin e provokatorit më të madh dhe të hapët e luante Baraku, kryetari i delegacionit çekoslovak; ai u duk që ishte një provokator i poshtër. Mirëpo qëllimet e tyre dështuan. Kongresi tregoi unitetin e çeliktë të Partisë sonë. Një unitet i tillë nuk është parë kurrë në Partinë tonë. Këtë e themi edhe për shkak se në zgjedhjet e forumeve udhëheqëse të Partisë herët e tjera ka pasur për disa edhe ndonjë votë kundër. Këtë radhë, siç e konstatuat edhe vetë, asnjë votë nuk kishte kundër, pati unitet të plotë.

Ky ishte një grusht dhe një mësim i mirë për revizionistët. Ata panë se jo vetëm është e pamundur të procedojnë me intriga për përçarje, por edhe se Partia jonë është tërësisht kompakte përballë rrezikut që kërcënon Partinë, popullin dhe komunizmin ndërkombëtar. Këtë ata nxjerrin konkluzionin mbi kompaktësinë e Partisë sonë rreth Komitetit të saj Qendror dhe unitetin tonë me Partinë Komuniste të Kinës, që mban lart të

papërlyer flamurin e marksizëm-leninizmit. Këtë kompaktësi ata e panë në Kongresin tonë edhe në shkallë ndërkombëtare.

Ditët e para të Kongresit ata as mirëmëngjes nuk na thoshin, por ditët e fundit, kur panë unanimitetin e çeliktë të Partisë sonë, Pospjellovi me njerëzit e tij kërkuan takim me ne. Kështu ne patëm një bisedim me ta.

Pospjellovi nxori defterin dhe lexoi tekstualisht ato që kishte shkruar nga frika se mos bënte ndonjë gabim dhe herë pas here shikonte nga Andropovi. Ne mendojmë se ardhja e tyre kishte për qëllim të sabotonte Kongresin tonë. Ata nuk zunë në gojë as Kongresin, as raportet që u mbajtën atje, as diskutimet e delegatëve, sikur te ne të mos kishte ndodhur asgjë. Por, sipas tyre, kishin ndodhur «disa ngjarje me rëndësi», në marrëdhëniet midis vendeve tona, sikur gjoja një nëpunësi ynë, duke pirë raki në restorant, kishte sharë Hrushovin përpara një specialisti sovjetik. Në këtë vend, sipas tyre, ndodheshin si dëshmitarë njerëz sovjetikë dhe një çekoslovak. Veç asaj, ata ngritën çështjen sikur ne kishim kontrolluar në zyrat ku punojnë gjeologët sovjetikë dhe ndonjë çështje tjetër, fare pa rëndësi saqë as mend nuk mbahen. Pasi referoi këto, Pospjellovi erdhi në përfundimin që miqësia në mes të dy vendeve dhe në mes partive tona nuk mund të kuptohet duke eliminuar Hrushovin, duke mos folur për N. Hrushovin.

Ne në mënyrë shoqërore u thamë atyre pikëpamjen e Partisë sonë se si e kuptojmë miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Leninit dhe si e vërtetoi edhe Kongresi këtë çështje, se në ç'pozita është

Partia jonë. Ne u thamë se populli dhe Partia jonë e duan Bashkimin Sovjetik dhe se kurrë nuk i duam të keqen Bashkimit Sovjetik.

Ka njerëz në botë, u thamë, që për shkak se ne mbrojmë me konsekuencë marksizëm-leninizmin na quajnë «antisovjetikë», kurse ata që janë me të vërtetë antisovjetikë tani hiqen si «mbrojtësit» e Bashkimit Sovjetik. Për Gomulkën mua Hrushovi më ka thënë se vepron si fashist, kurse tani Gomulka na qenka bërë «prosovjetik», kurse ne qenkemi bërë «antisovjetikë»! Po kjo, u thamë, neve nuk na prish punë, ne e dimë se sa na do populli dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik.

Përsa i përket Hrushovit ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ai është udhëheqës i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që e ka zgjedhur Kongresi juaj, prandaj ne si të tillë e njohim, se nuk përzihemi në punët e brendshme të një partie dhe të një vendi mik. Por edhe ai nuk mund ta rrëzojë dot udhëheqjen e Partisë sonë. Këtë duhet ta keni të qartë, u thamë.

Miqësia jonë me Bashkimin Sovjetik nuk është diçka simbolike. Këtë miqësi duhet ta kalitim në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin, por kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste, mbi baza barazie. Ju jeni sigurisht shumë më të fuqishëm se ne ekonomikisht dhe ushtarakisht, por udhëheqja sovjetike të mos mendojë se ne jemi një popull i vogël e i varfër dhe mund të na imponohen pikëpamje jo të drejta. Kështu e kuptojmë ne bashkëpunimin, në mënyrë të sinqertë, vëllazërore, në rrugën marksiste-leniniste, u thamë atyre.

Dihen mosmarrëveshjet tona politike, ideologjike dhe praktike me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. T'ju themi se këto mund të rregullohen shpejt, me një takim, me një mbledhje, do të gënjënim veten. Ato duhet dhe mund të zhduken gradualisht dhe vetëm me vullnet të mirë dhe në rrugë marksiste-leniniste nga të dyja palët.

Pastaj u theksuam se për forcimin e miqësisë duhet të jepen prova nga të dyja anët, ndërsa ju keni dhënë vetëm prova të kundërta. Përveç të tjerave ne u shtruam edhe problemin e kredive. U theksuam, përse kërkojnë të na i presin kreditë dhe ta lidhin dhënien e tyre me vajtjen tonë medoemos në Moskë?! Është e qartë se udhëheqja revizioniste sovjetike bënte përpjekje të vazhdueshme që ne të shkonim edhe një herë në Moskë «për të rishikuar marrëveshjet ekonomike», të cilat, në fakt, ishin nënshkruar nga të dyja palët¹. Atëherë përse duheshin «rishikuar» marrëveshjet? S'kishte asnjë arsye për një «rishikim» të tillë të kredive, sepse kjo ishte një çështje e përfunduar. Prapa kësaj fshiheshin qëllime të tjera politike dhe ideologjike: të arrihej, sipas tyre, që udhëheqja e PPSH të përulej, t'u nënshtrohej presioneve ekonomike, të pushonte luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Por këto qëllime të revizionistëve hrushovianë dështuan.

Jo vetëm kaq. Udhëheqja e sotme sovjetike ka shkelur edhe marrëveshjen që kemi për furnizimin e

¹ Këto marrëveshje ishin arritur në vitin 1958, kur në Moskë kishin shkuar shokët Enver Hoxha e Mehmet Shehu dhe u nënshkruan nga të dyja palët në Tiranë më 3 korrik 1959.

ushtrisë. Kreditë që na janë dhënë me kohë nga Bashkimi Sovjetik për këtë sektor, pas Mbledhjes së Bukureshtit na janë prerë, me gjithë marrëveshjet ekzistuese të nënshkuara prej të dyja palëve për furnizimet ushtarake. Kjo është shumë serioze. Ne jemi një vend i vogël dhe i rrethuar nga shtete armiq, kundër vendit tonë po kurdisen gjithfarë komplotesh, dhe në këto rrethana kaq të vështira ata na kanë prerë furnizimet. Prandaj, u thamë, që këto gjëra duhen parë sa më shpejt nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe nga ana e qeverisë sovjetike, të marrin fund të tilla qëndrime të padrejta dhe të veprohet për të na i dhënë sa më parë ato që duhet të na jepen. Gjithashtu u theksuam se Kina ka bërë një detyrë të lartë internacionaliste ndaj nesh në këto situata të rënda, po kjo nuk do të thotë se ju nuk duhet të zbatoni marrëveshjet e arritura. Arsyetimeve tona ata nuk kishin si t'u përgjigjeshin.

Me një fjalë kështu u mbyll ky takim. Kur u largua delegacioni sovjetik nga Shqipëria, porsa arriti në Budapest, në bazë të informatave që na kanë ardhur, Andropovi kishte thënë se «është shumë më e mirë mjegulla e Budapestit se dielli i Tiranës». Vërtet, ai është njeriu i mjegullave.

Ju, shoku Li Hsien Nien, edhe përpara e kishit të qartë qëndrimin e Partisë sonë, po tani pas punimeve të Kongresit besoj e keni edhe më të qartë gjendjen e fortë, të shëndoshë të Partisë dhe të popullit tonë, unitetin e tyre të çeliktë dhe vendosmërinë e tyre për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të lirisë dhe të pavarësisë së Shqipërisë.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Partia dhe populli juaj janë të lidhur si mishi me thoin.

SHOKU ENVER HOXHA: Vendosmëria jonë është e patundur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe për të ecur përpara, në miqësi me Bashkimin Sovjetik, me Republikën Popullore të Kinës dhe me partitë e tyre si edhe me të gjitha vendet e kampit socialist. Ne do të luftojmë për forcimin e unitetit me të gjitha forcat tona.

Komiteti Qendror i Partisë sonë, e bashkë me të e gjithë Partia, nuk do t'u japin asnjë armë revizionistëve, për të na luftuar, nuk do të bëjnë asnjë veprim të pamatur që ata ta shfrytëzojnë në dëmin tonë. Ata janë aq të poshtër saqë, siç thotë një fjalë popullore, edhe gomarin mashkull e bëjnë me barrë, domethënë shpifin.

Ne kemi qenë dhe do të jemi solidarë për mbrojtjen e unitetit, të kësaj çështjeje të madhe me Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës, me shokun tonë të shtrenjtë Mao Ce Dun, për të cilin Partia jonë ka një dashuri dhe një respekt të thellë. Ne jemi krenarë për këto lidhje që në këto momente kaq të rënda për komunizmin ndërkombëtar, Partia e madhe Komuniste e Kinës, me shokun Mao Ce Dun në krye, mbajnë lart flamurin e pastër të marksizëm-leninizmit, gjë që është shpëtimtare për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për të gjithë njerëzimin.

Komunizmi ndërkombëtar, sipas pikëpamjes së Komitetit Qendror të Partisë sonë, po kalon një krizë jash-tëzakonisht të rëndë. Një korent i fortë revizionist po përshkon lëvizjen komuniste ndërkombëtare, duke krijuar një rrezik të madh serioz për të. Grupi revizionist

renegat i Titos është një nga armiqtë kryesorë të komunizmit, ai është demaskuar po nuk është shkatërruar akoma. Por grupi revizionist i N. Hrushovit është edhe më i rrezikshëm, ai po rrezikon gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, sepse nuk është demaskuar akoma. Kursi që ka marrë ai nuk shkakton vetëm kokëçarje, po një rrezikshmëri shumë të madhe për pagën dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Prandaj, ne mendojmë se, në radhë të parë, vetë Bashkimi Sovjetik është në rrezik të madh, sepse atje është në krye grupi revizionist i N. Hrushovit. Planet e tij janë që të futin vendet socialiste në një qorrsokak, në një rrugë që ndjellin kapitalistët e imperialistët. Planet e Hrushovit me shokë synojnë që të dobësohet kampi i socializmit, në radhë të parë Kina e madhe marksiste-leniniste që është pengesa kryesore e revizionistëve dhe mbrojtësja e vendosur e marksizëm-leninizmit.

Prandaj, ne mendojmë që krahas me detyrën për kalitjen e vazhdueshme të Partisë sonë, kemi edhe një detyrë të madhe internacionaliste, të luftojmë për të mbrojtur komunizmin ndërkombëtar nga veprimtaria e tërbuar armiqësore e grupit të Nikita Hrushovit, të shpëtojmë kështu njëkohësisht Bashkimin Sovjetik. Kjo duhet të jetë një detyrë internacionaliste e të gjitha partive që janë konsekuente në mbrojtje të marksizëm-leninizmit.

Ne, shqiptarët, Partia dhe Komiteti Qendror i saj këtë gjë e kemi të qartë dhe nuk na luan as topi, siç themi ne. Po si do t'ua arrijmë qëllimeve tona? Duke ndërhyrë në punët e brendshme të Bashkimit Sovjetik ose të vendeve të tjera socialiste, udhëheqjet e të cilave

kanë shkarë nga binarët e marksizëm-leninizmit? Në asnjë mënyrë jo! Vetëm qëndrimet tona të vendosura për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, qëndrimet tona të drejta politike kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern, atij hrushovian dhe atij titist, do të bëjnë që t'u hapen sytë atyre që u janë errësuar, sepse, për ata që janë armiq të marksizëm-leninizmit, siç është N. Hrushovi, ne nuk kemi asnjë shpresë.

Partia jonë është plotësisht dakord me qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës si për çështjet ideologjike, ashtu edhe për problemet e politikës ndërkombëtare. Ne shqiptarët do të luftojmë gjer në fund për këto çështje të mëdha. Ne mendojmë se, në këto situata kaq të vështira që po kalon komunizmi ndërkombëtar, popullit të madh kinez, Partisë suaj dhe Komitetit Qendror, të kryesuar nga shoku Mao Ce Dun, u bie barra e madhe dhe e lavdishme, t'u ndriçojnë rrugën partive marksiste-leniniste në luftën kundër përçarësve, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Kështu e kuptojmë ne këtë çështje.

Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se fitorja përfundimtare mbi revizionizmin nuk mund të zgjidhet shpejt e shpejt, as për një vit, as për 5 vjet, kjo është një punë e gjatë, e rëndë dhe e ndërlikuar.

Vite të tëra ka renegati Tito, që, pa pasur në dorë raketa apo bomba me hidrogjen, pa një potencial të madh ekonomik, pa autoritetin e madh ndërkombëtar si ai i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nën maskën e të cilit spekulon Nikita Hrushovi, prapë qëndron në fuqi.

Ju e kuptoni sa e vështirë është situata e vendit tonë në këto kushte. Tani ne jemi të rrethuar jo vetëm

nga vende kapitaliste, por edhe nga një rreth i dytë, nga vende, në krye të të cilave qëndrojnë përkohësisht udhëheqje revizioniste. Kanë 17 vjet imperialistët që po përpiqen ditë e natë të likuidojnë Partinë dhe pushtetin tonë popullor. Ata nuk do t'i hedhin armët, do t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre më me forcë dhe tani atyre u vjen në ndihmë edhe veprimtaria armiqësore e N. Hrushovit dhe e pasuesve të tij.

Ne e dimë se nuk jemi vetëm, se kemi miq besnikë dhe të vendosur Republikën Popullore të Kinës, të gjitha partitë marksiste-leniniste dhe popujt vëllezër të Azisë, të Afrikës, të Amerikës Latine e të tjerë, ne kemi mbështetjen e popullit vëlla sovjetik, kemi me vete komunistët marksistë-leninistë të Bashkimit Sovjetik dhe të të gjitha vendeve të tjera socialiste. Të gjithë këta janë faktorë shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e vendit tonë. Por praktikisht ne, ashtu si tha shoku Mehmet, hedhim vallen në gojën e ujkut. Prandaj Partia dhe populli ynë do të jenë kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm ushtarakisht, politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht për të shkatërruar planet e shteteve kapitaliste dhe planet e fshehta të revizionistëve modernë. Komiteti Qendror i Partisë sonë do të jetë shumë vigjilent në drejtim të mbrojtjes së atdheut si dhe të politikës dhe të taktikës që duhet të ndjekim në rrethanat e krijuara.

Asnjë moment taktik nuk do të lëmë pa shfrytëzuar. Kina Popullore është një shtet i madh, shumë i fuqishëm. Sigurisht armiqtë do të përpiqen ta prekin edhe atë, po me të duhet t'i bëjnë mirë llogaritë se ajo është një kontinent i tërë. Kështu, para se t'ia fillojnë një pune të tillë, qoftë imperialistët, qoftë revizionistët, duhet të

mendohen mirë, sepse Kina nuk preket dot lehtë. Kurse vendi ynë nuk është në të njëjtat kushte. E kam fjalën se shumë herë taktika e Partisë sonë do të jetë më e rreptë, më e prerë, më e fortë.

Imperialistët haptazi dhe grupet revizioniste në krye të shteteve socialiste të Evropës, si në Bashkimin Sovjetik, në Bullgari, në Çekoslovaki, në Poloni, në RD Gjermane etj. në mënyra të fshëhta, do të përpiqen të na likuidojnë, duke kujtuar se Shqipëria është një shtet i vogël dhe i vetmuar.

Prandaj, për arsye të këtyre rrethanave, taktikat tona do të jenë më të ashpra, më të vendosura. Por në situatën e krijuar armiqtë tanë, që përpiqen t'i bëjnë varrin Shqipërisë, llogaritin edhe potencialin e madh të Kinës në ndihmë të vendit tonë, pavarësisht se Kina është larg nga ne në pikëpamje territoriale. Në radhë të parë, ata nuk mund të mos llogaritin ndihmën e madhe politike dhe ideologjike. Armiqtë tanë nuk mund të mos e kenë parasysh këtë ndihmë të fuqishme në këto situata të rënda për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për paqen. Kjo është një ndihmë jashtëzakonisht e madhe për ne.

Grupi revizionist i Nikita Hrushovit dhe grupet revizioniste në udhëheqje të vendeve të demokracisë popullore të Evropës kanë filluar dhe po zhvillojnë një luftë të dendur ideologjike dhe politike kundër Partisë dhe kundër udhëheqjes sonë. Shtypi sovjetik, duke filluar nga gazeta «Pravda», qysh kur u bë Mbledhja e Bukureshtit, nuk po flet fare për Shqipërinë, as edhe për lajme ekonomike. Me një fjalë na kanë bërë në këtë drejtim izolim politik. Nga ana tjetër ideologjikisht,

pas Mbledhjes së Moskës, në partitë e tyre po shpifin gjithfarë gjërash kundër udhëheqjes së Partisë sonë. Ne e dimë ç'bën Gomulka dhe kemi informata se edhe në Poloni i është dhënë urdhër gjithë shtypit që të mos flitet fare për Shqipërinë.

Kështu ngjet edhe në Gjermaninë Demokratike, në Çekoslovakia e gjatë. Në Bullgari, ku edhe atje është në krye një grup revizionistësh, bile shërbëtorë shumë besnikë të N. Hrushovit, për arsye të lidhjeve miqësore që ekzistojnë në mes të popullit shqiptar dhe popullit bullgar dhe për shkak të presionit të madh të bazës, shtypi bullgar diçka flet për Shqipërinë. Por ne besojmë se vetë popujt dhe partitë e vendeve socialiste nuk do të durojnë dot për një kohë të gjatë këto pozita e këto veprime antimarksiste të grupeve revizioniste që kanë në udhëheqje të tyre. Në Bullgari, për shembull, kur u punua Deklarata e Moskës, Komiteti Qendror i Partisë dha urdhër që asnjë komunist të mos diskutonte mbi këto materiale dhe, bile, asnjë pyetje të mos bëhej. Por një parti e tërë në asnjë mënyrë nuk mund të heshtë dhe të durojë dot veprime të tilla.

Udhëheqësit e PK të Bullgarisë, pasi u kthyen nga Mbledhja e Moskës, nuk guxuan të thoshin asnjë fjalë të keqe për partinë tuaj. Nëpër aktivet e partisë, me gjithë urdhrat që dhanë për të mos u bërë as pyetje e as diskutime, ngjanë trubullira. Për shembull, në aktivin e partisë të një qyteti u ngrit një gjeneral dhe kërkoi shpjegime mbi kultin e individit dhe i tha të deleguarit: «Qëndroni ju përse i përket Stalinit në pikëpamjen se ai nuk ka pasur asnjë zotësi, se ai nuk e ka udhëhequr Bashkimin Sovjetik gjatë Luftës së Dytë Botërore?». I

deleguari nuk dinte ç'të thoshte dhe u përgjigj: «Nuk mund të themi se Stalini nuk ka pasur zotësi, po për drejtimin e luftës kishte gjithë ata mareshalë, ishin anëtarët e Komitetit Qendror, prandaj të gjitha problemet e luftës ai i ka drejtuar së bashku me gjithë këta njerëz». Ai që bëri pyetjen, u ngrit e tha: «Atëherë ku qëndron kulti i Stalinit, gjersa ai udhëhiqte në mënyrë kolegjiale çështjet më të rëndësishme të jetës së popullit me një sërë kuadrosh?».

Në Hungari punët mendojmë se janë diçka më ndryshe. Udhëheqja e partisë dhe e shtetit hungarez sillet më me kujdes ndaj nesh. Në Moskë delegacioni hungarez nuk atakoi si të tjerët as Kinën, as ne. Kur u kthyem nga Moska për në atdhe me shokun Mehmet, kaluam nga Hungaria. Udhëheqësit hungarezë u treguan korrektë dhe miqësorë me ne. Në një pritje një nga udhëheqësit kryesorë shtetëror hungarez i tha ambasadorit tonë në Budapest: «Temperamenti i udhëheqjes shqiptare në Moskë ishte i nevojshëm dhe i domosdoshëm».

Pastaj erdhën festat tona të 28 dhe 29 Nëntorit. I gjithë shtypi hungarez shkruajti për sukseset e vendit tonë. Në çdo qytet në Hungari u bënë mbledhje me komunistët dhe me popullin. Pastaj mjaft shfaqje të tjera simpatie janë manifestuar në drejtim të shokëve tanë nga kuadro hungarezë me përgjegjësi. Ata u kanë thënë njerëzve tanë: «Ju e keni drejt rrugën dhe ne kemi respekt të madh për udhëheqjen tuaj. Edhe neve, hungarezëve, sovjetikët na bëjnë presione, ashtu sikurse kanë bërë në Shqipëri, po tani ne mësuam nga ju si të qëndrojmë». Po kështu në Bashkimin Sovjetik, nga takimet

që kanë njerëzit tanë me punonjës të ndryshëm sovjetikë, del se shumica e tyre u shtrëngojnë fort duart njerëzve tanë dhe u thonë: «Ju e keni mirë».

Gjendja e krijuar midis partive komuniste dhe punëtorë është një çështje e madhe dhe shumë e rëndë politike dhe ideologjike. Valter Ulbrihti ka folur haptazi se shqiptarët janë dogmatikë dhe sektarë. Prandaj ne kemi parasysh se këtej e tutje do të intensifikohet edhe më shumë lufta ideologjike kundër partive tona.

Ne mendojmë se Hrushovi, gjithë grupi i tij revizionist në BS dhe grupet e tjera revizioniste në kokë të disa partive luftojnë për forcimin e pozitave të tyre. Ata luftojnë të pastrojnë radhët e tyre nga elementët e padëshirueshëm për ta, për të likuiduar pozitën marksiste-leniniste në partitë e tyre, për të likuiduar elementët e shëndoshë marksistë. Ata do të përdorin edhe terrorin e provokacionet ashtu siç bën tani Titoja. Ky është mendimi i Komitetit tonë Qendror mbi rrugën që do të ndjekin këto grupe revizioniste.

Por te ne ata do të gjejnë një mur çeliku. Ata e panë në Kongres unitetin ideologjik dhe politik të Partisë sonë. Megjithatë ata nuk do të tërhiqen, po do ta zhvillojnë punën e tyre më tej, do të përpiqen të bëjnë diversione, po Partia jonë nuk do të zbrapset asnjë çap.

Tani është çështja e bllokadës ekonomike që parashikojmë ne të na bëjnë. Ata, duke parë se nuk mund ta çajnë dot ideologjikisht dhe politikisht Partinë tonë, përveç akteve diversioniste, do të përpiqen të na bëjnë edhe luftë ekonomike. Nëpërmjet kësaj rruge ata do të mundohen të dëmtojnë Partinë dhe Republikën tonë

Popullore, duke u fshchur, bile, edhe nën maskën e ndihmës reciproke midis vendeve socialiste.

Në këto kushte një rëndësi vendimtare për Partinë dhe për vendin tonë merr realizimi i planit tonë të tretë pesëvjeçar. Realizimi i këtij plani ka për ne një rëndësi të madhe jo vetëm ekonomike, por edhe politike dhe ideologjike. Por siç e dini plani ynë mbështetet edhe në kreditë që na japin përveç Republikës Popullore të Kinës edhe vendet socialiste të Evropës.

Plani ynë i tretë pesëvjeçar është një plan real, i ngjeshur, po i llogaritur mirë, në bazë të mundësive tona. Në rast se ngjarjet do të zhvillohen normalisht, dhe po të na i japin pa asnjë pengesë kreditë vendet e tjera socialiste, që na i kanë akorduar, ky plan jo vetëm do të përballohet e do të realizohet, por edhe do të tejkalohet. Në formë marrëveshjet për këtë qëllim ne i kemi nënshkruar me të gjitha vendet, janë specifikuar, bile, edhe objektet që do të ndërtojmë qysh nga data e fillimit të hartimit të projekteve dhe gjer në zbatimin e tyre. Në marrëveshjet është parashikuar me hollësi çdo gjë: furnizimi me materiale, mënyra e përdorimit të kredive etj. Marrëveshjet, siç thashë, janë përfunduar me të gjitha vendet socialiste të Evropës, por me Bashkimin Sovjetik çështja qëndron ashtu sikurse ju kemi thënë.

Tani vihet pyetja: do të zbatohen apo nuk do të zbatohen këto marrëveshje? Kjo varet nga marrëdhëniet që do të kemi me këto vende, sigurisht edhe nga gjendja ndërkombëtare. Por ne jemi të bindur që udhëheqjet që janë aktualisht në krye të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve socialiste të Evropës, ose do të na i presin kreditë ose do të na sabotojnë dhe në radhë të parë

N. Hrushovi. Situatat politike mund t'i detyrojnë ata të mos na i presin kreditë për oportunitet politik, por për të na sabotuar, këtë e dimë që do të na e bëjnë. Një nga faktorët që ata mund të detyrohen të mos na i presin kreditë, janë edhe ndihmat e mëdha që na ka akorduar Republika Popullore e Kinës.

Nga ana jonë atyre ne nuk do t'u japim asnjë rast për të gjetur shkak e të veprojnë kundër nesh, prandaj, në rast se na i presin, këtë ata mund ta bëjnë vetëm në mënyrë arbitrare. Kina ne na ka ndihmuar dhe na ndihmon. Kjo do t'i vërë ata në pozita shumë të vështira dhe do të bëjë që të demaskohen. Sidoqoftë në të gjitha rastet ata do të përpiqen të na sabotojnë dhe, e dimë, se më shumë do të na sabotojnë sovjetikët dhe pas sovjetikëve çekët, se këta të fundit veprojnë si tregtarë, nga ana tjetër ata kanë edhe interes se kanë nevojë për kromin, bakrin dhe mineralet tona të tjera. Pastaj do të na sabotojnë me radhë edhe të tjerët, por kreditë e tyre janë më të vogla.

Komiteti Qendror i Partisë sonë i ka parasysh situatat që mund të paraqiten, prandaj përveç punës për të mbajtur gjallë entuziazmin e masave për realizimin e detyrave që kemi përpara dhe për kapërcimin e vështirësive, mendojmë se ne me qëndrimet tona të drejta duhet t'i detyrojmë ata që t'ua marrim kreditë që na kanë akorduar.

Në kreditë që ata na japin, ka disa çështje me shumë rëndësi dhe vendimtare për planin tonë pesëvjeçar. Ne me thonj e me dhëmbë do të luftojmë që ta realizojmë këtë plan dhe do t'i përballojmë të gjitha dallgët që do të na vijnë nga revizionistët hrushovianë. Por pikat më

delikate, objektet e këtij plani që ne mendojmë t'i kemi parasysh dhe t'i përballojmë me çdo kusht në këtë plan pesëvjeçar, janë:

Në radhë të parë është çështja e bujqësisë. Për këtë sektor, sikurse e dini, kemi bërë dhe do të bëjmë akoma shumë, sidomos për bonifikimin, ujitjen, hapjen e tokave të reja etj.

Detyra kryesore për bujqësinë tonë është sigurimi i bukës në vend. Ne duhet ta prodhojmë medoemos bukën në vend, sepse gjendja ndërkombëtare dhe ajo e vendit tonë janë të tilla që na imponojnë ta kryejmë sa më parë këtë detyrë. Komitetin Qendror të Partisë e ka preokupuar vazhdimisht ky problem edhe në pesëvjeçarët e mëparshëm dhe këtë çështje e ristudjuam edhe për këtë pesëvjeçar. Mirëpo, me gjithë dëshirën tonë të madhe, është e pamundur ta sigurojmë në vend bukën këtë pesëvjeçar. Qeveria e RP të Kinës na ka dhënë një ndihmë të konsiderueshme, së pari me furnizimin e sasive të mëdha të drithit qysh në muajt e verës dhe me një shpejtësi të madhe, sa kjo ndihmë ka qenë shpëtimtare për popullin tonë. Partia dhe populli ynë do t'ju jenë mirënjohës për këtë qëndrim vëllazëror dhe internacionalist.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Kjo është një përkrahje reciproke. Edhe ju na përkrahni në fushën politike. Në radhë të parë çështja duhet parë nën prizmin se Shqipëria është në pozita rrethimi kapitalist.

SHOKU ENVER HOXHA: Ndhima juaj me drithë për vitin 1961 është shumë e madhe. Ne i kuptojmë shumë mirë sakrificat që bën udhëheqja kineze po të merret parasysh sidomos fakti se edhe ju patët një vit

jo të mirë bujqësor. Kështu ne plotësojmë nevojat për bukë edhe për vitin 1961.

Për 4 vjetët e tjerë, 1962-1965, ne përsëri do të kemi nevojë të importojmë bukë. Kështu në planet tona kemi rezervuar mallra me të cilat do të importojmë drithëra me klering.

SHOKU MEHMET SHEHU: Këtë drith me klering ne ia kemi kërkuar Bashkimit Sovjetik, po asnjë përgjigje nuk kemi marrë andej gjer tani.

SHOKU ENVER HOXHA: Kemi kërkuar gjithashtu edhe nga vendet e tjera socialiste, por në rast se ato nuk na japin, ne e kemi në dispozicion kleringun për të blerë bukë.

Kështu është, pra, çështja e bukës te ne. Në lidhje me këtë, rëndësi të madhe ka për zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë ngritja e rendimenteve të kulturave bujqësore. Vetëm kështu ne mund ta prodhojmë bukën në vend. Kjo na imponon të ngremë patjetër uzinat e plehrave kimike. Me Bashkimin Sovjetik kemi nënshkruar për këtë qëllim marrëveshjen për të na ndihmuar në ngritjen e një uzine të plehrave azotike me gjithë TEC-in, të cilin kemi parashikuar ta ndërtojmë në Fier. Sovjetikët e dinë se ky është një problem kyç dhe jetik për zhvillimin e bujqësisë së vendit tonë, prandaj parashikojmë që ata ose nuk do të na e japin këtë objekt, ose do të na sabotojnë¹. Unë do t'ju them një shembull.

¹ Kështu ndodhi. Uzina e plehrave azotike dhe TEC-i në Fier, për shkak të shkeljes arbitrare të marrëveshjeve nga revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre, u ndërtuan me ndihmën e RP të Kinës dhe filluan nga prodhimi në vitin 1968.

Fabrikën e Çimentos në Vlorë, së cilës i bëmë rikonstruksionin vitin e kaluar, për një valixhe materialesh elektrike (50 kilogram), ata na e lanë 8 muaj me radhë pa e vënë në shfrytëzim. Atëherë merreni me mend ç'mund të bëjnë ata me uzinën e plehrave kimike. Ne kemi parashikuar t'i ngremë këto uzina dhe t'i kemi gati për shfrytëzim në vitin 1965, po ata mund të përpiqen të na i shtyjnë gjer nga viti 1968 ose 1970. Kështu bukën nuk do ta sigurojmë dot as në pesëvjeçarin e katërt. Ky është njëri objekt.

Objekti tjetër që parashikojmë të ndërtojmë është fabrika e çimentos. Në rast se ne nuk do ta ngremë këtë fabrikë, atëherë të gjitha ndërtimet e planit tonë të tretë pesëvjeçar do të mbeten pa u ndërtuar. Ata për fare pak materiale na sabotuan 8 muaj, kurse duke mos na ngritur këtë objekt shumë të rëndësishëm, do të na sabotojnë të gjithë planin e ndërtimeve.

Me çekët kemi arritur marrëveshjen që të ngremë një kombinat metalurgjik për ferro-kromin, ku do të ketë edhe një uzinë superfosfati. Në rrethanat që janë krijuar, ka mundësi që edhe ata të na sabotojnë, megjithëse çekët shikojnë edhe interesin e tyre dhe mund të mos e bëjnë një gjë të tillë, po mundësitë më të shumta janë që edhe ata të na sabotojnë¹.

Kishim edhe një çështje tjetër, ndërtimin e një

¹ Udhëheqja revizioniste çekosllovake i shkeli marrëveshjet e arritura me Qeverinë e RPSH, prandaj ngritja e këtyre dy veprave u shty për më vonë. Uzina e superfosfatit u ndërtua me ndihmën e RP të Kinës dhe filloi nga prodhimi në vitin 1968, kurse uzina e ferro-kromit filloi të ndërtohet në rrethin e Matit në vitin 1974, me ndihmën internacionaliste të RP të Kinës.

uzine për shkrirjen e hekur-nikelit. Ky objekt nuk ekziston në planin tonë pesëvjeçar, po ne e parashikojmë ndërtimin e tij si shumë të domosdoshëm, sepse vendet socialiste të Evropës do të na lënë pa na furnizuar me artikuj metalikë, për të cilët kemi shumë nevojë këtë pesëvjeçar. Polakët, nga të cilët kemi marrë vazhdimisht artikuj të tillë, na u përgjigjën se nuk kanë të na furnizojnë. Kështu nuk kemi ku t'i sigurojmë këto materiale. Prandaj ky objekt, megjithëse nuk e kemi në plan, mendojmë se është i domosdoshëm të ndërtohet, ai na imponohet nga situata e krijuar...

Më poshtë, miqtë njihen me objektet e tjera që duhet të ngrihen gjatë pesëvjeçarit të tretë (1961-1965), me masat që parashikon Komiteti Qendror i PPSH për realizimin e tyre etj. dhe pastaj përsëri vazhdon të flasë

SHOKU ENVER HOXHA: Më në fund doja t'ju njihja edhe me disa çështje të ushtrisë. Problemi i furnizimit të ushtrisë qëndron ashtu sikurse ju jeni në dijeni: sovjetikët i kanë pezulluar furnizimet për ushtrinë tonë. Prandaj kemi marrë disa masa për të përballuar gjendjen e krijuar e për të forcuar mbrojtjen e atdheut.

Sovjetikët edhe në këtë fushë jetike përpiqen të na bëjnë presion për të krijuar një situatë të vështirë në ushtri dhe në kuadrot tanë ushtarakë. Ata mendojnë të krijojnë pakënaqësi te oficerët tanë dhe të dobësojnë në këtë mënyrë rezistencën e ushtrisë sonë.

Ne kemi marrëveshje me sovjetikët për furnizimin e rregullt me armatime dhe me pajisje të ushtrisë sonë, por këto marrëveshje ata nuk i zbatojnë. Për këtë qëllim nga ana e qeverisë sonë i është bërë një letër qe-

verisë sovjetike. Dje iu dërgua gjithashtu edhe një letër mareshalit Greçko, kryekomandantit të forcave të armatosura të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, ku bëjmë raportin vjetor të zakonshëm, meqë bëjmë pjesë në këtë organizatë ushtarake, duke treguar gatishmërinë moralo-politike dhe ushtarake të ushtrisë sonë. Në këtë letër tregohet gjithashtu edhe gjendja e armatimeve të ushtrisë së vendit tonë dhe nevojat e saj. Në raport vihet në dukje se qeveria sovjetike ia ka pezulluar furnizimet ushtarake ushtrisë sonë, prandaj mareshali Greçko, si kryekomandant i forcave të armatosura të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, duhet të ndërhyjë pranë qeverisë sovjetike për t'i dhënë rrugë këtij problemi.

Tani ju, shokë kinezë, e kuptoni ç'rëndësi të madhe kanë për ne këto çështje.

Këto kishim për t'ju parashtruar, shoku Li Hsien Nien.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Të gjitha këto që më thatë, shoku Enver, unë do t'ua transmetoj personalisht shokut Mao Ce Dun dhe shokëve të tjerë të Komitetit Qendror të Partisë sonë.

SHOKU ENVER HOXHA: U thoni gjithashtu shokut Mao Ce Dun dhe shokëve të tjerë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës që te Partia e Punës e Shqipërisë dhe te populli shqiptar ata kanë një mik besnik përjetë, në rrugën marksiste-leniniste. Ne duam t'i shprehim Partisë suaj se shokët e delegacionit kinez, me shokun Li Hsien Nien në krye, që erdhën në Kongresin e Partisë sonë, i dhanë Kongresit dhe Partisë sonë një ndihmë jashtëzakonisht të madhe. Në gjithë këtë forcë

të madhe që u manifestua në Kongres dhe në gjithë popullin shqiptar ka kontribuar shumë edhe prania e delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës. Kjo ka ngjallur besimin e madh të Partia dhe të populli ynë se ne nuk jemi vetëm dhe marksizëm-leninizmi është i pamposhtur.

Ne mendojmë se në çdo kohë, po veçanërisht tani, uniteti i çeliktë i dy partive tona, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës, është një nga kushtet më të rëndësishme për lirinë dhe për pavarësinë e Shqipërisë së vogël dhe për interesat e socializmit.

SHOKU LI HSIEN NIEN: Unë ju falënderoj nga zemra për pritjen shumë të ngrohtë që na është bërë kudo, falënderoj gjithashtu nga zemra të gjithë shokët, dhe sidomos shokun Enver Hoxha, për vlerësimin e lartë që i bënë partisë sonë dhe shokut Mao Ce Dun.

Duke vazhduar, shoku Li Hsien Nien vlerësoi lart punimet e Kongresit IV të PPSH dhe shprehu respektin e thellë të PK të Kinës për PPSH, e cila, duke mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit në brigjet e Adriatikut, jep «një ndihmë shumë të madhe për të gjithë popujt e kampit socialist dhe të të gjithë botës». Pastaj shprehu gatishmërinë e PK të Kinës dhe të Qeverisë së RP të Kinës për ta ndihmuar popullin dhe Qeverinë e RP të Shqipërisë në mënyrë vëllazërore dhe internacionaliste në përpjekjet për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit.

Botohet për herë të parë me shkurtime sipas tekstit të procesverbalit që gjendet në AQP

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR PARTISË
KOMUNISTE TË ZELANDËS SË RE ME RASTIN
E 40-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ**

28 shkurt 1961

**KOMITETIT KOMBËTAR
TË PARTISË KOMUNISTE TË ZELANDËS SË RE**

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të të gjithë komunistëve dhe të popullit shqiptar ju dërgon përshëndetje të nxeha dhe vëllazërore me rastin e 40-vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste të Zelandës së Re.

Lufta 40-vjeçare për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore dhe të masave punonjëse nga shfrytëzimi kapitalist, për fitoret demokratike të popullit, për pavarësinë dhe për sovranitetin e vendit kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij e ka vënë Partinë Komuniste të Zelandës së Re në krye të masave punonjëse dhe ka treguar se ajo është mbrojtësja më besnike e interesave të popullit dhe e pavarësisë kombëtare.

Partia Komuniste e Zelandës së Re ka bërë një

luftë të gjatë dhe të vendosur kundër oportunitetit dhe kundër pikëpamjeve revizioniste për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Ne urojmë, të dashur shokë, që festa e 40-vjetorit të themelimit të Partisë suaj të shërbejë për forcimin e mëtejshëm të radhëve të partisë dhe për suksese të reja në luftën tuaj të drejtë për pavarësinë e vendit, për triumfin e socializmit dhe për paqen në botë!

Rroftë Partia Komuniste e Zelandës së Re!

Rroftë uniteti i pathyeshëm marksist-leninist i lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 61 (3904), 10 mars 1961

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**MESAZH PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
UILLIAM FOSTERIT KRYETAR NDERI I PK TË SHBA,
ME RASTIN E 80-VJETORIT TË DITËLINDJES**

28 shkurt 1961

I dashur shoku Uiliam Foster,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të të gjithë komunistëve dhe të popullit shqiptar ju dërgon përshëndetje të nxehta dhe vëllazërore me rastin e 80-vjetorit të ditëlindjes suaj.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar përshëndesin te ju luftëtarin e palodhur dhe besnik për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore amerikane, një nga personalitetet e shquara të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, që ka luftuar me konsekuencë kundër fraksioneve të djathta, trockistëve, oportunistëve të ndryshëm, dhe sidomos kundër rrezikut revizionist, që në periudhën e fundit kërcënonte ekzistencën e Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke mbrojtur kështu me vendosmëri partinë dhe parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të saj.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju uron me gjithë zemër shëndet të plotë dhe jetë të gjatë për të vazhduar edhe më tej luftën në shërbim

të popullit dhe të klasës punëtore të vendit tuaj, kundër shfrytëzimit të egër kapitalist, kundër imperializmit amerikan dhe veglave të tij, oportunistëve dhe revizionistëve të çdo ngjyre!

Përshëndetje revolucionare!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 53 (3896), 1 mars 1961*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i popullit», Nr. 53 (3896),
1 mars 1961*

NGA BISEDA ME AMBASADORIN SOVJETIK NË RPSH

20 mars 1961

Në fillim ambasadori Shikin transmetoi përmbajtjen e letrës së Hrushovit për thirrjen e mbledhjes së zakonshme të Komitetit Politik Konsultativ të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës si dhe tekstin e komunikatës për shtypin. Pastaj midis shokut Enver Hoxha dhe ambasadorit Shikin u zhvillua kjo bisedë e shkurtër:

SHOKU ENVER HOXHA: Dëshiroja të sqarohesha, nëse raporti i mareshalit Greçko do të ketë edhe konsiderata politike në lidhje me situatën ndërkombëtare dhe me qëndrimet e mëtejshme ndaj ngjarjeve ndërkombëtare, apo do të jetë një raport me karakter thjesht për teknikën ushtarake? A do të ketë raporte të tjera të kësaj natyre?

AMBASADORI SHIKIN: E kam vështirë t'ju përgjigjem, sepse me fjalimet nuk njihem, di vetëm ç'thuhet në letrën dhe ç'del nga titulli i raporteve.

SHOKU ENVER HOXHA: Derisa mbledhja bëhet në nivelin më të lartë, pyes nëse do të ngrihen çështje mbi situatën ndërkombëtare, në mënyrë që delegacioni ynë të shkojë i përgatitur. Pastaj, raporti i mareshalit

Greçko a do t'i prekë kërkesat për armatime dhe për forcimin ushtarak në bazë të nevojave që ka çdo ushtri, dhe a do të merren atje vendime për këtë?

AMBASADORI SHIKIN: Gjithashtu e kam vështirë t'ju përgjigjem.

SHOKU ENVER HOXHA: Mendimi ynë është se do të qe më mirë të kishim tezat kryesore të raporteve, në mënyrë që të përgatiteshim, sepse dhe koha e mbledhjes është e shkurtër, ajo do të zgjatë vetëm dy ditë. Sipas mendimit tonë situata ndërkombëtare dhe ngjarjet që po zhvillohen janë të tilla, që e bëjnë të nevojshme këtë mbledhje. Ky është mendimi im personal, por unë do t'ia parashtoj këtë Komitetit Qendror dhe do t'ju përgjigjemi sa më shpejt, duke ju thënë edhe përbërjen e delegacionit tonë¹.

Ne mendojmë se do të ishte e nevojshme që jo vetëm formalisht të merrnin dijeni imperialistët me anë të komunikatës se do të mbahet kjo mbledhje, por që atje të zgjidheshin shumë probleme të rëndësishme dhe delikate në lidhje me qëndrimin tonë ndaj gjendjes që është krijuar. Në qoftë se ne do të kishim tezat kryesore të raporteve, ne mund të bënim edhe propozime konkrete mbi këto çështje.

¹ Përgjigjja e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK të BS u dha të nesërmen më 21 mars 1961. Në këtë përgjigje, KQ i PPSH pranon propozimin e KQ të PK të BS për thirrjen në Moskë të mbledhjes së zakonshme të Komitetit Politik Konsultativ të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës dhe komunikon përbërjen e delegacionit të RPSH, duke theksuar se shokët Enver Hoxha e Mehmet Shehu nuk do të marrin pjesë në mbledhjen e sipërme.

Për çështjen e kohës së mbledhjes ne nuk kemi ndonjë kundërshtim, por në qoftë se do të kishim edhe disa shpjegime më të plota, edhe kjo çështje mund të shikohej. Por ne nuk duam që të krijojmë ndonjë pengesë për këtë mbledhje.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve që gjenden në Arkivin Qendror të Partisë

TË ORGANIZOJME MË MIRË NDIHMËN E SHIPEJTË MJEKËSORE NË BAZË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ
të PPSH¹*

25 mars 1961

Nga kjo mbledhje mendoj të dalim me një vendim, i cili të vërë si duhet para përgjegjësisë ndërmarrjet, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bashkimet Profesionale. Situata që ekziston, duhet ndryshuar patjetër. Ky vendim t'i shërbejë Partisë dhe klasës punëtore që të shkunden të gjithë, që nga organet qendrore deri në bazë dhe të tregohet një kujdes më i madh për shëndetin e njerëzve.

Shpërndarja e mjekëve mund të bëhet më mirë. Ka mundësi t'u dërgohen ndërmarrjeve të mëdha mjekë, të cilët të jenë me perspektivë për të qëndruar 2-3 vjet. Në qoftë se mjeku punon në spital, ka mundësi që të ketë edhe një ndërmarrje nën kujdes, gjë që do

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua informacioni mbi shkaqet e paaftësisë në punë dhe ndihma mjekësore në qendrat e punës.

të lehtësojë punën e spitalit, sepse do të bëhet më mirë lufta për parandalimin e sëmundjeve. Prandaj, është e domosdoshme të aktivizohen për këtë qëllim të gjithë mjekët, të cilët, me punën e tyre vullnetare, do të kontribuojnë shumë në qendrat e punës. Kjo të vlerësohet mirë, detyra të konkretizohet dhe për mjekët të krijohen kushte të përshtatshme, me qëllim që, brenda 15 ditëve, ata të fillojnë nga puna në ndërmarrjet ekonomike dhe në bonifikim. Nga ana tjetër, jo më vonë se 10-15 ditë, pikat e ndihmës së shpejtë në qendrat e punës, që drejtohen nga Kryqi i Kuq, të vihen në rregull.

Baza punon, lodhet, prandaj të marrim të gjitha masat që ta ndihmojmë atë konkretisht. Të krijojmë kushte të tilla që njerëzit të jenë të aftë për realizimin e planit dhe, kur ndonjëri sëmuret, t'i japim menjëherë ndihmën e parë mjekësore.

Herë pas here thuhet se ka mjekë që lëshojnë raporte jo të rregullta. Mendoj se s'bëjnë mirë ata mjekë që veprojnë kështu. Partia të punojë që mjekët ta kuptojnë këtë dhe, kur është rasti, të merren masa. Masat të bazohen në ligjet ekzistuese dhe të jenë me vend.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verballi i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

R A D I O G R A M

DELEGACIONIT SHQIPTAR NË MBLEDHJEN E KOMITETIT POLITIK KONSULTATIV TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS

M o s k ë

28 mars 1961

Ora 7^{30'}

Letrën e Greçkos hidheni në shportë¹, përgjigjuni vetëm atyre çështjeve që ai edhe të tjerët do të shtrojnë në mbledhje. Prandaj fjalimi juaj duhet rishikuar në këtë dritë. Mos flitni të parët.

Çështja e bazës. Qeveria Shqiptare nuk pranon as

¹ Është fjala për një letër dorëzuar delegacionit tonë orën e fundit para se të fillonte mbledhja e përfaqësuesve të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, që u zhvillua në Moskë më 28-29 mars të vitit 1961. Në letër kërkohej që Qeveria e RP të Shqipërisë të hiqte dorë nga baza ushtarako-detare e Vlorës dhe i gjithë territori i saj të vihej nën drejtimin e qeverisë sovjetike, forcat e armatosura të marinës shqiptare të tërhiqeshin nga ky territor, kurse të gjitha anijet luftarako-detare, ndihmëse etj., t'u jepeshin në dorëzim ekipazheve sovjetike.

ndryshimin më të vogël nga statukuoia aktuale e përcaktuar nga marrëveshjet zyrtare në mes dy qeverive. Hidhni poshtë shpifjet dhe arsyetimet e tyre, përmendni dhe shpërndani promemorien e Mehmetit e të Andrejevit në lidhje me ngjarjet në bazë. Argumentoni çështjen nga ana politiko-ushtarake, tregoni përgatitjen shembullore të marinarëve tanë. Lidhni kërcënimet dhe shantazhet e mëparshme të Hrushovit për këtë çështje dhe thoni se Qeveria Shqiptare nuk pranon tezat e marshalit Greçko, pse janë pa vend. Theksoni se çdo vendim që do të marrin në drejtim të heqjes së bazës dhe të mosfurnizimit të saj me armatime sipas marrëveshjeve dhe kontratave, dobëson mbrojtjen e kampit socialist e të Shqipërisë dhe i bën krejtësisht përgjegjës. Si konkluzion, u thoni se në emër të Partisë dhe të Qeverisë, ne nuk pranojmë dhe do të votojmë kundër çdo vendimi që mund të merret kundër statukuosë në bazë dhe mosrespektimit të marrëveshjeve midis BS dhe RPSH.

Na mbani në korent. Qëndroni në lartësinë e Partisë sonë.

E n v e r

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DIREKTIVAT QË DHA KONGRESI TË ZBËRTHEHEN ME KUJDES

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1961

Në Kongresin IV të Partisë u përcaktuan detyrat kryesore të planit të tretë pesëvjeçar. Tani, çështja është që këto detyra, orientime dhe direktiva që dha Kongresi, të zërthehen me kujdes dhe të vihen në jetë.

Puna për zërthimin e detyrave të Kongresit duhet filluar që nga çështjet ideologjike, organizative dhe ekonomike dhe e gjithë kjo të synojë për realizimin e planit në tërë treguesit e tij. Kjo kërkon që çdo dikaster të hartojë planin e sektorëve të vet, ndërsa drejtoritë ekonomike pranë aparatit të Komitetit Qendror të organizojnë më mirë kontrollin dhe ndihmën, me qëllim që të gjejnë zbatim detyrat që u përcaktuan në Kongresin e Partisë:

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit mbi një regjim më të fortë kursimi në të gjitha drejtimet e ekonomisë dhe të kulturës popullore.

Raporti që na është paraqitur në këtë mbledhje tregon se nuk janë mbajtur si duhet parasysh direktivat e Kongresit; raportet që u mbajtën, diskutimet që u zhvilluan, duhet të zbërtheshin dhe të lidheshin me detyrat aktuale që kanë dikasteret dhe ndërmarrjet ekonomike. Po të reflektohet më thellë në punimet e Kongresit, ne mund të zgjidhim më mirë detyrat dhe problemet që dalin edhe në fushën ekonomike.

Partia dhe Qeveria kanë punuar mjaft në drejtim të organizimit të punës për hartimin dhe për realizimin e planit të shtetit dhe rezultatet janë të mira. Në përgjithësi planet janë realizuar, kursime janë bërë etj., por megjithatë ka të meta dhe mundësi të mëdha që nuk shfrytëzohen si duhet. Duke u nisur nga situatat e vështira që po kalojmë, është e domosdoshme që të tregohemi më të kujdesshëm në organizimin e punës për plotësimin e detyrave të planit që po diskutojmë në këtë mbledhje. Në radhë të parë, kjo detyrë duhet bërë nga ana e dikastereve qendrore dhe prej këtej të zbritet në bazë, deri te punëtori i thjeshtë, me qëllim që të gjithë të luftojnë për të realizuar planin, jo në përgjithësi, por në çdo zë. Natyrisht, në tërë këtë punë duhet të ndihmojnë gjithnjë e më mirë si Partia, ashtu dhe Bashkimet Profesionale dhe organizatat e tjera të masave.

Organet qendrore, drejtoritë ekonomike të aparatit të Komitetit Qendror dhe Kryesia e Këshillit të Ministrave, duhet të luftojnë më tepër për një ndihmë e kontroll më të mirë bazës. Për këtë mund të krijohen ekipe të përkohshme, që të ushtrojnë kontroll e ndihmë në bazë, me qëllim që të organizohet zbatimi

i vendimeve të marra. Çështjet që dalin të zgjidhen në bazë e nga dikasteret dhe, në Byronë Politike e në Qeveri, të sillen ato probleme që nuk janë në kompetencë të tyre. Këto çështje, shokët zëvendëskryetarë të Këshillit të Ministrave, secili për sektorët e vet, t'i ndjekin mirë dhe të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e plotë të tyre. Ata të mos merren me gjëra të vogla, por të organizojnë mirë punën dhe t'u kërkojnë llogari vartësve. Vështirësi do të kemi edhe në të ardhshmen, bile edhe më të mëdha, por ne nuk do të tërhiqemi, përkundrazi do të luftojmë për kapërcimin me sukses të tyre.

Disa çështje të planit që shqyrtojmë sot, jam dakord t'ia paraqitim për diskutim Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, jo më vonë se muaji korrik i këtij viti. Gjatë kësaj kohe, Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe Drejtoria e Tregti-Financës pranë aparatit të KQ të PPSH, të marrin të gjitha masat që të vemi në Plenum me rezultate të reja. E theksoj edhe një herë që të caktohen e të instruktohen sa më parë ekipet, të cilat do të merren me kontrollin dhe me ndihmën bazës. Në përbërjen e ekipeve të caktohen përveç të tjerëve, edhe shokë ekonomistë, si nga dikasteret, ashtu dhe nga ndërmarrjet, sepse këta njohin problemet e prodhimit dhe mund të kontrollojnë e të ndihmojnë më mirë ndërmarrjet ekonomike, të nxjerrin detyra dhe të marrin masa në vend për të korrigjuar të metat që do të konstatojnë. Krahas këtyre ekipeve, mund të krijohen edhe komisione të veçanta, që të merren me projektet e ndërtimit dhe me sigurimin e lëndës së parë. Pasi të stabilizohet gjendja dhe të sqarohet problemi

se nga do të importojmë për'ndërtimin e objekteve sipas planit, duhet të tregohemi më të vëmendshëm në të gjitha drejtimet për të përballuar situatat që kalojmë. Më vonë do ta kemi më të qartë se cilat objekte do t'i ndërtojmë dhe cilat do t'i shtyjmë për më tutje. Prandaj, të forcojmë disiplinën dhe regjimin e kursimit, të sigurojmë lëndën e parë dhe të luftojmë për realizimin e planit.

Për hartimin e raportit që do të mbahet në Plenum të merret një grup shokësh nga drejtoria ekonomike e aparatit të KQ të Partisë dhe nga organet e pushtetit, nën drejtimin e shokut Haki [Toska], i cili mendoj të mbajë edhe raportin. Për çështjet që do të ngrejë ky raport, të hartohen tezat. Në raport duhet të ketë konkluzione të lidhura me detyrat që shtroi Kongresi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË NDIHMOJMË MË SHUMË ME KREDI ZONAT E THELLA MALORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 mars 1961

Ajo që ka rëndësi është që, në kushtet e tanishme, të shtojmë më shumë dhentë, dhitë, lopët si dhe kafshët për transport, aq të nevojshme për zonat e thella malore. Prandaj, për blegtorinë do të përkrahim më shumë fshatrat malore. Jam dakord që edhe ne, si shtet, të ndihmojmë për zhvillimin e blegtorisë dhe të frutikulturës, që këta sektorë të ecin më përpara. Duhet të kemi parasysh edhe anën tjetër që të mos sjellim asnjë çrregullim në qytete përsa u përket qumshtit dhe gjalpit.

Kreditë që mund t'u japim kooperativave bujqësore malore, është e domosdoshme të përdoren për që-

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua problemi «Mbi gjendjen ekonomike të fshatarësisë dhe të kooperativave bujqësore në zonat malore».

llimin që destinohen. Kjo kërkon që, para se të jepen këto kredi, të studjohen kushtet e kooperativave dhe të jetë e qartë se në cilin drejtim mund të zhvillohen ato, si për kulturat bujqësore, ashtu dhe për blegtorinë etj. Në lidhje me këtë të fundit, të ndihmojmë ato zona që kanë kushte më të mira blegtorale. Në këtë mënyrë ne do të përmirësojmë gjendjen ekonomike të kooperativave bujqësore pa e rënduar shtetin. Prandaj, është e nevojshme të studjojmë ndihmën që duhet dhënë, brenda mundësive, për ngritjen ekonomike të zonave malore, por ndihma e shtetit duhet kuptuar drejt. Nuk duhet të ndodhë që të presim ndihmë, por të mendohet për burime të reja ekonomike. Për shembull, fshatarët e Tropojës mund të mbledhin gështenjat dhe shqemën.

Edhe për frutikulturën, para se të japim kredi, të krijojmë fidanishte, të cilat të drejtohen nga shteti. Kredi mund t'u jepen edhe atyre kooperativave bujqësore që i kanë kushtet e përshtatshme, kanë tokë, krahë pune, ujitje, me qëllim që të krijojmë blloqe të mëdha pemësh. Kreditin ta japim të diferencuar, sipas fuqisë ekonomike që kanë kooperativat bujqësore. Kooperativave, që kanë më shumë të ardhura dhe që do të krijojnë blloqe pemësh, t'u jepen më pak kredi. Ka mjaft shembuj në Vlorë, në Berat e në vende malore, ku janë krijuar blloqe të tëra me pemë frutore pa asnjë kredi nga shteti. Kjo është bërë me krahë pune.

Detyra e rëndësishme e Partisë në fshat është të punojë që të mos largohen njerëzit nga fshati, të li-dhen ata ekonomikisht me fshatin, të ndihmohen nga shteti me kredi, por edhe të punojnë për ngritjen e nivelit të tyre ekonomik. Po kush do t'i kryejë këto punë

në fshat, në rast se ikin njerëzit? Natyrisht, edhe largime nga fshati do të ketë, por kjo do të bëhet në bazë të planit të shtetit dhe jo sipas dëshirave që ka njëri ose tjetri.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

EDHE PA BAZËN E VLORËS NE DO TË LUFTOJMË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

1 prill 1961

Jam plotësisht dakord me pikëpamjen e të gjithë shokëve të Byrosë Politike për këto çështje kaq të rëndësishme. Jam gjithashtu plotësisht dakord me punën e bërë nga delegacioni ynë që mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të vendeve pjesëmarrëse në Traktatin e Varshavës, i cili ka mbrojtur me besnikëri vijën e Partisë.

Këtë e tutje duhet t'u qëndrojmë akoma më fort kundërshtarëve tanë, të jemi më të zgjuar në marrëdhënie me ta, të ruajmë me kujdes parimet e marksizëm-leninizmit. E them këtë, pse, siç e shohim qartë çdo ditë e më shumë, ne kemi të bëjmë me udhëheqje oportuniste, revizioniste, armike të marksizëm-leniniz-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga delegacioni i Partisë dhe i Qeverisë sonë që mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, e cila u zhvillua në Moskë më 28-29 mars 1961.

mit, të cilat janë edhe në krye të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës. Për këtë kemi qenë e jemi të bindur dhe këtu nuk ka asnjë fije dyshimi.

Duhet kuptuar se udhëheqja revizioniste sovjetike jo vetëm ka hyrë në rrugë armiqësore, po kjo mbledhje e Traktatit të Varshavës ka qenë një veprim konkret i tradhtisë së saj, për të cilën u demaskua në Mbledhjen e Moskës. Presionet që na bënë në mbledhjen e Traktatit të Varshavës, janë si përgjigje e qëndrimit tonë heroik dhe marksist-leninist në mbrojtje të marksizëm-leninizmit dhe njëkohësisht si përgjigje ndaj Kongresit IV të Partisë sonë dhe vijës së tij të drejtë. Të tilla qëndrime mbajnë të gjithë tradhtarët, të cilët Kongresi IV i Partisë sonë i tmerron.

Do të bëhen edhe mbledhje të tjera në të ardhshmen, por ne përsëri do të fitojmë. Ne e dimë që revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre luftojnë të diskreditojnë Partinë tonë, bëjnë përpjekje për të përçarë udhëheqjen e saj; ata do t'i futen punës për të vazhduar me të gjitha mjetet komplotet e tyre, me qëllim që të rrëzojnë udhëheqjen e Partisë sonë, për të likuiduar Partinë, bëjnë edhe presione ushtarake për të okupuar Shqipërinë. Pra ata janë armiq dhe nga armiku nuk duhet pritur asnjë e mirë.

Gjithashtu, edhe nga ana ekonomike asnjë të mirë nuk duhet të presim nga revizionistët sovjetikë dhe veglat e tyre, të llogaritim që këta nuk do të na japin asnjë ndihmë. Prandaj të manovrojmë që plani ynë pesëvjeçar të realizohet pa këto ndihma. Kjo do të jetë një bombë e madhe kundër këtyre tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, kundër armiqve dhe komplotistëve.

të vendit tonë, që synojnë diskreditimin e Partisë duke krijuar pakënaqësi në popull. Por popullin tonë ata nuk e njohin siç e njohim ne që jetojmë në mes tij.

Në këto kushte, detyra jonë është që t'i marrim mirë në dorë çështjet ekonomike, t'i kuptojmë këto politikisht, të tregojmë zotësi të madhe organizative dhe një mobilizim të jashtëzakonshëm, sepse armiqtë e jashtëm do të na nxjerrin pengesa dhe vështirësi të mëdha, jo vetëm politike, por edhe me anë komplotesh dhe bllokadash të çfarëdo lloji. Këto pengesa e vështirësi duhet t'ia shpjegojmë popullit. Mendoj që këtë punë ta bëjmë pa qenë nevoja të përdorim dokumente, sepse populli e dëgjon dhe e kupton mirë Partinë e tij, e cila i ka thënë kurdoherë të vërtetën. Në këtë mënyrë populli do të jetë i përgatitur për të përballuar më vonë edhe situata më të vështira që do të vijnë. Pra, të mobilizojmë të gjitha forcat tona që të shpartallojmë çdo komplot të revizionistëve dhe të realizojmë detyrat e planit, të ngremë vazhdimisht nivelin politik dhe ideologjik të Partisë e të popullit, të punojmë në atë mënyrë që niveli i jetesës së popullit të mos ulet.

Duhet të kuptojmë gjithashtu se ndihma e RP të Kinës ka një rëndësi shumë të madhe për ne, prandaj atë ta përdorim drejt. Qëndrimi i shokëve kinezë në Mbledhjen e Moskës dihet nga të gjithë se ka qenë shumë i mirë. Partia Komuniste e Kinës ka një vijë të përgjithshme të drejtë dhe është në luftë të hapur parimore kundër grupit tradhtar të Nikita Hrushovit dhe të gjithë të tjerëve që e pasojnë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Në situatën që ndodhet vendi ynë, ndihma ekono-

mike e RP të Kinës do të bëjë që plani ynë të mbulohet plotësisht nga ana financiare, sepse duhet pasur parasysh që, jo vetëm Bashkimi Sovjetik, po as Çekosllovakia, as të tjerët që i pasojnë nuk do t'u përmbahen angazhimeve që kanë marrë ndaj vendit tonë. Diku Novotni ka thënë se do ta ndryshojnë qëndrimin ndaj nesh. Është e qartë se ai ka bërë aluzion përsa u përket kredive. Prandaj na mbetet t'i vëmë këta tradhtarë përpara përgjegjësisë, sepse janë duke sabotuar ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Si do ta bëjmë këtë, do ta shohim më vonë.

Rëndësi edhe më të madhe kanë çështjet ushtarake. Në këtë situatë baza e Vlorës është një kërcënim shumë serioz për ne, domethënë për pushtimin e Shqipërisë, për zhdukjen e pavarësisë së vendit tonë. Janë të drejta sa thanë shokët se ka shumë mundësi që udhëheqja sovjetike ta heqë bazën e Vlorës dhe anijet të mos na i dorëzojë neve, sepse e tillë është vija e Hrushovit. Ajo çon ujë në mullirin e imperializmit amerikan. Por duke u larguar nga baza, ata do të humbasin dhe ne do të fitojmë.

Hrushovi ka edhe plane të tjera të poshtra kundër vendit tonë. Njerëz të tillë si Ulbrihti duan të na trembin, kur thonë se «baza ushtarake e Vlorës ka një rëndësi shumë të madhe për Shqipërinë», por për ne, në kushtet e sotme kjo bazë s'ka asnjë rëndësi. Përkundrazi, atë mund ta përdorë Nikita Hrushovi si gozhdën e Nastradinit dhe të hedhë divizione të tëra, duke krijuar rreziqe të mëdha për vendin tonë. Prandaj, ashtu siç thanë të gjithë shokët e Byrosë Politike, edhe unë jam dakord që bazën ta likuidojmë duke kërkuar

që t'i mbajmë ne të gjitha luftanijet. Sikur të na mbe-
ten anijet ashtu si duam ne, është mirë, në të kundërtën
nuk na hyjnë në punë nëndetëset. Ne edhe pa to do të
luftojmë. Sikur t'i kemi edhe anijet, në rast sulmi të
armiqve, do të bëjmë kërdrinë, po lufta kryesore nuk
do të zhvillohet në det. Unë kështu mendoj për çësht-
tjen e bazës. Por të mos harrojmë se revizionistët sovje-
tikë mund të qëndrojnë në bazën e Vlorës, me qëllim
që të kurdisin ndonjë akt tjetër provokues dhe që të
kenë atje njerëzit e tyre. Prandaj të manovrojmë. Çfa-
rëdo shtate që mund të krijohet, domethënë qëndrojnë
ose ikin sovjetikët nga baza, ne, nga ana jonë, absolu-
tisht duhet të evitojmë incidentet dhe provokacionet
që mund të bëjnë ata.

Nuk dua të hyj në detaje, por dëshiroj të theksoj
se duhet të mendojmë seriozisht për përgatitjen tonë
ushtarake dhe për armatimin. Ju, shokët e ushtrisë,
përgatitni të gjitha variantet e mbrojtjes në kushte rre-
thimi dhe me këto armë që kemi. Pra të shkojmë nga
parimi që armë, municione, veshmbathje për ushtrinë
nga Bashkimi Sovjetik nuk do të kemi më. Prandaj t'i
futemi punës që tani dhe të marrim masa që disa nga
këto nevoja të ushtrisë t'i sigurojmë vetë dhe disa të
tjera t'ua kërkojmë miqve.

Këto janë disa çështje politike, ushtarake dhe eko-
nomike që ne duhet t'i kemi parasysh. Të jemi në
këmbë, të mbajmë kontakte të ngushta me popullin,
të forcojmë vigjilencën, të parashikojmë që në një for-
më ose në një formë tjetër komplotet do të përsëriten,
provokacionet kundër vendit tonë do të shtohen, do të
shtohen presionet e armiqve kundër nesh. Por ne do të

përballojmë çdo situatë, sepse Komiteti Qendror, Byroja Politike, e gjithë Partia, janë grusht dhe, megjithëse kemi armiq të shumtë dhe të fuqishëm, kemi edhe shumë miq, në radhë të parë Kinën e madhe, vendet e demokracisë popullore të Azisë, si edhe popujt e të gjitha vendeve socialiste dhe komunistët e mbarë botës.

Është e vërtetë se armiqtë tanë imperialistë e revizionistë mund të bëjnë shumë gjëra, po edhe nuk veprojnë dot menjëherë. Ata më parë duhet të përgatitin terrenin kundër nesh në fushën politike, ideologjike, të shpifin e të shpifin e pastaj të ndër marrin aksione. Por ne duhet të shohim qartë se si zhvillohen situatat, sepse, po i pamë ndryshe nga ç'janë, atëherë edhe masat për mbrojtjen e atdheut dhe të Partisë nuk mund të realizohen me atë intensitet e forcë organizimi dhe nuk mund të jenë në atë nivel politik që kërkohet. Partia dhe populli ynë kanë kaluar prova të mëdha, nga të cilat janë kalitur pa masë dhe janë në gjendje t'i kuptojnë këto situata drejt, edhe me nuancat e tyre të vogla.

Si përfundim, qëndrimin të udhëheqjes sovjetike në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës duhet t'i përgjigjemi me një letër, pastaj të mendojmë për t'iu përgjigjur edhe partive të tjera që e pasojnë për gjithçka është bërë kundër nesh, për qëndrime dhe taktika armiqësore kundër Partisë së Punës dhe Republikës sonë Popullore. Natyrisht, në këtë drejtim duhet të jemi të matur, të mos u japim armiqve armë në dorë kundër nesh, po armët në dorë t'i kemi ne. Shikoni, si këta tradhtarë të marksizmit janë vënë në pozita jashtëzakonisht të vështira nga një Parti e vogël si jona

dhe bëjnë veprime të tilla që njerëz me logjikë nuk mund t'i bëjnë; ata me këto veprime po i precipitojnë ngjarjet.

Por këtu nuk është vetëm çështja e Shqipërisë, po është çështja e gjithë komunizmit ndërkombëtar. Megjithëse shumë komunistë në botë nuk i dinë ose disa nuk i kanë kuptuar akoma këto ngjarje, ka edhe shumë komunistë që i kanë kuptuar. Grupi i Nikita Hrushovit me shokë e di sa e krimbur është situata. Ata akoma ia ngarkojnë Stalinit vështirësitë që u dalin. Por njerëzit sovjetikë nuk besojnë se këto vështirësi janë pasojë e «gabimeve» të Stalinit.

Në luftën kundër këtij grupi të rrezikshëm tradhtar të marksizëm-leninizmit edhe ne japim kontributin tonë. Ne jemi në rrugë të drejtë, prandaj çdo ditë që kalon vazhdimisht fitojmë, kurse grupi i Hrushovit e ka keq dhe në fund do të humbasë, por kjo do akoma kohë.

Të insistojmë e të theksojmë vazhdimisht çështjen e unitetit në Parti e në popull, sepse kjo është jetike. Të kemi parasysh se Hrushovi dhe grupi i tij do të bëjnë çfarëdo poshtërsish dhe do të veprojnë edhe kundër njerëzve më të mirë të Partisë sonë. Prandaj të shtrëngojmë radhët tona, se kështu revizionistët do ta thyejnë kokën patjetër. Të marrim masa dhe të mos neglizhojmë asnjë çështje.

Heroizmi i popullit tonë është i madh, po situatën ta kemi kurdoherë parasysh. Këtë vit ne siguroam 70 mijë tonë drithë më tepër se vitin e kaluar, por duhet të supozojmë se përsëri mund të na ngjasë një vit i keq. Kina sigurisht do të na ndihmojë, por revizionistët

sovjetikë dhe pasuesit e tyre si komplotistë të mëdhenj që janë, mund të veprojnë me dinakëri për të penguar rrugën e vaporëve kinezë dhe neve të mos na vijë grurë. Prandaj t'ia bëjmë të ditur popullit që në rast se do të na vijnë ditë të këqija, deri dhe luftë, ai të shtrëngojë rripin dhe të hajë bukë të racionuar, të jetë i vendosur që të hajë aq sa ka dhe me këtë të jetojë. Një pregatitje e tillë e popullit është e domosdoshme, secili ta ketë të qartë situatën që kalojmë. Përpara kemi një luftë të vështirë, prandaj të bëjmë kudo ekonomi.

Revizionistët sovjetikë, këta armiq të marksizëm-leninizmit, do t'i pengojnë të tjerët të marrin vesh se ç'bëhet në Shqipëri dhe se si lufton populli ynë. Ata do të përpiqen të na vënë mure në opinionin e partive motra. Ja, dje ambasadori ynë në Moskë na njoftoi se e kishin thirrur dhe i kishin thënë se kanë konstatuar që raporti i shokut Enver Hoxha në Kongresin IV të Partisë po shpërndahet jashtë rregullave nga njerëzit e ambasadës shqiptare në Moskë në persona të veçantë sovjetikë, ndërsa kjo punë mund të bëhet nga «Mezhdunarodnaja knjiga»¹. «Nuk po kuptoj, i ishte përgjigjur Nesti [Nase], një praktikë e tillë s'është ndjekur gjertani as për ne, as për përfaqësitë e tjera, prandaj përse të bëhet ky diferencim për dokumentet e Partisë sonë?».

Me kushtet që ata po krijojnë, sipas mundësive që kemi, ne të shikojmë edhe çështjen e studentëve shqiptarë, që studjojnë jashtë shtetit si dhe të oficerëve e të japim udhëzime se sa do të qëndrojnë dhe sa do të heqim. Pra duhet të bëjmë një plan, duke marrë para-

1 Nga rusishtja: Libri ndërkombëtar.

sysh çfarë armiqsh dhe vështirësish kemi përpara. Në goftë se rrethanat politike dhe lufta jonë e vendosur i detyrojnë ata të heshtin për një moment dhe të na japin, ta zëmë, disa traktorë, të mos mendojmë se ata bënë kthesën, po të jemi njëkohësisht vigjilentë.

Jemi pra dakord të bëjmë një letër?

Të gjithë shokët e Byrosë Politike u shprehën njëzëri që kjo letër të bëhej. Pastaj u vendos që të njoftoheshin mbi këtë çështje edhe anëtarët e Komitetit Qendror të PPSH si dhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë në rrethe.

Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

ANIJE LUFTARAKE TË FLOTËS VI AMERIKANE NË PORTET JUGOSLLAVE¹

8 prill 1961

Gazeta «Politika» e Beogradit njoftonte pardje se më 5 prill arriti në portin e Splitit kryqëzori «Springfild», i pajisur me raketa të telekomanduara dhe që kishte ngritur flamurin e komandantit të Flotës VI Amerikane, nënadmiralit Xhorxh Anderson.

Vizita të kësaj natyre të njësive luftarake dhe të admiralëve të Flotës VI Amerikane në ujërat dhe në skelat jugosllave, nuk ndodhin për herë të parë dhe as janë të rastit. Marina amerikane e luftës lëvrin me një «kryelartësi» agresive në ujërat e Mesdheut dhe të Adriatikut, sikur këto të ishin ujërat territoriale të SHBA-së. Veçanërisht portet jugosllave dhe greke janë bërë çerdhe intrigash të rrezikshme, sepse vendet në fjalë janë lidhur midis tyre me një ingranazh paktesh, fijet e të cilave shpien drejtpërsëdrejti në Uashington. Formulimet dhe termat e komunikatave zyrtare, siç është rasti konkret i «vizitës jozyrtare» të njësive luftarake «Springfild», nuk janë gjë tjetër veçse një tym

¹ Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit».

maskimi i zakonshëm që nuk mund të gënjejë asnjëri për rrezikshmërinë e tyre. Është e qartë se komandanti i Flotës VI Amerikane nuk shkon në Jugosllavi për turizëm, mbi një kryqëzor të pajisur me raketa të telekomanduara dhe që ka brenda 1 000 oficerë dhe marinarë. Ai shkon te miqtë e tij, te njerëzit që kanë gjuhë të njëjtë me të, për të kurdisur komplete të reja kundër vendit tonë, ashtu siç bënë me komplotin që u dështoi.

Vizita e nënadmiraletit amerikan në Jugosllavi do të pasohet, ashtu siç njoftuan këto ditë agjencitë e lajmeve, me vizitën e Rankoviçit në Athinë.

Nuk është e vështirë të kuptohet se vizita e komandantit të Flotës VI Amerikane në Jugosllavi, e kurdisur me miqtë e tij, është një demonstracion jo pa qëllime të ndryshme kundër vendit tonë, sidomos po të marrim parasysh kohën e zgjedhur për këtë. Nënadmiralet Xhorxh Anderson shkon në Jugosllavi vetëm pak javë pasi nga tribuna e Kongresit IV të PPSH u denoncua botërisht komploti i rrezikshëm që kishin përgatitur kundër pavarësisë së Shqipërisë, Jugosllavia në bashkëpunim me Greqinë, me Flotën VI Amerikane dhe me disa tradhtarë shqiptarë, komplot ky që u dërrmua dhe u plasi në duar. Ai shkon në Jugosllavi në një kohë kur shtypi jugosllav vazhdon me të madhe një fushatë të gjerë shpifjesh dhe provokacionesh kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, fushatë kjo e hapët dhe e nëndheshme, që ka për qëllim të ushqejë shtypin reaksionar botëror kundër Shqipërisë heroike dhe socialiste.

Duhet të shënojmë këtu gjithashtu se, ndërsa kryqëzori «Springfield» me nënadmiraletin amerikan çante

valët e Adriatikut dhe hidhte ankorën në Split, «Galebi» me mareshalin jugosllav lundronte në anën tjetër të Mesdheut, pasi e çoi atë nëpër vendet e Afrikës. Dhe, kur mareshali jugosllav mban fjalime dhe jep intervista me fjalë të mëdha «kundër kolonializmit», në një kohë kur SHBA përdorin të gjitha mënyrat për të mbajtur në këmbë këtë kolonializëm, siç e tregojnë ngjarjet e përgjakshme në Kongo e gjetkë, nënadmiralet amerikan vjen për vizitë në Jugosllavi. Njëra vizitë plotëson tjetrën.

Të tëra këto misione kanë të njëjtin qëllim — përpjekje të ethshme dhe komplete kundër lirisë së popujve dhe paqes, në atë ose në këtë zonë të botës.

Dihet nga të gjithë se Flota VI Amerikane është një forcë agresive goditëse kryesore e imperializmit amerikan dhe e NATO-s në Mesdhe. Ajo është në patrullim të vazhdueshëm, demonstron dhe kërcënon duke u përpjekur t'u tregojë popujve të brigjeve të detit Mesdhe se çdo përpjekje e tyre për liri dhe për një jetë më të mirë do të ketë si përgjigje zjarrin e armëve të saj dhe bajonetat e këmbësisë detare të kryqëzorëve. Flota VI Amerikane është gjithmonë gati për t'u lëshuar me tërbim kundër pavarësisë së popujve. Ngjarjet në Lindjen e Afërme dhe zbarkimi i këmbësisë detare në Liban e treguan qartë këtë.

Flota VI Amerikane përfaqëson një rrezik serioz për vendet mesdhetare, për vendet socialiste në këtë zonë dhe veçanërisht për vendin tonë, i cili është pika më e avancuar dhe i vetmi vend socialist që ndodhet në detin Mesdhe. Prandaj kjo pirate e detrave e kohëve tona vjen rrotull aq shpesh dhe me këmbëngulje nëpër

brigjet e Adriatikut. Por imperialistët amerikanë nuk kanë në Mesdhe vetëm Flotën VI. Kundër vendit tonë dhe vendeve të tjera socialiste, ata kanë krijuar një numër të madh bazash ushtarake në Itali e në Greqi, aerodrome, baza raketash dhe baza detare. Gjithë kjo veprimtari e rrezikshme, në fund të fundit, drejtohet kundër lirisë së popujve dhe paqes në përgjithësi.

Prandaj popujt ndjekin me vigjilencë këtë veprimtari të imperialistëve amerikanë dhe të aleatëve të tyre. Vigjilenca e popullit shqiptar dhe e Partisë së tij të Punës bëhet edhe më e madhe. Detyrat e saj kombëtare dhe internacionaliste Shqipëria e re kurrë nuk do t'i harrojë. Popullin shqiptar as e kanë gjetur e as do ta gjejnë ndonjëherë në gjumë planet dhe komplotet e imperialistëve të SHBA-së dhe të shërbëtorëve të tyre kundër vendit tonë, socializmit dhe paqes. Populli shqiptar kurrë nuk frikësohet nga kërcënimet e armiqve. Ai i denoncon ata përpara opinionit publik botëror. Me qëndrimin e tyre të vendosur Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e RPSH dhe populli shqiptar kanë bërë të dështojnë me turp të gjitha planet dhe komplotet e armiqve të lirisë së vendit tonë dhe të paqes. Kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë janë bërë shumë komplete; të tjera komplete mund të bëhen në të ardhshmen, por ato do të dështojnë kurdoherë dhe me siguri për turpin e autorëve të tyre. Armiqtë e Shqipërisë le të mendojnë mirë, dhe të mos harrojnë kurrë se me Shqipërinë e vogël heroike është populli sovjetik, është Kina e madhe, janë popujt e vendeve të demokracisë popullore, janë të gjithë popujt përparimtarë të botës.

Republika Popullore e Shqipërisë është një kësh-tjellë e pamposhtur e socializmit dhe e paqes në këtë zonë të botës. Ashtu si gjithmonë ajo do të qëndrojë e patundur si një shkëmb graniti, për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e vet dhe interesat e socializmit në tërësi, në brigjet e Adriatikut.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»
Nr. 86 (3929), 8 prill 1961*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

SKUADRAT E PUNËS SOCIALISTE NË FSHAT TË JENË SIEMBULL NË PUNË E NË SHKOLLË

Fjala me një grup të rinjsh dhe të rejash¹

12 prill 1961

Pasi i pret përzemërsisht të rinjtë shoku Enver Hoxha i pyet dhe interesohet nëse ndjekin shkolla shtetërore ose kurse agroteknike, ç'prodhime marrin në parcelat e tyre ose sa qumësht marrin në sektorin e blegtorisë, si jetojnë në fshat, si është pas-tërtia në fshat e në shtëpitë e tyre etj. Pastaj fillon bisedën si më poshtë:

Mbledhja që bëtë këtu në Tiranë ishte shumë e dobishme, sepse ju sollët eksperiencën tuaj nga të gjitha rrethet e vendit tonë, vutë në dukje sukseset tuaja, vështirësitë që hasni dhe luftën për kapërcimin e tyre.

Skuadrat e punës socialiste kanë rëndësi të madhe.

¹ Ky grup mori pjesë në takimin e parë kombëtar që u zhvillua në Tiranë më 11 prill 1961 me përfaqësues të skuadrave që punojnë për të fituar titullin «Skuadër e Punës Socialiste në bujqësi».

Këtë ju nuk duhet ta kuptoni si një çështje të thjeshtë, sepse, po t'i zbërtheni mirë detyrat që ato kanë, do të shihni në to një perspektivë të mrekullueshme dhe frytdhënëse. Rëndësia e tyre është e madhe, jo vetëm për pjesëtarët e këtyre skuadrave, por për të gjithë vendin tonë, domethënë për zhvillimin e gjithë ekonomisë, të arsimit dhe të kulturës, me qëllim që populli ynë të jetojë i lumtur dhe në mënyrë të kulturuar. Kjo është e domosdoshme dhe u përshtatet nevojave të kohës, ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Prandaj, kur themi të punojmë në mënyrë socialiste, kjo do të thotë të krijojmë mundësi të tilla që të zhvillohet edhe më shumë ekonomia jonë, të shtohen të ardhurat kombëtare, të përmirësohet çdo muaj e çdo vit jeta e popullit.

Puna është nder për të gjithë. Tani nuk ka njeri në Shqipëri që nuk punon. Por, kur themi të punojmë në mënyrë socialiste, kjo do të thotë që ta organizojmë mirë punën, të mos bëjmë punë me hope, ose disa të punojnë dhe të tjerë të tërheqin këmbët zvarrë. Puna duhet të organizohet në mënyrë të tillë që, para së gjithash, të realizohet plani, të shtohen prodhimet e njëkohësisht punëtori ose fshatari të ndiejë një kënaqësi të madhe se ka kryer detyrën për veten, për familjen dhe për popullin. Puna të organizohet në atë mënyrë që punonjësi të ketë kohë edhe për nevoja e detyra të tjera, të cilat kanë të bëjnë me rritjen dhe me përparimin e tij, si nga ana e intelektit, ashtu edhe për zbatimjen, për një jetë të përbashkët në shoqëri. Këto i siguron vetëm një punë e rregullt dhe e organizuar mirë.

Edhe prindërit tanë kanë punuar, por ata kanë punuar ashtu si kanë ditur, sepse shkollë e dituri nuk kishin, mjete kishin pak, prandaj edhe lodheshin më shumë dhe prodhonin shumë pak. Por në rendin tonë socialist ne kemi kushte që të punojmë më mirë nga prindërit tanë, dhe frytet e punës janë më të mëdha, sepse kemi edhe dituri, edhe mjete shumë më tepër. Ne kemi më shumë rezultate se prindërit tanë, por këta nuk mund t'i ngarkojmë me faj që s'kanë punuar si ne. Burimi i kësaj duhet gjetur te shtypja dhe te padituria që ekzistonin në regjimet e kaluara antipopullore.

Nëse sot punojmë më mirë, kjo shpjegohet me faktin se jetojmë në një kohë tjetër, kur vendi ynë është i lirë, kur populli i udhëhequr nga Partia ka zhdukur feudalizmin, kapitalizmin dhe okupatorët e huaj. Përveç këtyre Partia ka krijuar mundësi të mëdha në fshat, në radhë të parë kolektivizimin, siguron vazhdimisht edhe mjete si traktorë e vegla të ndryshme bujqësore, si edhe shkolla. Për të gjitha këto arsye ne ndryshojmë nga prindërit tanë, prandaj edhe rezultate kemi më shumë.

Në këtë drejtim skuadrat tuaja kanë rëndësi të madhe. Të kini parasysh që ju të jeni kudo shembull, domethënë të tërhiqni me vete, jo vetëm sa më shumë njerëz në to dhe të rinj, po edhe të kaluar nga mosha. Këta mund të mos ndjekin dot shkollën dhe ndonjë aktivitet tjetër, por kanë një eksperiencë të gjatë në punë dhe në jetë, nga e cila ju do të përfitoni mjaft. Edhe ata kanë çfarë të mësojnë nga ju. Ata do t'ju shikojnë, për shembull, kur ju, pas punës së lodhshme,

do të ktheheni në shtëpi plot gëzim dhe me libra në duar dhe do t'ju pyesin: ç'është ai libër që lexon? Atëherë ju do t'u shpjegoni ç'është, ç'përmban ai libër. Kjo punë e anëtarëve të skuadrës do të sjellë me siguri një ndryshim të madh në jetën e familjes dhe, si pasojë, në jetën e gjithë fshatit.

Rinia e ka kuptuar se ne i kemi të gjitha mundësitë që me zotësitë dhe me dituritë tona të korrим sukseste të mahnitshme jo vetëm në punë, por në çdo fushë. Ajo e kupton gjithashtu se fitoret, si këto tonat, nuk mund të arrihen pa udhëheqjen e lavdishme të Partisë, që e zgjoi popullin, i dha atij forcë e dituri dhe e udhëheq me bindje të ndërtojë jetën e lumtur. Partia shtroi para rinisë detyrën që kjo të bëhet shembull për të mësuar, edhe rinia e kuptoi drejt. Të gjitha shkollat e kategorive të ndryshme që u krijuan, i dhanë mundësi asaj dhe gjithë popullit të zhvillohen dhe të punojnë më mirë, të japin rezultate më të mëdha. Edhe kjo është një tjetër fitore e madhe. Prandaj ju të rinjtë e skuadrave socialiste duhet të vini të gjitha forcat për të kapërcyer me guxim çdo vështirësi që do të dalë përpara. Kjo do të arrihet kur ju t'i plotësoni kushtet për të qenë anëtarë të këtyre skuadrave.

Ju duhet t'i ndiqni me zell shkollat dhe të mësoni me ngulm. Po ka edhe nga ata që quhen autodidaktë, domethënë njerëz që mësojnë vetë, sepse nuk kanë mundësi të ndjekin shkollat. Ju duhet të bëheni si mësues të këtyre njerëzve dhe t'i nxitni e t'i ndihmoni që ata të mësojnë vetë.

Ndjekja e shkollave fillore dhe 7-vjeçare është një çështje me interes të madh për ju, shokë të fshatit,

sepse ato ju zgjerojnë kulturën e përgjithshme. Por ju mos harroni, gjithashtu, edhe kurset speciale për profesionet tuaja, që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe me blegtorinë. Edhe këto duhet t'i vazhdoni me kujdes, pavarësisht se ndiqni shkollat fillore ose 7-vjeçare, ku mësoni aritmetikë, gjuhë, histori etj. T'i ndiqni, pra, edhe këto kurse profesionale, që të lexoni edhe libra, nga të cilat do të mësoni për zhvillimin e lopëve, dhenve, shpendëve, bletëve, drithërave e degëve të tjera të bujqësisë. Kështu, edukimi juaj duhet të jetë i shumanshëm.

Ju duhet të jeni të lumtur që Partia realizoi kolektivizimin e bujqësisë. Ju shihni me sytë tuaj se si po ndryshojnë shpejt fshatrat dhe fushat tona, si ishin përpara dhe si janë tani. Kush vjen në Shqipëri dhe që ka qenë 2-3 vjet më parë habitet me punën e madhe që ka bërë e bën fshatarësia dhe, në radhë të parë, rinia e fshatit tonë, nën udhëheqjen e Partisë.

Por ne nuk kemi përfunduar çdo gjë në fshat. Atje puna porsa ka filluar. Kudo duhet të hapen e të punohen mirë tokat, t'u bëjmë shërbimet e duhura të gjitha kulturave se vetëm kështu do të shtohet prodhimi, të rritim kulturat e ndryshme dhe blegtorinë ta zhvillojmë ashtu siç na mëson shkenca. Mirëpo nuk bëhen në një ditë të gjitha këto gjëra, ashtu sikurse nuk u dërgua brenda një dite njeriu sovjetik në kozmos.

Ju morët vesh sot nga radioja se një njeri u hodh në hapësirën kozmike dhe u kthye shëndoshë e mirë në tokë. Kjo është një nga fitoret më të shkëlqyera të njerëzimit. Por, kjo është fitore e madhe e njerëzve sovjetikë. Për të arritur këtu, u desh fitorja e Revo-

lucionit të madh të Tetorit, u desh fitorja e socializmit që i udhëhoqën Lenini dhe Stalini, që përgatitën dhe krijuan kuadro, të cilët iu përveshën me zell të madh punës që nga rindërtimi i vendit pas revolucionit dhe gjer në këto ditë historike, kur njeriu shkoi në hapësirat qiellore. Kjo fitore e madhe i detyrohet gjithashtu punës krijuese të të gjithë shkencëtarëve të botës që gjatë epokave të ndryshme historike kanë luftuar, janë përpjekur dhe kanë kaluar vështirësi të panumërta duke bërë njëra pas tjetrës shpikje të ndryshme gjer në ditët tona. Vepra të tilla, pra, bëhen me luftë dhe me përpjekje.

Gjatë shekujve janë bërë shumë shpikje të mëdha, që kanë shkaktuar revolucione në shoqëri. Të tilla janë, për shembull, zbulimi i makinës së parë me avull, ai shkaktoi një revolucion të madh në botë, sepse shënoi fillimin e industrializimit; po kështu, shpikja e elektrikut, që tani neve na duket diçka e lehtë, por sa shkencëtarë kanë punuar dhe janë përpjekur gjersa ai u bë realitet! Pra, fabrikat, uzinat, anijet, automobilat, aeroplanët etj., nuk janë gjëra të thjeshta e të zakonshme, por rezultat i zhvillimit të shkencës e të teknikës nga ana e njerëzimit.

Shpikja e energjisë atomike është gjithashtu një revolucion i jashtëzakonshëm, kurse dërgimi i njeriut në kozmos një tjetër revolucion. Kjo i hap shkencës dhe të gjithë njerëzimit perspektiva të mrekullueshme që akoma nuk i parashikojmë dot. Me këtë fitore u rrëzuan të gjitha pikëpamjet e fesë, të hoxhallarëve e të priftërinjve që thoshin: «Qielli është i zotit», kurse tani qiellin e zotërojnë njerëzit.

E ç'janë gjithë këta shkencëtarë të mëdhenj që hodhën njeriun e parë në kozmos? Janë njerëz të zakonshëm si edhe ne, njerëz të popullit, punëtorë ose fshatarë, prindërit e të cilëve dje ishin njerëz pa kulturë, të shtypur etj., por që Revolucioni i madh i Tetorit, marksizmi, Lenini dhe Stalini, me Partinë e tyre i edukuan dhe i bënë të aftë të ngrenë industrinë e fuqishme socialiste, të bëjnë kolektivizimin, të ngrenë në një shkallë të tillë shkencën dhe teknikën.

Ne e dimë se për ndërtimin e mëtejshëm të socializmit në vendin tonë do të hasim vështirësi të reja, por sukseset e mëdha që kemi arritur, do të na japin më shumë kurajë që ta bëjmë Shqipërinë një vend të begatshëm dhe të kulturuar. Kjo detyrë i bie, në radhë të parë, rinisë, se çdo gjë bëhet për rininë që ajo të rritet mirë, që të mos shohë luftë dhe gjakderdhje, uri dhe sëmundje. Prandaj edhe rinia duhet të jetë luftëtarja më e madhe për të renë përparimtare. Dhe faktet tregojnë se rinia jonë, e edukuar nga Partia, e ka marrë në duart e veta këtë flamur dhe me guxim e trimëri po ecën përpara.

Për këtë qëllim edhe në të ardhshmen ju duhet të mësoni, të mendoni dhe të punoni si revolucionarë dhe për këtë i keni të gjitha mundësitë. Partia mendon dhe punon për ju, ajo doli nga gjiri i popullit, ajo është pararoja e klasës punëtoare dhe e fshatarësisë, ajo mendon, punon dhe realizon gjithçka për popullin, vë në zbatim çdo gjë për interesat e popullit. Për këtë arsye Partia jonë është një Parti e vërtetë marksiste-leniniste, që e mbron marksizëm-leninizmin me konsekuencë dhe nuk lejon të shkelen parimet e tij nga kushdo

qoftë. Pa mbrojtur parimet marksiste-leniniste, do të kalbej puna jonë, do të kalbej Partia dhe po u kalb Partia, zhvillimi i vendit shkon prapa, zhduket socializmi, rikthehet kapitalizmi.

Shihni, shokë të rinj, se si ecën përpara vendi ynë. Me këtë nuk dua të them se te ne çdo gjë është shesh me lule. Nuk ka vend socialist në botë që të jetojë, të punojë e të luftojë në rrethim si vendi ynë. Por në rrethim ne kemi qenë që kur lindëm si Parti e si vend socialist dhe vazhdojmë të jemi të rrethuar, jo vetëm nga armiq të egër që kemi në kufi, por edhe nga armiq të tjerë që nuk i kemi në kufi. Me gjithë luftën e tërbuar që na bëjnë armiqtë, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe reaksionarët italianë, si edhe të gjithë imperialistët e veglat e tyre, kudo që janë, vendi ynë ecën përpara në çdo pikëpamje, forcohet mbrojtja e atdheut, zhvillohet me të shpejtë industria, ecën përpara bujqësia, arsimi dhe kultura. Kjo ndodh sepse, me gjithë vështirësitë dhe kushtet e rënda, Shqipëria përparon, sepse vija e përgjithshme e Partisë sonë është e drejtë, marksiste-leniniste, e palëkundshme.

Shumë vende të demokracisë popullore kanë pasur mundësi më të mëdha sesa ne për zhvillimin e tyre ekonomik dhe në fakt kanë një nivel më të lartë, por ato po ndeshen në plot vështirësi për furnizimin e masave punonjëse me gjithfarë prodhimesh. Vështirësi të kësaj natyre ne nuk kemi pasur, për arsye se vija e Partisë sonë ka qenë kurdoherë e drejtë, se udhëheqja e Partisë dhe e shtetit tonë edhe në situata të vështira, si ajo nikoqirja e mirë, ka ditur ta furnizojë si duhet popullin që të mos krijoheshin vështirësi ekonomike

dhe pakënaqësi. Është fakt se në krahasim me vitin e e kaluar, këtë vit është parë kudo një përparim dhe një mobilizim i jashtëzakonshëm.

Sivjet, edhe në fshat u tejkalua plani i mbjelljeve. Kurrë nuk kemi mbjellë grurë sa këtë vit dhe në saje të punës së lavdërueshme të fshatarësisë, gruri këtë vit paraqitet i mirë. Tani duhet të mobilizohen të gjitha forcat për mbjelljen e pambukut, të misrit dhe të duhanit si dhe për t'u bërë atyre të gjitha shërbimet.

Në industri mund të themi se të gjitha ndërmarrjet e vendit tonë e kanë tejkaluar planin e tremujorit të parë. Shihni, pra, ç'mobilizim të madh që ka, si në bujqësi ashtu edhe në industri. Po përse ndodh kjo? Sepse populli ka besim të madh te Partia e tij, ai e sheh që Partia ndjek një vijë të drejtë dhe është e lidhur shumë ngushtë me të, e sheh se ajo që thotë Partia vihet në jetë për të mirën e tij. Ai është i bindur se rruga e Partisë është e drejtë dhe punon me gjithë shpirt për të. Ndryshe ai do të ishte i pakënaqur, do të pëshpëriste, siç ndodh në disa vende të tjera, partitë e të cilave ndjekin një vijë revizioniste.

Pra, le të mobilizohemi, shokë të rinj, për të mirën e popullit, t'u themi edhe atyre që nuk na duan të mirën, armiqve tanë, ja si është populli shqiptar, i zgjuar, organizator i fortë si çeliku, që, edhe në kushtet më të vështira të rrethimit, është i zoti jo vetëm të shpartalloyë armiqtë, por edhe të realizojë planet në të gjithë sektorët.

Populli ka besim të madh te Partia dhe këtë ai e tregoi edhe gjatë ditëve të Kongresit IV të Partisë, që është një ngjarje historike me rëndësi të madhe për

vendin tonë. Ju duhet t'i studjoni me kujdesin më të madh materialet e këtij Kongresi dhe në bazë të tyre të ecni në punën tuaj, sepse vendimet e tij janë të lidhura me jetën e të ardhshmen e popullit tonë.

Në botë ka parti që nuk ecin në rrugë të drejtë, megjithëse quhen komuniste, por vetëm emrin mbajnë të tillë. Ndërsa Partia jonë është e pastër, me një vijë të qartë, e vendosur për çështjen e marksizëm-leninizmit dhe të popullit. Në partitë e tjera ka udhëheqës dhe rryma të rrezikshme revizioniste që maskohen, hiqen si marksiste dhe sulmojnë të gjitha ato parti, të cilat qëndrojnë në vijë të drejtë.

Por historia nuk ecën prapa. Ajo ka treguar se të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit në mos sot, nesër do të demaskohen. Sido që të bëjnë dhe me çfarëdo maske që të mbulohen, atyre marksizëm-leninizmi do t'ua çjerrë maskën, ata e kanë të humbur davanë. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë bëjnë veprime që nuk pajtohen me rrugën marksiste-leniniste të Partisë sonë. Partia jonë kujt do qoftë ia thotë në fytyrë të shtrembrën, i thotë se këto veprime nuk janë të drejta. Kështu duhet të veprojë çdo komunist i vërtetë. Kur dikush bën një veprim që nuk është në rrugë të drejtë, çdo komunist e ka për detyrë ta kritikojë. Kështu bën Partia jonë, kështu bën edhe organizata e rinisë kur ndonjë i ri gabon. Ajo ia thotë gabimin në sy dhe nuk e përkëdhel. Në këtë rast një njeri që ka logjikë, me parti ose pa parti, kur një shok i flet për të mirë, do t'i vërë gishtin kokës.

Qëndrimet e Partisë sonë kanë qenë kurdoherë marksiste-leniniste dhe janë shumë të paktë ata që nuk i pëlqejnë. Le të thonë sa të duan Hrushovi e

Toliati se klasa punëtore italiane do ta marrë pushtetin me rrugë paqësore, këto janë vetëm përralla. Në të gjitha vendet kapitaliste ka luftë klasash, atje punëtorët bëjnë greva, ndërsa pushteti i borgjezisë vret popullin. Prandaj, po nuk luftove feudalët dhe borgjezinë, pushteti nuk merret. Shefqet Vërlaci dhe Gjon Marka Gjoni nuk na e dhanë lirinë, por u duhej vënë zjarri kullave të tyre dhe u duhej dhënë plumbi ballit që ata të lëshonin pushtetin, ndryshe, me fjalë, ata nuk e dorëzonin. Pra rruga jonë është e drejtë. Komunizmi do të fitojë dhe, ata që punojnë me djallëzi, ata që mbulohen me maska, do të demaskohen. Dihet sa shumë maska përdorën Trocki, Buharini, Kamenievi, Zinovievi dhe të tjerë tradhtarë të komunizmit, por të gjitha këto plehra i pastroi fshesa e hekurt e Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit. Gjithashtu dihet sa shumë maska ka vënë Titoja, po të gjitha ato u çorrën.

Lenini dhe Stalini na kanë mësuar që të kemi një situatë të shëndoshë në Parti dhe në popull dhe të krijojmë në to një siguri për të ardhshmen e socializmit. Ka pasur udhëheqës të vendeve socialiste e të partive komuniste e punëtore që na kanë hedhur gurë, por masat e gjera të popujve e të komunistëve të këtyre vendeve, vetëm fjalë të mira kanë thënë për Partinë dhe për vendin tonë. Në disa vende socialiste udhëheqjet po i mbajnë në errësi të anëtarët e partisë, nuk u thonë realitetin. Kur komunistët dhe populli i këtyre vendeve gjejnë mundësinë dhe lexojnë, për shembull, materialet e Kongresit tonë, shprehen: «Ç'na thotë këstu udhëheqja jonë për udhëheqjen shqiptare?!».

Këta udhëheqës, pra, shpifin kundër Partisë sonë, por siç thotë një fjalë e urtë «gënjeshtër i ka këmbët të shkurtëra». Mund të gënjeshtër një-dy ose dhjetë njerëz dhe për një farë kohe, por kurrë nuk mund të gënjeshtër një popull të tërë dhe për një kohë të gjatë.

Perspektivat e zhvillimit të vendit tonë janë të shkëlqyera. Këtë pesëvjeçar ne do të bëjmë që bujqësia të ecë më përpara. Brenda pesëvjeçarit do të shohim një ndryshim të madh në bujqësi. Me një punë të vrullshme, me makineritë që kemi dhe me ato që do të sjellim, me ngritjen e dy uzinave të plehrave kimike, me shtimin e sipërfaqeve të ujitshme, bujqësia jonë do të dalë një herë e mirë nga prapambetja dhe do të arrijmë të marrim më shumë prodhime. Kjo do të sjellë gradualisht sigurimin e bukës në vend. Pra e ardhshmeja e bujqësisë është e madhe.

Në drejtim të industrisë, vendit tonë do t'i shtohen objekte të reja. Disa vepra, shumë të rëndësishme për ekonominë tonë, ka mundësi t'i ngremë që këtë pesëvjeçar. Republika Popullore e Kinës do të na ndihmojë për ngritjen e metalurgjisë së zezë. Këtë pesëvjeçar do të ndërtojmë uzinën e superfosfatit të Laçit, përveç një sërë fabrikash e uzinash të tjera si edhe një fabrikë shumë të madhe për prodhimin e çimentos. Pra, edhe nga pikëpamja industriale, vendi ynë do të ecë shumë përpara.

Tani punonjësve të fshatit, dhe sidomos skuadrave tuaja të punës socialiste, ju bie barra të furnizoni industrinë tonë me lëndë të parë bujqësore, kryesisht të prodhoni drithë, panxhar, pambuk, duhan dhe prodhime të tjera. Ne kemi ngritur dhe do ta zhvillojmë in-

dustrinë e drurit, por të keni kujdes në prerjen e pyjeve, të mbillni më shumë drurë pyjorë sesa të prisni. Veçanërisht rrethi i Pukës të bëhet një qendër e madhe e industrisë së drurit.

Edhe rrethi i Kukësit së shpejti do të bëhet një qendër e madhe minerare. Atje kemi gjetur bakër, hekur-nikel, atje nxjerrim krom. Kukësi, që më parë rriste vetëm bagëti, do të bëhet një qendër me rëndësi ekonomike. Ne shpresojmë që atje të zbulohen edhe pasuri të tjera. Të gjitha këto pasuri po i zbulojnë gjeologët dhe specialistët tanë nën udhëheqjen e Partisë. Të gjitha këto, që nga fabrikat, traktorët, farërat e zgjedhura do të bëhen pasuri e popullit, do të vihen në shërbim të tij. Kështu populli do të ketë më shumë ushqime, më shumë veshje të bukura, për të gjithë, por sidomos për fëmijët e të rejtat.

Pra, plani pesëvjeçar që kemi përpara, është një plan i madh dhe i ngjeshur. Prandaj duhet të punojmë me të gjitha forcat që ta realizojmë, duke bërë një punë të organizuar mirë, duke fituar betejat hap pas hapi. Domethënë, jo vetëm t'i punojmë tokat, por edhe t'i mbjellim e jo vetëm t'i mbjellim, por edhe të kujdesemi që të mbijnë bimët, t'u bëhen atyre shërbimet kulturore që të rriten e të zhvillohen, gjersa t'i korrin e t'i hedhim në depo. Në këtë mënyrë t'i përballojmë vështrësitë që do të na dalin.

Perspektiva e vendit tonë është e mirë dhe e bukur dhe populli ynë e sheh këtë perspektivë, prandaj është mobilizuar me të gjitha forcat në punë, në radhë të parë rinia dhe ju që jeni bërë shembull me skuadrat tuaja të punës socialiste.

Ju jeni organizuar në skuadrat e punës socialiste dhe keni vënë të gjitha forcat të plotësoni detyrat që kanë marrë përsipër këto, domethënë të punoni, të prodhoni, të mësoni dhe të silleni në mënyrë socialiste.

Sjellja në shoqëri ka rëndësi të madhe. Njerëzit kanë veçoritë e tyre të karakterit. Ka prej tyre që janë të butë, ka të tjerë që janë kurdoherë të qeshur, ka edhe zezvekë, ka të tillë që janë të thjeshtë e pranojnë këshillë e kritikë, por ka edhe nga ata që, një fjalë t'u thuash, u mbetet qejfi. Një njeri që është edukuar në mënyrë komuniste di si të sillet me njerëzit, si t'ua fitojë atyre zemrën, t'i korrigjojë. Po të jetë shoku gjaknxehtë, ai duhet të flasë i qetë me të, që t'i ulë gjaknxehtësinë, se po të bëhet edhe ky gjaknxehtë e të shkojnë majë më majë, kush fiton atëherë? Në rast se të duhet të sqarosh diçka me një njeri nevrik, për shembull, me përgjegjësën ose me drejtorin, lëre në atë kohë dhe kthehu bisedo me të kur ai është me nerva të qeta. Njeriu bëhet nevrik në disa rrethana të caktuara. Një njeri i logjikshëm, që i ka të qarta rrethanat, duhet të përpiqet të gjejë shkakun përse u bë nevrik ai tjetri. Si të vrasë mendjen dhe të gjejë arsyet e vërteta, atëherë i merr krahët çështjes, ia shpjegon qetë e me durim dhe do të shohësh që do t'i kalojë nervozizmi e nuk do të jetë më arrogant.

Të gjitha këto kanë rëndësi të madhe se komunisti duhet të jetë njeri i përsosur. Por edhe komunistët nuk janë pa të meta dhe pa huqe. Partia të gjithëve përpiqet të na ndreqë dhe të na edukojë. Edhe skuadrat e punës socialiste këtë rol të madh kanë për edukimin e sjelljen e njerëzve në shoqëri dhe në familje ndaj prindërve.

T'i doni dhe t'i respektoni prindërit. Tani shumica e tyre e kuptojnë, për shembull, se është e domosdoshme që ju të shkoni në mbledhje, por më parë shumë prej tyre kishin frikë për vajzat, sepse, në kohën kur janë rritur ata, vendi ishte shumë i prapambetur, gratë ishin si skllave, ato nuk mund t'u qëndronin burrave karshi, të thoshin mendimet e tyre, kur burrat kryenin ndonjë veprim të padrejtë. Por vajza jonë u ngrit, mësoi në shkollë dhe doli në punë. Prandaj ajo e shikon ndryshe jetën dhe, po të ndodhë që dikush të bëjë ndonjë gjest jo të mirë kundër saj, ajo e vë në vend. Domethënë, gruaja sot te ne përpiqet të punojë dhe të jetojë në mënyrë socialiste, sepse ajo i kupton më mirë çështjet sesa mund t'i kuptonin në të kaluarën gratë e vendit tonë.

Tani ne kemi arritur në një kohë të lavdishme. Rinia jonë, e edukuar dhe e frymëzuar nga Partia punon, mëson dhe ecën përpara. Skuadrat e punës socialiste organizojnë edhe mjaft aktivitete interesante për edukimin dhe për dëfrimin e anëtarëve të tyre. Te ne ka akoma pleq konservatorë, por në përgjithësi, sot, të kaluarit nga moshë nuk thonë më se këto, që bënë rinia, janë punë kalamajsh, por thonë që të rinjtë tanë janë luanë, sepse shohin me vepra ç'ka bërë dhe ç'po bënë rinia dhe, me të drejtë, ata kanë tani një respekt të madh për të. Kjo është një fitore e madhe. Prandaj ta shfrytëzojmë këtë fitore dhe të bëjmë që edhe të kaluarit nga moshë të ecin përpara me shembullin e punës së organizuar mirë dhe të edukatës suaj socialiste. Kjo ka rëndësi të madhe.

Të kini parasysh që pikëpamjet e vjetra të disa

prindërve, që pengojnë aktivitetet tuaja, t'i rrëzoni me takt, t'i bindni me durim. Kjo është një nga kushtet më të rëndësishme të edukatës komuniste. Disa të moshuar mund të ngulin këmbë për një çështje, po si, të zihemi ne tani! Jo, në asnjë mënyrë, të mos zihemi, po të bisedojmë dhe t'i bindim, në mos plotësisht sot për sot, të paktën pjesërisht, se fitim e kemi.

Por bindja e njerëzve nuk bëhet as me receta as edhe me një ilaç të mjekut që të jep një aspirinë dhe të shkon koka. Një vajzë, për shembull, që e pengon babai të vejë në mbledhje, duhet të punojë me të, t'i lexojë diçka nga ndonjë libër ose gazetë, t'i flasë për Partinë, për sukseset e vendit tonë, për ç'gjëra flitet në mbledhje. Këto biseda të hapura me siguri do t'i dobësojnë kundërshtimet e atyre që nuk i lënë vajzat të venë në mbledhje, sepse do të binden e do të mendojnë se vajzën e kam punëtore, të zgjuar, të fortë dhe të ndershme, prandaj le të vejë ku të dojë se di si të mbrohët, se, kur është në rrugë të drejtë, ka mbrojtje të fortë Partinë.

Komiteti Qendror i Partisë është shumë i entuziazmuar për punën që keni bërë dhe po bëni ju, të rinjtë e skuadrave të punës socialiste, veçanërisht në fshat. Mos u dëshpëroni në rast se sot lëvizja e skuadrave të punës socialiste në bujqësi nuk është në atë nivel që është në qendrat e punës. Do të vijë koha që edhe ju ta arrini atë nivel. Pas 3, 4 ose 5 vjetësh kjo do të ndodhë me siguri dhe ne do të shikojmë një ndryshim të madh në këtë drejtim. Ja, tani ne mburremi me punonjësit e industrisë sonë. Po kush janë këta njerëz? Ata janë punëtorët tanë të lavdishëm, që kanë ardhur nga

fshati, djem dhe vajza fshatarësh që u futën në fabrika 10-12 vjet më parë dhe atje morën vrullin dhe edukatën e klasës sonë punëtore dhe sot luftojnë si njerëz të kalitur, sikur të kishin tradita prej dhjetëra vjetësh.

Punëtorët tanë kanë tradita revolucionare, por këto tradita i ka edhe fshatarësia jonë. Prandaj, ka qenë një punë më e lehtë për punëtorët tanë të rinj, të ardhur nga fshati, që të krijonin këto tradita revolucionare. Unë jam i bindur se edhe me skuadrat tuaja do të bëhet një punë e madhe në bujqësi dhe kjo do të sjellë një ndryshim të madh në punën dhe në edukimin e njerëzve. Ju sot jeni pionierët e kësaj lëvizjeje në fshatrat tuaja, por nesër kjo lëvizje do të bëhet masive. Kur t'ju pyesin shokët dhe shoqet e reja se të ç'kohe jeni, ju do t'u thoni se jemi pjesëmarrësit e parë të skuadrave të punës socialiste në fshat, që u krijuan në vitin 1960.

Natyrisht, Partia do t'ju ndihmojë, por për ju duhet të tregojë shumë kujdes organizata e Bashkimit të Rinisë. Ju nuk duhet të mërzhiteni që në fshat nuk i keni këto gjëra që shihni këtu në qytet. Sigurisht qyteti është më përpara, këtu ka kinema, teatro, opera, muzeume, parqe etj. Por ju në mënyrë të organizuar nga organizata e rinisë të vini herë pas herë në qytet dhe t'i vizitoni këto qendra kulturore që s'i keni në fshat.

Pa dyshim, Partia punon dhe organizata e rinisë nën udhëheqjen e saj duhet t'ju drejtojë edhe në punë të tilla që çojnë drejt zhdukjes së ndryshimeve thelbësore në mes qytetit dhe fshatit. Sigurisht kjo gjë nuk arrihet menjëherë. Janë dashur disa vjet që të arrihen këto ndryshime që janë bërë në fshatin tonë. Në fshat tani ka kënde të kuq, grupe artistike, vatra ose shtëpi

kulture, elektrik, radio etj., dhe këto nga viti në vit do të shtohen. Por këto bëhen vetëm duke shtuar të ardhurat, pra, duke rritur prodhimin, dhe kjo arrihet me punë.

Këto ndryshime nuk mund të bëhen as me dy as me pesë vjet. Duhet të kalojnë disa pesëvjeçarë, që fshati ynë të marrë pamjen e një qyteti të vogël. Vetëm duhet të kemi dashuri të madhe për fshatin, të lidhemi më shumë me të. Këtë dua ta theksoj se ka disa që e kanë mendjen në qytet. Qyteti do njerëz dhe tërheq nga fshati aq sa ka nevojë, aq sa parashikojnë planet tona. Tani, fshati ynë socialist, sapo vete lulëzon, bujqësia e blegtoaria përparojnë çdo ditë. Mirëqenia, shkolla, radioja, rrugët automobilistike, rrjeti i tregtisë socialiste do të shtohen çdo vit. Prandaj, detyra jonë është që ne, me mendjen dhe me punën tonë, ta zbukurojmë çdo ditë e më shumë fshatin. Çdo gjë në këtë drejtim bëhet me dashuri dhe preokupacion të vazhdueshëm. Njeriu ka dashuri dhe merak për shtëpinë e vet, prandaj e zbukuron atë përditë, herë bën një dollap, herë një tryezë, mbjell lule etj. me qëllim që pas punës të ketë një ambient të këndshëm për t'u çlodhur. Kështu duhet vepruar edhe për fshatin, për të cilin dashuria dhe merak duhet të jenë të vazhdueshëm, sepse është një detyrë që lidhet me të ardhshmen — socializmin e komunizmin.

Duke përfunduar, ju uroj nga zemra suksese sa më të mëdha në veprimtarinë tuaj si skuadra të punës socialiste në bujqësi. Ju jeni nga njerëzit e pararojës e nga më të dalluarit në bujqësinë tonë. Prandaj ju bie barra t'i shtoni skuadrat tuaja me njerëz të rinj e të

krijoni edhe skuadra të tjera, të cilat të aktivizohen në punë për të realizuar kështu të gjitha kushtet që të meritojnë titullin «Skuadër e Punës Socialiste në bujqësi». Partia ka besim të plotë se ju do t'i kryeni me nder detyrat që keni marrë përsipër në lëvizjen tuaj të lavdishme.

Edhe një herë ju uroj nga zemra jetë të lumtur e të gëzuar, punë të mbarë dhe të frytshme dhe të mbushni hambarët e kooperativës plot me prodhime!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISA DETYRA QË DUHEN PLOTËSUAR MË MIRË NË SEKTORIN E NAFTËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 prill 1961

Shokët punëtorë dhe drejtues të naftës bëjnë përpjekje, planin e realizojnë dhe marrin inisiativa siç janë ato për kursimet, për zbatimin e metodave të reja, për zbulimin dhe për nxjerrjen e naftës etj. Këto janë anë pozitive që duhen inkurajuar. Por megjithatë duhen plotësuar edhe disa detyra të tjera, që janë shumë të rëndësishme.

Në Patos duhet të përfundojë çështja e ngrohjes së shtresave me anë të energjisë elektrike. Kjo është e lidhur me çështjen e prodhimit, kurse studimi, që është duke u bërë përsa i përket djegies së shtresave, të vazhdohet, sepse është një ndërmarrje shumë e mirë,

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit mbi realizimin e planit të tremujorit të parë të vitit 1961 dhe mbi disa probleme që dalin në industrinë e naftës.

prandaj të bëhet puna deri në fund, pastaj do të vendosim, sepse edhe kjo është e lidhur me prodhimin.

Një problem tjetër i përhershëm është ai i shfrytëzimit të puseve, që janë lënë në heshtje dhe nuk janë skartuar. Kjo çështje duhet të merret më seriozisht se deri tani, të bëhet një plan për ripërtëritjen e tyre dhe të kemi rezultat më të dukshëm në këtë drejtim.

Mendimi që u shfaq për ndërtimin e një ofiçine bazë për riparimin e makinave dhe të agregateve të naftës, është i drejtë. Kjo ka mundësi të bëhet, sepse atje kemi shumë kuadro të lartë. Ja, një kuadër i mesëm në Lushnjë ka bërë gjëra interesante. Prandaj t'i futemi kësaj çështjeje, sepse do të jetë një fitore e madhe. Si të studjohet mirë ky problem, të caktohen edhe afatet, me qëllim që të mos mbetet vetëm një dëshirë, po të zbatohet.

Çështjen e kursimeve, ju, shokë të naftës, përpuni ta zgjeroni, sidomos në zërat e importit, si tubacionet, makinat etj. Krijoni ekipe të veçanta për nxjerrjen e tubacioneve dhe caktoni edhe përqindjet në këtë drejtim. Nga ana e organeve të tregtisë së jashtme duhen bërë përpjekje më shumë se përpara për zbatimin e planeve të importit. Të punohet që të zbatohen marrëveshjet me klering dhe të vijnë sa më parë materialet, kështu edhe ato që janë parashikuar me kredi, po të mos na jepen, atëherë duhet menduar për të marrë masa të tjera.

Për rërën bituminoze sa të jetë e mundur të shpejtohet puna, sepse bitumi na kërkohet nga të katër anët. Po të nxjerrim bitum edhe nga rëra bituminoze, do të

kemi të ardhura të mëdha. Prandaj të ngrihet sa më parë impianti eksperimental dhe ai të kthchet shpejt në qendër industriale.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Sekre-
taratit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 20-të

V—IX

1961

- ÇDO LËSIIM NË PARIME ÇON NË DEGJENERIMIN
E PARTISË E TË DIKTATURËS SË PROLETARIATIT
— Nga fjala e mbylljes në Konferencën VIII të organi-
zatës së Partisë të kryeqytetit (6 janar 1961) 1—26
- PRESIONI I HAPËT POLITIK DHE EKONOMIK I
REVIZIONISTËVE SOVJETIKË DO TË DËSHTOJË
PARA VENDOSMËRISË DIHE VULLNETIT TË HE-
KURT TË POPULLIT E TË KOMUNISTËVE SHQIP-
TARË — Letër dërguar KQ të PK të BS (14 janar 1961) 27—33
- LETËR PËRGËZIMI DREJTUAR NAFTËTARËVE
DHE EFEKTIVIT TË REPARTEVE TË AVIACIONIT
(7 shkurt 1961) 34—35
- PARTIA JONË ËSHTË EDUKUAR TË MBROJË ATA
QË KANË TË DREJTË DHE TË KRITIKOJË ATA
QË S'KANË TË DREJTË — Bisedë me delegacionin e
Partisë Komuniste të Kinës që kishte ardhur për të
marrë pjesë në Kongresin IV të PPSH (9 shkurt 1961) 36—58

NE JEMI NJË PARTI E VOGËL, POR KEMI TË DREJTË TË THEMI HAPUR PIKËPAMJEN TONË — Nga biseda me delegacionin e Partisë së Punës të Koresë që kishte ardhur për të marrë pjesë në Kongresin IV të PPSH (10 shkurt 1961)	59—68
NE NUK I HAMË FJALËT, VEÇANËRISHT KUR ËSHTË ÇËSHTJA PËR TË MBROJTUR MARKSIZËM-LENINIZMIN, VENDIN DHE PARTINË TONË — Nga biseda me delegacionin e Partisë së Punonjësve të Vietnamit që kishte ardhur për të marrë pjesë në Kongresin IV të PPSH (12 shkurt 1961)	69—78
RAPORT NË KONGRESIN IV TË PPSH «MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË» (13 shkurt 1961)	79—202

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË	83—119
---	--------

II

REZULTATET E NDËRTIMIT SOCIALIST NË VENDIN TONË	119—157
A. — NDËRTIMI ME SUKSES I BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT	120—128
B. — PLANI I DYTË PESHËVJEÇAR — HAP I RËNDËSISHËM NË ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË EKONOMISË E TË KULTURËS SONË	128—157

1) DETYRAT QË IU SHTRUAN INDUSTRISE, NDERTIMIT DHE TRANSPORTIT U PLOTESUAN PARA AFATIT ..	131
2) KOLEKTIVIZIMI I BUJQESISE ËSHTË SUKSESI ME I MADH I PARTISË NË FSHAT	138
3) NGRITJA E MIREQENIES MATERIALE TE MASAVE PUNONJESE	145
4) REVOLUCIONI KULTUROR ZHVILLOHET ME SUKSES NË VENDIN TONË	149

III

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I VENDIT TONË NË RRUGËN E NDËRTIMIT SOCIALIST	158—225
---	---------

1) VAZHDIMI I INDUSTRIALIZIMIT SOCIALIST TE VENDIT – HALLKË VENDIMTARE PER ZHVILLIMIN E BAZES MATERIALO-TEKNIKE TE SOCIALIZMIT	162
2) ZHVILLIMI I METEJSHEM I BUJQESISE GJATE PESEVJEÇARIT TË TRETË	180
3) DETYRAT E PESEVJEÇARIT TË TRETË PER MIREQENIEN MATERIALE TE MASAVE PUNONJESE	205
4) PREGATITJA E KUADRIT DHE ZHVILLIMI I ARSIMIT, I KULTURES E I SHKENCAVE NE PESEVJEÇARIN E ARDHSHEM	209

IV

MBI DISA PROBLEME TË FORCIMIT TË PARTISË	226—261
--	---------

1) PERBERJA E PARTISË – TREGUES I RENDESISHEM I FORCES SE SAJ	228
---	-----

2) PROBLEMI KRYESOR SOT NE ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TE PARTISE ËSHTË FORCIMI I ROLIT DHE NGRIJTJA E NIVELIT TE PUNËS SË ORGANIZATAVE-BAZË TE PARTISE	232
3) TE PËRMIRESOJME EDHE ME SHUME METODEN E PUNËS SË KOMITETEVE TE PARTISE	236
4) TE RRRITIM KUJDESHIN E ORGANEVE DHE TE ORGANIZATAVE TE PARTISE, SI EDHE TE ORGANEVE SHËTERORE, PER EDUKIMIN E KUADROVE TE RINJ ..	241
5) TE FORCOJME PUNËN E PARTISE PER RRRITJEN E METEJSHME TE ROLIT TE ORGANIZATAVE TE MASAVE.	248
6) FORCIMI I METEJSHËM I PUSHTETIT POPULLOR KUSHT I DOMOSDOSHËM PER REALIZIMIN ME SUKSES TE TE GJITHA DETYRAVE QË QENDROJNË PARA NESH	254

V

LUFTA NË FRONTIN IDEOLOGJIK DHE DETYRAT E PARTISË 261—292

1) PUNA IDEOPOLITIKE E PARTISE DUHET T'U PERGJIGJET DETYRAVE TE NDERTIMIT SOCIALIST TE VENDIT, T'I SHERBEJE EDUKIMIT KOMUNIST TE PUNONJESVE.	265
2) TE FORCOHET PUNA PER PROPAGANDIMIN E PARIMEVE THEMELORE TE MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE LUFTA PER RUAJTJEN E PASTËRTISE SË TIJ	271

- LAVDI NË SHIEKUJ GJERGJ DIMITROVIT! — Fjala e ndërhyrjes me rastin e dorëzimit si dhuratë të bustit të Gjergj Dimitrovit (15 shkurt 1961) 293—294
- TË ZGJEDHIM NJË UDHËHEQJE TË ÇELIKTË, ASHTU SIÇ IA DO ZEMRA PARTISË — Fjala në emër të përfaqësisë në Kongresin IV të PPSH (20 shkurt 1961) 295—299
- NE KEMI PËRGJEGJËSI TË DYFISHTË, TË RËNDË POR TË LAVDISHME: SI ANËTARË PARTIE DHE SI UDHËHEQËS — Fjala në Plenumin I të KQ të PPSH të zgjedhur në Kongresin IV të PPSH (20 shkurt 1961) 300—303
- TË SHPIEM NË ORGANIZATAT-BAZË DHE NË POPULL FRYMËN LUFTARAKE TË KONGRESIT IV — Fjala e mbylljes në Kongresin IV të PPSH (20 shkurt 1961) 304—311
- SHPIFJET DHE PRESIONET NUK NA FRIKËSOJNË — NE NUK GJUNJËZOHEMI — Nga biseda me delegacionin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që mori pjesë në Kongresin IV të PPSH (20 shkurt 1961) 312—331
- VETËM QËNDRIMET TONA TË VENDOSURA KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT MODERN DO TË BËJNË QË T'U HAPEN SYTË ATYRE QË U JANË ERRËSUAR — Nga biseda me delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës që mori pjesë në Kongresin IV të PPSH (25 shkurt 1961) 332—356
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR PARTISË KOMUNISTE TË ZELANDËS SË RE ME RASTIN E 40-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ (28 shkurt 1961) 357—358
- MESAZH PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR UILLIAM FOSTERIT KRYETAR NDERI I PK TË SHBA

ME RASTIN E 80-VJETORIT TË DITËLINDJES (28 shkurt 1961)	359—360
NGA BISEDA ME AMBASADORIN SOVJETIK NË RPSH (20 mars 1961)	361—363
TË KALITIM KURDOHERË KUADROT E MINISTRI- SË SË PUNËVE TË BRENDSHME — Diskutim në mble- dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 mars 1961)	364—365
TË ORGANIZOJMË MË MIRË NDIHMËN E SHIPEJTË MJEKËSORE NË BAZË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 mars 1961)	366—367
RADIOGRAM DELEGACIONIT SHQIPTAR NË MBLEDHJEN E KOMITETIT POLITIK KONSULTA- TIV TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS (28 mars 1961)	368—369
DIREKTIVAT QË DHA KONGRESI TË ZBËRTHE- HEN ME KUJDES — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 mars 1961)	370—373
TË NDIHMOJMË MË SHUMË ME KREDI ZONAT E THELLA MALORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 mars 1961)	374—376
EDHE PA BAZËN E VLORËS NE DO TË LUFTOJMË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (1 prill 1961)	377—385
ANIJE LUFTARAKE TË FLOTËS VI AMERIKANE NË PORTET JUGOSLLAVE (8 prill 1961)	386—390
SKUADRAT E PUNËS SOCIALISTE NË FSHAT TË	

-
- JENË SHEMBULL NË PUNË E NË SHKOLLË —
Fjala me një grup të rinjsh dhe të rejash (12 prill 1961) 391—409
- DISA DETYRA QË DUHEN PLOTËSUAR MË MIRË
NË SEKTORIN E NAFTËS — Diskutim në mbledhjen
e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 prill 1961) 410—412